



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 110

Tiranë – E hënë, 8 gusht 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 21.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2021..... 13459
Rezolutë e Kuvendit datë 21.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2021..... 13460
Rezolutë e Kuvendit datë 21.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2021..... 13462
Rezolutë e Kuvendit datë 21.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2021.. 13463
Rezolutë e Kuvendit datë 21.7.2022	Mbi pabazueshmërinë e pretendimeve për trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe Shqipëri..... 13464
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 11, datë 29.7.2022	Për disa shtesa në ligjin nr. 8926, datë 22.7.2002, “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre” 13467
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 29.7.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar..... 13468
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 496, datë 27.7.2022	Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si autoritet kontraktor për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për zbatimin e projektit të oborrit të Kryeministrit..... 13479
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 497, datë 27.7.2022	Për krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin..... 13480

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 27.7.2022	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), Njësia Administrative Laç dhe Mamurras, Bashkia Kurbin, dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese.....	13482
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 27.7.2022	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të një objekti arsimor në Bashkinë Vorë dhe caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese.....	13483
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 501, datë 27.7.2022	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), Bashkia Kurbin, dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese.....	13483
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 27.7.2022	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), Bashkia Kurbin, dhe caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese.....	13484
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 27.7.2022	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak.....	13484
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 27.7.2022	Për kalimin te fondi shqiptar i zhvillimit dhe bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë dhe Krujë të njësive të banimit, të shërbimit, të ndërtimit nën tokë dhe njësive teknike në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë dhe Krujë.....	13485
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 506, datë 27.7.2022	Për kalimin te bashkitë Tiranë dhe Durrës të objekteve arsimore.....	13512
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 507, datë 27.7.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 597, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”	13513
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 27.7.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 72, datë 2.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për vitin 2022”	13513
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 27.7.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Projektimi i shkollës së biçikletave për grup-moshat 7–10 vjeç, Tiranë”	13515
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 27.7.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.....	13516

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 27.7.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 514, datë 18.9.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos – Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese”	13519
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 517, datë 29.7.2022	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.....	13519
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 29.7.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 81, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”	13520
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 29.7.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 111, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”	13521
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 29.7.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar.....	13522
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 521, datë 29.7.2022	Për lirim nga detyra.....	13522
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 523, datë 29.7.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimit e modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje”	13522
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 528, datë 29.7.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e ceremonialit shtetëror në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	13523
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 29.7.2022	Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit.....	13523
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 533, datë 29.7.2022	Për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Masave për Importet.....	13529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 29.7.2022	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të detajuara për ngrirjen e përkohshme të fondeve apo të pasurive të tjera të personave ose enteve të shpallura nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo organizatat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.....	13529

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 29.7.2022	Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushtet e veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2022.....	13531
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 541, datë 29.7.2022	Për kriteret e përzgjedhjes të anëtarëve, si dhe për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.....	13532
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 29.7.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 179, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’, dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, ‘Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore’”	13534
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 543, datë 29.7.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 315, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për markat”	13534
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 546, datë 29.7.2022	Për lirin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore për Shpronësim.....	13535
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 29.7.2022	Për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit të mesëm të lartë “ <i>British School of Tirana</i> ”, ku mësimi zhvillohet në gjuhën angleze.....	13535
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 552, datë 29.7.2022	Për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit bazë “Rruga e Dijes”, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare.....	13536
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 553, datë 29.7.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, të ndryshuar.....	13536
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 29.7.2022	Për organizimin e veprimtarisë së dhurimit vullnetar të gjakut nga punonjësit/nëpunësit e administratës shtetërore.....	13537
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 556, datë 29.7.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve, që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022”, të ndryshuar.....	13537
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 558, datë 29.7.2022	Për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare në fondin pyjor kombëtar.....	13538
Udhëzimi i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 16, datë 20.7.2022	Për rregullat dhe procedurat për lëshimin e dokumentit të identifikimit të detarit (pasaportë detari), për shtetasit e huaj/pa shtetësi, për qëllime peshkimi, në Republikën e Shqipërisë.....	13539

Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Brendshëm nr. 17, datë 20.6.2022	Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore.....	13541
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 143, datë 18.7.2022	Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë.....	13567
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 157, datë 1.8.2022	Për miratimin e planit vjetor minerar 2022.....	13602
Urdhër i Ministrisë së Drejtësisë nr. 223, datë 26.7.2022	Për delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm.....	13611
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 391, datë 1.8.2022	Për delegim kompetence.....	13611
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 392, datë 1.8.2022	Për delegim kompetence.....	13611
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 437, datë 20.7.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.....	13612
Vendim i Bordi të Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Produkteve Ushqimore Bazë dhe Produkteve të Tjera të Lidhura me To nr. 6, datë 10.6.2022	Për miratimin e marzheve në bazë të monitorimit të çmimeve për produktet ushqimore bazë dhe produktet e tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”	13613
Vendim i Bordi të Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Produkteve Ushqimore Bazë dhe Produkteve të Tjera të Lidhura me To nr. 7, datë 27.6.2022	Për miratimin e marzheve në bazë të monitorimit të çmimeve për produktet ushqimore bazë dhe produktet e tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg.....	13615
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 166, datë 28.6.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, me fuqi të instaluar deri 2 mw, për vitin 2022.....	13616
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 167, datë 28.6.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	13618
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 168, datë 28.6.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	13619

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 169, datë 28.6.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	13620
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 170, datë 28.6.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	13622
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 171, datë 28.6.2022	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut, që kontrollon interesat e shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k.....	13624
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 173, datë 7.7.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2022.....	13625
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 174, datë 7.7.2022	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “ <i>Supply and instalation of transmission meter/ data center</i> ” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.....	13626
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 175, datë 7.7.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “M&K Energy Trading Co” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	13627
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 176, datë 7.7.2022	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.6.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Blac Energy’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”.....	13628
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 132/8, datë 25.7.2022	Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV, Burrel–Bulqizë”.....	13630
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 228/6, datë 25.7.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV Valias”.....	13632
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 280(1630), datë 27.4.2022	Për kufizimin e zotësisë për të vepruar të shtetasës Kristina Llazo Zhulati, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e shoqatës “Opera della Divina Provvidenza Madonnina del Grappa”.....	13632
	Kërkesë për shpalljen e vdekjes së shtetasit Mazar Pustina.....	13632
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Halil Zhegu.....	13632



**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË
SHTETIT PËR VITIN 2021**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit në përmbushje të misionit të tij për dhënien e informacionit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik, transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar;

Duke konsideruar se veprimtaria e Autoritetit është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medies në kohë dhe me cilësi;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e Autoritetit me institucione të tjera vendëse dhe institucione homologe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Autoritetit,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2021, në drejtim të:

Nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me qëllim përcaktimin e kontributit të secilës palë dhe bashkërendimin e veprimtarisë midis institucioneve për të garantuar realizimin e një procesi të rregullt ligjor, në funksion të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit.

Përshtetëzimit të veprimtarisë së Autoritetit me zhvillimin e tryezave ndërinstitucionale në lidhje me hartimin e akteve nënligjore që do të përcaktojnë autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara.

Intensifikimit të marrëdhënieve me institucionet homologe të vendeve ish-komuniste si një mënyrë efektive për t'u njohur dhe përfituar nga përvoja e tyre në përmbushjen e misionit të Autoritetit.

Pranimin të Autoritetit si anëtar me të drejta të plota në Rrjetin Evropian të Arkivave të ish-Policive Sekrete.

Finalizimit të “Udhërrëfyesit për të drejtat e familjarëve të të zhdukurve të komunizmit” dhe shpërndarjes së tij gjerësisht gjatë takimeve në

qytete të ndryshme të vendit të zhvilluara në kuadër të edukimit qytetar.

Kuvendi kërkon që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2022 të angazhohet në këto drejtime:

Të vijojë angazhimin për hartimin e draftit të aktit nënligjor, i cili do të përcaktojë autoritetet përgjegjëse dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara duke dhënë kontribut në përcaktimin e detyrave të AIDSSH-së në këtë proces, por edhe më gjerë, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore qendrore dhe vendore.

Të vijojë përpjekjet për dorëzimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme, në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me autoritetet publike dhe arkivat për zbatimin e detyrimeve ligjore.

Të intensifikojë bashkëpunimet me institucionet qeveritare për qartësimin e fatit të të zhdukurve në komunizëm, në komunikimin me familjet, grupet e interesit, pushtetin lokal, organizatat ndërkombëtare.

Të bëjë funksional sistemin e arkivit digjital për lehtësim të procesit të kërkimit dhe konsultimit me dokumentet arkivore sipas standardeve ndërkombëtare.

Të bashkëpunojë ngushtë me ISKK-në sa i takon shfrytëzimit të dokumentacionit arkivor sipas parashikimeve ligjore, me qëllim garantimin e mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve nga ana e studiuesve duke mbështetur kërkimin shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit.

Të intensifikojë bashkëpunimin me institucione homologe të huaja, me qëllim përthithjen e eksperiencave më të mira nga veprimtaria e tyre.

Të intensifikojë punën për deklasifikimin e dosjeve, duke përjashtuar ato që cenojnë sigurinë kombëtare dhe të vijojë me digjitalizimin e tyre.

Të publikojë në faqen zyrtare *online* të Autoritetit, për aq sa lejohet nga kuadri ligjor, listën e individëve që kanë rezultuar si bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit dhe që janë pjesë e administratës publike.

Miraturar në datën 21.7.2022.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**



**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
INSPEKTORATIT TË LARTË
TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT
TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT
TË INTERESAVE PËR VITIN 2021**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke besuar në objektivat dhe përpjekjet e vendit tonë për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, si kusht dhe detyrim thelbësor në kuadër të procesit të integritetit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

Duke theksuar rëndësinë e koordinimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese në vend dhe institucioneve të pavarura për rritjen e efikasitetit të hetimeve penale apo administrative, si dhe ndëshkimin e praktikave korruptive, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete dhe të prekshme në parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit;

Duke vlerësuar gjetjet në raportin për Shqipërinë për vitin 2021 të Komisionit Evropian, në lidhje me progresin e shënuar nga Inspektorati, si dhe mbështetjen e vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për përmbushjen e objektivave prioritarë të institucionit;

Duke inkurajuar e mbështetur Inspektoratin me forcimin e kapaciteteve administrative, teknike, financiare dhe të instrumenteve ligjore, me qëllim përmbushjen e misionit institucional për zbulimin e pasurimit korruptiv dhe praktikave të ngjashme me të, në parandalimin e konfliktit të interesave për të gjitha kategoritë e zyrtarëve, subjekteve të ligjit dhe personave të lidhur, si dhe inkurajimin për denoncimin e tyre,

Vlerëson veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2021, në drejtim të:

Progresit të shënuar në funksionimin tërësor institucional dhe në veçanti në përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2020”.

Angazhimit në përputhje me rekomandimet e progresraportit të KE-së dhe GRECO-s për përfundimin dhe vënien në funksion të plotë

brenda vitit 2021 të sistemit elektronik të interesave privatë, hartimin dhe miratimin e akteve të nevojshme nënligjore për formularët e deklarimit dhe mënyrën e plotësimit të tyre, si dhe organizimin e disa sesioneve trajnuese për këtë qëllim në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, ku janë trajnuar më shumë se 280 pjesëmarrës.

Zbulimit të rasteve të fshehjeve të pasurisë, si dhe shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave privatë, duke administruar një numër total prej 4032 deklaratash e interesave privatë, duke kaluar në kontroll të plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë 802 subjekte deklaruese, duke ndëshkuar me masën administrative “gjobë” për rastet e refuzimeve për deklarim, rastet e mosdeklarimeve dhe rastet e konfliktit të interesit 130 zyrtarë, si dhe duke paraqitur pranë prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policisë së Shtetit dhe strukturave të hetimit tatimor 16 raste referimesh penale.

Mbështetjes së procesit reformues të sistemit të drejtësisë, me fokus të veçantë forcimin e bashkëpunimit me organet e rivlerësimit dhe ONM-në nëpërmjet trajtimit me përparësi të 155 kërkesave të ardhura nga këto institucione, si dhe në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, nga Inspektorati është ushtruar kontroll i plotë për 312 kandidatë në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë.

Administrimit dhe analizimit të 520 raportimeve të dërguara nga njësitë përgjegjëse të ngritura në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, nga të cilat 199 i përkasin sektorit publik dhe 321 sektorit privat, si dhe përditësimit të të dhënave të regjistrave kombëtarë të këtyre njësive.

Monitorimit të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm të zbatimit të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në bashkëpunim intensiv me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Departamentin e Administratës Publike dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Regjistrimit dhe trajtimit në zbatim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm



raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja të 11 rasteve të sinjalizimit dhe 1 kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja.

Rritjes së kapaciteteve të njërive përgjegjëse të ngritura në sektorin publik dhe privat, në kuadër të zbatimit të ligjit për sinjalizimin nëpërmjet organizimit të disa sesioneve trajnuese në bashkëpunim me prezencën e OSBE-së në Shqipëri gjatë periudhës 24 qershor–2 korrik 2021, në të cilat u trajnuan 220 anëtarë të njërive përgjegjëse.

Nënshkrimi të Memorandumit të Bashkëpunimit me Agjencinë e Prokurimit Publik, në funksion të rritjes së integritetit të zyrtarëve publikë në prokurime dhe ndërgjegjësimin e tyre për zhvillimin e procedurave në mënyrë të pavarur.

Intensifikimi të trajnimeve për stafin e Inspektoratit nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnimet e organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme për veprat penale në fushën e pastrimit të parave, si dhe trajnimet e organizuara në bashkëpunim me Këshillin e Evropës apo GIZ-in mbi praktikën më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e konfliktit të interesit apo parandalimit të pastrimit të parave.

Ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët e shoqërinë civile, si dhe forcimin e bashkëpunimit me medien investigative në veçanti, duke trajtuar me përparësi, korrektësi dhe brenda afateve ligjore kërkesat e publikut, në lidhje me publikimin e deklaratave të interesave privatë.

Kuvendi kërkon që Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2022 të vazhdojë punën, në këto drejtime:

1. Të ketë prioritet të punës verifikimin e kandidatëve në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë.

2. Të marrë të gjitha masat institucionale për funksionimin e plotë të sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, me fokus rritjen e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse për plotësimin e deklarimeve nga subjektet e ligjit në mënyrë të saktë.

3. Të intensifikojë bashkëpunimin ndërinstitucional me Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit, si dhe organet ligjzbatuese, në veçanti me SPAK-un, për të përmirësuar në mënyrë të efektshme ndjekjen e hetimeve administrative ose penale në drejtim të interesave

privatë të deklaruar nga zyrtarët, të cilët janë subjekt i ligjit për deklarimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave.

4. Të adresojë në mënyrë të efektshme rekomandimet e lëna nga organizatat ndërkombëtare, përfshirë edhe rekomandimet e lëna në raportin e vlerësimit të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) për përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra në kuadër të proceseve integruese.

5. Të krijojë instrumente të qëndrueshme në veprimtarinë e saj, që mundësojnë fuqizimin e rolit proaktiv, në drejtim të monitorimit sistematik të njërive përgjegjëse për zbatimin efektiv të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

6. Të angazhojë kapacitetet administrative në dhënien e asistencës së nevojshme, përfshirë udhëzime specifike, këshilla dhe trajnime organeve përgjegjëse të institucioneve shtetërore për zbatimin e saktë të dispozitave ligjore për konfliktin e interesit, veçanërisht për evidentimin e saktë të deklarimeve rast pas rasti, të cilat nga raportet e organizmave ndërkombëtarë nuk zbatohen.

7. Të forcojë bashkëpunimin me shoqërinë civile, medien dhe publikun e gjerë për informacionet e dhëna për rastet e denoncimit të shkeljes së ligjit për deklarimin e interesave privatë pasurore, për rastet e identifikimit të konfliktit të interesave, si dhe për rastet e dyshuara të korrupsionit në sektorin publik dhe privat.

8. Të nxitet për të paraqitur në Kuvend nevojat për rritje të kapaciteteve administrative dhe financiare, me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale të ngarkuara nga kuadri ligjor në fuqi.

Miraturar në datën 21.7.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla



REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur përgjegjësinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, mbikëqyrjen e veprimtarive të administratës zgjedhore, monitorimin e veprimtarisë së subjekteve zgjedhore, institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidhjen në rrugë administrative të kërkesave ose ankesave që kanë lidhje me procesin zgjedhor;

Duke vlerësuar pozitivisht veprimtarinë përgatitore të KQZ-së në drejtim të miratimit të rregulloreve bazë, nisjen e një fushate për edukimin e zgjedhësve, trajnimin e stafit të qendrave të votimit, si dhe përmbushjen e detyrimeve që lidhen me identifikimin elektronik të zgjedhësve;

Duke konstatuar se KQZ-ja rriti transparencën institucionale, rriti sasinë dhe cilësinë e informacionit të përcjellë te publiku nëpërmjet përdorimit të të gjitha mjeteve dhe formave të komunikimit në mediet sociale dhe ato tradicionale,

Vlerëson veprimtarinë e KQZ-së gjatë vitit 2021, në drejtim të:

Implementimit për herë të parë të identifikimit elektronik të votuesve dhe nënshkrimit elektronik në ditën e zgjedhjeve nëpërmjet pajisjes elektronike për identifikimin e votuesve dhe nënshkrimin elektronik, si dhe videomonitorimin e qendrave të votimit.

Zhvillimit me sukses për herë të parë të projektit pilot të votimit dhe numërimit elektronik.

Miratimit të një sërë udhëzimesh dhe vendimesh në përmbushje të detyrimeve ligjore për organizimin dhe drejtimin e zgjedhjeve të datës 25 prill 2021.

Ndërtimit të faqes së re zyrtare *online* me një strukturë interaktive në raport me informacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm për zgjedhësit, subjektet politike dhe palët e interesuara.

Ngritjes së një ndërfaqeje (portal) *online* nëpërmjet së cilës të gjitha institucionet shtetërore raportojnë aktivitetet e tyre duke përcaktuar datën, orën, vendin dhe aktivitetin, në zbatim të detyrave që i ngarkon Kodi i ri Zgjedhor.

Rritjes së transparencës në procesin përgatitor dhe administrues të zgjedhjeve.

Realizimit të procesit të këqyrjes paszgjedhore dhe vendosjes së sanksioneve pas problematikave të evidentuara.

Realizimit të disa moduleve në faqen zyrtare *online*, që shërbejnë për transparencën e procesit zgjedhor në lidhje me formularët e dekriminalizimit, raportimin financiar të partive, denoncimet dhe kallëzimet.

Auditimit të kryer për raportimin financiar për fushatën zgjedhore të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit.

Trajtimit me efektivitet të një numri të konsiderueshëm ankimesh administrative, me një proces shqyrtimi administrativ të shpejtë dhe transparent.

Kuvendi rekomandon që KQZ-ja për vitin 2022 të përmirësojë punën, në këto drejtime:

1. Të rishikohen proceset e punës dhe aktet nënligjore për eliminimin e problematikave të identifikuar përgjatë procesit të administrimit zgjedhor nga Komisionet e Qendrave të Votimit.

2. Të kërkojë nga subjektet zgjedhore publikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre të fushatës para ditës së zgjedhjeve, në mënyrë që të rritet përgjegjësia e partive politike, transparenca e përgjithshme e procesit zgjedhor, si dhe mundësia e votuesve për të bërë një zgjedhje të informuar, bazuar në njohjen e burimeve të financimeve të fushatave.

3. Të merren masat për eliminimin e problematikave të përsëritura, në lidhje me administrimin e fondeve nga KZAZ-të.

4. Të paraqiten në Kuvend raportet e auditimit për raportimin financiar vjetor të partive politike dhe për financimin e partive politike për fushatat zgjedhore.

5. Të miratohen aktet nënligjore në zbatim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor për të mundësuar votimin e shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit.

6. Aktet e miratuara nga Rregullatori dhe Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, të pasqyrohen në faqen zyrtare *online*, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Mbledhjeve të Komisionit Rregullator dhe Rregulloren për Mënyrën e Funkcionimit dhe Zhvillimit të



Seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

7. Të bashkëpunojë me Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore në Kuvend duke kontribuar me propozime për ndryshime në legjislacionin zgjedhor, duke përfshirë por pa u kufizuar në monitorimin e medieve sociale *online*, nisur nga fakti se subjektet zgjedhore shpenzojnë shuma të mëdha parash për fushatë në këto medie, organizimin dhe funksionimin e komisioneve të niveleve të ulëta, shqyrtimin e ankimeve dhe denoncimeve zgjedhore, përdorimin e teknologjisë në zgjedhje, etj.

8. Të zhvillohet një fushatë edukuese gjithëpërfshirëse dhe e përshtatur sipas kategorive të ndryshme të votuesve për të shmangur zhvlerësimin e fletëve të votimit dhe për të rritur besimin në procesin zgjedhor.

9. Të kontribuojë në ruajtjen e garancive ligjore që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Të shtohen parashikime të detajuara në aktet nënligjore për krijimin e lehtësive për votimin e personave me aftësi ndryshe në qendrat e votimit.

10. Të marrë masa lidhur me garantimin e fshehtësisë së votës, veçanërisht për votuesit e moshës së tretë dhe me aftësi të kufizuara, përfshirë edhe rastet kur votimi kryhet në mënyrë elektronike.

11. Të ketë një bashkëpunim të shtuar me institucionet e tjera në shkëmbimin e opinionëve për problematikat e hasura gjatë zbatimit të akteve nënligjore të miratuara në kuadër të reformës zgjedhore.

Miraturar në datën 21.7.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin dhe rëndësinë e organeve të barazisë në një shoqëri demokratike, ku të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi duhet të respektohen;

Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit si institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

Duke vlerësuar angazhimin e Avokatit të Popullit për të kryer funksionin e tij, në përputhje me legjislacionin kombëtar, por edhe me atë ndërkombëtar (veçanërisht Parimet e Parisit dhe të Komisionit të Venecias),

Vlerëson veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2021, në drejtim të:

Inspektimit të kushteve në të cilat trajtohen shtetasit në përgjithësi dhe të miturit në veçanti në institucionet e privimit të lirisë dhe adresimin e rekomandimeve përkatëse në institucionet përgjegjëse.

Inspektimit të institucioneve të shëndetit mendor dhe adresimin e rekomandimeve përkatëse në institucionet përgjegjëse.

Angazhimin e Avokatit të Popullit për monitorimin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të Rrjetit Global të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (GANHRI), Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM), Organizatës së Ombudsmanëve Frankofonë (AOMF), Shoqatës së Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI).

Angazhimin në realizimin e raportit “Për standardin e minimumit jetik në Shqipëri”.

Zhvillimin të aktiviteteve për përmirësimin e konsolidimit të njohurive të nxënësve për edukimin ligjor për të drejtat themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve dhe punën e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Përfshirjes së Avokatit të Popullit në fazën e konsultimit të jashtëm për projektakte të propozuara nga ministritë e linjës, si dhe përfshirjes në procesin legjislativ për dhënien e mendimeve ose të sugjerimeve për projektligje të ndryshme.

Angazhimin për raportin “Për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, si një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve”, si dhe “Raportin për çështjet e dhunës në familje dhe ndaj grave”.



Hartimit të raportit të monitorimit “Për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare që u zhvilluan në datën 25 prill 2021.

Trajtimit të një numri më të lartë të ankesave/kërkesave nga një vit më parë.

Kuvendi kërkon që Avokati i Popullit për vitin 2022 të angazhohet, në këto drejtime:

Të intensifikojë reagimin institucional me vizibilitet më të shtuar në publik për rekomandimet që nuk zbatohen apo në rast mosbashkëpunimi nga autoritetet publike, me qëllim rritjen e besimit të publikut ndaj këtij institucioni kushtetues.

Të informojë Kuvendin për institucionet që nuk kthejnë përgjigje, në lidhje me rekomandimet e adresuara, si dhe të përfshijë në raportin vjetor dhe periodik institucionet që nuk kanë kthyer përgjigje.

Të intensifikojë sesionet informuese në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në rang vendi, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve për të drejtat e tyre themelore dhe punën e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave, me qëllim rritjen e numrit të ankesave/kërkesave që vijnë drejtpërdrejt nga fëmijët.

Të vijojë inspektimet/monitorimet e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve dhe të rrisë numrin e rekomandimeve nga ky seksion, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Të rrisë aktivitetin ndërgjegjësues dhe informues në zyrat rajonale, me qëllim promovimin dhe nxitjen e respektimit të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individëve dhe promovimit të mekanizmave mbrojtës të tyre.

Të angazhohet në përgatitjen e një plani masash për informimin dhe promovimin e mekanizmave mbrojtës të të drejtave dhe lirive, me fokus të veçantë shtetasit pjesë e grupeve vulnerabel dhe atyre të marginalizuara të shoqërisë.

Të vijojë bashkëpunimin me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi përmes projekteve konkrete për të koordinuar dhe bashkuar përpjekjet, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen dhe parandalimin e shkeljeve.

Miratuar në datën 21.7.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

REZOLUTË MBI PABAZUESHMËRINË E PRETENDIMEVE PËR TRAFIKIMIN E PALIGJSHËM TË ORGANEVE NJERËZORE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI

1. Duke iu referuar rezolutës 1782 (2011) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKiE) “Për hetimin e pretendimeve për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë”, e cila bazohet në një raport (dokumenti 12462, datë 7 janar 2011) të Dik Martit (*Dick Marty*), asokohe anëtar dhe raportues i Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut në APKiE;

2. Duke rikujtuar se raporti u hartua në vijim të një mocioni për rezolutë (dokumenti 11574, datë 15 prill 2008), me autor ish-anëtarin e APKiE-së, Kostandin Kosaçev (*Konstantin Kosachev*), Federata Ruse, Grupi Evropian Demokrat, bazuar në kujtimet e zonjës Karla Del Ponte (*Carla Del Ponte*), ish-Prokurore e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Krime Lufte për ish-Jugosllavinë (ICTY), e cila në librin e saj “Gjuetia: unë dhe kriminelët e luftës”, botuar dy muaj pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe rreth tre muaj pasi kishte dhënë dorëheqjen si prokurore e ICTY-së, ngrinte dyshime se pjesëtarë, drejtues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kishin kryer trajtime çnjerëzore të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe në Shqipëri, krime këto që nuk mund të hetoheshin nga ICTY-ja për mungesë juridiksioni, si dhe për shkak të mandatit të kufizuar në kohë dhe territor të kësaj gjykate; këto pretendime ishin hetuar edhe më parë nga zyra e ICTY-së gjatë mandatit të Del Pontes, por nuk ishin gjetur prova për të bazuar pretendimet për kryerjen e këtyre krimeve;

3. Duke nënvizuar se raporti i Dik Martit, në vijim të pretendimeve të ish-prokurores Karla Del Ponte dhe mocionit për rezolutë të nisur prej deputetit rus në APKiE, Kosaçev, edhe pse nuk është një raport faktmbledhës apo hetimi, ngre pretendime për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore, që dyshohen të jenë kryer nga pjesëtarë dhe drejtues të UÇK-së ndaj shtetasve serbë, kosovarë dhe komunitetit rom apo minoriteteve të tjera të Kosovës në territorin shqiptar, më konkretisht në



Veri të Shqipërisë: Kukës, Burrel, Rripe, Cahan dhe Fushë-Krujë, në periudhën pas përfundimit të luftës në Kosovë, kryesisht pas qershorit të vitit 1999, dhe ka shërbyer si dokumenti ku bazohen rekomandimet në rezolutën 1782 (2011) të APKiE-së drejtuar vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian, organizatave ndërkombëtare, Kosovës, Shqipërisë, Serbisë dhe mbi të cilin u realizuan një sërë nismash kushtetuese dhe/ose ligjore dhe rregullatore, si dhe veprimtari institucionale në Kosovë, Shqipëri dhe Bashkimin Evropian (EULEX), siç përshkruhen në vijim në këtë rezolutë;

4. Duke vlerësuar Kuvendin e Kosovës që pati vullnetin politik, edhe pse disa prej atyre të cilët votuan ishin të akuzuarit e krimeve të pretenduara në raportin e Dik Martit për të miratuar amendamentin kushtetues n.24 të gushtit 2015, që parashikoi krijimin e dhomave të specializuara për ndjekjen penale mbi pretendimet që lidhen me çfarë pretendohet në raportin e Dik Martit dhe që ishte objekt hetimi edhe nga Task Forca Hetimore Speciale e Bashkimit Evropian, ngritur sipas vendimit të muajit maj të vitit 2011 të Komitetit Politik dhe Sigurisë së Bashkimit Evropian për disa ndryshime në planin operacional të EULEX-it, në vijim të rezolutës 1782 (2011) të APKiE-së;

5. Duke sjellë në vëmendje se veprimin e klasës politike të Kosovës për amendamentin kushtetues n.24 të gushtit 2015 e vlerësoi edhe APKiE-ja në rezolutën 2094 (2016) “Situata në Kosovë dhe roli i Këshillit të Evropës”, e cila në pikën 3 thotë, shprehimisht: “Asambleja mirëpret miratimin nga Kuvendi i Kosovës të amendamenteve kushtetuese, të cilat i hapën rrugën krijimit të dhomave të specializuara për ndjekjen penale të rasteve të hetuara nga Task Forca Hetimore Speciale, si vazhdim i rezolutës së Asamblesë 1782 (2011) për hetimin e pretendimeve për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë. Asambleja e konsideron këtë vendim si një hap drejt pajtimit dhe një shenjë e gatishmërisë së pushtetit për të luftuar mosndëshkimin.”;

6. Duke vlerësuar dhe rikujtuar, gjithashtu, se në zbatim të amendamentit kushtetues, si dhe ligjit nr. 04/L-274, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë”, Kuvendi

i Kosovës miratoi edhe ligjin nr. 05/L-053, “Për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar”, duke u dhënë juridiksionin këtyre organeve të pavarura dhe të përkohshme, pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, në përbërje të së cilave nuk ka shtetas kosovarë, për të hetuar e ushtruar ndjekjen penale për krimet e supozuara që janë raportuar në raportin e Dik Martit dhe që kanë qenë edhe objekt i hetimeve penale të kryera nga Task Forca Hetimore Speciale e Bashkimit Evropian;

7. Duke nënvizuar se as Task Forca Hetimore Speciale e Bashkimit Evropian, e kryesuar nga Klint Williamson (*Clint Williamson*), e autorizuar në vitin 2011 për një hetim të plotë penal për akuzat për vrasje të personave, me qëllim nxjerrjen dhe shitjen e organeve të tyre, nuk gjeti kurrë prova dhe fakte në mbështetje të pretendimeve në raportin e Dik Martit;

8. Duke vënë në dukje se as Zyra e Prokurorit të Specializuar, që është krijuar për të hetuar dhe ndjekur penalisht individë për krime të supozuara në raportin e Dik Martit, në asnjë prej hetimeve të saj e në asnjë prej aktakuzave që u ngritën kundër ish-drejtuesve të UÇK-së në vitin 2020, nuk përmend asnjë rast që të lidhet me trafikimin e organeve njerëzore;

9. Duke theksuar gatishmërinë dhe vullnetin e Shqipërisë për të bashkëpunuar pa rezerva me të gjitha institucionet ndërkombëtare, me qëllim që t’u jepet një përgjigje përfundimtare pretendimeve në raportin e Dik Martit dhe për t’i shkuar deri në fund këtij procesi, për të mbyllur njëherë e mirë kapitullin se në Shqipëri nuk janë kryer krime të supozuara si ato që përmenden në raportin e Dik Martit, si dhe duke nënvizuar asistencën dhe bashkëpunimin efektiv të Shqipërisë me çdo mision faktmbledhës ose investigues të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, EULEX-it, Bashkimit Evropian apo tjetër që kanë pasur interes të kryejnë investigime veçanërisht në zbatim të rekomandimeve të rezolutës së APKiE 1782 (2011) edhe përpara se të ngriheshin Dhomat e Specializuara apo Zyra e Prokurorit Special në Kosovë;

10. Duke vënë në dukje se shprehje e vullnetit të Shqipërisë për të bashkëpunuar në interes të drejtësisë dhe zbardhjes së të vërtetës për krimet e supozuara në raportin e Dik Martit është edhe miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit nr.



53/2012, “Për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it”, i cili autorizon autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë t’i ofrojnë Task Forcës Hetimore Speciale të Bashkimit Evropian bashkëpunimin dhe ndihmën përkatëse që u kërkohet;

11. Duke rikujtuar se miratimi i ligjit nr. 53/2012 nga Kuvendi i Shqipërisë është vlerësuar në raportin e APKiE-së (dokumenti 13586, datë 2 shtator 2014), “Respektimi i detyrimeve dhe angazhimeve nga Shqipëria”, ku në pikën 5.5 “Ndjekja e raportit të Asamblesë për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë”, paragrafi 129, shprehimisht thuhet: “Ne mirëpresim faktin që autoritetet shqiptare kanë ofruar një bashkëpunim të plotë dhe të papenguar për hetuesit e EULEX-it për këto krime të supozuara në territorin shqiptar. Duke e konsideruar me rëndësi të madhe që pretendimet e ngritura në këtë raport të hetohen plotësisht dhe në mënyrë transparente, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin “Për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it” në maj të vitit 2012. Bazuar në këtë ligj, prokurorët e EULEX-it lejohen të hetojnë brenda territorit shqiptar për implikimet e supozuara të Shqipërisë në trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në territorin shqiptar. Ata kanë pasur mbështetjen e plotë të të gjitha institucioneve kompetente. Në lidhje me hetimin e pavarur dhe të veçantë nga autoritetet shqiptare, siç kërkohet nga Kuvendi, autoritetet deklaruan se hetimet e tyre deri më tani nuk kanë konfirmuar gjetjet e Martit.”;

12. Duke nënvizuar se pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 53/2012, autoritetet shqiptare bashkëpunuan ngushtësisht me Task Forcën Hetimore Speciale të Bashkimit Evropian dhe organet e specializuara në Kosovë, duke ofruar të gjithë ndihmën, asistencën e nevojshme, informacionet e kërkuara, si dhe kryerjen e veprimeve përkatëse në lidhje me to, me qëllim zbardhjen e të vërtetës mbi pretendimet në raportin e Dik Martit;

13. Duke konstatuar se nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 53/2012 e deri më sot asnjë prej organeve të specializuara në Kosovë apo organizatat ndërkombëtare nuk kanë ngritur asnjë pretendim për mungesën e bashkëpunimit të autoriteteve shqiptare në këtë proces;

14. Duke nënvizuar seriozitetin dhe përgjegjshmërinë e Kuvendit të Shqipërisë për të ushtruar kontrollin parlamentar për zbatimin e rezolutës 1782 (2011) të APKiE-së, si dhe të ligjit nr. 53/2012, me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 71/2020 u ngrit një komision i posaçëm për realizimin e këtij funksioni parlamentar, i cili nuk e përmbylli dot veprimtarinë e tij, për shkak të mbarimit të legjislaturës së IX të Kuvendit (2017–2021), por arriti të marrë informacione e raporte të plota që vërtetojnë se gatishmëria e autoriteteve shqiptare ka qenë efektive dhe këto autoritete u janë përgjigjur në kohë e me konstruktivitet kërkesave të autoriteteve të huaja për bashkëpunim, ndihmë, asistencë dhe veprime konkrete sipas përcaktimeve të ligjit nr. 53/2012, duke përmbyllur kështu njëkohësisht edhe rekomandimet e rezolutës 1782 (2011) për Shqipërinë;

15. Duke konstatuar se nga aktet, provat, raportet dhe informacionet që mblodhi komisioni i posaçëm ngritur me vendim të Kuvendit nr. 71/2020, nuk ka asnjë fakt apo provë që të vërtetojë pretendimet e ngritura në raportin e Dik Martit për vrasje të personave me qëllim nxjerrjen dhe shitjen e organeve të tyre dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe/apo në Shqipëri;

16. Duke theksuar se Dik Martit, pas vizitave që kreu si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, kurrë deri më sot nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar krimet e supozuara të kryera në lidhje me trafikimin e organeve njerëzore, siç pretendon në raportin e tij;

17. Duke qenë se kësisoj, edhe pas më se një dekade nga rezoluta 1782 (2011) e APKiE-së rezulton se asnjë nga misionet dhe/apo hetimet e organeve të drejtësisë vendëse apo ndërkombëtare nuk kanë gjetur asnjë fakt e asnjë provë që të vërtetojë pretendimet e ngritura në raportin e Dik Martit për vrasje me qëllim trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe/apo në Shqipëri;

18. Duke respektuar dhe pa ndërhyrë në asnjë hetim apo procedurë gjyqimi ndaj personave të veçantë, udhëheqësve të luftës së UÇK-së dhe duke qenë të përkushtuar për zbatimin e plotë të rekomandimeve të rezolutave të APKiE-së si vend anëtar i Këshillit të Evropës;



19. Duke ndarë të njëjtin mendim me Dik Martit, aty ku shprehet në raportin e tij, se: “E vërteta dhe përgjegjshmëria janë nevoja absolute nëse duhet të ketë pajtim dhe stabilitet të qëndrueshëm në rajon”;

20. Duke vlerësuar legjitimitetin e luftës heroike të UÇK-së për çlirimin e vendit dhe duke qenë të bindur se, pavarësisht se nuk mund të vendosen paralele midis masakrave çnjerëzore, spastrimeve etnike, deportimeve, vrasjeve, përdhunimeve, plaçkitjeve dhe krimeve të luftës nga drejtues dhe anëtarë të makinerisë zyrtare luftarake serbe dhe paramilitarët e saj gjatë luftës në Kosovë nga njëra anë, dhe integritetit e kauzës së drejtë të luftës së UÇK-së si reagim në mbrojtje të jetës dhe lirisë së popullit në Kosovë nga ana tjetër, çdo dyshim për krime duhet zbardhur nga organet e drejtësisë sipas parimeve të procesit të rregullt ligjor, por procesi për këtë çështje do të duhet të mbarojë dikur, me qëllim që popujt të gjejnë forcën të pajtohen e të jetojnë së bashku duke shëruar plagët e së shkuarës,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

Konstaton se pas më shumë se dhjetë vjetësh hetime të thelluara nga Task Forca Hetimore Speciale e BE-së dhe pasardhësja e saj, Zyra e Prokurorit të Specializuar, pretendimet e ngritura në raportin e Dik Martit për vrasje të personave me qëllim nxjerrjen dhe shitjen e organeve të tyre dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Shqipëri dhe/apo në Kosovë, të përfshira në rezolutën 1782 (2011) të APKiE-së, pikat 1 dhe 4, mbeten të paargumentuara, të paprovuara dhe të pabazuara në prova dhe fakte e për rrjedhojë duhet të konsiderohen si të tilla nga të gjitha institucionet kombëtare e ndërkombëtare.

Përgëzon autoritetet e Republikës së Kosovës, të cilat në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 19.6 të rezolutës 1782 (2011) të APKiE-së kanë bashkëpunuar pa rezerva me EULEX-in dhe çdo organ tjetër gjyqësor të mandatuara për të kryer hetime vijuese, si dhe në kuadër të çdo procedure tjetër që synon të zbulojë të vërtetën.

Përsëritet autoritetet e Kosovës, të cilat në përputhje me një marrëveshje ndërkombëtare dhe amendamentin kushtetues nr. 24 të gushtit 2015 miratuan themelimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, pjesë përbërëse e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe të natyrës së përkohshme, me qëllim

kryesor hetimin dhe/ose gjykimin e krimeve të pretenduara në raportin e Dik Martit.

I bën thirrje Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të realizojë një raport vijues (*follow up report*) dhe si rrjedhojë edhe një rishikim të rezolutës 1782 (2011) duke rivlerësuar pretendimet për trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Shqipëri dhe/apo në Kosovë, në dritën e zhvillimeve që kanë ndodhur gjatë kësaj dekade, fakteve, provave dhe informacioneve të përditësuara, sikurse edhe për sa i përket angazhimit, gatishmërisë dhe bashkëpunimit të plotë të Shqipërisë dhe Kosovës në shërbim të së vërtetës dhe vendosjes së drejtësisë.

I kërkon qeverisë shqiptare të mbetet plotësisht e përkushtuar për të ndihmuar drejtësinë dhe identifikuar përgjegjësinë për të gjitha krimet e kryera në ish-Jugosllavi dhe përsërit thirrjen e tij për të gjithë të interesuarit që të bashkëpunojnë me Mekanizmin Ndërkombëtar për kryerjen e funksioneve të mbetura të gjykatave penale (IRMCT) brenda juridiksionit të saj.

Shpreh vullnetin e palëkundur për të ndihmuar drejtësinë dhe mbështetur çdo përpjekje që synon të zbulojë të vërtetën.

Miraturar në datën 21.7.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

AKT NORMATIV Nr. 11, datë 29.7.2022

PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 8926, DATË 22.7.2002, “PËR FORMËN DHE PËRMASAT E FLAMURIT KOMBËTAR, PËRMBAJTJEN E HIMNIT KOMBËTAR, FORMËN DHE PËRMASAT E STEMËS SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 4, të ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar,



përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, bëhen këto shtesa:

a) Në fund të pikës 2 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Përjashtim nga ndalimi i ngritjes dhe vendosjes së flamujve të huaj, sipas kësaj pike, përbën flamuri i Bashkimit Evropian, i cili vendoset përkrah flamurit kombëtar në të gjitha institucionet publike, në mjediset e tyre të brendshme dhe të jashtme.”.

b) Në pikën 5, pas fjalëve “... si dhe raporti i përmasave të tij për këto mjedise, ...”, shtohen “... si dhe mënyra e përdorimit dhe përmasat e flamurit të Bashkimit Evropian ...”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AKT NORMATIV Nr. 12, datë 29.7.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 115/2021, “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Nenet 1, 2, 3, 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2022 është:

Të ardhurat	576 831 milionë lekë;
Shpenzimet	660 694 milionë lekë;
Deficiti	83 863 milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2022 është:

Të ardhurat	431 643 milionë lekë;
Shpenzimet	515 506 milionë lekë;
Deficiti	83 863 milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2022 është:

Të ardhurat 60 290 milionë lekë,
nga të cilat:

- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	18 733 milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	9 353 milionë lekë;
- të ardhura të tjera	32 204 milionë lekë;
Shpenzimet	60 290 milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2022 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta

Të ardhurat, gjithsej,	147 203 milionë lekë,
nga të cilat:	
- kontributet	98 899 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	41 704 milionë lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	3 100 milionë lekë;
- bonusi i pensionistëve	3 500 milionë lekë;
Shpenzimet	147 203 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2022, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të



sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensione.

2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat, gjithsej, 7 732 milionë lekë,

nga të cilat:

- kontributet	1 896 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 636 milionë lekë;
- transfertat për indeksimin e pensione	200 milionë lekë;
Shpenzimet	7 732 milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensione është parashikuar 3 300 milionë lekë.

Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 950 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në përpjesëtim me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2022 është:

Të ardhurat, gjithsej,	52 836 milionë lekë,
nga të cilat:	
- kontributet dhe të tjera	15 760 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	37 076 milionë lekë;
Shpenzimet	52 836 milionë lekë.

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11 000 milionë lekësh, përfshirë detyrimet e prapambetura dhe rimbursimin e medikamenteve për kurimin e COVID-19. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Nenet 9 dhe 10 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore janë:

Grantet	13 994 milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	395 000 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	22 650 milionë lekë.

Neni 10

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër se deficiti i përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 33 000 milionë lekësh.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja është rreth 480 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikativë, si më poshtë:

- huamarrje afatgjata të destinuar për projekte me vlerë rreth 22 902 milionë lekë;
- huamarrje në formën “mbështetje buxhetore” nga institucione financiare ndërkombëtare me vlerë rreth 19 357 milionë lekë;
- ripagesa të principalit me vlerë rreth -42 529 milionë lekë;
- nën-hua për pushtetin vendor me vlerë rreth 750 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit, nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë, është rreth 50 383 milionë lekë.

Çdo diferencë, që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice, akumulohet në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë ose, në rast mungese, përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2021, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila automatikisht rrit me



të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 e 2, të këtij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- shpenzime të buxhetit qendror 495 256 milionë lekë;
- fondi rezervë i buxhetit 3 350 milionë lekë;
- kontigjencë për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës 12 100 milionë lekë;
- kontigjencë për risqet e borxhit 4 800 milionë lekë.”.

2. Në paragrafin 7, fjalët “... Fondi prej 2 400 milionë lekësh përdoret për politika të reja pagash...” zëvendësohen me “... Fondi prej 1 900 milionë lekësh përdoret për politika të reja pagash...”.

3. Në paragrafin e fundit, fjalia e fundit riformulohet, si më poshtë vijon:

“Fondi i kontigjencës për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës, prej 12 100 milionë lekësh, përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.”.

4. Në fund të nenit shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Fondi prej 1 670 milionë lekësh në zërin “Shpenzime kapitale të brendshme”, në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i planifikuar për përballimin e efekteve që burojnë nga zbatimi i aktit normativ nr. 10, datë 18.5.2022, “Për kompensimin financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi, sipas përcaktimeve në kontratat publike për punë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg gjatë vitit 2022”, do të përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave mbi kufijtë e përcaktuar në nenin 17, të këtij ligji, bazuar në kërkesat e institucioneve përgjegjëse dhe vetëm pas ezaurimit të mundësive të financimit brenda tavanit buxhetor të miratuar për çdo institucion.”.

Neni 4

Tabelat 1, 3 dhe 4, që përmenden në nenin 11, zëvendësohen me tabelat 1, 3 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 5

Në nenin 12, bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë, fjalët “84 214 veta” zëvendësohet me “84 576 veta”;
- Tabela nr. 2 dhe aneksi nr. 5, që përmenden në nenin 12, zëvendësohen me tabelën nr. 2 dhe aneksin nr. 5, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 6

Neni 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 14

Fondi rezervë i buxhetit, prej 3 350 milionë lekësh, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.

Kontigjenca për risqet e borxhit, prej 4 800 milionë lekësh, përdoret nga ministri përgjegjës për financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë dhe kontigjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11, të këtij ligji.”.

Neni 7

Neni 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese për vitin 2022, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 48 392 milionë lekë, i dhënë me hollësi si më poshtë:



- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 33 480 milionë lekë;

- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfutuese deri në 14 912 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 431 703 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi, si më poshtë:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore, 1 361 245 milionë lekë;

- Stoku i borxhit të garantuar nga qeverisja qendrore, 69 808 milionë lekë;

- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore, 650 milionë lekë.”.

Neni 8

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

BUXHETI 2022 SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

Kodi	Emërtimi i institucionit / Programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financim i huaj	Totali i shp. kapitale	
1	Presidenca	227,778	16,000	0	16,000	243,778
01120	Veprimtaria e Presidentit	227,778	16,000	0	16,000	243,778
2	Kuvendi	1,030,244	283,000	0	283,000	1,313,244
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	378,961	283,000	0	283,000	661,961
01120	Veprimtaria ligjvënëse	651,283	0	0	0	651,283
3	Kryeministria	458,050	50,000	0	50,000	508,050
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	458,050	50,000	0	50,000	508,050
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	6,617,510	2,533,844	2,863,251	5,397,095	12,014,605
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	318,354	5,000	0	5,000	323,354
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,441,431	280,509	388,014	668,523	2,109,954
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	615,340	992,841	0	992,841	1,608,181
04250	Zhvillimi rural duke mbësht. prodh. bujq. bleg. agroind dhe market.	3,647,725	945,844	2,413,755	3,359,599	7,007,324
04860	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	442,850	170,000	0	170,000	612,850
05470	Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	18,000	0	0	0	18,000
04230	Mbështetje për peshkimin	133,810	139,650	61,482	201,132	334,942
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	4,986,051	23,742,314	16,643,755	40,386,069	45,372,120
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	463,050	13,000	0	13,000	476,050
04520	Transporti rrugor	2,585,375	15,571,887	5,980,132	21,552,019	24,137,394
04540	Transporti detar	105,435	80,000	10,000	90,000	195,435
04550	Transporti hekurudhor	523,853	400,000	1,958,349	2,358,349	2,882,202
04560	Transporti ajror	15,793	71,200	0	71,200	86,993
04610	Mbështetje për rrjetet e komunikacionit	0	4,000	20,000	24,000	24,000
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	444,348	6,486,185	5,419,274	11,905,459	12,349,807
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane	180,000	667,042	476,000	1,143,042	1,323,042
04320	Mbështetje për energjinë	130,278	200,000	2,780,000	2,980,000	3,110,278
04430	Mbështetje për burimet natyrore	210,640	91,000	0	91,000	301,640
04440	Mbështetje për industrinë	267,032	64,000	0	64,000	331,032
06180	Planifikimi urban	60,249	94,000	0	94,000	154,249
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	58,227,388	3,691,329	938,000	4,629,329	62,856,717
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	644,654	203,000	350,000	553,000	1,197,654
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	370,721	0	0	0	370,721
01130	Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	748,000	2,070,000	0	2,070,000	2,818,000
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,420,499	445,640	0	445,640	2,866,139
01150	Menaxhimi i të ardhurave doganore	3,600,000	126,220	120,690	246,910	3,846,910
01160	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	74,675	2,000	0	2,000	76,675
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	360,070	71,800	150,000	221,800	581,870
04160	Mbështetje për mbikëq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	295,145	16,500	0	16,500	311,645
10220	Sigurimi shoqëror	42,146,116	0	0	0	42,146,116
10550	Tregu i punës	2,282,235	71,000	0	71,000	2,353,235
04170	Inspektimi në punë	162,397	4,500	0	4,500	166,897
09240	Arsimi i mesëm (profesional)	2,080,478	280,669	317,310	597,979	2,678,457
06190	Strehimi	3,042,400	400,000	0	400,000	3,442,400
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	41,333,522	3,326,000	320,000	3,646,000	44,979,522
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	699,209	80,000	0	80,000	779,209
09120	Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)	24,043,152	1,108,000	0	1,108,000	25,151,152
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	6,673,328	1,012,000	0	1,012,000	7,685,328
09450	Arsimi universitar	9,400,000	606,000	200,000	806,000	10,206,000
09770	Fonde për shkencën	395,286	250,000	100,000	350,000	745,286



08140	Zhvillimi i sportit dhe rinisë	122,547	270,000	20,000	290,000	412,547
12	Ministria e Kulturës	2,075,191	2,069,500	160,000	2,229,500	4,304,691
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	158,390	0	0	0	158,390
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	609,500	27,000	65,000	92,000	701,500
08230	Arti dhe kultura	1,307,301	2,042,500	95,000	2,137,500	3,444,801
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	72,277,247	1,026,944	1,410,000	2,436,944	74,714,191
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	326,479	3,000	0	3,000	329,479
07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor	7,719,649	70,912	158,000	228,912	7,948,561
07330	Shërbimet e Kujdesit Dytësor	30,916,859	930,712	1,152,000	2,082,712	32,999,571
07450	Shërbimet e Shëndetit Publik	5,325,174	13,680	0	13,680	5,338,854
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	310,159	0	0	0	310,159
10430	Perkujdesi Social	26,644,602	8,640	100,000	108,640	26,753,242
01190	Rehabilitimi i të Përdjekurve Politike	1,034,325	0	0	0	1,034,325
14	Ministria e Drejtësisë	10,436,872	476,700	110,000	586,700	11,023,572
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	393,699	95,600	110,000	205,600	599,299
03310	Ndihma Juridike	65,700	2,000	0	2,000	67,700
01120	Publikimet Zyrtare	51,323	2,000	0	2,000	53,323
01130	Mjekësia Ligjore	82,650	5,000	0	5,000	87,650
03440	Sistemi i Burgjeve	5,850,075	360,900	0	360,900	6,210,975
03350	Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor	135,454	3,000	0	3,000	138,454
01160	Shërbimet për çështjet e birësimeve	14,865	200	0	200	15,065
01180	Shërbimi i Kihimit dhe Kompensimit të Pronave	3,701,620	6,000	0	6,000	3,707,620
03490	Shërbimi i Provës	141,486	2,000	0	2,000	143,486
15	Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme	2,842,931	91,000	80,780	171,780	3,014,711
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	257,985	55,000	0	55,000	312,985
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,320,809	15,000	0	15,000	2,335,809
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ-së	193,709	0	0	0	193,709
01150	Mbështetje institucionale për procesin e integritetit	70,429	21,000	80,780	101,780	172,209
16	Ministria e Brendshme	19,091,568	960,000	350,290	1,310,290	20,401,858
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,127,431	96,250	0	96,250	1,223,681
03140	Policia e Shtetit	15,299,090	712,750	335,290	1,048,040	16,347,130
03150	Garda e Republikës	1,743,855	29,000	0	29,000	1,772,855
01160	Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor	474,014	62,000	15,000	77,000	551,014
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	447,177	60,000	0	60,000	507,177
17	Ministria e Mbrojtjes	21,486,727	6,504,500	1,900,000	8,404,500	29,891,227
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,186,356	160,000	0	160,000	1,346,356
02120	Forcat e Luftimit	5,774,739	3,912,500	1,200,000	5,112,500	10,887,239
09430	Arsimi Ushtarak	803,551	390,000	0	390,000	1,193,551
02150	Mbështetje e Luftimit	5,870,927	913,000	0	913,000	6,783,927
07340	Mbështetje për Shëndetësinë	1,119,930	250,000	0	250,000	1,369,930
10270	Mbështetje Sociale për Ushtarakët	5,200,000	0	0	0	5,200,000
10910	Emergjencat civile	1,531,225	879,000	700,000	1,579,000	3,110,225
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1,743,455	50,000	0	50,000	1,793,455
03520	Veprimtaria Informativ Shtetërore	1,743,455	50,000	0	50,000	1,793,455
19	Drejtoria e Radio Televizionit	567,600	0	0	0	567,600
08310	Shërbimet për shqiptarët jashtë kufirit	240,000	0	0	0	240,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	197,600	0	0	0	197,600
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	67,600	0	0	0	67,600
08340	Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografisë	62,400	0	0	0	62,400
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	176,995	65,000	0	65,000	241,995
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	176,995	65,000	0	65,000	241,995
22	Akademia e Shkencës	134,068	9,200	0	9,200	143,268
01520	Veprimtaria akademike	134,068	9,200	0	9,200	143,268
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	445,554	20,000	24,000	44,000	489,554
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH-së	445,554	20,000	24,000	44,000	489,554
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,246,192	578,740	490,000	1,068,740	2,314,932
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	189,267	2,000	0	2,000	191,267
05320	Programe për mbrojtjen e mjedisit	392,008	150,000	390,000	540,000	932,008
04260	Administrimi i pyjeve	324,739	39,500	0	39,500	364,239
04760	Zhvillimi i turizmit	340,179	387,240	100,000	487,240	827,419
28	Prokuroria e Përgjithshme	2,139,513	130,000	0	130,000	2,269,513
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	2,139,513	130,000	0	130,000	2,269,513
29	Këshilli i Lartë i Gjyqësor	3,192,656	412,000	0	412,000	3,604,656
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	258,046	15,000	0	15,000	273,046
01140	Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë	8,444	0	0	0	8,444
03310	Buxheti gjyqësor	2,926,166	397,000	0	397,000	3,323,166
30	Gjykata Kushtetuese	146,909	19,000	0	19,000	165,909
03320	Veprimtaria gjyqësore kushtetuese	146,909	19,000	0	19,000	165,909
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	56,004	1,000	0	1,000	57,004
08320	Veprimtaria telegrafike e ATSH-se	56,004	1,000	0	1,000	57,004
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	141,625	8,000	0	8,000	149,625



01110	Veprimtaria e KLP-së	141,625	8,000	0	8,000	149,625
40	Partitë politike	356,208	0	0	0	356,208
01110	Mbështetje për partitë politike	345,600	0	0	0	345,600
01120	Mbështetje për shoqatat	8,320	0	0	0	8,320
01130	Mbështetje për organizatat e veteraneve me status	2,288	0	0	0	2,288
41	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar	893,971	30,000	0	30,000	923,971
03390	Veprimtaria e SPAK-ut	893,971	30,000	0	30,000	923,971
50	Instituti i Statistikës	635,141	67,000	400,000	467,000	1,102,141
01320	Veprimtaria statistikore	635,141	67,000	400,000	467,000	1,102,141
55	Shkolla e Magjistraturës	290,468	8,000	0	8,000	298,468
09820	Veprimtaria Arsimore	290,468	8,000	0	8,000	298,468
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	9,500,000	7,851,924	17,351,924	17,351,924
06210	Programe zhvillimi	0	6,300,000	7,851,924	14,151,924	14,151,924
06220	Infrastruktura vendore dhe rajonale	0	2,800,000	0	2,800,000	2,800,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	400,000	0	400,000	400,000
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	156,805	1,000	0	1,000	157,805
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	156,805	1,000	0	1,000	157,805
63	Institucionet e sistemit të drejtësisë	711,489	68,600	0	68,600	780,089
03320	Veprimtaria e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	186,143	64,000	0	64,000	250,143
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magistratit	258,235	2,000	0	2,000	260,235
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	192,576	2,000	0	2,000	194,576
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	74,535	600	0	600	75,135
66	Avokati i Popullit	120,838	4,000	0	4,000	124,838
03320	Shërbimi i avokatisë	120,838	4,000	0	4,000	124,838
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	56,858	1,000	0	1,000	57,858
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	56,858	1,000	0	1,000	57,858
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	186,550	81,500	0	81,500	268,050
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	186,550	81,500	0	81,500	268,050
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	157,509	33,000	0	33,000	190,509
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	157,509	33,000	0	33,000	190,509
77	Autoriteti i Konkurrencës	69,197	1,000	0	1,000	70,197
04120	Mbikëqyrja e tregut dhe garantimi i konkurrencës	69,197	1,000	0	1,000	70,197
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	12,054	1,000	0	1,000	13,054
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	12,054	1,000	0	1,000	13,054
87	Institucione të tjera qeveritare	7,736,508	2,630,129	293,000	2,923,129	10,659,637
01320	Shërbime Qeveritare	278,000	30,000	0	30,000	308,000
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik	61,620	1,000	0	1,000	62,620
05640	Administrimi i ujerave	93,014	10,000	93,000	103,000	196,014
03310	Shërbimi i Avokatisë Shtetërore	212,147	2,000	0	2,000	214,147
01150	Shërbime të tjera	685,811	147,753	0	147,753	833,564
01140	e-Qeverisja	5,825,265	2,322,376	0	2,322,376	8,147,641
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike	337,030	66,000	150,000	216,000	553,030
08610	Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët	110,118	50,000	50,000	100,000	210,118
08480	Mbështetje për Kultet Fetare	133,503	1,000	0	1,000	134,503
88	Mbështetje për Shoqërinë Civile	121,252	1,000	0	1,000	122,252
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	121,252	1,000	0	1,000	122,252
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	73,962	6,500	0	6,500	80,462
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	73,962	6,500	0	6,500	80,462
90	Komisioni i Prokurimit Publik	66,908	25,000	0	25,000	91,908
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	66,908	25,000	0	25,000	91,908
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	48,119	3,000	0	3,000	51,119
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	48,119	3,000	0	3,000	51,119
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	36,243	1,000	0	1,000	37,243
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	36,243	1,000	0	1,000	37,243
95	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	89,507	12,000	67,000	79,000	168,507
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	89,507	12,000	67,000	79,000	168,507
TOTALI		262,901,236	58,538,800	33,902,000	92,440,800	355,342,036



Tab. 2

Kod min	Emërtimi i Ministrisë / Institucionit buxhetor	Numri i punonjësve sipas AN
1	Presidenca	86
2	Kuvendi	434
3	Kryeministria	196
5	Ministria e Bujqësisë	2,459
6	Ministria e Infrastrukturës / Energjisë	1,153
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6,023
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	31,005
12	Ministria e Kulturës	1,002
13	Ministria e Shëndetësisë	4,313
14	Ministria e Drejtësisë	5,368
15	Ministër Punët e Jashtme	561
16	Ministria e Brendshme	15,248
17	Ministria e Mbrojtjes	8,863
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	998
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	139
22	Akademia e Shkencës	29
24	Kontrolli Lartë i Shtetit	233
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	879
28	Prokuroria e Përgjithshme	958
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor (QTI)	1,729
30	Gjykata Kushtetuese	62
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	40
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	65
41	SPAK/Byro hetimi	241
50	Instituti i Statistikës	236
55	Shkolla e Magjistraturës	39
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9
63	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	76
63	Kolegji i Posaçëm i Apelit	57
63	Komisioneri Publik	30
63	Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	93
66	Avokati i Popullit	57
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	37
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	85
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	70
77	Autoriteti i Konkurrencës	46
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
87	Institucione të tjera qeveritare	1,382
	<i>Drejtoria e Sigurimit të Informacionit Klasifikuar (DSIK)</i>	38
	<i>Agjencia e Prokurimit Publik</i>	44
	<i>Komiteti për Pakëzat Kombëtare</i>	24
	<i>Inspektorati Qendror</i>	21
	<i>Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore</i>	83
	<i>Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje</i>	72
	<i>Agjencia e Zhvillimit të Territorit</i>	43
	<i>Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit</i>	41
	<i>Agjencia Autonome e Auditimit të Fondave të BE-së</i>	23
	<i>Agjencia Kombëtare e Shqërsisë së Informacionit</i>	389
	<i>Agjencia Ofrimit të Shërbimeve Publike (ADISA)</i>	165
	<i>Komiteti Shtetëror i Kulteve</i>	10
	<i>Departamenti i Administratës Publike</i>	61
	<i>Shkolla Shqiptare e Administratës Publike</i>	23
	<i>Autoriteti Komb. Cert. Elektrikë (ACESK)</i>	24
	<i>Sekretariati Teknik i KEK</i>	6
	<i>Autoriteti Shtetëror Gjeohapësinor (ASIG)</i>	46
	<i>Avokatura e Shtetit</i>	107
	<i>Agjencia Kombëtare e Rinisë</i>	20
	<i>Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës</i>	73
	<i>Ajencinë për Media dhe Informim</i>	69
88	Mbështetje për shoqërinë civile	16
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	49
90	Komisioni i Prokurimit Publik	36
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	34
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	19
95	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit	65
	Total punonjës buxhetorë	84,526
	<i>Rezervë për institucione të qeverisjes qendrore</i>	50
	Total numri i punonjësve	84,576



Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2022

Tab.3

Në mijë lekë

Nr.	Bashkitë	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 2022	Shtesë nga Kuvendi, “Transferti e pakushtëzuar për vitin 2022”	Shtesë me AN “Transferti e pakushtëzuar”	Transferrat e pakushtëzuara sektoriale															Totali
					Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor			Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Shtese me AN për Mbrojtjen nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i pyjeve	Shtesë nga Kuvendi për Administrimin e Pyjeve	Rrugët	Ujitja dhe kullimi	Klubet shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”	Shtesë nga Kuvendi “Transferti e pakushtëzuar sektoriale për investime në rrugë”	Shtesë nga Kuvendi “Për menaxhimin e mbetjeve urbane”	
						Ndarë me formulë për personelin mësimor	Shtese me AN për Arsimin parashkollor	Për stafin mbështetës												
1	Belsh	124,983			0	27,491		1,551	1,284	13,866		0	931		8,483	10,563	0		2,800	191,953
2	Berat	308,280			27,665	109,155		40,336	14,546	32,725		23,984	5,893		5,228	15,699	0		0	583,510
3	Bukqizë	273,559		10,000	0	54,979		10,104	0	20,003		0	15,004		30,955	14,155	0		0	428,759
4	Cërrik	148,346			4,644	46,651		5,566	5,882	16,041		0	2,327		1,948	16,927	0		6,100	254,432
5	Delvinë	67,724			0	20,909		5,042	1,863	13,997		0	2,655		3,654	10,563	0		0	126,407
6	Devoll	199,230			0	55,734		3,549	2,595	14,238		0	4,702		11,254	12,107	0		0	303,409
7	Dibër	425,819			24,326	128,198		29,747	9,921	26,436		0	8,606		15,173	14,927	0		0	683,153
8	Divjakë	220,870			0	55,459		1,513	1,358	13,276		0	936		8,403	31,499	0		0	333,314
9	Dropull	83,191			0	2,795		524	1,180	13,866		0	4,647		5,440	6,576	0		0	118,218
10	Durrës	877,905			22,977	197,350		50,924	19,539	51,851		0	3,341		25,934	47,422	0		221,600	1,518,844
11	Elbasan	711,855			28,749	228,936		58,487	34,484	36,089		21,333	12,681		18,878	15,699	0		16,800	1,183,990
12	Fier	618,189			21,500	174,483		41,848	11,439	35,439	6,000	27,040	4,211		9,205	61,953	0		0	1,011,308
13	Finiq	125,140			0	9,058		1,537	0	16,276			3,718		3,032	16,470	0		0	175,232
14	Fushë Arrëz	81,069			0	23,703		10,084	4,803	21,041		0	20,298		14,508	2,984	0		900	179,390
15	Gjirokastrë	219,985			18,262	82,347		25,210	6,287	30,619		0	7,335		8,278	10,168	0		0	408,491
16	Gramsh	223,688			6,524	71,310		9,075	3,861	17,837		0	16,101		20,988	10,563	0		3,800	383,747
17	Has	148,628			6,800	34,074		3,549	3,060	15,753		0	9,279	5,000	1,721	10,563	0		0	238,428
18	Himarë	124,998			0	15,110		1,028	645	16,399		0	8,224		4,821	10,563	0		0	181,787
19	Kamzë	526,497			0	188,930	25,000	31,700	10,442	49,677		0	572		0	3,756	0		35,000	871,574
20	Kavajë	226,373			12,856	72,864		17,143	6,845	17,721		0	936		6,052	20,834	0		53,400	435,024
21	Këlcyrë	62,850	8,000		0	8,408		1,513	2,964	14,041		0	3,313		8,278	10,563	0		0	119,931
22	Klos	144,730			0	27,152		5,546	1,877	13,866		0	7,866		10,867	2,984	0		0	214,888
23	Kolonjë	124,983			9,820	33,376		5,546	4,254	16,657		0	16,261		9,639	18,843	0		0	239,379
24	Konispol	62,899			0	11,190		1,551	0	13,866		0	1,810		1,866	11,335	0	50,000	0	154,517
25	Korçë	462,077			22,114	147,076		43,865	19,592	31,163		0	15,805		7,067	47,566	0		0	796,325
26	Krujë	295,925			0	85,114		16,658	3,778	19,777		0	6,247		7,679	17,242	0		38,000	490,418
27	Kuçovë	168,659			0	61,519		18,655	7,243	15,195	2,650	1,535			2,174	14,155	0		0	291,785
28	Kukës	329,778			19,644	92,433		31,764	5,132	56,828		2,525	11,959		20,749	6,576	0		0	577,388
29	Kurbini	234,268			0	85,705		23,675	15,894	16,542		0	2,958		4,180	21,605	0		10,000	414,827
30	Lezhë	340,463			9,399	101,851		27,731	18,397	39,055		0	8,242		5,589	23,920	0		7,600	582,246
31	Libohovë	42,729			0	6,174		1,551	1,191	13,866		0	2,841		6,859	2,993	0		0	78,203
32	Librazhd	287,603			0	69,972		10,104	3,283	14,837		0	9,179		26,012	14,155	0		3,400	438,546
33	Lushnje	417,311			9,348	141,465		31,280	11,838	15,606		0	1,817		7,916	49,109	0		0	685,689
34	Malësi e Madhe	304,520			4,253	54,168	6,000	3,025	5,479	25,100	4,000	0	17,694		13,945	13,878	0		5,400	457,462
35	Maliq	309,640			0	80,163		4,072	10,732	13,866		0	6,038		9,368	41,659	0		0	475,539
36	Mallakastër	164,087			0	60,256		15,630	7,044	15,545		0	2,996		7,735	14,155	0		0	287,449
37	Mat	195,016			12,738	56,822		18,655	7,680	17,003		0	9,467		27,154	12,563	0		0	357,098



38	Memaliaj	107,766	5,000		0	32,753		5,042	7,762	14,066		0	3,432		4,730	2,993	0		0	183,543
39	Mirditë	207,162			22,116	49,138		17,134	7,880	19,827		0	16,000		20,224	16,155	0		0	375,635
40	Patos	134,575	5,000		0	43,404		12,605	3,717	19,045		0	1,144		1,949	15,741	0		0	237,180
41	Peqin	134,477			0	39,942		5,062	4,058	14,540		0	1,511		4,647	10,563	0	11,300		226,100
42	Përmet	122,060			6,634	22,510		5,042	4,947	17,412		0	6,079		7,332	10,563	0		0	202,580
43	Pogradec	371,147			0	134,639		7,583	9,930	19,645		0	18,041		22,001	11,335	0		0	594,321
44	Polican	102,099			0	27,559		6,935	5,334	15,407		0	4,181		3,684	3,793	0		0	168,992
45	Përrenjas	179,902			0	44,491		5,081	3,780	16,341		0	8,068		19,824	12,563	0	6,400		296,450
46	Pukë	115,050			13,822	31,735		12,605	7,680	19,495		0	13,048		6,945	2,984	0	2,500		225,863
47	Pustec	36,255	5,000		0	6,075		325	0	18,876		0	918		335	5,984	0		0	73,767
48	Roskovec	115,119			0	30,719		2,541	2,437	13,866		0	1,144		4,257	7,348	0		0	177,430
49	Rrogozhinë	148,325			0	32,372		6,070	2,477	13,276		0	1,486		0	10,563	0	15,300		229,869
50	Sarandë	134,873			18,567	45,797		13,109	3,796	18,999		0	2,716		0	6,576	0		0	244,433
51	Selenicë	176,714			0	28,218		4,558	10,022	15,866		0	4,767		2,955	16,555	0		0	259,654
52	Shijak	141,939			0	38,496		6,555	3,131	18,276		0	936		51	6,576	0	20,000		235,961
53	Shkodër	665,861			58,505	126,163	7,000	53,445	25,911	41,893		36,651	11,866		20,135	29,451	0	15,000		1,091,880
54	Skrapar	127,428			11,198	36,029		11,216	9,793	19,537			9,530		13,592	15,563	0	0		253,886
55	Tepelenë	86,777			6,800	33,566		8,067	3,690	14,412			5,302		6,622	2,988	0		0	168,225
56	Tiranë	2,523,451			90,860	620,016		261,174	91,645	119,614			10,353		21,270	22,506	32,000		0	3,792,888
57	Tropojë	212,844			0	44,046		11,596	3,738	17,452			15,578		9,369	3,484	0		0	318,108
58	Dimal	142,830			0	48,006		524	1,689	13,997			918		4,049	19,686	0		0	231,698
59	Vau i Dejës	230,732			8,813	40,685		1,047	2,457	13,276		19,958	6,944		6,134	12,878	0	2,100		345,025
60	Vlorë	565,117			26,042	209,457		66,049	33,264	43,796			6,279		2,920	41,600	0		0	994,525
61	Vorë	125,574			0	44,044		2,541	5,273	13,276			932		525	10,563	0	22,600		225,329
Totali		16,591,944	23,000	10,000	524,975	4,532,238	38,000	1,135,242	520,822	1,378,149	10,000	134,140	409,597	5,000	564,582	966,310	32,000	50,000	500,000	27,426,000



TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2022

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2022

në milion lekë (in million lek)

EMËRTIMI	Akti normativ 2022	Në % të PBB	ITEMS
TOTALI I TË ARDHURAVE	576,831	30.9%	TOTAL REVENUE
Të ardhura nga ndihmat	13,994	0.7%	Grants
<i>Nga të cilat: mbështetje buxhetore</i>	<i>2,994</i>	<i>0.2%</i>	<i>from which: Budget Support</i>
<i>Nga të cilat: grante për fondin e rindërtimit</i>			<i>from which: Reconstruction Fund</i>
<i>Nga të cilat: projekte të destinuara për investime</i>	<i>11,000</i>	<i>0.6%</i>	
Të ardhura tatimore	540,187	28.9%	Tax Revenue
Nga Tatimet dhe Doganat	395,000	21.2%	From tax offices and customs
Tatimi mbi vlerën e shtuar	190,000	10.2%	V.A.T
Tatimi mbi fitimin	46,000	2.5%	Profit Tax
Akcizat	55,000	2.9%	Excise Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	47,000	2.5%	Personal Income Tax
Taksa nacionale dhe të tjera	48,500	2.6%	National Taxes and others
Taksa doganore	8,500	0.5%	Customs Duties
Të ardhura nga pushteti vendor	27,632	1.5%	Local Taxes
Taksa lokale	21,445	1.1%	Local Taxes
Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	6,187	0.3%	Property Tax
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	0	0.0%	Simple profit tax of small business
Të ardhurat nga Fondet Speciale	117,555	6.3%	Revenues from Special Funds
Sigurimi shoqëror	100,795	5.4%	Social Insurance
Sigurimi shëndetësor	15,760	0.8%	Health insurance
Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,000	0.1%	Revenues for owners' in value-compensation
Të ardhura jotatimore	22,650	1.2%	Nontax Revenue
Tran.fitimi nga Banka e Shqipërisë	1,000	0.1%	Profit transfer from BOA
Të ardhura nga institucionet buxhetore	12,300	0.7%	Income of budgetary institutions
Dividenti	300	0.0%	Divident
Tarifat e shërbimeve	3,400	0.2%	Services Fees
Të tjera	5,650	0.3%	Others
TOTALI I SHPENZIMEVE	660,693	35.4%	TOTAL EXPENDITURE
Shpenzime korrente	504,802	27.0%	Current Expenditures
Personeli	88,972	4.8%	Personnel expenditures
Paga	73,828	4.0%	Wages
Kontributi për sigurime shoqërore	12,145	0.7%	Social insurance contributions
Fondi i veçantë i pagave	300	0.0%	Bonus fund
Politika të reja pagash	1,900	0.1%	Contingency for new wage policies
Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	800	0.0%	Higher Education from its own revenues
Interesat	50,757	2.7%	Interest
Të brendshme	27,363	1.5%	Domestic
Të huaja	18,593	1.0%	Foreign
Kontingjencë për risqet e borxhit	4,800	0.3%	Contingency for debt related risks
Shpenzime operative mirëmbajtje nga të cilat:	63,173	3.4%	Operational & Maintenance of which:
<i>Të qeverisjes qendrore</i>	<i>59,673</i>	<i>3.2%</i>	<i>Central government</i>
<i>Shpenzime nga të ardhurat e arsimit universitar</i>	<i>900</i>	<i>0.0%</i>	<i>From Universities own revenues</i>



	<i>Të tjera jashtë limitit</i>	2,600	0.1%	<i>from Exceptional Revenues</i>
Subvencionet		1,689	0.1%	Subsidies
Shpenzime për Fondet Speciale		212,271	11.4%	Social insurance outlays
Sigurime shoqërore		148,135	7.9%	Social insurance
Politika të reja pensionesh		3,300	0.2%	Contingency for new pension policies
Bonusi i pensionistëve		3,500	0.2%	Pensioners' Bonus
Sigurime shëndetësore		52,836	2.8%	Health insurance
Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve		4,500	0.2%	Expenditure for owners' in value-compensation
Shpenzime për buxhetin vendor		60,290	3.2%	Local Budget expenditure
Transferrat nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor		28,086	1.5%	Central Government Grant for Local Government
	<i>Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme</i>	<i>18,733</i>	<i>1.0%</i>	<i>Unconditional Fund</i>
	<i>Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (grant specifike)</i>	<i>9,353</i>	<i>0.5%</i>	<i>Specific Grant</i>
Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)		27,632	1.5%	Local Budget (Own revenues)
Taksa të ndara		1,040	0.1%	Local Budget (from shared taxes revenues)
Buxheti vendor (të ardhurat e veta jotatimore)		2,840	0.2%	Local Budget (from non-tax revenues)
Financimi i huaj vendor		692	0.0%	Local foreign financing
Shpenzime të tjera		27,650	1.5%	Other expenditures
Pagesa e papunësisë		900	0.0%	Unemployment insurance benefits
Ndihma ekonomike dhe paaftësia		23,550	1.3%	Social assistance and disability
Kompensim për ish-të përndjekurit politikë		1,000	0.1%	Compensation for ex political prisoners
Bonusi i lindjeve		2,200	0.1%	Birth Bonus
Fondi rezervë		15,450	0.8%	Reserve fund, Contingency
Fondi rezerve i buxhetit		3,350	0.2%	Reserve Fund
Kontigjenca për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës		12,100	0.6%	Anti-Crisis Contingency
Shpenzime kapitale		112,441	6.0%	Capital expenditures
Financimi i brendshëm		58,539	3.1%	Domestic financing
Investime nga të ardhurat e arsimit të lartë		1,000	0.1%	From Higher Education System's own revenues
Financimi huaj		33,902	1.8%	Foreign financing
	<i>nga të cilat: Energjia</i>	<i>2,100</i>	<i>0.1%</i>	<i>from which: Energy</i>
Fondi i rindërtimit		20,000	1.1%	Reconstruction Fund
Transfertë kapitale për llogarinë speciale të shpronësimeve		1,000	0.1%	Expropriation Fund
Kthim kapitali nga AIC		-2,000	-0.1%	Capital return from AIC
Të tjera		28,000	1.5%	Other
Hua e dhënë për energjinë		8,000	0.4%	Borrowing to Energy Sector
Mbështetje buxhetore për sektorin energjetik		20,000	1.1%	Budget support for Energy Sector
DEFICITI		-83,863	-4.5%	Cash Balance
FINANCIMI DEFICITIT		83,863	4.5%	Financing (Cash)
Brendshëm		83,383	4.5%	Domestic
Të ardhura nga privatizimi		0	0.0%	Privatization receipts
Huamarrje e brendshme		33,000	1.8%	Domestic borrowing
Të tjera		50,383	2.7%	Other
I huaj		480	0.0%	Foreign
Hua afatgjatë (e marrë)		23,652	1.3%	Long-term Loan(Drawings)
Ndryshimi i gjendjes së arkës				Chang. of stat. Account
Ripagesat		-42,529	-2.3%	Repayments
Mbështetje buxhetore		19,357	1.0%	Budget support
Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)		1,867,351	100.0%	Gross Domestic Product (GDP)



ANEKS NR. 5
PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME

Për kontraktimin e punonjësve me kohë të pjesshme mbi numrin organik të punonjësve të institucioneve buxhetore për vitin 2022, ndiqen këto rregulla:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme miratohet nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet propozimit të Ministrit përgjegjës për Financat.

2. Institucioni duhet të ketë fondet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të personelit të kontraktuar.

3. Veprimtaria që kryejnë punonjësit me kontratë është kryesisht veprimtari e njësisë strukturore mbështetëse/rregullatore/shërbimi të institucionit dhe në asnjë rast veprimtari inspektuese apo audituese.

4. Kontraktimi i punonjësve bëhet në përputhje me kriteret e parashikuara për atë pozicion pune, për një periudhë kohore deri në 6 muaj gjatë një viti buxhetor me kohë pune ditore të plotë, ose deri në 6 orë në ditë përgjatë vitit buxhetor. Përjashtim nga ky përcaktim, bën kontraktimi i punonjësve që kryejnë një veprimtari që realizon të ardhura dytësore, përdorimi i të cilave parashikohet në ligjin vjetor të buxhetit, për këtë qëllim.

5. Pagesa e punonjësve me kontratë të përkohshme, përcaktohet në referencë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pozicionin për të cilin ai kontraktohet. Për pozicionin “Specialist”, paga e punonjësit me kontratë të përkohshme në institucionet e pavarura dhe aparatet e ministrive nuk kalon nivelin e kategorisë IV-a dhe në institucionet në varësi të tyre, nivelin e kategorisë IV-b.

Në rast se pozicioni ka shtesa specifike mbi pagën e kategorisë/klasës përkatëse, ato nuk përfitohen nga punonjësi me kontratë të përkohshme, me përjashtim të shtesës mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin.

6. Përjashtim nga këto rregulla bëjnë punonjësit e përkohshëm të Kryeministrit, të cilët kontraktohen sipas urdhrit të Kryeministrit/Sekretarit të Përgjithshëm në Kryeministri dhe i shtrijnë efektet financiare nga data 1 korrik 2022.

7. Pagesa bëhet në përputhje me procedurat e kryerjes së pagesave për punonjësit organik dhe përfshihet në shpenzimet e personelit të

institucionit. Përjashtim nga ky rregull, bëjnë anketuesit/kontrollorët e terrenit të kontraktuar në realizimin e Census-it dhe anketimeve afatshkurta (më pak se dy javë) si dhe operatorët teknik për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit në qendrat e votimit, pagesa e të cilëve e bazuar në ditët e punës, do të përfshihet në shpenzimet operative të institucionit.

8. Në raste specifike që lidhen me mësimdhënien, veprimtarinë bujqësore, veprimtarinë statistikore, rregullat dhe procedurat e marrjes në punë të punonjësve me kontratë përcaktohen nëpërmjet udhëzimit të përbashkët të miratuar mes institucionit qendror përgjegjës dhe Ministrisë përgjegjëse për Financat.

VENDIM

Nr. 496, datë 27.7.2022

**PËR NGARKIMIN E FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI
AUTORITET KONTRAKTOR PËR
KRYERJEN E PROCEDURËS SË
PROKURIMIT PUBLIK PËR ZBATIMIN
E PROJEKTIT TË OBORRIT TË
KRYEMINISTRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për zbatimin e projektit të oborrit të Kryeministrit.

2. Në funksion të zbatimit të projektit të përcaktuar në pikën 1, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ngarkohet të kryejë:

a) të gjitha procedurat sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratën përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e saj dhe të projektit përkatës;

b) paraqitjen, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, të kërkesave për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit pranë autoritetit të zhvillimit të territorit, si dhe ndjekjen e të gjitha veprimeve e procedurave të nevojshme për këtë



qëllim, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Këtu përfshihet edhe marrja e miratimeve paraprake nga autoritetet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

3. Kryeministria i vendos në dispozicion Fondit Shqiptar të Zhvillimit paketën e projektit teknik, shoqëruar me preventivin, të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në bashkëpunim me Institutin e Ndërtimit.

4. Fondi Shqiptar i Zhvillimit i paraqet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesën për të hartuar dhe ndërmarrë nismën për alokimin e fondeve të nevojshme për zbatimin e projektit pranë tij.

5. Ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 497, datë 27.7.2022

**PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN,
ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË DHE
RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË
KOMITETIT KOMBËTAR PËR
ZHVILLIMIN RAJONAL DHE
KOHEZIONIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 4, të nenit 17, të ligjit nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, këtu e në vijim “KKZHRK”, si dhe miratimin e përbërjes, mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij.

2. KKZHRK-ja është organ ndër-institucional, përgjegjës për hartimin, monitorimin e zbatimit dhe vlerësimin e politikës së zhvillimit rajonal, si dhe koordinimin e zbatimit të masave të ndërmarra në

kuadër të programit operacional për zhvillimin rajonal.

3. KKZHRK-ja ka stemën e vet zyrtare.

4. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”, në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

II. KOMPETENCAT, PËRBËRJA DHE DREJTIMI I KKZHRK-së

1. KKZHRK-ja ka këto kompetenca:

a) harton dhe miraton paraprakisht politikën e zhvillimit rajonal dhe kohezionit, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) harton dhe miraton paraprakisht Planin Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) shqyrton dhe miraton paraprakisht planet rajonale të zhvillimit rajonal dhe kohezionit, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

4	Godina 1	Nj. nd. nën tokë	4	-1	1		10	28.1	38.1
5	Godina 1	Nj. nd. nën tokë	5	-1	1		10	28.1	38.1
6	Godina 1	Nj. nd. nën tokë	6	-1	1		10	28.1	38.1
7	Godina 1	Nj. nd. nën tokë	7	-1	1		10	28.1	38.1
8	Godina 1	Nj. nd. nën tokë	8	-1	1		10	28.1	38.1
9	Godina 1	Nj. nd. nën tokë	9	-1	1		10	28.1	38.1
10	Godina 1	Nj. nd. nën tokë	10	-1	1		10	28.1	38.1
KATI -I							100	281	381
11	Godina 2	Nj. nd. nën tokë	11	-1	2		10	28.1	38.1
12	Godina 2	Nj. nd. nën tokë	12	-1	2		10	28.1	38.1
13	Godina 2	Nj. nd. nën tokë	13	-1	2		10	28.1	38.1
14	Godina 2	Nj. nd. nën tokë	14	-1	2		10	28.1	38.1
15	Godina 2	Nj. nd. nën tokë	15	-1	2		10	28.1	38.1
16	Godina 2	Nj. nd. nën tokë	16	-1	2		10	28.1	38.1
17	Godina 2	Nj. nd. nën tokë	17	-1	2		10	28.1	38.1
18	Godina 2	Nj. nd. nën tokë	18	-1	2		10	28.1	38.1
19	Godina 2	Nj. nd. nën tokë	19	-1	2		10	28.1	38.1
20	Godina 2	Nj. nd. nën tokë	20	-1	2		10	28.1	38.1
KATI -I							100	281	381
21	Godina 3	Nj. nd. nën tokë	21	-1	3		10	28.1	38.1



22	Godina 3	Nj. nd. nën tokë	22	-1	3		10	28.1	38.1
23	Godina 3	Nj. nd. nën tokë	23	-1	3		10	28.1	38.1
24	Godina 3	Nj. nd. nën tokë	24	-1	3		10	28.1	38.1
25	Godina 3	Nj. nd. nën tokë	25	-1	3		10	28.1	38.1
26	Godina 3	Nj. nd. nën tokë	26	-1	3		10	28.1	38.1
27	Godina 3	Nj. nd. nën tokë	27	-1	3		10	28.1	38.1
28	Godina 3	Nj. nd. nën tokë	28	-1	3		10	28.1	38.1
29	Godina 3	Nj. nd. nën tokë	29	-1	3		10	28.1	38.1
30	Godina 3	Nj. nd. nën tokë	30	-1	3		10	28.1	38.1
KATI -I							100	281	381
31	Godina 4	Nj. nd. nën tokë	31	-1	4		10	28.1	38.1
32	Godina 4	Nj. nd. nën tokë	32	-1	4		10	28.1	38.1
33	Godina 4	Nj. nd. nën tokë	33	-1	4		10	28.1	38.1
34	Godina 4	Nj. nd. nën tokë	34	-1	4		10	28.1	38.1
35	Godina 4	Nj. nd. nën tokë	35	-1	4		10	28.1	38.1
36	Godina 4	Nj. nd. nën tokë	36	-1	4		10	28.1	38.1
37	Godina 4	Nj. nd. nën tokë	37	-1	4		10	28.1	38.1
38	Godina 4	Nj. nd. nën tokë	38	-1	4		10	28.1	38.1
39	Godina 4	Nj. nd. nën tokë	39	-1	4		10	28.1	38.1
40	Godina 4	Nj. nd. nën tokë	40	-1	4		10	28.1	38.1
KATI -I							100	281	381
41	Godina 5	Nj. nd. nën tokë	41	-1	5		10	28.1	38.1
42	Godina 5	Nj. nd. nën tokë	42	-1	5		10	28.1	38.1
43	Godina 5	Nj. nd. nën tokë	43	-1	5		10	28.1	38.1
44	Godina 5	Nj. nd. nën tokë	44	-1	5		10	28.1	38.1
45	Godina 5	Nj. nd. nën tokë	45	-1	5		10	28.1	38.1
46	Godina 5	Nj. nd. nën tokë	46	-1	5		10	28.1	38.1
47	Godina 5	Nj. nd. nën tokë	47	-1	5		10	28.1	38.1
48	Godina 5	Nj. nd. nën tokë	48	-1	5		10	28.1	38.1
49	Godina 5	Nj. nd. nën tokë	49	-1	5		10	28.1	38.1
50	Godina 5	Nj. nd. nën tokë	50	-1	5		10	28.1	38.1
KATI -I							100	281	381
51	Godina 6	Nj. nd. nën tokë	51	-1	6		10	28.1	38.1
52	Godina 6	Nj. nd. nën tokë	52	-1	6		10	28.1	38.1
53	Godina 6	Nj. nd. nën tokë	53	-1	6		10	28.1	38.1
54	Godina 6	Nj. nd. nën tokë	54	-1	6		10	28.1	38.1
55	Godina 6	Nj. nd. nën tokë	55	-1	6		10	28.1	38.1
56	Godina 6	Nj. nd. nën tokë	56	-1	6		10	28.1	38.1
57	Godina 6	Nj. nd. nën tokë	57	-1	6		10	28.1	38.1
58	Godina 6	Nj. nd. nën tokë	58	-1	6		10	28.1	38.1
59	Godina 6	Nj. nd. nën tokë	59	-1	6		10	28.1	38.1
60	Godina 6	Nj. nd. nën tokë	60	-1	6		10	28.1	38.1
KATI -I							126.72	240.35	367.07
61	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	1	-1	1		11.52	21.85	33.37
62	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	2	-1	1		11.52	21.85	33.37
63	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	3	-1	1		11.52	21.85	33.37
64	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	4	-1	1		11.52	21.85	33.37
65	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	5	-1	1		11.52	21.85	33.37
66	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	6	-1	1		11.52	21.85	33.37
67	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	7	-1	1		11.52	21.85	33.37
68	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	8	-1	1		11.52	21.85	33.37
69	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	9	-1	1		11.52	21.85	33.37
70	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	10	-1	1		11.52	21.85	33.37
71	Godina 7	Nj. nd. nën tokë	11	-1	1		11.52	21.85	33.37
KATI -I							115.2	218.5	333.7
72	Godina 8	Nj. nd. nën tokë	12	-1	2		11.52	21.85	33.37
73	Godina 8	Nj. nd. nën tokë	13	-1	2		11.52	21.85	33.37
74	Godina 8	Nj. nd. nën tokë	14	-1	2		11.52	21.85	33.37
75	Godina 8	Nj. nd. nën tokë	15	-1	2		11.52	21.85	33.37
76	Godina 8	Nj. nd. nën tokë	16	-1	2		11.52	21.85	33.37
77	Godina 8	Nj. nd. nën tokë	17	-1	2		11.52	21.85	33.37
78	Godina 8	Nj. nd. nën tokë	18	-1	2		11.52	21.85	33.37
79	Godina 8	Nj. nd. nën tokë	19	-1	2		11.52	21.85	33.37
80	Godina 8	Nj. nd. nën tokë	20	-1	2		11.52	21.85	33.37
81	Godina 8	Nj. nd. nën tokë	21	-1	2		11.52	21.85	33.37
KATI -I							103.68	196.65	300.33
82	Godina 9	Nj. nd. nën tokë	22	-1	3		11.52	21.85	33.37
83	Godina 9	Nj. nd. nën tokë	23	-1	3		11.52	21.85	33.37
84	Godina 9	Nj. nd. nën tokë	24	-1	3		11.52	21.85	33.37
85	Godina 9	Nj. nd. nën tokë	25	-1	3		11.52	21.85	33.37
86	Godina 9	Nj. nd. nën tokë	26	-1	3		11.52	21.85	33.37



87	Godina 9	Nj. nd. nën tokë	27	-1	3		11.52	21.85	33.37
88	Godina 9	Nj. nd. nën tokë	28	-1	3		11.52	21.85	33.37
89	Godina 9	Nj. nd. nën tokë	29	-1	3		11.52	21.85	33.37
90	Godina 9	Nj. nd. nën tokë	30	-1	3		11.52	21.85	33.37
KATI -1							126.72	240.35	367.07
91	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	1	-1	1		11.52	21.85	33.37
92	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	2	-1	1		11.52	21.85	33.37
93	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	3	-1	1		11.52	21.85	33.37
94	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	4	-1	1		11.52	21.85	33.37
95	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	5	-1	1		11.52	21.85	33.37
96	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	6	-1	1		11.52	21.85	33.37
97	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	7	-1	1		11.52	21.85	33.37
98	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	8	-1	1		11.52	21.85	33.37
99	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	9	-1	1		11.52	21.85	33.37
100	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	10	-1	1		11.52	21.85	33.37
101	Godina 10	Nj. nd. nën tokë	11	-1	1		11.52	21.85	33.37
KATI -1							115.2	218.5	333.7
102	Godina 11	Nj. nd. nën tokë	12	-1	2		11.52	21.85	33.37
103	Godina 11	Nj. nd. nën tokë	13	-1	2		11.52	21.85	33.37
104	Godina 11	Nj. nd. nën tokë	14	-1	2		11.52	21.85	33.37
105	Godina 11	Nj. nd. nën tokë	15	-1	2		11.52	21.85	33.37
106	Godina 11	Nj. nd. nën tokë	16	-1	2		11.52	21.85	33.37
107	Godina 11	Nj. nd. nën tokë	17	-1	2		11.52	21.85	33.37
108	Godina 11	Nj. nd. nën tokë	18	-1	2		11.52	21.85	33.37
109	Godina 11	Nj. nd. nën tokë	19	-1	2		11.52	21.85	33.37
110	Godina 11	Nj. nd. nën tokë	20	-1	2		11.52	21.85	33.37
111	Godina 11	Nj. nd. nën tokë	21	-1	2		11.52	21.85	33.37
KATI -1							103.68	196.65	300.33
112	Godina 12	Nj. nd. nën tokë	22	-1	3		11.52	21.85	33.37
113	Godina 12	Nj. nd. nën tokë	23	-1	3		11.52	21.85	33.37
114	Godina 12	Nj. nd. nën tokë	24	-1	3		11.52	21.85	33.37
115	Godina 12	Nj. nd. nën tokë	25	-1	3		11.52	21.85	33.37
116	Godina 12	Nj. nd. nën tokë	26	-1	3		11.52	21.85	33.37
117	Godina 12	Nj. nd. nën tokë	27	-1	3		11.52	21.85	33.37
118	Godina 12	Nj. nd. nën tokë	28	-1	3		11.52	21.85	33.37
119	Godina 12	Nj. nd. nën tokë	29	-1	3		11.52	21.85	33.37
120	Godina 12	Nj. nd. nën tokë	30	-1	3		11.52	21.85	33.37
Banasa Kolektive Njësia Administrative Fushe-Krui, Krujë. Kabina Elektrike (Godina 1,6,7,10)									
Nr	Emërtimi i objektit	Tipologjia	Nr.	Kati	Shkalla	Sip. neto (m²)	Sip. totale (m²)	Sip. e përbashkët(m²)	Sip. totale përfshirë sip. e përbashkët (m²)
KATI 0									
1	Godina 1	Kabinë Elektrike	1	0	1	14.7	18.60		18.60
KATI 0									
2	Godina 6	Kabinë Elektrike	2	0	6	14.7	18.60		18.60
KATI 0									
3	Godina 7	Kabinë Elektrike	3	0	7	11.81	15.12		15.12
KATI 0									
3	Godina 10	Kabinë Elektrike	4	0	10	11.81	15.12		15.12
Bashkia Durrës									
Lista Inventarit për Banasa Kolektive Njësia Administrative Manzë, Durrës Njësi Shërbimi Objektet (A1, A5, B1, B2)									
KATI 0							129.03	148.95	11.31
1	Objekti A1	Shërbime	1	0	1	37.61	42.82	3.25	46.07
2	Objekti A1	Shërbime	2	0	1	23.9	27.70	2.10	29.80
3	Objekti A1	Shërbime	3	0	1	67.52	78.43	5.96	84.39
KATI 0							130.3	141.1	26.24
1	Objekti A5	Shërbime	1	0	B	23.9	26.8	4.98	31.78
2	Objekti A5	Shërbime	1	0	B	38.1	41.5	7.72	49.22
3	Objekti A5	Shërbime	1	0	B	68.3	72.8	13.54	86.34
KATI 0							601.03	204.04	805.07
1	Objekti B1	Shërbime	1	0	1	59.3	66.36	22.53	88.89
2	Objekti B1	Shërbime	2	0	1	25.62	30.6	10.39	40.99
3	Objekti B1	Sallë polivalente	3	0	2	88.88	98.5	33.44	131.94
4	Objekti B1	Sallë polivalente	4	0	2	86.5	97.65	33.15	130.8
5	Objekti B1	Sallë polivalente	5	0	3	86.5	97.65	33.15	130.8
6	Objekti B1	Sallë polivalente	6	0	3	88.4	98.06	33.29	131.35
7	Objekti B1	Sallë polivalente	7	0	4	24.94	29.72	10.09	39.81
8	Objekti B1	Shërbime	8	0	4	71.15	82.49	28	110.49
KATI 0							536.5	608.5	180.3
1	Objekti B2	Shërbime	1	0	1	71	82.6	24.5	107.1
2	Objekti B2	Shërbime	2	0	1	25	30.7	9.1	39.8



3	Objekti B2	Shërbime	3	0	2	87	98.6	29.2	127.8
4	Objekti B2	Shërbime	4	0	2	173	195.3	57.9	253.2
5	Objekti B2	Shërbime	5	0	3	88	98.6	29.2	127.8
6	Objekti B2	Shërbime	6	0	4	26	31.7	9.4	41.1
7	Objekti B2	Shërbime	7	0	4	66.5	71	21	92

Bashkia Kamzë

Lista Inventarit për Banesa Kolektive Njësia Administrative Valias, Kamzë Njësi Shërbimi Objektet (1-12)

KATI 0					25.32	30.72		
1	GODINA 1	Nj. shërbimi	1	0	25.32	30.72		
KATI 0					150.21	165.14		
1	GODINA 2	Nj. shërbimi	2	0	45.25	51.06		
2	GODINA 2	Nj. shërbimi	3	0	52.48	57.04		
3	GODINA 2	Nj. shërbimi	4	0	52.48	57.04		
KATI 0					76.56	87.12		
1	GODINA 3	Nj. shërbimi	1	0	39.3	44.62		
2	GODINA 3	Nj. shërbimi	2	0	37.26	42.50		
KATI 0					76.56	87.12		
1	GODINA 4	Nj. shërbimi	1	0	39.3	44.62		
2	GODINA 4	Nj. shërbimi	2	0	37.26	42.50		
KATI 0					150.21	165.14		
1	GODINA 5	Nj. shërbimi	2	0	45.25	51.06		
2	GODINA 5	Nj. shërbimi	3	0	52.48	57.04		
3	GODINA 5	Nj. shërbimi	4	0	52.48	57.04		
KATI 0					76.56	87.12		
1	GODINA 6	Nj. shërbimi	1	0	39.3	44.62		
2	GODINA 6	Nj. shërbimi	2	0	37.26	42.50		
KATI 0					76.56	87.12		
1	GODINA 7	Nj. shërbimi	1	0	39.3	44.62		
2	GODINA 7	Nj. shërbimi	2	0	37.26	42.50		
KATI 0					150.21	165.14		
1	GODINA 8	Nj. shërbimi	2	0	45.25	51.06		
2	GODINA 8	Nj. shërbimi	3	0	52.48	57.04		
3	GODINA 8	Nj. shërbimi	4	0	52.48	57.04		
KATI 0					76.56	87.12		
1	GODINA 9	Nj. shërbimi	1	0	39.3	44.62		
2	GODINA 9	Nj. shërbimi	2	0	37.26	42.50		
KATI 0					76.56	87.12		
1	GODINA 10	Nj. shërbimi	1	0	39.3	44.62		
2	GODINA 10	Nj. shërbimi	2	0	37.26	42.50		
KATI 0					150.21	165.14		
1	GODINA 11	Nj. shërbimi	2	0	45.25	51.06		
2	GODINA 11	Nj. shërbimi	3	0	52.48	57.04		
3	GODINA 11	Nj. shërbimi	4	0	52.48	57.04		
KATI 0					25.32	30.72		
1	GODINA 12	Nj. shërbimi	1	0	25.32	30.72		

Bashkia Kavajë

Banesa Kolektive Njësia Administrative Kavajë Njësi Shërbimi (Objektet 1.3, 2.2, 2.3)

Nr.	Emërtimi i objektit	Tipologjia	Nr.	Kati	Shkalla	Sip. neto (m²)	Sip. totale (m²)	Sip. e përbashkët (m²)	Sip. totale përfshirë sip. e përbashkët (m²)
KATI 0						418.78	455.56	129.24	584.80
1	Objekti 1.3	Nj. shërbimi	1	0	1	89.96	98.74	28.01	126.75
2	Objekti 1.3	Nj. shërbimi	2	0	2	149.42	163.56	46.40	209.96
3	Objekti 1.3	Nj. shërbimi	3	0	3	179.4	193.26	54.83	248.09
KATI 0						543.19	615.79		615.79
1	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	01	0	1	88.97	99.48		99.48
2	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	02	0	1	46.70	53.16		53.16
3	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	03	0	1	58.68	65.32		65.32
4	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	04	0	2	30.54	35.72		35.72
5	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	05	0	2	29.49	34.34		34.34
6	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	06	0	2	55.71	62.21		62.21
7	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	07	0	2	45.18	51.38		51.38
8	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	08	0	3	30.12	35.28		35.28
9	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	09	0	3	66.83	74.80		74.80
10	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	10	0	3	34.40	40.10		40.10
11	Objekti 2.2	Nj. shërbimi	11	0	3	56.57	64.00		64.00
KATI 0						1082.51			1181.51
1	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	01	0	1	106.68	118.85		118.85
2	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	02	0	1	35.60	40.95		40.95
3	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	03	0	2	69.26	76.1		76.1
4	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	04	0	2	94.31	103.2		103.2



5	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	05	0	2	75.80	84.40		84.40
6	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	06	0	3	101.20	110.40		110.40
7	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	07	0	3	99.90	110.90		110.90
8	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	08	0	4	51.90	59.00		59.00
9	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	09	0	4	63.38	69.67		69.67
10	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	10	0	4	193.30	206.40		206.40
11	Objekti 2.3	Nj. shërbimi	11	0	5	191.18	201.64		201.64

Bashkia Krujë

Lista e Inventarit për Banesa Kolektive Njësia Administrative Fushë-Krujë_Njësi Shërbimi Objektet (G1-G12)

Nr.	Emërtimi i objektit	Tipologjia	Nr.	Kati	Shkalla	Sip. neto (m ²)	Sip. totale (m ²)	Sip. e përbashkët (m ²)	Sip. totale përfshirë sip. e përbashkët (m ²)
KATI 0									
1	Godina 1	Shërbime	1	0	1	16	20.00		20.00
KATI 0									
2	Godina 2	Shërbime	1	0	1	16	20.00		20.00
KATI 0									
3	Godina 3	Shërbime	1	0	1	16	20.00		20.00
KATI 0									
4	Godina 4	Shërbime	1	0	1	16	20.00		20.00
KATI 0									
5	Godina 5	Shërbime	1	0	1	16	20.00		20.00
KATI 0									
6	Godina 6	Shërbime	1	0	1	16	20.00		20.00
KATI 0									
7	Godina 7	Shërbime	1	0	1	21.76	26.42		26.42
KATI 0									
8	Godina 8	Shërbime	1	0	1	21.76	26.42		26.42
KATI 0									
9	Godina 9	Shërbime	1	0	1	18	21.9		21.9
KATI 0									
7	Godina 10	Shërbime	1	0	1	21.76	26.42		26.42
KATI 0									
8	Godina 11	Shërbime	1	0	1	21.76	26.42		26.42
KATI 0									
9	Godina 12	Shërbime	1	0	1	18	21.9		21.9

VENDIM

Nr. 506, datë 27.7.2022

PËR KALIMIN TE BASHKITË TIRANË
DHE DURRËS TË OBJEKTEVE
ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te bashkitë Tiranë dhe Durrës të 11 (njëmbëdhjetë) objekteve arsimore, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Tiranë dhe Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Bashkia Durrës

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Tipologjia e Ndërrhyrjes	Financimi i ndërtimit	Sipërfaqe (m ²)
1	Bashkia Durrës	Durrës	Durrës	9-vjeçare	Shaqe Mazreku	Ndërtim	Buxhet GoA	3,305.0
2	Bashkia Durrës	Durrës	Ishëm	9-vjeçare	Vellezerit Haradinaj	Ndërtim	Buxhet GoA	4,074.0
3	Bashkia Durrës	Durrës	Durrës	9-vjeçare + kopsht	Bedrie Bebeziqi	Ndërtim	Buxhet GoA	2,107.0
4	Bashkia Durrës	Durrës	Sukth	9-vjeçare	Njazi Mastori 1+2+3	Ndërtim	Buxhet GoA	5,725.0
5	Bashkia Durrës	Durrës	Sukth	filllore + kopsht	Perlat	Ndërtim	Buxhet GoA	770.0
TOTAL								15,981.0



BASHKIA TIRANË											
Nr.	Emërtimi i kontratës	Objekti	Njësia Administrative	Vlera e objektit sipas kontratës (ndërtim montim+ studim projektim)	Vlera e kontraktuar e mbikëqyrësit të punimeve	Vlera e kontraktuar e kolaudatorit të punimeve	Sipërfaqe e katit përdhës	Sipërfaqe total ndërtimi (m ²)	Nr. i klasave/grupeve	Nr. i laboratorëve	Sipërfaqe trualli
1	Ndërtimi i Kopshtit, "Fikas".	Kopshti "Fikas"	Petrelë	19,893,024	218,202	19,893,024	198	395	3		263
2	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare, "Hasan Vogli"	Shkolla "Hasan Vogli"	9	253,492,727	1,917,024	101,390	1,376	4,748	24	4	1,780
3	"Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Mangull"	Shkolla Mangull	Petrelë	101,800,000	838,584	50,717	836	1,865	9	5	2,136
4	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare, "Murat Toptani"	Shkolla "Murat Toptani"	5	180,549,814	1,403,417	75,730	679	2,120	10	4	1,433
5	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare, "Pezë e Vogël"	Shkolla "Pezë e Vogël"	Pezë	110,068,839	914,101	53,900	1,305	1,971	10	4	5,575
6	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare "Qazim Turdiu"	Shkolla "Qazim Turdiu"	9	362,713,599	2,681,976	145,000	2,473	7,076	34	4	6,047
TOTAL				1,028,518,003	7,973,304	20,319,761	6,866	18,175	90	21	17,234

VENDIM

Nr. 507, datë 27.7.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 597, DATË 13.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE DHE OBJEKTEVE TË TJERA, QË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja "d", e 2, të nenit 12, të ligjit nr. 33/2021, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën "b", të pikës 2, të vendimit nr. 597, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, pas nënndarjes "ii" shtohen nënndarjet "iii" dhe "iv", me këtë përmbytje:

"iii. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

iv. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar."

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 508, datë 27.7.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 72, DATË 2.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS PËR VITIN 2022"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Shtojcat 2 dhe 3, të përmendura në pikën 1, të vendimit nr. 72, datë 2.2.2022, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me shtojcat me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



SHTOJCA 2
BUXHETI I AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS JANAR-DHJETOR 2022
I RISHIKUAR

Në 000/ lekë

Përshkrimi	Buxheti janar–dhjetor 2022	
	Të ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga shërbimet + parcela ndërtimore	6,121,571	
Fonde të akorduara nga buxheti i shtetit	652,000	
Shpenzime personeli		2,315,190
Shpenzime korrente		720,000
Transferta për Qendrën e Kadastrës Digjitale		652,000
Shpenzime kapitale		1,789,662
Fondi rezervë		104,700
Total	6,773,571	5,581,552
Teprica (1)-(2)		1,192,019

SHTOJCA 3
BUXHETI I AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS JANAR-DHJETOR 2022
I RISHIKUAR

Nr.	Emërtimi	Buxheti janar–dhjetor 2022 (i rishikuar)
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	6,773,571
1	Të ardhura nga shërbimet	1,800,000
2	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	300,000
3	Të ardhura të tjera	280,000
4	Fonde që trashëgoohen nga viti 2021	3,741,571
5	Fonde të akorduara nga buxheti i shtetit	652,000
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	5,581,552
1	Shpenzime personeli	2,315,190
1	Paga për punonjësit sipas strukturës organike të propozuar	1,348,509
2	Kontribute për sigurime shoqërore për punonjësit në organikë	224,596
3	Paga për punonjësit me kontratë të propozuar	578,114
4	Kontribute për sigurime shoqërore për punonjësit me kontratë	96,545
5	Fondi i veçantë i pagave	67,425
2	Shpenzime operative	720,000
1	Shpenzime për mallra dhe shërbime	570,000
2	Shpenzime të planifikuara për gjyqin e arbitrazhit	150,000
3	Transferta	652,000
1	Transferta për Qendrën e Kadastrës Digjitale	652,000
4	Shpenzime kapitale	1,789,662
	Investime kapitale të patrupëzuara	469,111
1	Shpenzime për investime të patrupëzuara	469,111
	Investime kapitale të trupëzuara (rikonstruksion + infrastrukturë IT)	1,320,551
1	Rikonstruksione (drejtoritë vendore të ASHK-së Tiranë + Vlorë + Kukës etj.)	940,551
2	Infrastrukturë e sistemeve të IT-së + blerje pajisjesh dhe orendi	380,000
5	Fondi rezervë	104,700
1	Fondi rezervë	104,700
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME	1,192,019

**VENDIM****Nr. 510, datë 27.7.2022**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA PROJEKTI
“PROJEKTIMI I SHKOLLËS SË
BIÇIKLETAVE PËR GRUP-MOSHAT 7-10
VJEÇ, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Projektimi i Shkollës së Biçikletave për grup-moshat 7-10 vjeç, Tiranë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 399 239 042 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyzet e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 399 239 042 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyzet e dy) lekësh, përballohet nga Bashkia Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN
NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “PROJEKTIMI I SHKOLLËS SË BIÇIKLETAVE PËR GRUP-MOSHAT
7–10 VJEÇ, TIRANE

Nr.	Pronari			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqe e shpronësuar	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale (lek)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Arben Selami Hoxha Ariana Nestor Nepravishta Armand Tartari Dorian Nestor Nepravishta Fasli Abedin Nepravishta Fatbardh Nepravishta Rezar Tartari Uran Tartari Vera Bajram Nepravishta			8160	6/440	692.55	Truall	692.55	66,969	46,379,381	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Liljana Nikolla, Jahmir Gani Hyka, Luan Fetah Rama, Denis Naim Matoshi, Armand Gropi, Dorian Gropi, Irid Kotoni, Erjon Besnik Rama, Ylber Shaban Gropi, Ramazan Shaban Gropi, Osman Ismail Dervishi, Suzana Selman Gropi, Majlinda Selman Pina, Alma Selman Gropi, Saimir Selman Gropi, Agron Ismail Dervishi, Artur Ramis Shehu, Erida Agim Asllani, Blerim Gani Hyka, Andi Ramazan Gropi, Global Construction, Oriada Latif Abazaj, Elton Gjergji Mehmeti, Endi Rama, Fatbardha Ismail Dervishi Greta Gropi, Jolanda Jonuz Gropi, Myzejen Rama, Xhelal Karaj, Xhesika Rrok Dodaj			8160	6/438	5269	Truall	5269	66,969	352,859,661	Vendoset sekuestro shkresa nr. 3116 prot., datë 12.11.2021, prot. 10027 datë 17.11.2021. Pjesa takuese 2163/30000 në pronësi të Denis Matoshit. Vendimi 29, datë 2021 vendoset sekuestro shkresa nr. 3116 prot. datë 12.11.2021 prot. 10027, datë 17.11.2021. Pjesa takuese 2163/30000 në pronësi të Denis Matoshit. Vendimi 29, datë 7.11.2021. Depozituar K. SIP, me shoq. A&A CONSTRUCTION nr. 1163/357, datë 4.11.2020, nr. 999/327, datë 21.10.2020, nr. 1065/334, datë 27.10.2021, nr. 1229/376 + nr. 1228/376, datë 20.11.2020, nr. 1052/332, datë 24.10.2020, nr. 1224/371, datë 19.11.2020, nr. 993/325, datë 20.10.2020, nr. 998/326, datë 21.10.2020, nr. 1227/374, datë 20.11.2020
Vlera											399,239,042

VENDIM

Nr. 511, datë 27.7.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 666, DATË 10.10.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT
NË MENSA E KONVIKTE DHE
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR
PËRFITIMIN E BURSIVE E TË
PAGESAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR NË
INSTITUCIONET ARSIMORE
PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të
nenit 19, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor
parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të
ndryshuar, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr.
15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional

¹ Ky vendim është përafëruar pjesërisht me
rekomandimin e Këshillit të Evropës, të datës 28 qershor
2011, mbi politikat për të reduktuar braktisjen e
parakohshme të shkollës (2011/C 191/01).

në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5, të ligjit nr.
10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit
ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të
menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë
së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të
Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes
nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të
Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe
të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye
apo për shkak të detyrës”, të nenit 2, të ligjit nr.
7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të
punës”, të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153,
datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të
ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë
28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar,
të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi
i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të
ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 57/2019, “Për
asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe
të nenit 14 të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e
vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit
të Arsimit dhe Sportit dhe të ministrit të Financave
dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”.

2. Shkronja “c”, e nën pikës 2.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.”.

3. Shkronjat “c” dhe “g”, të nën pikës 2.3, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“c) Nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga komisioni mjekoligjor.

g) Nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton.”.

4. Pas shkronjës “g”, të nën pikës 2.3, shtohet shkronja “gj”, me këtë përmbajtje:

“gj) Nxënëset, të cilat regjistrohen në arsimin profesional në të gjitha drejtimet mësimore, përjashtuar ato që përfitojnë nga shkronja “f”, e këtij vendimi, trajtohen me 50% të bursës.”.

5. Shkronja “b”, e nën pikës 2.4, shfuqizohet.

6. Pika 23 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“23. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave/konvikteve, ku nxënësit studiojnë. Kuota mujore e bursës për nxënësit konviktorë u jepet në formën e kuotës ushqimore, si dhe shpenzimet vetjake të dhëna të pasqyra nr. 2 u paguhen me para në dorë këtyre nxënësve. Nxënësve, të cilët nuk jetojnë në konvikt dhe plotësojnë kriteret për bursë, u paguhet vlera e plotë e bursës pranë bankave të nivelit të dytë në llogarinë bankare në emër të prindit/prindërve ose të përfaqësuesit ligjor, për llogari të nxënësit.”.

7. Pikat 29 dhe 30 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“29. Ministria përgjegjëse për arsimin profesional, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin profesional, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, jep jo më pak se 2 500 (dy mijë e pesëqind) bursa.

30. Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa.”.

8. Pas pikës 34 shtohen pikat 34/1 dhe 34/2, me këtë përmbajtje:

“34/1. Grupet vulnerabël të nxënësve përfitojnë, sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbështetje nga punonjës të caktuar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në rolin e mediatorit për këto grupe, për t’i mbështetur në funksion të ndërgjegjësimit dhe të përmirësimit të aksesit të tyre në arsim. Mediatorët shërbejnë për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin midis grupeve vulnerabël dhe institucioneve të arsimit parauniversitar, në funksion të rritjes së frekuentimit të procesit mësimor.

34/2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, u ofrojnë nxënësve romë dhe egiptianë programe të veçanta pas mësimit për kryerjen e detyrave mësimore ose marrjen e mësimave plotësuese.”.

9. Pasqyrat nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me pasqyrat nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrtat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe ofruesit e arsimit të mesëm profesional publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj



PASQYRA NR. 1
KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT PËR DHËNIEN E BURSËS

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmëbursa	Me pagesë
	<i>Për qytetin</i>	<i>Me të ardhura mujore, lek/ frymë</i>	<i>Me të ardhura mujore, lek/ frymë</i>	<i>Me të ardhura mujore, lek/ frymë</i>
1	Për familjet me 2 persona	deri 4500	4,500–5,000	mbi 5000
2	Për familjet me 3 persona	deri 4200	4200–4,800	mbi 4,800
3	Për familjet me 4 persona	deri 4100	4100–4,600	mbi 4,600
4	Për familjet me 5 persona	deri 4000	4000–4,500	mbi 4,500
5	Për familjet me 6 persona	deri 3800	3,800–4,300	mbi 4,300
6	Për familjet me 7 persona	deri 3500	3500–4,200	mbi 4,200
7	Për familjet me 8 persona	deri 3200	3200–4,000	mbi 4,100

PASQYRA NR. 2
MASA E BURSËS PËR NXËNËSIT (NË LEK)

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës mujore në lekë			Financimi	
		<i>Lekë për kuotë ushqimi</i>	<i>Shpenzime vetjake (bigjiene personale, mjete mësimore)</i>	<i>Totali i kuotës</i>	<i>Financimi nga nxënësi/ prindër</i>	<i>Financimi nga shteti</i>
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	a) Bursa	6670	650	7320	0	7320
	b) Gjysmëbursa	6670	650	7320	3660	3660
	c) Me pagesë	6670	650	7320	7320	0
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive e Arsimit Special					
	a) Bursa	7250	650	7,900	0	7,900
	b) Gjysmëbursa	7250	650	7,900	3950	3950
	c) Me pagesë	7250	650	7,900	7,900	
3	Për nxënësit jetimë	7250	650	7,900	0	7,900

PASQYRA NR. 3
KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar në lek/kg	Vlera ditore në lek
1	Bukë	gramë	350–400	977	103.3	41.3
2	Makarona	gramë	30	107	123.0	3.7
3	Oriz	gramë	30	109	154.0	4.6
4	Sheqer	gramë	40	157	103.3	4.1
5	Fasule	gramë	30	93	206.6	6.2
6	Perime	gramë	130	27	103.3	13.4
7	Fruta	gramë	100	42	103.3	10.3
8	Vaj	gramë	30	270	185.0	5.6
9	Gjalpë	gramë	20	152	671.0	13.4
10	Mish	gramë	70–80	115	774.0	61.9
11	Djathë	gramë	25	40	618.0	15.5
12	Reçel	gramë	20	93	258.0	5.2
13	Vezë	kokërr	1	42	13.0	0.0
14	Qumësht	gramë	200	98	82.0	16.4
15	Patate	gramë	200	170	41.3	8.3
16	Nënprodukte mishi	gramë	30	100	413.2	12.4
	Kuota ditore			2712		222.3

**VENDIM****Nr. 512, datë 27.7.2022**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 514, DATË 18.9.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E ZBATIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT PËR REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO-ROMANOS – KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT DHE KAKTIMIN E BASHKISË DURRËS SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 514, datë 18.9.2021, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkisë Durrës, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, i transferohet fondi në masën 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë pa TVSH, për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos – Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, në formën e transfertës së pakushtëzuar, dhe të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.”.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM**Nr. 517, datë 29.7.2022**

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRIT TË SHTETIT DHE KRYENEGOCIATOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator është drejtimi teknik i negociatave dhe bashkërendimi i brendshëm i procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet zhvillimit të procesit teknik të negocimit, bashkërendimit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian, bashkërendimit të prioritetëve, hartimit dhe propozimit të politikave, bashkërendimit të kuadrit strategjik të lidhur me anëtarësimin, zhvillimit të kapaciteteve, rritjes së performancës për arritjen e rezultateve, si dhe informimit të publikut për këto procese.

3. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) bashkërendon procesin e brendshëm të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;



b) bashkërendon prioritetet e politikave shtetërore dhe politikëbërjen;

c) bashkërendon, harton politikat dhe kuadrin strategjik, në lidhje me anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe i bën propozime Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian;

c) bashkërendon punën e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera për hartimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian;

d) bashkërendon hartimin e agjendës së reformave në të gjithë sektorët;

dh) kryen negociatat teknike të anëtarësimit në Bashkimin Evropian për të gjithë grup-kapitujt (*clusters*) dhe kapitujt negociues, si dhe bashkërendon punën për përgatitjen e institucioneve shqiptare;

e) bashkërendon dhe ndjek zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian nga institucionet shqiptare, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

ë) bashkërendon dhe ndjek ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian;

f) propozon projektakte, që kanë lidhje me procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

g) ngre mekanizmat metodologjikë, platforma, instrumente dhe mjete të lidhura me negociatat dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian, si dhe për politikat publike dhe reformat, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

gj) zhvillon kapacitetet dhe mbështetje për institucionet shqiptare për procesin e negociatave dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe politikëbërjen;

h) bashkërendon punën për hartimin dhe zbatimin e programit për informimin e publikut për çështjet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

4. Ngarkohet ministri i Shtetit dhe Kryenegociator për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 518, datë 29.7.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 81, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 81, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në fjalinë e parë, të pikës 2, fjalët “... drejtimi teknik dhe bashkërendimi i procesit të integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian ...” zëvendësohen me “... drejtimi politik i procesit të integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe zhvillimi i dialogut politik me institucionet e Bashkimit Evropian ...”.

b) Shkronja “ë”, e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) Drejton, bashkërendon dhe shpreh qëndrimet politike në emër të shtetit shqiptar për procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, përfshirë nëpërmjet rrjetit të përfaqësive diplomatike pranë Bashkimit Evropian dhe në vendet anëtare të tij. Zhvillon dialogun politik, përfshirë lidhur me politikën e përbashkët të jashtme e të sigurisë, me institucionet e Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare, në kuadrin e procesit të negociatave të aderimit dhe të procesit të stabilizimit dhe të asociimit.”.

2. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 519, datë 29.7.2022****PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 111, DATË 2.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 111, datë 2.3.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 2 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.”.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ushtron veprimtarinë e saj edhe në këto fusha:

a) Ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë e ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për:

i. hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit të objekteve të dëmtuara dhe të shkatërruara;

ii. planifikimin dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit;

iii. drejtimin dhe koordinimin operacional të strukturave dhe të njërive të veçanta, shtetërore dhe publike, të ngarkuara drejtpërdrejt për kryerjen e detyrave, në terren, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit;

iv. ndjekjen, koordinimin, monitorimin e zbatimit të përgjegjësisë dhe të detyrave të ngarkuara autoriteteve përgjegjëse në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të

fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, për rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26.11.2019.

b) Kontakton dhe bashkërendon me organizatat shtetërore dhe organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, shoqatat, personalitetet publike dhe donatorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë vendit, për:

i. prezantimin e gjendjes dhe të dëmeve të shkaktuara;

ii. përgatitjen dhe propozimin e projekteve, të përgjithshme e të veçanta, si pjesë e programeve të procesit të rindërtimit;

iii. detajimin e nevojave dhe paraqitjen e kërkesave për donacione financiare dhe mbështetje të specializuar njerëzore;

iv. informimin e secilit prej tyre për mënyrën e përdorimit dhe të eficiencës së arritur për çdo donacion apo mbështetje tjetër të ofruar prej tyre.”.

c) Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1 Vendimi nr. 650, datë 3.11.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave”, shfuqizohet.”.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 520, datë 29.7.2022****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe në vijim të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, të kreut I, bëhen këto ndryshime:
i. Fjalët “z. Zef Mazi, Kryenegociator;” zëvendësohen me “znj. Majlinda Dhuka, ministër Shteti dhe Kryenegociator (në vijim “Kryenegociatori”);”

ii. Fjalët “znj. Juliana Latifi” zëvendësohen me “z. Denar Biba”.

b) Në kreun II bëhen këto ndryshime:

i. Në fjalinë e parë, të pikës 1, hiqen fjalët “... barazohet me ministrin e shtetit dhe;”;

ii. Në fjalinë e dytë, të shkronjës “k”, të pikës 1, hiqen fjalët “... përmes ministrit përgjegjës për Evropën dhe punët e jashtme ...”;

iii. Pika 3 shfuqizohet.

c) Në kreun V bëhen këto ndryshime:

i. Pika 5 shfuqizohet;

ii. Në pikën 7 hiqen fjalët “... Kryenegociatori dhe ...”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit dhe Kryenegociator dhe grupi negociator për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 521, datë 29.7.2022****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Ornela Çuçi, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 523, datë 29.7.2022****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1040, DATË 25.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË ZBATIMIT TË KRITEREVE TË LEGALIZIMIT DHE MIRATIMIN E MODELIT TË AKTIT TË LEGALIZIMIT PËR NDËRTIMET PA LEJE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18, pika 4, e 21, pika 3, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.1 të vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për



përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimit të modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje”, shtohet pika 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.2 Ndërtimi pa leje i ngritur dhe i deklaruar nga institucioni shtetëror qendror/njësia e vetëqeverisjes vendore, në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së tij/saj, legalizohet pa iu nënshtruar kriterëve të legalizimit të parashikuara në këtë vendim. Për ndërtimin pa leje, për të cilin nuk është paraqitur më parë kërkesë, kërkesa paraqitet nëpërmjet platformës unike qeveritare “e-Albania”.

Në funksion të procedurave të legalizimit, institucioni shtetëror qendror/njësia e vetëqeverisjes vendore dorëzon pranë ASHK-së dokumentacionin ligjor, teknik e financiar, që disponon në lidhje me ndërtimin. Pronësia për ndërtimin dhe truallin rregullohet në përputhje me legjislacionin për pronat e paluajtshme të shtetit.”.

2. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës, institucionet shtetërore qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 528, datë 29.7.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 420, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT SHTETËROR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 9, të ligjit nr. 43/2015, “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të nënpikës 1.2, të pikës 1, të kapitullit V, “Vizita dhe takime”, të vendimit nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Vizitat zyrtare mund të shoqërohen dhe me zbukurim flamujsh të vendit mik dhe atij shqiptar.”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 531, datë 29.7.2022

PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PERSONELIT TË POLICISË SË SHTETIT DHE PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE E KATEGORIZIMIN PËR GRADAT NË POLICINË E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 6, e 61, pika 1, të ligjit nr. 108/20214, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i përgjithshëm i personelit të Policisë së Shtetit në organikë është 11 834 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) veta.

2. Funksionet korresponduese dhe kategorizimi për çdo gradë në Policinë e Shtetit përcaktohen në lidhjen nr. 1 “Tabela e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për çdo gradë”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Studenti, që përfundon arsimin e lartë policor në një institucion jashtë vendit, të barasvlershëm me Akademinë e Sigurisë, sipas marrëveshjeve të lidhura me shtetin ku studenti ka përfunduar arsimin, si dhe ka kryer njohjen dhe njësimin e diplomave në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet në kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë, në momentin e emërimit për herë të parë në detyrë i jepet grada “Nënkomisar” dhe i nënshtrohet trajnimit në Akademinë e Sigurisë.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 446, datë 22.5.2017, “Për miratimin e numrit të



përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar, dhe nr. 892, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, shfuqizohen.

5. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja 1

TABELA E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE DHE KATEGORIZIMI PËR ÇDO GRADË

GRADAT	NUMRI LIMIT PËR GRADË	FUNKSIONET
Drejtues madhor	1	Drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit
Drejtues i lartë	7	Zëvendësdyrëtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Dyrtorët e Departamenteve dhe Rektori i Akademisë së Sigurisë
Drejtues i parë	52	A. Në strukturat e Dyrtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit - Dyrektor, në Dyrtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; - Dyrektor, në Departamentet e Dyrtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. - Dyrektor i Kabinetit të Dyrtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit (Zyra Ndihmëse); - Këshilltar në Kabinetin e Dyrtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit (Zyra Ndihmëse). B. Në strukturat e veçanta - Dyrektor, në Dyrtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Dyrtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Dyrtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Dyrtësisë, Dyrtor i Dyrtorisë Hetimore dhe Dyrtori i Teknologjisë së Informacionit dhe funksione të barasvlershme me to. C. Në Akademinë e Sigurisë - Dyrektor Dyrtoria e Mbështetjes Akademike; - Asistent Rektori në Akademinë e Sigurisë; - Dekan; - Dyrektor i Qendrës Kërkimore-Shkencore; - Përgjegjës Departamenti, në Fakultet; - Profesor; - Dyrektor i Kolegjit Profesional të Lartë. D. Në strukturat e Dyrtorive Vendore të Policisë - Dyrektor i Dyrtorive Vendore të Policisë.
Drejtues	144	A. Në strukturat e Dyrtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit - Shef sektori, në Dyrtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Departamentet në Dyrtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; - Asistent i Zëvendësdyrtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; - Asistent i Dyrtorit të Departamentit në Dyrtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; - Oficer kontakti ndërlihdës, në Dyrtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe



		funksiione të barasvlershme me to. B. <u>Në strukturat e veçanta</u> 1. Komandant i Repartit Special “RENEA”; 2. Drejtor i Qendrës së Mbyllur të të Huajve të Kufirit dhe Migracionit; 3. Zëvendësdrejtor i Hetimit në Drejtorinë Hetimore; 4. Shef Njësie në Drejtorinë Hetimore; 5. Shef Sektori në Drejtorinë Hetimore, në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe funksione të barasvlershme me to. C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u> 1. Drejtor i Departamentit të Certifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të Tretëve; 2. Lektorë në Fakultet; 3. Shef Sektori i Kurrikulave dhe Kontrollit të Cilësisë; 4. Përgjegjës Departamenti në Kolegjin Profesional të Formimit Policor dhe funksione të barasvlershme me to. D. <u>Në Drejtoritë Vendore të Policisë</u> 1. Drejtor i Drejtorive Vendore, të Policisë Kufitare dhe Migracionit; 2. Zëvendësdrejtor, në Drejtoritë Vendore të Policisë.
Kryekomisar	430	A. <u>Në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit</u> 1. Specialist, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në Departamentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; 2. Specialist koordinator, në Sektorin (zyra) Qendrore Kombëtare INTERPOL, EUROPOL; 3. Specialist asistent në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; 4. Shef Njësie në Njësinë e Informacioni të Pasagjerit; 5. Specialist për planifikimin, në Drejtorinë e Planifikimit Policor; 6. Shef Qendre/Koordinator institucional, në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin; 7. Oficer kontakti ndërlidhës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe funksione të barasvlershme me to. B. <u>Në strukturat e veçanta</u> 1. Komandant i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë; 2. Shef i Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë; 3. Shef sektori në Repartin Special “RENEA”; 4. Komandant i Repartit Special, të Kufirit dhe Migracionit “DELTA”; 5. Komandanti i Repartit Special “RESI”; 6. Shef Sektori në Njësinë “FAST Albania”; 7. Shef Njësie në Njësinë e Menaxhimit të Informatorëve; 8. Shef njësie/specialist në Njësinë Speciale të Antieksplozivave dhe në Njësinë Speciale të Negocimit; 9. Komandant i Repartit të Sigurisë së Brendshme dhe Ceremonialit; 10. Specialist koordinator me SHISH, specialist drejtimi, specialist në sektorin e analizës dhe kartotekës, shef i njësie rajonale antiterrorizëm, shef i njësisë për verifikimin e terrorizmit dhe sigurisë dhe shef i njësisë operacionale antiterrorizëm, në Drejtorinë e Antiterrorit; 11. Shef sektori për përgjimin e telekomunikimit në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 12. Specialist, në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, në Drejtorinë Hetimore dhe



		Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe funksione të barasvlershme me to. C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u> 1. Shef Sektori në Departamentin e Certifikimeve dhe Shërbimeve ndaj të Tretëve; 2. Shef Sektori i Burimeve Njerëzore; 3. Shef Sektori/instruktor në Sektorin e Trajnimit në Terren dhe Vazhdues; 4. Specialist për Kontrolllet; 5. Kërkues i Parë; 6. Shef Sektori ai për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Cepol; 7. Shef Sektori i Disiplinës dhe i Sigurisë; 8. Përgjegjës Departamenti në Kolegjin Profesional të Formimit Policor dhe funksione të barasvlershme me to. D. <u>Në strukturat e Drejtorive vendore të Policisë</u> 1. Shef sektori në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Drejtoritë Vendore të Kufirit e Migracionit; 2. Specialist asistent, në Drejtoritë Vendore të Policisë; 3. Shef Komisariati, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në ato të Kufirit dhe Migracionit me personel mbi 36 punonjës dhe funksione të barasvlershme me to.
Komisar	569	A. <u>Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit</u> 1. Specialist, specialist për kërkimin, në Sektorin (zyra) Qendrore Kombëtare INTERPOL; 2. Koordinator institucional/specialist, në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin. 3. Specialist për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit “të dhënat PNR” dhe Specialist për Informacionin Paraprak për Pasagjerin “të dhënat API”, në Njësinë e Informacionit të Pasagjerit; 4. Specialist dhe funksione të barasvlershme me to. B. <u>Në strukturat e veçanta</u> 1. Specialist në sektorin për përgjimin e telekomunikimin në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 2. Specialist në Drejtorinë Hetimore; 3. Shef seksioni, komandant njësie, në Repartin Special “RENEA”, në Repartet Speciale, në Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë; 4. Shef i Seksionit të Burimeve Njerëzore, në Repartet e Njësitë Speciale, Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë; 5. Specialist koordinator ai zëvendëskomandant, specialist i trajnimeve dhe masave mbrojtëse, shef i Njësisë Operacionale në Repartin Special “RESI”; 6. Zëvendëskomandant, shef seksioni në Repartin Special të Kufirit dhe Migracionit “DELTA”; 7. Shef i Qendrës së Drejtimit dhe Menaxhimit të Operacioneve Speciale, Shef njësie/specialist në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 8. Shef njësie operacionale, shef seksioni, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; 9. Shef njësie në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 10. Shef njësie në Njësinë për Hetimin e Financimit të Terrorizmit në Drejtorinë e Antiterrorit; 11. Shef seksioni dhe shef stacioni, në Repartin e Sigurisë së Brendshme e Ceremonialit, në Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë dhe në Qendrën e Mbyllur të të Huajve të Kufirit dhe Migracionit; 12. Specialist në Drejtorinë Hetimore; 13. Specialist në njësinë operacionale antiterrorizëm, specialist në njësinë rajonale antiterrorizëm, specialist në njësinë për hetimin e financimit të terrorizmit dhe specialist në njësinë për verifikimin e terrorizmit dhe sigurisë, në Drejtorinë e



		Antiterrorit dhe funksione të barasvlershme me to. C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u> 1. Shef seksioni në Sektorin e Disiplinës dhe të Sigurisë; 2. Specialist/instruktor, specialist/instruktor (APO), specialist/instruktor (KNP) në Kolegjin Profesional të Formimit Policor; 3. Specialist/instruktor në Departamentin e Certifikimeve dhe Shërbimeve Ndaj të Tretëve dhe funksione të barasvlershme me to. D. <u>Në Drejtoritë Vendore të Policisë</u> 1. Shef komisarati në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në ato të Kufirit dhe Migracionit me personel deri në 36 punonjës. 2. Shef seksioni në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe ato të Kufirit dhe Migracionit; 3. Shef seksioni në Komisaritet e Policisë, në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe ato të Kufirit dhe Migracionit; 4. Shef seksioni/specialist në Sektorin e Komandës dhe Kontrollit në Drejtoritë Vendore të Policisë; 5. Shef Stacioni në Komisaritet e Policisë në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në strukturat e Kufirit dhe Migracionit dhe funksione të barasvlershme me to.
Nënkomisar	1533	A. <u>Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit</u> 1. Oficerë të turnit, specialist, në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin. 2. Specialist i Analizës në Njësinë e Informacionit të Pasagjerit; 3. Specialist dhe funksione të barazvlefshe me to. B. <u>Në strukturat e veçanta</u> 1. Zëvendëskomandant njësie, specialist, në Repartin Special “RENEA”, në Repartet Speciale, në Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë; 2. Specialist në Drejtorinë Hetimore; 3. Zëvendës shef njësie, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; 4. Specialist në Njësinë Speciale të Antiexplozivave dhe në Njësinë Speciale të Negocimit; 5. Specialist në Institutin të Përgatitjes së Qenve të Policisë; 6. Specialist, në Repartin Special të Kufirit dhe Migracionit “DELTA”; 7. Specialist në Qendrën e Mbyllur të Huajve të Kufirit dhe Migracionit dhe funksione të barasvlershme me to. C. <u>Në Akademinë e Sigurisë</u> 1. Specialist për disiplinën në Fakultet, specialist për disiplinën në Kolegj në Sektorin e Disiplinës dhe Sigurisë; 2. Specialist për trajnimet; 3. Përgjegjës turni dhe Informacioni dhe funksione të barasvlershme me to. D. <u>Në drejtoritë vendore të policisë</u> 1. Specialist në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe specialist në drejtoritë vendore kufirit dhe migracionit; 2. Specialist, në Komisaritet e Policisë; 3. Specialist, në komisaritet e kufirit dhe migracionit; 4. Shef poste policie; 5. Specialist, në stacionet e policisë; 6. Specialist, në seksionet dhe stacionet e policisë kufitare; 7. Specialist për shërbimet e rendit, ai dhe ekspert antiexploziv;



		8. Përgjegjës turni, në seksionet dhe Stacionet e Policisë Kufitare dhe funksione të barasvlershme me to.
Inspektor i parë Inspektor i dytë Inspektor	7863	1. Përgjegjës grupi në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 2. Ndhmësspecialist në Sektorin për Përgjimet e Telekomunikimit; 3. Ndhmësspecialist për magazinimin e drogave, në Sektorin e Hetimit nën Mbulim; 4. Ndhmësspecialist në Sektorin e Hetimit nën Mbulim; 5. Ndhmësspecialist në Drejtorinë Hetimore Qendrore; 6. Ndhmësspecialist në Drejtorinë e Antiterrorit; 7. Ndhmësspecialist i policimit në komunitet/SPZ; 8. Ndhmësspecialist i policimit në komunitet për edukimin në shkolla dhe punën me të rinjtë/SPZ; 9. Ndhmësspecialist, për zbatimin e vendimeve, kontrollin e armëve; 10. Ndhmësspecialist në sektorin e komandës dhe kontrollit, 11. Ndhmësspecialist/agjentë; 12. Ndhmësspecialist, operator për shërbimin ndaj të tretëve, 13. Ndhmësspecialist, laborant; 14. Ndhmësspecialist për informacionin; 15. Ndhmësspecialist në drejtoritë vendore të policisë dhe funksione të barasvlershme me to; 16. Ndhmësspecialist; 17. Kontrollor; 18. Ndhmësspecialist i vijës së dytë dhe kontrollor; 19. Përgjegjës grupi dhe ndhmësspecialist në Drejtoritë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, si dhe funksione të barasvlershme me to; 20. Ndhmësspecialist për analizën/kartotekën/statistikën; 21. Ndhmësspecialist në Seksionin e Verifikimit të Shkeljeve administrative dhe analizës, për shërbimin e Policisë Rrugore; 22. Oficer i patrullës së Përgjithshme (F.P.) Shqiponja/Motorist dhe funksione organike të barasvlershme me to; 24. Trupë shërbimi operacional në Repartin Special “RENEA” dhe funksione të barasvlershme me to; 25. Ndhmë specialist, forcë speciale dhe shofer në Njësinë Speciale të Negocimit; 26. Ndhmësspecialist, forcë speciale shoqërues qeni dhe shofer në Njësinë Speciale të Antieksplodivave; 27. Ndhmësspecialist, forcë speciale në Repartin Special “Resi”; 28. Ndhmësspecialist, forcë speciale në Repartin Special “Delta”; 29. Ndhmësspecialist/përgjegjës grupi në repartet e ndërhyrjes së shpejtë; 30. Ndhmësspecialist në Policinë Shkencore; 31. Ndhmësspecialist në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 32. Ndhmësspecialist, forcë speciale në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; 33. Trupë shërbimi operacional në Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë; 34. Komandant skuadre/trupë shërbimi në Repartin e Sigurisë së Brendshme dhe Ceremonialit; 35. Ndhmësspecialist për migracionin e parregullt; 36. Ndhmësspecialist, intervistimin, riintegrimin, ripranimin/kontrollor; 37. Ndhmësspecialist (QSHI me shtetet fqinjë); 38. Drejtues mjeti lundrues; 39. Ndhmësspecialist, kontrollor për mjetet e peshkimit; 40. Ndhmësspecialist për përgatitjen; 41. Ndhmësspecialist, operator për kamerat në stacionet e policisë për kufirin dhe migracionin; 42. Ndhmësspecialist, operator për kamerat në Qendrën e Mbyllur për të Huajt; 43. Ndhmësspecialist; 44. Zëdhënës; 45. Ndhmësspecialist operator; 46. Ndhmësspecialist për analizën/kartotekën/statistikën; 47. Ndhmësspecialist për krimet dhe policisë shkencore; 48. Ndhmësspecialist në seksionin e teknologjisë dhe përgjimit;



	49. Oficer i Patrullës së Përgjithshme; 50. Trupë shërbimi në policinë rrugore; 51. Ndihmësspecialist në Komisaritet e Policisë; 52. Oficer i patrullës së Përgjithshme (F.P.) Shqiponja/Motorist dhe funksione të barasvlershme me to; 53. Punonjësit e policisë që përfundojnë Kolegjin Profesional të Formimit Policor; 54. Ndihmësspecialist sekretari-arkiv; 55. Ndihmësspecialist në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit; 56. Oficer i Patrullës së Përgjithshme, trupë shërbimi në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit; 57. Trupë shërbimi në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit dhe funksione të barasvlershme me to.
--	--

VENDIM**Nr. 533, datë 29.7.2022**

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË
KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E
MASAVE PËR IMPORTET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 4, të ligjit nr. 9790, datë 19.7.2007, “Për masat mbrojtëse në importet”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e masave për importet, si më poshtë vijon:

a) Znj. Delina Ibrahimaj, ministër i Financave dhe Ekonomisë, kryetar;

b) Znj. Elira Demiraj, drejtor i përgjithshëm i Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, anëtar;

c) Z. Nikolla Lera, drejtor i përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, anëtar;

ç) Z. Alban Mësonjësi, drejtor i Programit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtar;

d) Znj. Elona Boci, specialiste e Drejtorisë së Diplomacisë Ekonomike në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, anëtar;

dh) Z. Bashkim Sykja, përfaqësues i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, anëtar;

e) Z. Ylber Karanxha, zëvendës-drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, anëtar;

ë) Znj. Arjana Dyrishi, drejtor i Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, anëtar.

2. Vendimi nr. 317, datë 12.4.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e masave për importet”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe komisioni për vlerësimin e masave për importet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 538, datë 29.7.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE TË PROCEDURAVE TË
DETAJUARA PËR NGRIRJEN E
PËRKOHSHE TË FONDEVE APO TË
PASURIVE TË TJERA TË PERSONAVE
OSE ENTEVE TË SHPALLURA NGA
STRUKTURAT PËRKATËSE TË
KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË
KOMBEVE TË BASHKUARA APO
ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE KU
REPUBLIKA E SHQIPËRISË ËSHTË
PALË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10/1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Secili nga subjektet, institucionet dhe personat e përcaktuar në pikën 1, të nenit 10/1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, përcakton punonjësin ose, sipas rastit, strukturën përgjegjëse kompetente për të siguruar marrjen dijeni dhe përditësimin e vazhdueshëm me aktet e shpalljes nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo të organizatave ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë. Punonjësi apo struktura përgjegjëse kompetente konsiderohet se ka marrë dijeni për këto akte në momentin kur publikohen në faqen zyrtare të strukturave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo të organizatave ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Në rastet kur subjektet apo personat e përcaktuar më sipër janë të vetëpunësuar, të cilët nuk kanë të punësuar persona të tjerë, për efekt të zbatimit të këtij vendimi, veprojnë në cilësinë e strukturës përgjegjëse.

3. Punonjësi apo struktura përgjegjëse kompetente, e përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, verifikon dhe përditëson listën e klientëve ekzistues, menjëherë nga marrja dijeni për aktet e shpalljeve nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo të organizatave ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, për t’u siguruar për të dhëna për fonde apo pasuri të tjera, veprime financiare, transaksione aktuale apo të mbetura në tentativë, si dhe përditëson proceset e brendshme për transaksionet në vijim apo për klientët e ardhshëm.

4. Nëse pas verifikimit, punonjësi apo struktura përgjegjëse konstaton të dhëna për fonde apo pasuri të tjera, veprime financiare apo transaksione aktuale ose të mbetura në tentativë apo raste të përputhjes së akteve të shpalljes me listën e klientëve ekzistues, njofton menjëherë zyrtarisht titullarin, administratorin apo përfaqësuesin ligjor të subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, në varësi të formës së organizimit. Ndërsa struktura përgjegjëse, sipas pikës 2 të këtij vendimi, vijon me ngrirjen e përkohshme të fondeve, sipas kësaj pike.

5. Titullari, administratori apo përfaqësuesi ligjor i subjektit, kur konfirmon plotësimin e kushteve sipas pikës 3 të këtij vendimi, nxjerr menjëherë

vendimin e ngrirjes së përkohshme të fondeve apo pasurive të tjera të personit/personave apo entit/enteve të shpallura, pa u kushtëzuar nga nxjerrja e urdhrit të bllokimit të përkohshëm apo vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

6. Vendimi për ngrirjen e përkohshme të fondeve apo pasurive të tjera përmban të dhënat e mëposhtme:

a) të dhënat identifikuese të personit ose personave apo entit ose enteve të shpallura;

b) përmbledhje ekzekutive të rrethanave të faktit;

c) të gjitha të dhënat në dispozicion për rastin e ngrirjes së përkohshme, përfshirë transaksionet e mbetura në tentativë;

ç) datën dhe vendin e marrjes së vendimit, si dhe periudhën kohore gjatë të cilës vendimi do të ketë fuqi;

d) të dhënat zyrtare të kontaktit të subjektit apo institucionit që ka marrë vendimin.

7. Subjektet, institucionet dhe personat e parashikuar në nenin 10/1, të ligjit nr. 157/2013, të ndryshuar, njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në rrugë elektronike dhe shkresore, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga data e nxjerrjes së vendimit për ngrirjen e përkohshme të fondeve apo pasurive të tjera të personave ose enteve të shpallura. Subjektet e sipërpërmendura zbatojnë udhëzimet e Drejtorisë të Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për çdo rast.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve nga marrja e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi, i propozon ministrit përgjegjës për financat nxjerrjen e urdhrit të bllokimit të përkohshëm, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit.

9. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, organet përgjegjëse për zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit, subjektet apo institucionet raportuese, si dhe çdo person tjetër i përcaktuar në nenet 7 dhe 10, të ligjit nr. 157/2013, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 540, datë 29.7.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
PËRFITIMIT, KRITEREVE DHE
KUSHTET E VEÇANTA TË PËRFITIMIT
PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË
VOGLA DHE TË MESME,
PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka si qëllim përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit nga fondi i zhvillimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat zhvillojnë projekte, që nxisin e përmirësojnë digjitalizimin.

2. Termat e përdorur në përmbajtje të këtij vendimi kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.

3. Përfitimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme nga mbështetja e programeve apo projekteve nga donatorët apo institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për mbulimin e shpenzimeve të projektit, të cilat janë kontribut i vetë kërkesit dhe nuk mbulohen nga ky fond, nuk përbën pengesë për përfitimin e fondit për të njëjtin projekt.

II. MASA E PËRFITIMIT, KRITERET DHE KUSHTET E VEÇANTA PËR PËRFITIMIN E FONDIT

1. Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, nga buxheti i shtetit për vitin 2022, është në shumën/vlerën 105 000 000 (njëqind e pesë milionë) lekë dhe përballohet në masën 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë nga shpenzimet korrente dhe 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekë nga shpenzimet kapitale të programit 04130, “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në varësi të projektit konkurrues të

përgatitur nga kërkesi, fondi mbulon 80 (tetëdhjetë) % të kostove të miratuara, por jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind) lekë.

2. Kërkesi për përfitimin e fondit plotëson kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën 5, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, si dhe kriteret e veçanta të lidhura me projektplanin e biznesit, si më poshtë vijon:

a) Përputhshmëria e planit të biznesit me objektin dhe qëllimin e dhënies së grantit, duke pasur në fokus nxitjen, përparimin e zhvillimin e proceseve teknologjike dhe treguesve të digjitalizimit;

b) Qartësia, saktësia dhe objektiviteti i planit të biznesit, elemente të cilat identifikohen nëpërmjet rezultateve të matshme nga realizimi i tij;

c) Qartësia dhe specifikimi konkret i argumentuar i treguesve të digjitalizimit;

ç) Plani konkret dhe i argumentuar, që justifikon rritjen e numrit të të punësuarve në ndërmarrje;

d) Të dhëna konkrete dhe të argumentuara për impaktin pozitiv në mjedis, produkt i realizimit të projektplanit të biznesit.

3. Aktivitetet e lejuara në projektet e ndërmarrjeve, me qëllim përfitimin e mbështetjes, plotësojnë të paktën një nga këto kushte të veçanta:

a) Blerjen/ndërtimin e pajisjeve/makinerive të reja digjitale/teknologjike;

b) Blerjen/ndërtimin e aplikacioneve për shërbim klienti apo menaxhim të dhënash;

c) Ndërtimin e një faqeje *web-i*/platforme *online* për marketingun e kompanisë/biznesit, promovimin e ndërlidhjen me klientët;

ç) Blerjen/ndërtimin e aplikacioneve / programeve apo paketave të ndryshme të programeve kompjuterike.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 541, datë 29.7.2022****PËR KRITERET E PËRZGJEDHJES TË ANËTARËVE, SI DHE PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE KOMPETENCAT E KËSHILLIT KONSULTATIV PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 43, datë 21.4.2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka si qëllim përcaktimin e kriterëve të përzgjedhjes të anëtarëve, si dhe rregullave të hollësishme për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

2. Termat e përdorur në përmbajtje të këtij projektvendimi kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 43/2022.

II. KRITERET E PËRZGJEDHJES TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT KONSULTATIV

1. Përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit Konsultativ bëhet nga institucionet e përcaktuara në pikën 4, të kreut III, të këtij vendimi, pas plotësimit në mënyrë kumulative të kriterëve të përzgjedhjes të përcaktuara në këtë krye.

2. Kriteret e përzgjedhjes, që duhet të plotësojnë anëtarët e Këshillit Konsultativ janë, si më poshtë vijon:

a) të kenë integritet të lartë moral dhe profesional;

b) të pranojnë në mënyrë vullnetare të jenë anëtarë të Këshillit Konsultativ;

c) të kenë aftësi të mira komunikimi dhe mund të kontribuojnë në propozimin për përmirësimin e klimës së biznesit;

ç) Të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre si anëtarë të Këshillit Konsultativ.

III. RREGULLA TË HOLLËSISHME PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE KOMPETENCAT E KËSHILLIT KONSULTATIV PËR NDËRMARRJET

1. Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, (në vijim “Këshilli”) ngrihet në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 43/2022, dhe ka si qëllim dhënien e mendimeve, këshillave dhe diskutimin e çështjeve që lidhen me ofrimin e mbështetjes dhe zhvillimin e biznesit, si dhe mënyrën e hartimit të skemave mbështetëse për biznesin.

2. Këshilli është organ kolegjal, i cili ushtron veprimtarinë e tij këshillimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organet kolegiale.

3. Këshilli kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e ekonomisë dhe ka në përbërje të tij 11 anëtarë, si më poshtë vijon:

a) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë, përgjegjës për politikën e nxitjes së biznesit;

b) 1 (një) përfaqësues nga ministri i shtetit, përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes, përgjegjës për *start-up*-et dhe inovacionin;

c) 1 (një) përfaqësues nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, përgjegjës për mbështetjen e biznesit;

ç) 1 (një) përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, përgjegjës për bashkëpunimin me biznesin;

d) 3 (tre) përfaqësues të sipërmarrjes dhe biznesit, të përzgjedhur nga organizatat dhe dhomat më të përfaqësuara të tregtisë dhe biznesit;

dh) 1 (një) përfaqësues nga Shoqata e Bankave, përgjegjës për mirëfunksionimin e sistemit bankar;

e) 2 (dy) përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, nga të cilët një përfaqësues nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe një përfaqësues nga institucionet jopublike të arsimit të lartë;

ë) 1 (një) përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të propozuar nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, përgjegjës për qeverisjen vendore.

4. Përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit bëhet, si më poshtë vijon :

a) Anëtarët e Këshillit, pjesë e organeve të administratës publike, caktohen nga ministrat



përgjegjës, përkatësisht, për ekonominë, sipërmarrjes dhe arsimit;

b) Anëtari i Këshillit, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën “c”, të pikës 3, të kreut III, të këtij vendimi, caktohet nga ministri përgjegjës për çështjet e ekonomisë, me propozim të drejtorit ekzekutiv të AIDA-s;

c) Anëtari i Këshillit, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën “ç” të pikës 3, të kreut III, të këtij vendimi, caktohet nga ministri përgjegjës për çështjet e ekonomisë, pas propozimit nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;

ç) Anëtari i Këshillit, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën “d”, të pikës 3, të kreut III, të këtij vendimi, caktohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, me propozimin e përfaqësuesve më të mëdhenj të sipërmarrjes dhe biznesit;

d) Anëtari i Këshillit, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën “dh”, të pikës 3, të kreut III, të këtij vendimi, caktohet nga ministri përgjegjës ekonominë, me propozimin e Shoqatës së Bankave;

dh) Anëtari i Këshillit, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën “ë”, të pikës 3, të kreut III, të këtij vendimi, caktohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, me propozimin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë.

5. Anëtarët e Këshillit Konsultativ emërohen me mandat 3 (tre) vjet, me të drejtë riemërimi një herë.

6. Anëtari i Këshillit lirohet ose shkarkohet nga detyra përpara mbarimit të mandatit nga organi që e ka emëruar, kur vërtetohet se:

a) është dënuar nga gjykata, me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;

b) ndodhet në pamundësi fizike ose mendore për të ushtruar funksionet e ngarkuara, për një periudhë mbi 6 (gjashtë) muaj;

c) shkel rëndë rregullat e etikës së punës në administratën publike, në përputhje me parashikimet e kodit të etikës;

ç) vepron në shkelje të detyrave të përcaktuara sipas ligjit;

d) jep dorëheqjen.

7. Këshilli merr vendime me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm. Anëtarët e Këshillit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesit, nuk marrin pjesë në proceset e diskutimit dhe këshillimit dhe vendimmarrëse,

kur kanë dyshime për ekzistencën e konfliktit të interesit.

8. Në ushtrimin e detyrave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, Këshilli Konsultativ për ndërmarrjet mbështetet nga Sekretariati teknik. Detyrat e Sekretariatit teknik të Këshillit kryhen nga anëtarët e përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për ekonominë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

9. Këshilli Konsultativ ushtron kompetencat e përcaktuara në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 43/2022.

10. Sekretariati teknik i Këshillit ushtron detyrat, si më poshtë vijon:

a) Organizon mbledhjet e këshillit, përgatit dhe administron dokumentacionin që shqyrtohet në to;

b) Kryen komunikimet dhe njoftimin e palëve të treta, për llogari të Këshillit;

c) Mbledh të dhëna, informacione dhe statistika që lidhen apo ndihmojnë në ushtrimin e veprimtarisë nga Këshilli.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, institucionet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, të pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi, përcjellin pranë ministrit përgjegjës për ekonominë emrat e anëtarëve të përzgjedhur.

2. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, shoqatat e biznesit dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë përcjellin pranë ministrit përgjegjës për ekonominë emrat e anëtarëve të përzgjedhur, së bashku me argumentet dhe sqarimet përkatëse.

3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e emrave përkatës, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, ministri përgjegjës për ekonominë emëron anëtarët e Këshillit Konsultativ.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 542, datë 29.7.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 179, DATË 26.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR RREGULLAT, KUSHTET DHE PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANESAVE QË KANË QENË SUBJEKT I LIGJIT NR. 7652, DATË 23.12.1992, ‘PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE’, DHE TË LIGJIT NR. 9321, DATË 25.11.2004, ‘PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË BANESA, TË NDËRTUARA ME FONDET E SHOQËRIVE DHE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja “a”, e 3, të nenit 77, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 31 e vendimit nr. 179, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“31. Privatizimi i banesave, sipas këtij vendimi, ka afat 2 (dy) vjet pas daljes së certifikatës së pronësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 543, datë 29.7.2022

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 315, DATË 31.5.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MARKAT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 143, 149, 151/c, 152, 155, 163/a, 163/b, 175/a e 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me

Faqe| 13534

propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rregulloren për markat, që i bashkëlidhet vendimit nr. 315 datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

a) Në nenin 15, pas pikës 9 shtohet pika 9.1, me këtë përmbajtje:

“9.1 Zyra do të konsiderojë si ndarje të aplikimit të markës edhe rastet kur një kërkesë për regjistrimin e markës është publikuar me më pak mallra dhe/ose shërbime sesa ka në dëshminë e depozitimit. Zyra pas publikimit të aplikimit fillestar me mallrat dhe/ose shërbimet e munguara në buletin e PI-së do të vazhdojë procedurat e parashikuara në ligj apo në këtë rregullore për regjistrimin e saj për të gjitha mallrat dhe/ose shërbimet e kërkuara.”;

b) Pas nenit 15 shtohet neni 15/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 15/a

Ndarja e një marke të regjistruar

1. Parashikimet e dhëna në pikat 1–7, të nenit 15, të kësaj rregulloreje, gjejnë zbatim edhe për kërkesën e dorëzuar për ndarjen e një marke të regjistruar.

1.1 Formulari i kërkesës për ndarjen e markës së regjistruar, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, do të përmbajë, gjithashtu, të dhënat e mëposhtme:

1.1.1 numrin e regjistrimit të markës;

1.1.2 emrin dhe adresën e pronarit.

2. Nëse përpara dorëzimit të kërkesës, për ndarjen apo jo të markës së regjistruar, është duke u shqyrtuar një kërkesë për shfuqizim apo pavlefshmëri të markës së regjistruar nga DPPI-ja ose gjykata, vendimmarrja për kërkesën për ndarjen e markës së regjistruar pezullohet, sipas rastit, deri në momentin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirëkuptim midis palëve apo marrjes së formës së prerë të vendimit të gjykatës.

Detyrimin për njoftimin e DPPI-së, në lidhje me një kërkesë të depozituar zyrtarisht për shfuqizim apo pavlefshmëri të markës së regjistruar në DPPI apo në gjykatë e ka kërkuuesi i shfuqizimit/zhvlerësimit të markës së regjistruar, që kërkohet të ndahet.



3. Markës së ndarë i caktohet një numër i ri kërkesë, si dhe një numër i ri regjistrimi. Marka e ndarë do të ruajë të njëjtën datë depozitimi ose prioriteti, si dhe datë regjistrimi me markën fillestare dhe do të njoftojë pronarin e markës për ndarjen. Njoftimi do të përmbajë ekstraktin e regjistrimit për markën fillestare dhe markën e ndarë.

4. Pas vendimarrjes së DPPI-së për ndarjen e markës së regjistruar, marka e ndarë nuk do të jetë objekt i publikimit, në kuptim të nenit 151 të ligjit, dhe as kundërshtimit në kuptim të nenit 152 të ligjit.

5. Ndarja e markës së regjistruar do të publikohet në Buletinin Zyrtar.

6. Zyra do të konsiderojë si ndarje të regjistrimit të markës edhe rastet, kur një kërkesë për regjistrimin e markës është:

6.1 publikuar dhe regjistruar me më pak mallra dhe/ose shërbime se sa ka në dëshminë e depozitimit. Zyra pas publikimit të kërkesës fillestare me mallrat dhe/ose shërbimet e munguara në buletin e PI-së do të vazhdojë procedurat e parashikuara në ligj apo në këtë rregullore për regjistrimin e saj për mallrat dhe/ose shërbimet e munguara.

6.2 publikuar me më pak mallra dhe/ose shërbime nga sa ka në dëshminë e depozitimit dhe regjistruar me të gjitha mallrat dhe/ose shërbimet. Në këtë rast, zyra do të bëjë korrigjimin e certifikatës së markës së regjistruar, dhe, pas publikimit të kërkesës fillestare me mallrat dhe/ose shërbimet e munguara në buletin e PI-së, do të vazhdojë procedurat e parashikuara në ligj apo në këtë rregullore për regjistrimin e saj për këto mallra dhe/ose shërbime.

7. Kërkesa për ndarjen e markës së regjistruar do të jetë sipas formularit që bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 546, datë 29.7.2022

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të kreut III, të vendimit nr. 395, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Erlis Hereni, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Egra Ibrahim emërohet drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 551, datë 29.7.2022

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË “BRITISH SCHOOL OF TIRANA”, KU MËSIMI ZHVILLOHET NË GJUHËN ANGLEZE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit të mesëm të lartë “*British School of Tirana*”, me kohë të plotë, i cili ushtron veprimtarinë arsimore në adresën: kompleksi “Kodra e diellit 2”, Rruga e Ullinjve, Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë. Në këtë institucion arsimor mësimi zhvillohet në gjuhën angleze, ndërsa lëndët “Gjuhë shqipe”, “Letërsi”, “Histori e kombit shqiptar” dhe “Gjeografia e Shqipërisë” zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit të mesëm të lartë “*British School of Tirana*” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 552, datë 29.7.2022

**PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT
ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR
TË ARSIMIT BAZË “RRUGA E DIJES”,
NË TË CILIN ZHVILLOHEN EDHE
LËNDË FETARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit bazë “Rruga e Dijes”, me kohë të plotë, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare dhe ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Institucioni arsimor privat parauniversitar ushtron veprimtarinë arsimore në adresën: “Dy vilat trekatëshe”, rruga “Don Bosko”, Tiranë.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit bazë “Rruga e Dijes” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 553, datë 29.7.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 600, DATË 9.10.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E SHËRBIMIT TË
SIGURISË PUBLIKE NË 150
INSTITUCIONE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR DHE TË
KRITEREVE PËR OFICERËT E
SIGURISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 37, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Titulli i vendimit ndryshohet dhe zëvendësohet me:

“Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”.

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e shërbimit të sigurisë publike në institucionet e arsimit parauniversitar të mesëm të lartë që kanë të paktën 100 nxënës dhe institucionet e arsimit parauniversitar bazë, që kanë të paktën 700 nxënës. Institucionet e arsimit parauniversitar,



që kanë shërbim të sigurisë publike, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. Shërbimi i sigurisë publike konsiston në monitorimin nga oficeri i sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar të ndërveprimit të vazhdueshëm të nxënësve, personelit mësimor dhe komunitetit.”.

c) Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Oficerët e sigurisë, që ushtrojnë detyrën në institucionet arsimore parauniversitare, të cilave u hiqet shërbimi i sigurisë publike, transferohen në institucionet arsimore parauniversitare, brenda së njëjtës zyre vendore arsimore parauniversitare.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 554, datë 29.7.2022

**PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARISË
SË DHURIMIT VULLNETAR TË
GJAKUT NGA PUNONJËSIT/
NËPUNËSIT E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 9739, datë 21.5.2007, “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet e administratës shtetërore organizojnë çdo muaj, sipas një grafiku të përcaktuar prej tyre, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, veprimtari të dhurimit vullnetar të gjakut, pa pagesë, nga punonjësit /nëpunësit e administratës shtetërore.

2. Institucionet e administratës shtetërore njoftojnë punonjësit/nëpunësit e tyre për ditët e planifikuara të dhurimit vullnetar të gjakut.

3. Punonjësit/nëpunësit e administratës shtetërore, të cilët dhurojnë vullnetarisht dhe pa pagesë gjak, kanë të drejtë:

a) të largohen ditën e dhurimit kundrejt detyrimit të institucionit për të paguar rregullisht ditën e punës;

b) të marrin pushim ditën e nesërme të dhurimit kundrejt detyrimit të institucionit për të paguar rregullisht ditën e punës.

4. Institucionet të marrin masa për të garantuar mirëfunksionimin e veprimtarisë së tyre në ditët që punonjësit/nëpunësit largohen nga puna për arsyen e lartpërmendur.

5. Punonjësit/nëpunësit e administratës shtetërore, të cilët dhurojnë vullnetarisht dhe pa pagesë gjak, minimalisht tri herë në vit, mund të akomodohen, kundrejt tarifave preferenciale të përcaktuara, 7 (shtatë) ditë në Shtëpinë e Pushimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme, sipas një grafiku të përcaktuar nga institucioni përkatës me dy ministritë e përmendura në këtë pikë.

6. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 556, datë 29.7.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR.101, DATË 9.2.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË
SEKTORËVE, QË DO TË
MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË
FINANCIMIT NGA FONDI I
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2022”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, e 36, të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr.64/2012, “Për peshkimin”, të



ndryshuar, dhe të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nënpikën 2.1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) Mbështetje për kultivimin e grurit, për sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 ha, në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për ha.”

2. Në pikën 2.2, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d. Mbështetje me 40 (dyzet) lekë për litër të karburantit për anijet e peshkimit, për furnizimet, nga data 1 korrik 2022 deri më 31 dhjetor 2022.”

3. Në nënpikën 2.5.1, shifra 1 450 000 000 (një miliard e katërqind e pesëdhjetë milionë) lekë zëvendësohet me shifrën 1 950 000 000 (një miliard e nëntëqind e pesëdhjetë milionë) lekë.

4. Efektet financiare shtesë prej 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekësh, që shoqërojnë miratimin e këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e kontingjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 558, datë 29.7.2022

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E SHKELJEVE ME PASOJA TË LEHTA APO ME PASOJA TË RËNDA DHE SANKSIONET FINANCIARE NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 10, të nenit 36, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Shkeljet në Fondin Pyjor Kombëtar vlerësohen me pasoja të rënda, në varësi të dëmit mjedisor që shkaktojnë dhe pasojave që sjellin në pyje, në rastet, kur:

a) janë kryer në një zonë pyjore të mbrojtur mjedisore, sidomos në zonat që janë me status strikt të mbrojtur dhe parqeve kombëtare, për të cilin është marrë statusi aktual i mbrojtjes, duke i nxjerrë ato jashtë funksionit;

b) kanë shkatërruar një monument natyror, të shpallur si të tillë;

c) janë kryer në ngastrat e përfshira në rezervat strategjike, pyjet e virgjëra, eksperimentale e studimore, kanë dëmtuar grumbujt e drurëve dhe të llojeve pyjore, të paracaktuara për konservim, germoplazmë, “*in-situ*” dhe “*ex-situ*”, për grumbullim, përpunim, shpërndarje dhe certifikim të materialit mbjellës;

ç) janë kryer në një pyll mbrojtës, të cilësuar të tillë në planet e mbarështimit, duke e nxjerrë atë jashtë funksionit, për të cilin kanë marrë statusin aktual mbrojtës;

d) kanë dëmtuar në masë dhe asgjësuar, me prerje, me shkulje, me marrje lloje të florës, të rralla, të rrezikuara e që gëzojnë status të veçantë mbrojtjeje dhe kanë shkatërruar cilësitë e një habitati konkret, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi;

dh) janë importuar dhe mbjellë fara, fidanë, kalema apo shpatulla të infektuara e të sëmura dhe të pashoqëruara me certifikatën e origjinës dhe atë fitosanitare;

e) kullotja kryhet në pyllëzimet e kryera 10-vjeçarin e fundit dhe në sipërfaqet e ricunguara 5-vjeçarin e fundit;

ë) dëmtohet filizëria në grumbujt pyjorë, në masën mbi 30% të sipërfaqes së nënngastrës pyjore;

f) dëmtohen elemente të infrastrukturës pyjore;

g) tjetërsohen sipërfaqe të fondit pyjor në truall, në masën mbi 0.1 ha, në kundërshtim me procedurat ligjore në fuqi;

gj) kryhen prerje shfrytëzuese në kufirin e sipërm të vegetacionit, në masën mbi 0.1 ha;



h) në një grumbull pyjor kryhen prerje të paligjshme në masë, në një sipërfaqe mbi 0.5 ha;

i) falsifikohet dhe përdoret çekiçdamka dhe kur markohet materiali drusor, pa lejen e strukturave përkatëse;

j) zjarrvënia dhe djegia e sipërfaqeve pyjore bëhen me dashje dhe me qëllim përfitimi;

k) kryhet krasitje për gjithë mbi 30% të sipërfaqes së nëngastrës pyjore;

l) nxirren rrënjë, kucka dhe zhardhokë, në masën mbi 30% të llojeve apo sipërfaqes së vlerësuar;

ll) nga sipërfaqet pyjore nxirren gurë, merret dheu apo humusi mbi 30% të sipërfaqes së vlerësuar, prej 1 ha;

m) transporti dhe eksporti i lëndës drusore dhe bimëve mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore kryhen pa dokumentet përkatëse, të lëshuara nga organet e ngarkuara me ligj (aktmiratimi, kontratë, leje shfrytëzimi, vërtetim transporti dhe certifikatë origjine);

n) kundërvajtjet administrative janë të përsëritura;

nj) nuk realizohen pyllëzimet, si detyrim i subjekteve që zhvillojnë aktivitet në fondin pyjor;

o) pengohen strukturat qendrore dhe vendore përgjegjëse për pyjet apo strukturat inspektuese e kontrolluese në kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji.

3. Shkeljet, që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, konsiderohen shkelje me pasoja të lehta.

4. Sanksionet financiare përcaktohen, për çdo rast, në përpjesëtim të drejtë me rëndësinë dhe natyrën e shkeljes së konstatuar dhe pasojat e ardhura, duke u mbështetur në tarifat për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në Fondin Pyjor Kombëtar dhe të gjobave, të përcaktuara në nenin 36, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”.

5. Për përcaktimin e sanksioneve financiare të një dëmi konkret, të shkaktuar në Fondin Pyjor Kombëtar, mbahen parasysh treguesit e mëposhtëm:

a) sipërfaqja pyjore që është dëmtuar (prerë, djegur, zënë, gërryer, krasitur e kullotur), e shprehur në njësinë fizike (ha), duke evidentuar natyrën e dëmtimit të mbulesës pyjore të saj;

b) shkalla e dëmtimit të sipërfaqes së dëmtuar ndaj totalit të saj të shprehur në %;

c) mënyra dhe mjetet konkrete me të cilat është shkaktuar dëmi;

ç) sasia e drurëve të dëmtuar, me vlerën e përlllogaritur, sipas pikës 4, të këtij vendimi;

d) llojet e dëmtuara me status të veçantë/rrezikuar: drurë farorë, lloje të kërcënuara ose në rrezik zhdukjeje, fidanë në fidanishte, germoplazmë (fruta, fara) dhe parcela eksperimentale, duke llogaritur dëmin sa trefishi i vlerës, sipas pikës 4, të këtij vendimi;

dh) sanksionet për dëmet e tjera vlerësohen sipas pikës 4 të këtij vendimi;

e) shpenzimet që nevojiten për ta riparuar dëmin.

6. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM Nr. 16, datë 20.7.2022

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË DETARIT (PASAPORTË DETARI), PËR SHTETASIT E HUAJ/PA SHTETËSI, PËR QËLLIME PESHKIMI, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, shkronjës “b”, të nenit 401, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga



institucionet shqiptare, për lëshimin e dokumentit të identifikimit të detarit (Pasaportë Detari), për shtetasit e huaj/pa shtetësi, për qëllime peshkime, në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet për të gjithë detarët me shtetësi të huaj/pa shtetësi, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët kërkojnë të pajisen me dokument identifikimi (Pasaportë Detari) nga institucionet shqiptare të parashikuara me ligj, me qëllim peshkimi.

2. Ky udhëzim nuk zbatohet për detarë që imbarkohen në bordin e mjeteve lundruese në përdorim të Forcave të Armatosura, kapitenarive të Porteve, Policisë Kufitare, Doganës dhe organeve të tjera shtetërore të parashikuara me ligj.

3. Shtetasit e huaj/pa shtetësi do të pajisen me dokument identifikimi (Pasaportë Detari), në Republikën e Shqipërisë, vetëm për lundrim kombëtar/të brendshëm.

Neni 3 Formati i Pasaportës së Lundrimit

1. Format i dokumentit të identifikimit të detarit (Pasaportë Detari) propozohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe miratohet nga ministri përgjegjës për transportin detar.

2. Dokumenti i identifikimit të detarit (Pasaportë Detari) që kanë aplikuar sipas legjislacionit në fuqi dhe ka plotësuar kriteret e parashikuara në këtë udhëzim, do të lëshohet nga zyra përkatëse për regjistrimin e detarëve, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare.

Neni 4 Amëza e detarit

1. Drejtoria e Përgjithshme Detare merr masa për mbajtjen e amzës për detarët me shtetësi shqiptare, sipas parashikimeve në nenin 106 të Kodit Detar.

2. Drejtoria e Përgjithshme Detare merr masa për mbajtjen e amzës për detarët me shtetësi të huaj.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare ndjek procedurën dhe administron dokumentacionin

përmes, Zyrës së Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detarëve, për Amëzën e Detarit.

Neni 5 Kriteret për pajisjen me pasaportë lundrimi të detarëve me shtetësi të huaj/pa shtetësi, për Flotën e Peshkimit

1. Detarët me shtetësi të huaj/pa shtetësi, që kërkojnë të pajisen me dokument identifikimi (Pasaportë Detari), për t'u imbarkuar në mjetet lundruese të peshkimit, duhet të ngarkojnë në portalin *e-Albania* dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) kontratën e punësimit si detar (origjinale);
- b) certifikatë shëndetësore për detarët, lëshuar nga Shërbimi Shëndetësor Portual;
- c) dokumentin për analizën e grupit e gjakut (origjinale);
- d) lejen Unike, në Republikën e Shqipërisë;
- e) pasaportën e Detarit të lëshuar nga shteti i tij;
- f) dokument kualifikimi për detyrën që do të kryej (nëse ka).
- g) mandatpagesa sipas llojit të shërbimit.
- h) dy fotografi (5 x 4 cm për dokument të cilat dorëzohen fizikisht në zyrën përkatëse);

2. Dokumentet që nuk janë në gjuhën shqipe duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

3. Pasaporta e detarit do t'i lëshohet në të njëjtën pozicion, siç e ka të përcaktuar në pasaportën e lëshuar nga shteti i kandidatit.

4. Në rastet kur Pasaporta e Detarit, e lëshuar nga shteti i kandidatit nuk e ka të përcaktuar nivelin e pozicionit atëherë Drejtoria e Përgjithshme Detare do të bëjë një testim në zbatim të legjislacionit në fuqi për përcaktimin e nivelit të pozicionit të punës që mund të kryejë në anije.

5. Detarët me shtetësi të huaj, që kërkojnë të pajisen me dokument identifikimi (Pasaportë detari), para marrjes së saj duhet të dorëzojnë fizikisht pranë Zyrës së Regjistrimit të Mjeteve Lundruese dhe Detarëve, Pasaportën e Detarit të lëshuar nga shteti i tyre i cili do të mbahet në dosjen e detarit.

6. Ky dokument do t'i kthehet përsëri zotëruesit, pasi do të dorëzojë te zyra e regjistrimit të detarëve në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, pasaportën e detarit të lëshuar nga kjo zyrë.



7. Afati i vlefshmërisë së dokumentit të identifikimit të detarit, për shtetasit e huaj apo për ato pa shtetësi, do të korrespondojë me afatin e kohëzgjatjes së Lejes së Unike, në Republikën e Shqipërisë.

8. Shtyrja e afatit të Pasaportës së detarit do të bëhet sa herë rinovohet Leja Unike, nga autoritetet kompetente;

9. Për shtyrjen e afatit të Pasaportës së Detarit, detari me shtetësi të huaj/pa shtetësi do të paraqesë fizikisht te zyra e regjistrimit të detarëve dokumentet origjinale të mëposhtme:

- a) Pasaporta e Detarit;
- b) leja Unike e rinovuar nga autoritetet kompetente;
- c) certifikatë shëndetësore për detarët, lëshuar nga Shërbimi Shëndetësor Portual; dhe
- d) kontratën e punësimit si detar (origjinale).

Neni 6

Ankimi kundër refuzimit të lëshimit të pasaportës së detarit

1. Kundër refuzimit të lëshimit të pasaportës së detarit, detari ka të drejtën e ankimit administrativ te Drejtoria e Përgjithshme Detare, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Procedura e shqyrtimit të ankimit administrativ duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit administrativ. Kundër vendimit të DPD-së bëhet ankim në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare, për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 17, datë 20.6.2022

PËR PËRCAKTIMIN E UNIFORMITETIT MINIMAL TË STANDARDEVE PROCEDURALE PËR MBLEDHJEN E DETYRIMEVE TË TAKSAVE E TARIFAVE VENDORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 4, pikat 1, 5 dhe 8, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

QËLLIMI I UDHËZIMIT

Ky udhëzim ka për qëllim që në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, dhe ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, me ndryshimet përkatëse, të përcaktojë procedura uniforme e të qarta për mbledhjen e detyrimeve tatimore, të taksapaguesve në nivel vendor, për të garantuar një zbatim korrekt, të njëjtë dhe efektiv të legjislacionit nga ana e administratës tatimore vendore në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ai gjithashtu synon rregullimin e bashkëpunimit të ndërsjellë midis administratës tatimore qendrore dhe asaj vendore në veprimtaritë e tyre specifike, për administrimin në tërësi të sistemit tatimor. Kur me vendim të Këshillit Bashkiak, mbledhja e detyrimeve tatimore vendore bëhet nëpërmjet një agjenti, rregullat procedurale, për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, përcaktohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe dispozitat e aktmarrëveshjes së lidhur midis palëve.

I. ORGANIZIMI I MBLEDHJES SË DETYRIMEVE TATIMORE VENDORE TË PAPAGUARA

Njësitë e vetëqeverisjes vendore/NJVV-të kanë të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave për përmbushjen e funksioneve të tyre. Ato kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore vendore të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit,



apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.

Në varësi të strukturës organizative të NJVV-së ky funksion është i organizuar në bazë drejtorie, sektori apo specialisti.

Drejtuesi i strukturës tatimore vendore harton rregulloren bazë të procedurave të mbledhjes së detyrimeve tatimore vendore të papaguara, e cila miratohet nga kryetari i bashkisë.

Në rastin kur me vendim të Këshillit Bashkiak mbledhja e detyrimeve tatimore vendore bëhet nëpërmjet një agjenti, rregullat procedurale, për mbledhjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore përcaktohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe dispozitat e aktmarrëveshjes së lidhur midis palëve.

II. VEPRIMET PARAPRAKE TË MBLEDHJES SË DETYRIMEVE TATIMORE VENDORE ME MASA SHTRËNGUESE

1. Identifikimi i çështjeve

Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore përgjegjëse për masat shtrënguese ka autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, kur konstaton se taksapaguesi është në kushtet e paragrafit 1, të nenit 88, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Procedurat e mbledhjes së detyrimeve tatimore vendore të papaguara, fillojnë në rastet kur:

a) ka përfunduar afati i përcaktuar në ligj, akte nënligjore apo vendime të këshillit bashkiak, për pagesën e taksës apo tarifës vendore, i cili zbatohet pas verifikimit nga administrata tatimore vendore, të mungesës së ankimit administrativ;

b) ka përfunduar ankimi administrativ në organin kompetent brenda hierarkisë administrative (bashkisë), si dhe verifikimi nga administrata tatimore vendore si i pa vazhduar në shkallën e pushtetit gjyqësor, pranë gjykatës administrative;

c) kur ka përfunduar me një vendim të formës së prerë, jo në favor të palës paditëse, një gjykim nga gjykata administrative.

III. PROCEDURA PËR MBLEDHJEN ME MASA SHTRËNGUESE TË DETYRIMEVE TATIMORE VENDORE

Procedurat dhe hapat e mbledhjes së detyrimeve fiskale në nivel vendor, bazohen në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për aq sa ato

nuk rregullohen apo nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, dhe ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, në fuqi.

Hapat dhe procedurat që ndiqen nga drejtoritë e taksave dhe tarifave vendore apo strukturat administrative tatimore të ngjashme me to, për mbledhjen e detyrimeve të papaguara të taksave e tarifave vendore:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar

Njoftimi dhe kërkesa për të paguar është akti administrativ i cili shërben si një njoftim me shkrim, me të cilin administrata tatimore vendore, i kërkon taksapaguesit, pagesën e plotë të taksave dhe tarifave vendore, nëse prej tij nuk janë paguar plotësisht dhe në afatin e përcaktuar detyrimet tatimore vendore.

Struktura administrative e taksave dhe tarifave vendore përgatit dokumentin *Njoftim dhe Kërkesë për të Paguar* (aneksi A - Formulari MSh001), kur taksapaguesi nuk ka paguar në afat detyrimet e tij, lidhur me taksat e tarifave vendore.

Njoftimi i dërgohet taksapaguesit me njërin nga format e mëposhtme:

- me anën e shërbimit postar rekomandë;
- dorazi;

- në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike dhe kur taksapaguesi ka dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike.

Njoftimi e kërkesa për të paguar nxirret brenda 3 ditëve pune nga dita e parë e punës pas përfundimit të afatit ligjor të përcaktuar për pagimin e detyrimeve tatimore vendore.

Njoftimi vendoset/regjistrohet në dosjen e taksapaguesit (dosja e ndjekjes së masave për taksapaguesin) brenda 5 ditëve nga data e dërgimit të tij me postë rekomandë, rrugë elektronike apo nga data kur njoftimi i është dorëzuar dorazi taksapaguesit kundrejt konfirmimit të këtij të fundit për marrjen e tij.

Me kalimin e 10 ditëve nga data e nisjes me postë, rrugë elektronike të këtij njoftimi, ose brenda 3 ditëve nga data e dorëzimit në dorë taksapaguesit të njoftimit, drejtoria e taksave dhe tarifave vendore ka detyrimin të fillojë zbatimin e procedurës për mbledhjen me masa shtrënguese të detyrimeve tatimore të papaguara.



1.1 Bllokimi i shitjes së aktiveve

Administrata tatimore vendore, sipas afatit në paragrafin e fundit më lart, i dërgon Qendrës Kombëtare të Biznesit kërkesën për ndalimin e veprimeve që kanë të bëjnë me transferimin e kapitaleve të veta të taksapaguesit.

Modeli i kërkesës për vendosjen e masës së bllokimit të pasurisë dhe të drejtave pasurore është sipas formularit në fund (Aneksi A - Formulari MSh002).

Taksapaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesë/të transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes/transferimit të aktiveve, synohet shlyerja plotësisht e detyrimit tatimor të papaguar. Në këtë rast, taksapaguesi paraqet në QKB një dokument nga administrata tatimore vendore, që vërteton se transaksioni kryhet për efekt të pagimit të detyrimit tatimor.

1.2 Konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit

Administrata tatimore vendore, mbështetur në nenin 89, pika 2, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të taksapaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi i taksave dhe tarifave vendore për të cilat kanë filluar masat shtrënguese.

Taksapaguesi njoftohet paraprakisht se do të fillojë verifikimi dhe monitorimi në terren i aktivitetit tregtar të tij.

Urdhri për të konfiskuar në fund të çdo dite një shumë jo më pak se 50% e qarkullimit ditor të realizuar por jo më shumë se detyrimi tatimor, lëshohet nga titullari i NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete.

Në këtë urdhër, detyrimisht, përveç bazës ligjore duhet të theksohet edhe fakti që procedura që po ndiqet është në marrëveshje të plotë me administratën tatimore qendrore/rajonale, shprehur edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit e mirëkuptimit reciprok.

Ky urdhër është akti i vetëm me anë të të cilit administrata tatimore vendore ushtron të drejtën e konfiskimit të qarkullimit ditor.

Urdhri i konfiskimit të qarkullimit përmban detyrimisht të dhënat e mëposhtme:

- Emrin e taksapaguesit;
- NIPT-in;
- Adresën e veprimtarisë ekonomike të taksapaguesit;
- Numrin dhe datën e njoftimit të vlerësimit tatimor;
- Bazën ligjore sipas të cilës është duke u kryer masa e konfiskimit;
- Shumën e qarkullimit ditor për të cilën vendoset masa e konfiskimit;
- Shumën e qarkullimit ditor të matur;
- Shprehjen e qartë të detyrimit që taksapaguesi, brenda ditës së nesërme të punës, duhet të kalojë për llogari të administratës tatimore vendore pagesën e shumës së konfiskuar për detyrimet për të cilat ka filluar procedura e mbledhjes me masa shtrënguese të detyrimit.

Në fund të ditës mbahet procesverbal, midis inspektorit të caktuar nga drejtuesi i strukturës së taksave dhe tarifave vendore dhe taksapaguesit, mbi qarkullimin ditor dhe kalimin e 50% të shumës së qarkullimit ditor (jo më shumë se detyrimi tatimor), në llogarinë bankare të administratës tatimore vendore, ditën e nesërme të punës. Nëse kjo ditë është pushim, pagesa kryhet ditën e parë të punës që ndjek atë të ditës së pushimit.

Taksapaguesi pajiset nga struktura e taksave dhe tarifave vendore me urdhërpagesat përkatëse/faturat për arkëtim për të bërë pagesën respektive ndaj NVV-së në bankë, postë ose institucion tjetër financiar. Inspektori i caktuar me kryerjen e procedurës ndjek dhe verifikon nëse derdhja e shumës 50% të qarkullimit (jo më shumë se detyrimi tatimor) është bërë rregullisht.

1.3 Kallëzimi për ndjekje penale

Kur struktura përkatëse e taksave dhe tarifave vendore konsideron se pagesa e taksave dhe tarifave vendore është në rrezik dhe ndodhet përpara rasteve, kur:

- taksapaguesi është vështirë të gjendet ose kërkon të largohet nga vendi;
- taksapaguesi kërkon që nëpërmjet likuidimit, falimentimit të shmangë pagesën e detyrimeve;



- taksapaguesi kërkon të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij, me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve;

- taksapaguesi kërkon të shesë/transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë për të shmangur pagesën e detyrimeve; apo

- arsye tjera të ngjashme të dokumentuara.

Mund të propozojë për kallëzim për ndjekje penale, për marrjen e masës së sigurimit personal, sipas nenit 233, të Kodit të Procedurës Penale.

Administrata tatimore vendore, vetë, nëpërmjet titullarit të NJVV-së ose drejtuesit të strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete, ose nëpërmjet organit të prokurorisë, ka të drejtë t'i kërkojë bankave me seli në Republikën e Shqipërisë, të mos lejojnë taksapaguesin të bëjë transferimin e shumave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesit

Urdhri i bllokimit të llogarive bankare është një njoftim dhe kërkesë për pagesë, që administrata tatimore vendore, nëpërmjet titullarit të NJVV-së ose drejtuesit të strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete, i dërgon bankave, për të bllokuar çdo llogari në emër të taksapaguesit, i cili nuk ka paguar taksat e tarifave vendore në shumën dhe kohën e duhur.

Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të taksapaguesit (Aneksi A - Formulari MSh003), i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë, në të cilat taksapaguesi, mund të ketë llogaritë e tij.

Urdhri i bllokimit të llogarive bankare nxirret, pasi kanë kaluar 10 (dhjetë) ditë pune nga dërgimi i dokumentit *Njoftim dhe kërkesë për të paguar*. Ky dokument firmoset nga titullari i NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete, dhe dërgohet me:

- postë; ose
- në rrugë elektronike.

Në rast se struktura e taksave dhe tarifave vendore lëshon urdhra bllokimi për më shumë se 20 taksapagues, në të njëjtën ditë, urdhrat dërgohen në format elektronik.

Urdhri i bllokimit përmban domosdoshmëri të dhënat e mëposhtme:

a) identitetin e taksapaguesit (personit juridik, fizik tregtar, individ), llogaritë e të cilit preken nga dalja e këtij urdhri;

b) shkakun e nxjerrjes së tij;

c) shumën që bankat duhet të bllokojnë.

Banka, brenda ditës së nesërme të punës nga dita e marrjes së urdhrit, bën bllokimin e llogarive/depozitave të taksapaguesit. Banka, brenda 5 ditëve pune nga marrja e urdhrit, njofton strukturën e taksave dhe tarifave vendore për gjendjet e llogarive/depozitave të taksapaguesit.

Njoftimi bëhet me:

- shkresë zyrtare; ose
- në rrugë elektronike.

Struktura e taksave dhe tarifave vendore, brenda 2 ditëve pune nga marrja dijeni për bllokimin, përgatit dhe i dërgon bankës urdhrin e ekzekutimit (Aneksi A- Formulari MSh004).

Urdhri i ekzekutimit përmban:

- shumën që kërkohet të transferohet;
- numrat/kodet e llogarive të taksave/tarifave përkatëse;
- kodin buxhetor të NJVV-së në sistemin e thesarit.

Praktika shoqërohet me urdhrin e pagesës ose faturës për arkëtim, ku përcaktohen kodet e llogarive apo *barcode*-t, për secilën taksë/tarifë, si dhe kodin e NJVV-së për llogari të së cilës do të bëhet pagesa.

Banka, jo më vonë se 3 ditë pune nga dita e marrjes së urdhrit:

- transferon shumën;
- njofton strukturën e taksave dhe tarifave vendore në NJVV dhe taksapaguesin, me shkrim ose në rrugë elektronike.

Në rast se detyrimi ekzekutohet plotësisht, administrata vendore, me të marrë dijeni, menjëherë, i dërgon bankave, një urdhër zhbllokimi.

Në rast se detyrimi ekzekutohet pjesërisht, administrata tatimore dërgon një urdhër të ri bllokimi bankave, për shumën e detyrimit që rezulton mbas ekzekutimit të pjesëshëm.

Në rast se taksapaguesi nuk ka gjendje në llogaritë bankare në asnjë nga bankat, llogaritë do të vazhdojnë të mbahen të bllokuara në bazë të urdhërbllokimit.

3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor

Struktura e taksave dhe tarifave vendore, nëse konstaton se me gjithë bllokimin e llogarive



bankare, detyrimet tatimore vendore nuk janë paguar, ajo kërkon sigurimin e pagimit të këtij detyrimi, nëpërmjet vendosjes së masave të sigurisë për të gjithë pasurinë e taksapaguesit.

Masat e sigurimit të pasurisë merren gjithmonë me anë të një vendimi me shkrim të titullarit të NJVV-së dhe/ose nëpunësit zbatues përgjegjës.

Pavarësisht se vendimi për marrjen e masave të sigurimit të pasurisë së taksapaguesit bëhet nga titullari i NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete, ato kanë efekt për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Çdo person juridik, që ka regjistruar pasuri të taksapaguesit, është i detyruar të ekzekutojë vendimin e nxjerrë për marrjen e masave të sigurimit mbi pasurinë e taksapaguesit debitor.

3.1 Llojet e masave të sigurimit të detyrimit tatimor dhe afatet

Kur me gjithë masat për bllokimin e llogarive bankare të taksapaguesit debitor, akoma detyrimet tatimore janë të papaguara, atëherë administrata tatimore vendore, brenda 10 (dhjetë) ditëve, zbaton masat e sigurimit të detyrimit tatimor.

Përmbajtja e tyre është në formatin e shkresës zyrtare, si më poshtë:

- a) Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e masave të sigurimit të detyrimit tatimor;
- b) Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore;
- c) Njoftim për vendosjen e barrës siguroese.

Njoftimi për taksapaguesin mbi vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor bëhet me qëllim që taksapaguesi:

- të marrë dijeni për vendosjen e masës së sigurimit mbi pasuritë e tij; si dhe
- të ketë mundësinë e ushtrimit të së drejtës së ankimit.

3.1.1 Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e masave të sigurimit të detyrimit tatimor

Njoftimi i përgjithshëm për vendosjen e barrës siguroese dhe hipotekore (Aneksi A - Formulari MSH005) publikohet në faqen zyrtare të internetit të administratës tatimore vendore/bashkisë dhe bëhet me qëllim që:

- personat e tretë të marrin dijeni për fillimin e këtyre procedurave;
- institucionet të cilët kanë regjistrime të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të taksapaguesit debitor të marrin dijeni paraprakisht

dhe të moslejojnë kryerjen e transaksioneve për transferimin e pasurive të taksapaguesit debitor, deri në momentin që detyrimi tatimor i papaguar është arkëtuar.

3.1.2 Njoftimi për vendosjen e barrës hipotekore

Barra hipotekore, si mjet i sigurimit të pagimit të detyrimeve tatimore, vendoset gjithnjë në bazë të vendimit të nxjerrë nga titullari i NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete.

Akti (Aneksi A - Formulari MSh006) me anë të të cilit kërkohet të vendoset barra hipotekore, i dërgohet:

- i. Drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ku ndodhet pasuria e paluajtshme e taksapaguesit, apo selia e tij; si dhe
- ii. Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Nëse struktura e taksave dhe tarifave vendore nuk disponon të dhëna mbi pasurinë e paluajtshme të debitorit, i kërkohet drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ku ndodhet pasuria e paluajtshme e taksapaguesit, apo selia e tij, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, që brenda 5 ditëve pune, të identifikojnë këto pasuri dhe të bëjnë vendosjen në hipotekë të tyre në favor të administratës tatimore vendore.

Në rastet kur pasuritë e paluajtshme janë në bashkëpronësi edhe me persona të tjerë ndaj të cilëve nuk mund të shtrihet procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, administrata e cila ka nxjerrë vendimin për vendosjen e hipotekës, duhet të bëjë veçimin e këtyre pjesëve dhe të vendosë hipotekën, vetëm për pjesën që i takon si pronësi taksapaguesit debitor.

3.1.3 Njoftimi për vendosjen e barrës siguroese

Barra siguroese merret si masë sigurimi për të gjitha pasuritë e luajtshme të debitorit. Për të bërë identifikimin e pasurive të luajtshme ndaj të cilave mund të vendoset barrë siguroese, administrata tatimore vendore i dërgon njoftim për vendosjen e barrës siguroese (Aneksi A - Formulari MSh007), zyrove takuese në Republikën e Shqipërisë/Regjistri i Barrëve Siguroese, të cilat janë të ngarkuara nga ligji për të bërë regjistrimin e pasurive të luajtshme.



Zyrat të cilat regjistrojnë pasuri të luajtshme bëjnë regjistrimin e barrës në emër të NJVV-së përkatëse/administratës tatimore vendore.

Në qoftë se sendet mbi të cilat është vendosur barra siguruese, janë të siguruara shpërblimi që taksapaguesi apo personat ndaj të cilëve është vendosur barra siguruese, do të merrnin në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, kalon në favor të administratës tatimore vendore/NJVV-së.

Institucionet e regjistrimit të barrëve siguruese, brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit, informojnë NJVV-në/administratën tatimore përkatëse nëse taksapaguesi ka pasuri në emër të tij apo jo.

3.2 Ankimimi i masës së sigurimit të detyrimit tatimor

Mosekzekutimi i masës së sigurimit në mënyrë të rregullt është objekt ankimimi.

Ankimimi bëhet pranë NJVV-së/strukturës së taksave dhe tarifave vendore, e cila ka nxjerrë vendimin e masës së sigurimit të detyrimit tatimor.

Drejtuesi i strukturës së taksave dhe tarifave vendore duhet të garantojë që procedurat e ndjekura deri në vendosjen e masave të sigurisë të jenë zbatuar në mënyrë të rregullt në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Kur një parregullsi e pretenduar nga taksapaguesi rezulton se është e vërtetë, atëherë titullari i NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete, në bazë të një vendimi me shkrim, duhet të motivojë revokimin e vendimit dhe të çlirojë nga barra sendet mbi të cilat është vendosur barra siguruese apo hipotekore.

Kur kërkesa e taksapaguesit nuk është paraqitur brenda afatit kohor prej 30 ditësh nga marrja e njoftimit, ajo konsiderohet e pavlefshme dhe nuk shqyrtohet.

Vendimi i revokimit dhe i pranimit të kërkesës ankimore të taksapaguesit, duhet të jetë i arsyetuar dhe të jepet brenda 60 ditëve nga data e protokollimit të kërkesës ankimuese të taksapaguesit.

Në çdo rast, vendimi që ka marrë në shqyrtim kërkesën për kundërshtim të marrjes së masave të sigurisë ruhet në dosjen e taksapaguesit.

Në qoftë se kërkesa e taksapaguesit nuk miratohet, taksapaguesi mund ta ankimojë këtë vendim në përputhje me nenin 7, të ligjit 9632, datë

30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshimet përkatëse.

4. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë

Nëse taksapaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata vendore, mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit të pasurisë në pronësi të taksapaguesit të siguruar në favor të NJVV-së/administratës tatimore vendore.

Në çdo rast, autorizimi për fillimin e procedurës së sekuestrimit dhe konfiskimit nxirret nga titullari i NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete.

4.1 Pasuria, objekt i sekuestrimit dhe evidentimi i pasurisë

Administrata vendore mund të zbatojë procedurën e sekuestrimit mbi pasuritë/aktivet ekonomike, si më poshtë:

- a) pasurinë e luajtshme të subjektit;
- b) pasurinë e paluajtshme të subjektit.

Administrata vendore nuk mund të sekuestrojë pasuritë që janë përcaktuar në nenin 529 të Kodit të Procedurës Civile.

4.2 Urdhri i sekuestrimit

Urdhri i sekuestrimit është akti i vetëm me anë të të cilit administrata tatimore vendore ka të drejtë të fillojë procedurat e sekuestrimit, pasi më parë ishin vendosur masat e sigurisë.

Urdhri i sekuestrimit bëhet me shkrim dhe firmoset nga titullari i NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete.

Urdhri i sekuestrimit përmban detyrimisht të dhënat:

- a) shumën e detyrimeve tatimore të papaguara;
- b) afatin për pagesën e detyrimeve tatimore;
- c) pasurinë që sekuestrohet;
- ç) mënyrën e ekzekutimit të sekuestrimit;
- d) informacionin rreth së drejtës së taksapaguesit për ankim administrativ.

4.3 Zbatimi i urdhrat të sekuestrimit

Nga ana e titullarit të NJVV-së ose drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete, urdhërohet ngritja e grupit të punës, për zbatimin e kësaj mase shtrënguese.



Në grupin e punës bëjnë pjesë punonjës që janë ngarkuar me mbledhjen e detyrimeve tatimore vendore me masa shtrënguese, si dhe të Policisë Bashkiake, në mbështetje të tyre.

Njësia e vetëqeverisjes vendore njofton, me anë të një shkrese zyrtare, zyrën ku ajo ka regjistruar barrën siguruese/RBS-në dhe drejtorinë vendore dhe atë të përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në rastin e regjistrimit të barrës hipotekore.

4.4 Përgjegjësia për sekuestrimin e pasurisë

Punonjësit e ngarkuar me zbatimin e masave shtrënguese në strukturën e taksave dhe tarifave vendore, si dhe të ngarkuarit nga efektivet e Policisë Bashkiake janë përgjegjës për kryerjen e veprimeve procedurale për të ekzekutuar sekuestron mbi sendet, mbi të cilat janë vendosur si barrë siguruese dhe hipotekore.

Përpara se të fillojë sekuestrimi, grupi i ngarkuar me çështjen duhet:

- a) të verifikojë nëse sekuestrimi është autorizuar në mënyrë korrekte;
- b) të verifikojë shumën aktuale të borxhit, përfshirë interesat dhe gjokat;
- c) të verifikojë nëse janë ndjekur gjithë procedurat e mbledhjes dhe masat shtrënguese;
- d) të verifikojë që akti të ketë adresën e saktë dhe të azhurnuar të taksapaguesit;
- e) të pajiset me të gjithë të dhënat e disponueshme për pasurinë që mund të sekuestrohet, duke treguar tipat e pasurisë që mund të jenë në gjendje të sekuestrohen në këtë rast.

Vizitat për sekuestrimin bëhen gjatë orarit të punës, por përjashtimisht, nëse gjykohej e nevojshme, mund të autorizohen vizita në çdo kohë, me miratim zyrtar të titullarit të NJVV-së ose të drejtuesit të strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete.

4.5 Përjashtimet nga sekuestrimi i pasurisë

Inspektorët nuk duhet të sekuestrojnë pasuri që nuk i përkasin debitorit. Vëmendje të veçantë i duhet kushtuar dallimit:

- a) aktive të shoqërisë dhe aktivet e drejtuesve të saj;
- b) aktive të një ortakërie dhe aktivet e partnerëve veç e veç.

Debitori duhet pyetur që të konfirmojë pronësinë mbi çdo mall që mund të sekuestrohet. Nëse debitori nuk bashkëpunon, inspektori duhet

të sekuestrojë çdo pasuri që mendohet se i përket atij.

Nëse debitori pretendon se nuk njeh asnjë nga mallrat apo aktivet që do të sekuestrohen, atij duhet t'i kërkohej të paraqesë dokumentacionin që ofron provë të dokumentuar për të mbështetur pretendimin.

Në mungesë të fakteve të tilla, inspektorët duhet të sekuestrojnë artikujt në fjalë. Përjashtohen nga sekuestrimi pasuritë e debitorit sipas përcaktimeve në nenin 509 të Kodit të Procedurave Administrative.

4.6 Dokumentimi i sekuestrimit

Me kryerjen e procesit të sekuestrimit të pasurisë nga ana e grupit të punës, për realizimin e sekuestrimit, mbahet një procesverbal *“Inventari i pasurisë së sekuestruar”* (Aneksi A - Formulari MSh 008). Në procesverbal duhet të regjistrohet numri dhe përshkrimi i të gjithë artikujve të sekuestruar. Përshkrimi duhet të jetë aq i hollësishëm, sa të lejojë identifikimin e saktë të artikullit p.sh.: llojin e aktivitetit, modelin/tipin, sasinë, numrin serial/regjistrimit, madhësinë/kapacitetin, ngjyrën, vendndodhjen, etj.

Çdo faqe e procesverbalit të inventarit duhet të firmoset dhe t'i vendoset data, nga inspektorët e ngarkuar e të pranishëm në atë proces sekuestrimi.

Një kopje e këtij procesverbali i jepet taksapaguesit ose përfaqësuesit të tij.

4.7 Konfiskimi i pasurisë së sekuestruar dhe shitja e saj

Me kalimin e afatit 15-ditor, nga dita e marrjes së njoftimit të sekuestrimit nga ana e taksapaguesit, sendet e paluajtshme ose të luajtshme të sekuestruara nga administrata tatimore, prej taksapaguesit, konfiskohen dhe i nënshtrohen procesit të shitjes së tyre, me qëllim arkëtimin e detyrimit tatimor.

Në këtë rast administrata tatimore vepron në përputhje me të gjitha rregullat e parashikuara në ligjin *“Për ankandin publik”*.

Në zbatim të procedurave të shitjes, njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti shitës dhe përgjegjës për realizimin e ankandit publik, në përputhje me ligjin *“Për ankandin publik”*.

Me përfundimin e procesit të shitjes së mallrave të konfiskuara, të ardhurat nga shitja përdoren fillimisht për të paguar shpenzimet për zhvillimin e ankandit publik dhe më pas zbatohet radha e pagesës së detyrimeve tatimore.



Kostot administrative përbëhen nga të gjitha kostot e paguara më parë, për marrjen e masave të sigurisë, sekuestrimit të tyre, vlerësimit, transportit, të publikimit etj.

Kur nga shitja realizohen më shumë të ardhura se sa ka qenë detyrimi tatimor i papaguar prej taksapaguesit, këto shuma i kthehen taksapaguesit brenda 5 ditëve pune nga data e përfundimit të arkëtimit të parave të realizuara nga shitja në favor të NJVV-së/administratës tatimore vendore.

Në këtë rast, administrata vendore njofton me shkrim taksapaguesin, si dhe i kërkon atij të japë numrin e llogarisë bankare, në mënyrë që të bëhet kalimi i këtyre shumave në favor të taksapaguesit.

Në rast se taksapaguesi nuk ka llogari bankare, atëherë këto shuma depozitohen në një bankë në vendin, ku taksapaguesi ka selinë apo vendbanimin e tij, në emër dhe për llogari të këtij të fundit.

5. Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë

5.1 E drejta e mbledhjes së detyrimit tatimor palës së tretë

Administrata tatimore vendore ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit të papaguar dhe nga personat e tretë, nëpërmjet transferimit të detyrimit të taksapaguesit tek këta persona. Persona të tretë konsiderohen ata që gjatë periudhës së mbledhjes me masa shtrënguese të detyrimeve tatimore kanë përfituar prej taksapaguesit debitor sende të luajtshme apo të paluajtshme.

Ligji kërkon domosdoshmërisht përmbushjen e dy kritereve për transferimin e detyrimit të personi i tretë:

i. detyrimi tatimor i taksapaguesit të mos jetë arkëtuar plotësisht edhe pas shitjes së pasurive të taksapaguesit, pasuri ndaj të cilave më parë ishin marrë masat e sigurimit të detyrimit;

ii. personi i tretë t'i ketë fituar këto pasuri prej taksapaguesit debitor, gjatë periudhës së fillimit dhe zbatimit të procedurave të mbledhjes me masa shtrënguese të detyrimit tatimor të papaguar.

Vetëm në këto raste administrata tatimore transferon detyrimin e papaguar.

5.2 “Njoftimi dhe kërkesa për pagesë” për transferimin e detyrimit

Nëse struktura e taksave dhe tarifave vendore konstaton se janë përmbushur kriteret për transferimin e detyrimit, merr masa për t'i dërguar personit të tretë dokumentin “Njoftimi dhe kërkesë për pagesë”, për detyrimin tatimor të transferuar.

Me këtë dokument NJVV-ja/administrata tatimore njofton personin e tretë, se tek ai është transferuar detyrimi tatimor i një taksapaguesi, nga i cili ky person ka përfituar pasuri gjatë periudhës së sekuestrimit të pasurive të taksapaguesit debitor dhe detyrimin për pagesën e tij.

Në çdo rast njoftimi duhet të përmbajë të arsyetuar edhe shkakun e transferimit të këtij detyrimi tatimor të personi i tretë.

Transferimi i detyrimit tatimor tek të tretët, aprovohet paraprakisht nga ana e titullarit të NJVV-së dhe/ose nëpunësit zbatues përgjegjës.

Njoftimi i këtij detyrimi bëhet gjithmonë me shkrim, dhe përmban:

a) emrin tregtar, NIPT-in/NUIS-in e personit të tretë që i transferohet detyrimi;

b) selinë e regjistruar apo adresën e vendbanimit të tij;

c) shumën e detyrimit që atij i transferohet si detyrim tatimor;

ç) vlerësimin e shumës që i takon të paguajë;

d) pasurinë e përfituar prej tij;

dh) afatin e pagimit të kësaj shume në favor të administratës tatimore;

e) bankën dhe numrin e llogarisë se ku do të kryejë pagesën;

f) emrin tregtar, NIPT-in e taksapaguesit debitor;

h) selinë e regjistruar apo adresën e taksapaguesit debitor.

5.3 Afati procedural për pagimin e detyrimit të transferuar

Afat maksimal i pagimit të shumës së detyrimit tatimor, që i transferohet personit të tretë, është dita e 14-ë, nga data e marrjes dijeni të njoftimit. Në rast se kjo ditë bie ditë pushimi, ky afat shtyhet deri në ditën e parë të punës që vjen mbas këtij afati.

5.4 Përlllogaritja e detyrimit të transferuar

Detyrimi tatimor që do të përlllogaritet për personin e tretë, ndaj të cilit është transferuar detyrimi, bëhet mbi bazën e vlerës së tregut të pasurisë, e cila i është transferuar personit të tretë.

Për të llogaritur vlerën e tregut, struktura e taksave dhe tarifave vendore mbështetet në të dhëna të marra prej INSTAT-it, në të dhëna që ajo disponon prej taksapaguesve të tjerë, në çmime që mund të kenë zyra të ndryshme që merren me regjistrimin e pasurive dhe në çmimet, në rastet e kryerjes së transaksioneve për kalimin e pronësisë



së tyre, që mund të ketë evidentuar Administrata Tatimore Qendrore.

6. E drejta për të kërkuar detyrimet nga palët e treta

6.1 Afati procedural dhe procedura për mbledhjen e detyrimit të transferuar

Struktura e taksave dhe tarifave vendore kur ka dijeni që palë të treta kanë për të paguar shumën të caktuar në favor të taksapaguesit debitor, kërkon nga këta persona që detyrimet e tyre monetare kundrejt taksapaguesit t'i derdhin në favor të administratës tatimore vendore.

Palët e treta për të kryer këto pagesa duhet të jenë njoftuar me shkrim, ndërkohë që detyrimi i tyre fillon brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, por jo më vonë se sa 37 ditë prej datës së nisjes së njoftimit zyrtar.

Në çdo rast administrata tatimore vendore, brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijeni për pagesat që kanë për të kryer palët e treta kundrejt taksapaguesit, duhet të përgatisë e nisë për palën e tretë “Njoftimin dhe kërkesën për pagesë”.

6.2 Fillimi i procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit të transferuar

Nëse me kalimin e 37 ditëve nga data kur është nxjerrë “Njoftimi dhe kërkesa për pagesë” nuk janë kryer pagesat dhe nëse personi që i transferohet detyrimi edhe pas njoftimit të bërë nga administrata tatimore, nuk e kundërshton atë brenda afateve kohore të parashikuara në ligj, inspektori përgjegjës për çështjen duhet të fillojë mbledhjen me masa shtrënguese të këtij detyrimi ndaj personit të tretë. Procedura e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor ndaj personit të tretë është e njëjtë me procedurën për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara nga taksapaguesi debitor.

7. Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe administratorit

7.1 Kushtet e zbatimit

Në rastin e taksapaguesve persona juridikë, kur pas shites së pasurive të taksapaguesit debitor nuk është arritur të mbledhet detyrimi i papaguar, atëherë detyrimi i papaguar i taksave e tarifave vendore, transferohet tek ortakët/ortaku i vetëm, aksionarët, si dhe tek administratori i personit juridik.

Struktura e taksave dhe tarifave vendore duhet të ketë analizuar paraprakisht nëse personi juridik, përgjegjësia e të cilit për mospagimin e detyrimit tatimor u transferohet personave si më lart,

ndodhet në kushtet e nenit 16, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kusht i domosdoshëm i zbatimit të kësaj mase është që më parë gjykata të ketë vendosur për përgjegjësinë e ortakut/aksionarit/administratorit me një vendim të formës së prerë.

Në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë kjo procedurë është e pazbatueshme.

7.2 Procedura që ndiqet

Transferimi i detyrimit tatimor tek ortakut i vetëm/ortakët, aksionarët dhe tek administratori/administratorët e personit juridik fillohet nga inspektori përgjegjës për çështjen, miratohet nga drejtuesi i strukturës së taksave dhe tarifave vendore dhe aprovohet nga titullari i NJVV-së ose nga vetë drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore, kur kjo e fundit është e organizuar si njësi shpenzuese më vete.

Në çdo rast kur administrata tatimore vendore transferon detyrimin tatimor të papaguar prej personit juridik, ajo njofton personat përkatës për aktin e transferimit të këtij detyrimi.

Përgjegjësia individuale do të jetë proporcionalisht e drejtë, me pjesën që ortakut apo aksionari zotëron në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Në çdo rast administrata tatimore, nuk bën ndarjen e detyrimit të personat me cilësinë e ortakut, aksionarit apo administratorit, por vetëm njofton këta për transferimin e detyrimit dhe janë këta të fundit të detyruar bashkërisht për përmbushjen e tij.

Administrata tatimore nuk i ndan këta persona nga njëri-tjetri, por kërkon prej tyre përmbushjen e detyrimit.

Në rast se personi juridik, i cili ka detyrime tatimore të papaguara, nuk arrin t'i paguajë këto detyrime edhe pas përfundimit të procesit të likuidimit apo falimentimit, detyrimi tatimor i papaguar, i transferohet si solidarë personave që kanë pasur cilësinë e ortakut, aksionarit apo të administratorit/administratorëve në momentin e kryerjes së procesit të likuidimit, apo falimentimit të personit debitor.

IV. MARRËVESHJA E PAGESËS ME KËSTE

1. Kur lidhet një marrëveshje me këste

Strukturat e taksave dhe tarifave vendore lejojnë taksapaguesit, që në çdo kohë dhe sa herë që është



e nevojshme, të lidhin marrëveshje të pagesës me këste të detyrimeve të taksave e tarifave vendore.

Taksapaguesi duhet të vërtetojë pamundësinë financiare, si dhe të tregojë që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes. Për të gjykuar në lidhje me pamundësinë financiare, mund të shërbejnë pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e detyrimeve, kapitalet e shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet, mungesa e kontratave të mëparshme, etj.

2. Procedurat e lidhjes së marrëveshjes me këste

2.1 Kërkesa për të paguar detyrimet tatimore nëpërmjet një marrëveshje me këste

Taksapaguesi paraqet një kërkesë me shkrim e cila i drejtohet drejtuesit të strukturës së taksave e tarifave vendore.

Në kërkesë duhet të pasqyrojë situatën financiare në të cilën ndodhet, si dhe të parashtrojë arsyet që e pengojnë për të paguar detyrimet tatimore në mënyrë të plotë e të menjëhershme.

2.2 Pranimi i kërkesës për pagimin e detyrimeve tatimore me marrëveshje me këste

Inspektori i ngarkuar me çështjen shqyrton kërkesën e taksapaguesit dhe nëse e gjykon të argumentuar ja përcjell dosjen drejtuesit të strukturës së taksave e tarifave vendore.

Drejtuesi, brenda një afati prej 10 ditë pune nga marrja e kërkesës, mund të pranojë pagesën me këste të detyrimit tatimor mbi bazën e një marrëveshjeje me shkrim, duke mbajtur në vëmendje faktorët:

i. kërkesa paraqet fakte të arsyeshme për mungesën e fondeve të mjaftueshme për të paguar menjëherë borxhin;

ii. nuk ka ndonjë mundësi që taksapaguesi të përfitojë fonde me anë të mjeteve të tjera;

iii. parashikohet që taksapaguesi të plotësojë detyrimet e tij sipas marrëveshjes për pagesën me këste dhe detyrimet tatimore të ardhshme.

Taksapaguesi detyrohet të paguajë menjëherë të paktën 20% të vlerës së detyrimit, për të cilin lidhet marrëveshja.

Masat shtrënguese ndërmerren vetëm pasi ka përfunduar afati për të cilin është pranuar pagesa me këste, ose pas datës së zgjidhjes së marrëveshjes së pagesës me këste.

2.3 Kohëzgjatja e një marrëveshjeje të pagesës me këste

Një marrëveshje për pagesë me këste nuk mund të nënshkruhet për një periudhë më të gjatë se fundi i vitit të ardhshëm kalendarik pas momentit të nënshkrimit të marrëveshjes.

Një model i kësaj marrëveshjeje është në aneksin A, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2.4 Refuzimi për të lidhur marrëveshje të pagesës me këste

Në rast se drejtuesi i strukturës së taksave e tarifave vendore gjykon se kërkesa e taksapaguesit është e paargumentuar, ai mund të refuzojë kërkesën për marrëveshje pagese me këste ose të kërkojë garanci bankare para se të hyjë në një marrëveshje të tillë.

Garancia duhet të jepet nga njëra prej bankave, e cila bëhet garant për detyrimin e taksapaguesit.

1. Operimet klasifikohen si operime UAS në kategorinë ‘e hapur’ vetëm, kur plotësohen kërkesat e mëposhtme:

a) UAS-ja i përket një prej klasave të përcaktuara në rregulloren e miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, ose është ndërtuar privatisht ose plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 20 të kësaj rregulloreje;

b) avioni pa pilot ka një masë maksimale të ngritjes prej më pak se 25 kg;



c) piloti që komandon në distancë siguron që avioni pa pilot të mbahet në një distancë të sigurt nga njerëzit dhe se nuk fluturohet mbi grumbullimet e njerëzve;

d) piloti në distancë mban avionët pa pilot në (shikim) VLOS në çdo kohë, përveç kur fluturon në programin ‘më ndiq mua’ ose kur përdor një avion vëzhgues pa pilot, siç përcaktohet në pjesën A të aneksit;

e) gjatë fluturimit avioni pa pilot mbahet brenda 120 metrave nga pika më e afërt e sipërfaqes së tokës, përveç kur fluturon mbi një pengesë, siç përcaktohet në pjesën A të aneksit;

f) gjatë fluturimit, avioni pa pilot nuk mbart mallra të rrezikshme dhe nuk lëshon asnjë material.

2. Operimet UAS në kategorinë ‘e hapur’ do të ndahen në tre nënkategori, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesën A të aneksit.

Neni 5

Kategoria ‘Specifike’ e operimeve UAS

1. Kur një nga kërkesat e përcaktuara në nenin 4 ose në pjesën A të aneksit nuk është përmbushur, një operatori UAS-je do t’i kërkohej të marrë një autorizim operacional, në pajtim me nenin 12 të kësaj rregulloreje, nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (AAC), kur Shqipëria është shteti ku ai është regjistruar.

2. Kur aplikohet pranë AAC-së për një autorizim operacional, në përputhje me nenin 12, operatori kryen një vlerësim të riskut, në përputhje me nenin 11 dhe e paraqet atë së bashku me aplikimin, përfshirë masat zbutëse përkatëse.

3. Në përputhje me pikën UAS.SPEC.040, të parashtruar në pjesën B të aneksit, AAC-ja lëshon një autorizim operacional, nëse konsideron se rreziqet operationale janë zbutur në mënyrën e duhur në përputhje me nenin 12.

4. AAC-ja do të specifikojë nëse autorizimi operacional ka të bëjë me:

a) miratimin e një operimi të vetëm ose një numër operimesh të specifikuara në kohë ose vendndodhje(et) ose të dyja. Autorizimi operacional përfshin listën e plotë të masave zbutëse;

b) miratimin e një LUC-je, në përputhje me pjesën C të aneksit.

5. Kur operatori UAS dorëzon një deklaratë tek AAC-ja, si autoriteti kompetent i shtetit të

regjistrimit, në përputhje me pikën UAS.SPEC.020, të parashikuar në pjesën B të aneksit, për një operim që përputhet me një skenar standard, siç përcaktohet në shtojcën 1 të atij aneksi, operatorit UAS nuk do t’i kërkohej të ketë një autorizim operacional në përputhje me paragrafët 1 deri 4 të këtij neni dhe të procedurës së përshkruar në pikën 5, të nenit 12. Operatori do të përdorë deklarin e referuar në shtojcën 2 të aneksit.

6. Një autorizim operacional ose një deklaratë nuk kërkohej për:

a) operatorët UAS që kanë një LUC me privilegjet e duhura, në përputhje me pikën UAS.LUC.060 të aneksit;

b) operimet e kryera në kuadër të klubeve të avionëve model dhe shoqatave, që kanë marrë një autorizim në përputhje me nenin 16.

Neni 6

Kategoria ‘E certifikuar’ e operimeve UAS

1. Operimet klasifikohen si operime UAS në kategorinë ‘e certifikuar’ vetëm kur plotësohen kërkesat e mëposhtme:

a) UAS-ja është certifikuar në përputhje me shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 19, të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot”; dhe

b) operimi kryhet në cilindo nga kushtet e mëposhtme:

i. mbi grumbullimet e njerëzve;

ii. përfshin transportin e njerëzve;

iii. përfshin transportimin e mallrave të rrezikshme, që mund të rezultojnë në risk të lartë për palët e treta, në rast aksidentesh.

2. Për më tepër, operimet UAS do të klasifikohen si operime UAS në kategorinë ‘e certifikuar’, ku AAC-ja, bazuar në vlerësimin e riskut të parashikuar në nenin 11, konsideron që rreziku i operimit nuk mund të zbutet në mënyrë të duhur pa certifikimin e UAS-së dhe të operatorit UAS, si dhe kur është e aplikueshme, pa licencimin e pilotit që komandon në distancë.



Neni 7

Rregullat dhe procedurat për operimin e UAS-së

1. Operimet UAS në kategorinë ‘e hapur’ duhet të jenë në përputhje me kufizimet operacionale të përcaktuara në pjesën A të aneksit.

2. Operimet UAS në kategorinë ‘specifike’ duhet të jenë në përputhje me kufizimet operacionale të përcaktuara në autorizimin operacional, siç përmendet në nenin 12 ose autorizimin siç përmendet në nenin 16, ose në një skenar standard të përcaktuar në shtojcën 1 të aneksit siç deklarohet nga operatori UAS.

Ky paragraf nuk do të zbatohet kur operatori UAS ka një LUC me privilegjet e duhura.

Operimet UAS në kategorinë ‘specifike’ do t’i nënshtrohen kërkesave të zbatueshme të operimit, të përcaktuara në urdhrin në fuqi të ministrit përgjegjës për transportin ajror, që përaftron rregulloren (BE) 923/2012, “Mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat e operimeve në lidhje me shërbimet dhe procedurat e lundrimit ajror”.

3. Operimet UAS në kategorinë ‘e certifikuar’ do t’i nënshtrohen kërkesave të zbatueshme të operimit, të parashtruara në urdhrat në fuqi të ministrit përgjegjës për transportin ajror, që përafrojnë: rregulloren (BE) 923/2012, “Mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat e operimeve në lidhje me shërbimet dhe procedurat e lundrimit”, rregulloren (BE) nr. 965/2012, “Mbi përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”, dhe rregulloren (BE) nr. 1332/2011, “Për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta të përdorimit të hapësirës ajrore dhe funksionimin e procedurave për shmangien e përplasjes në ajër”.

Neni 8

Rregullat dhe procedurat për kompetencën e pilotëve të komandimit në distancë

1. Pilotët e komandimit në distancë që operojnë UAS-të në kategorinë ‘e hapur’ do të jenë në përputhje me kërkesat e kompetencës të përcaktuara në pjesën A të aneksit.

2. Pilotët e komandimit në distancë që operojnë UAS-të në kategorinë ‘specifike’ duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kompetencës të

përcaktuara në autorizimin operacional të dhënë nga AAC-ja ose në skenarin standard të përcaktuar në shtojcën 1 të aneksit ose siç përcaktohet nga LUC-ja dhe do të ketë të paktën kompetencat e mëposhtme:

a) aftësinë për të aplikuar procedurat operacionale (procedurat normale, të parashikuara dhe emergjente, planifikimin e fluturimit, inspektimet para fluturimit dhe pas fluturimit);

b) aftësinë për të menaxhuar komunikimin aeronautik;

c) të menaxhojë rrugën dhe fluturimin e avionit pa pilot dhe automatizimin;

d) udhëheqjen, punën në grup dhe vetëmenaxhimin;

e) zgjidhjen e problemeve dhe vendimarrjen;

f) ndërgjegjësimin për situatën;

g) menaxhimin e ngarkesës së punës;

h) koordinimin ose dorëzimin (e detyrës), sipas rastit.

3. Pilotët që komandojnë në distancë, që veprojnë në kuadrin e klubeve të avionëve model ose shoqatave, duhet të respektojnë minimumin e kërkesave të kompetencës të përcaktuara në autorizimin e dhënë në përputhje me nenin 16.

Neni 9

Mosha minimale për pilotët që komandojnë në distancë

1. Mosha minimale për pilotët që komandojnë në distancë dhe operojnë një UAS në kategorinë ‘e hapur’ dhe ‘specifike’ është 16 vjeç.

2. Nuk kërkohet asnjë moshë minimale për pilotët që komandojnë në distancë:

a) kur ata operojnë në nënkategorinë A1, siç përcaktohet në pjesën A, të aneksit të kësaj rregulloreje, me një klasë UAS C0 të përcaktuara në pjesën 1, të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, dhe që është një lodër në kuptimin e VKM-së nr. 262, datë 3.4.2013, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për sigurinë e lodrave’”;

b) për UAS-në e ndërtuar privatisht me një masë maksimale të ngritjes prej më pak se 250g;

c) kur ata veprojnë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të një piloti të komandimit në distancë që përputhet me pikën 1 dhe nenin 8.

3. AAC-ja mund të ulë moshën minimale sipas një qasjeje të bazuar në risk, duke marrë parasysh risqe specifike të lidhura me operimet në territorin e Republikës së Shqipërisë:

a) për pilotët që komandojnë në distancë që veprojnë në kategorinë ‘e hapur’ deri në 4 vjet;

b) për pilotët që komandojnë në distancë që veprojnë në kategorinë ‘specifike’ deri në 2 vjet.

4. Kur AAC-ja ul moshën minimale për pilotët që komandojnë në distancë, ata pilotë që komandojnë në distancë do të lejohen të operojnë një UAS vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. AAC-ja mund të përcaktojë një moshë të ndryshme minimale për pilotët që komandojnë në distancë që veprojnë në kuadrin e klubeve të avionëve model ose shoqatave në autorizimin e lëshuar në përputhje me nenin 16.

Neni 10

Rregullat dhe procedurat për vlefshmërinë ajrore të UAS-ve

Përveçse kur UAS-ja është ndërtuar privatisht, ose përdoret për operimet e përmendura në nenin 16, ose plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 20, UAS-ja e përdorur në operimet e përcaktuara në këtë rregullore duhet të përputhet me kërkesat dhe rregullat teknike dhe procedurat për vlefshmërinë ajrore, të përcaktuara në aktet e deleguara të miratuara në bazë të nenit 58, të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020.

Neni 11

Rregullat për kryerjen e një vlerësimi të riskut operacional

1. Një vlerësim i riskut operacional duhet të:

a) përshkruajë karakteristikat e operimit të UAS-së;

b) propozojë objektiva të përshtatshme të sigurisë teknike operacionale;

c) identifikojë risqet e operimit në tokë dhe në ajër, duke marrë parasysh të gjitha sa më poshtë:

i. shkallën në të cilën palët e treta ose prona në tokë mund të rrezikohen nga aktiviteti;

ii. kompleksitetin, performancën dhe karakteristikat operacionale ku marrin pjesë avionët pa pilot;

iii. qëllimin e fluturimit, llojin e UAS-së, mundësinë e përplasjes me avionët e tjerë dhe klasën e hapësirës ajrore të përdorur;

iv. llojin, shkallën dhe kompleksitetin e operimit dhe aktivitetit të UAS-së, duke përfshirë, kur është e rëndësishme, madhësinë dhe llojin e trafikut, trajtuar nga organizata ose personi përgjegjës;

v. shkallën të cilën personat e prekur nga risqet e pjesëmarrjes në operimin e UAS-së janë në gjendje të vlerësojnë dhe të ushtrojnë kontroll mbi ato risqe;

d) identifikojë një sërë masash të mundshme për zbutjen e riskut;

e) përcaktojë nivelin e nevojshëm të qëndrueshmërisë (cilësisë së lartë) së masave të zgjedhura zbutëse në atë mënyrë që operimi të mundet të zhvillohet në mënyrë të sigurt.

2. Përshkrimi i operimit të UAS-së përfshin të paktën sa vijon:

a) natyrën e aktiviteteve të kryera;

b) mjedisin operacional dhe zonën gjeografike për operimin e synuar, veçanërisht popullsinë e mbingarkuar, relievin, llojet e hapësirës ajrore, vëllimin e hapësirës ajrore ku do të zhvillohet operimi dhe cili vëllim i hapësirës ajrore mbahet si zonë neutrale ndarëse e nevojshme për minimizimin e riskut, përfshirë kërkesat operacionale për zonat gjeografike;

c) kompleksitetin e operimit, veçanërisht cilat mjete teknike të kërkuara për planifikimin dhe ekzekutimin, kompetencat, përvojën dhe përbërjen e personelit janë planifikuar për të kryer operimin;

d) karakteristikat teknike të UAS-së, përfshirë performancën e tij, duke marrë parasysh kushtet e operimit të planifikuar dhe, sipas rastit, numrin e regjistrimit të tij;

e) kompetencën e personelit për kryerjen e operimit, përfshirë përbërjen, rolin, përgjegjësitë e tyre, trajnimin dhe përvojën e fundit.

3. Vlerësimi duhet të propozojë një nivel të synuar të sigurisë në operim, i cili duhet të jetë i barabartë me nivelin e sigurisë në operim si në aviacionin me pilotë, në këndvështrimin e karakteristikave specifike të operimit të UAS-ve.

4. Identifikimi i risqeve përfshin përcaktimin e të gjithave më poshtë:

a) riskun në tokë të operimit të pamitiguar, duke marrë parasysh llojin e operimit dhe kushtet nën të cilën zhvillohet operimi, duke përfshirë të paktën kriteret e mëposhtme:



- i. VLOS-in ose BVLOS-in;
- ii. dendësinë e popullsisë së zonave të mbingarkuara;
- iii. fluturimin mbi një grumbullim njerëzish;
- iv. karakteristikat e dimensionit të avionit pa pilot;
- b) riskun ajror të operimit të pamitiguar, duke marrë parasysh të gjitha sa më poshtë:
 - i. vëllimin e saktë të hapësirës ajrore ku do të zhvillohet operimi, i shtuar me një vëllim të hapësirës ajrore të nevojshme për procedurat e paparashikuara;
 - ii. klasën e hapësirës ajrore;
 - iii. ndikimin në pjesën tjetër të trafikut ajror dhe menaxhimin e trafikut ajror (MTA/ATM) dhe në veçanti:
 - lartësinë (*altitude*) e operimit;
 - hapësirën ajrore të kontrolluar kundrejt hapësirës ajrore të pakontrolluar;
 - mjedisin e aerodromit kundrejt mjedisit joaerodrom;
 - hapësirën ajrore mbi mjedisin e zonave urbane kundrejt atyre rurale;
 - ndarjen nga trafiku tjetër.
- 5. Identifikimi i masave të mundshme zbutëse, të nevojshme për të arritur nivelin e synuar të sigurisë në operim të propozuar, duhet të konsiderojë mundësitë e mëposhtme:
 - a) masën e kontrollit për njerëzit në terren;
 - b) kufizimet strategjike operacionale për operimin e UAS-së, në veçanti:
 - i. kufizimin e vëllimeve gjeografike ku zhvillohet operimi;
 - ii. kufizimin e kohëzgjatjes ose periudhës kohore të programuar në të cilin zhvillohet operimi;
 - c) mitigimin strategjik nëpërmjet rregullave të përbashkëta të fluturimit ose strukturave të përbashkëta të hapësirës ajrore dhe shërbimeve të përbashkëta;
 - d) aftësinë për të përballuar kushtet e mundshme të pafavorshme të operimit;
 - e) faktorët e organizimit, siç janë procedurat operuese dhe të mirëmbajtjes të përpunuara nga operatori i UAS-së, dhe procedurat e mirëmbajtjes në përputhje me përdorimin e manualit të prodhuesit;
 - f) nivelin e kompetencës dhe ekspertizës së personelit të përfshirë në sigurinë në operim të fluturimit;

g) riskun e gabimit njerëzor në zbatimin e procedurave operacionale;

h) tiparet e projektimit dhe në veçanti performancën e UAS-së:

i. disponueshmërinë e mjeteve për të minimizuar risqet e përplasjes;

ii. disponueshmërinë e sistemeve që kufizojnë energjinë ose thyerjen lehtësisht të avionit pa pilot në momentin e përplasjes;

iii. projektimin e UASv me standardet e njohura dhe projektin për dështimet në mënyrë të sigurt teknikisht.

6. Qëndrueshmëria e masave zbutëse të propozuara duhet të vlerësohen për të përcaktuar nëse ato janë në përpjesëtim me objektivat e sigurisë teknike dhe risqet e operimit të synuar, veçanërisht për të siguruar që çdo fazë e operimit është teknikisht e sigurt.

Neni 12

Autorizimi i operimeve në kategorinë 'specifike'

1. AAC-ja duhet të vlerësojë vlerësimin e riskut dhe qëndrueshmërinë e masave zbutëse që operatori UAS propozon për të mbajtur të sigurt operimin e UASv në të gjitha fazat e fluturimit.

2. AAC-ja jep një autorizim operacional kur vlerësimi nxjerr në përfundim se:

a) objektivat e sigurisë në operim (*safety*) marrin parasysh risqet e operimit;

b) kombinimi i masave zbutëse, të lidhura me kushtet operacionale për kryerjen e operimeve, kompetenca e personelit të përfshirë dhe tiparet teknike të avionëve pa pilot përputhen dhe janë plotësisht në gjendje për të mbajtur operimin teknikisht të sigurt në funksion të rreziqeve të identifikuara në tokë dhe në ajër;

c) operatori UAS jep një deklaratë që konfirmon që operimi i synuar përputhet me çdo rregull të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht, në lidhje me privatësinë, mbrojtjen e të dhënave, përgjegjësinë, siguracionin, sigurinë, dhe mbrojtjen e mjedisit.

3. Kur operimi nuk duket mjaftueshëm i sigurt, AAC-ja duhet të informojë përkatësisht aplikantin, duke dhënë arsye për refuzimin për të lëshuar autorizimin e operimit.

4. Autorizimi operacional i dhënë nga AAC-ja duhet të detajojë:



- a) qëllimin e autorizimit;
- b) kushtet ‘specifike’ që duhet të zbatohen:
 - i. në operimin e UAS-së dhe kufizimet operacionale;
 - ii. në kompetencën e kërkuar të operatorit UAS dhe, kur është e zbatueshme, të pilotëve që komandojnë në distancë;
 - iii. për karakteristikat teknike të UAS-së, përfshirë certifikimin e UAS-së, nëse është e zbatueshme;
- c) informacionin e mëposhtëm:
 - i. numrin e regjistrimit të operatorit UAS dhe karakteristikat teknike të UAS-së;
 - ii. një referencë për vlerësimin e riskut operacional të zhvilluar nga operatori UAS;
 - iii. kufizimet operacionale dhe kushtet e operimit;
 - iv. masat mitiguese që ka zbatuar operatori UAS;
 - v. vendndodhjen(et) ku operimi është i autorizuar të zhvillohet dhe çdo vend tjetër në një shtet tjetër, në përputhje me nenin 13, kur është e zbatueshme;
 - vi. të gjitha dokumentet dhe regjistrimet përkatëse për llojin e operimit dhe llojin e ngjarjeve që duhet të raportohen, si shtesë e atyre të përcaktuara në urdhrin e ministrit përgjegjës për transportin ajror nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”.

5. Me marrjen e deklaratës së përmendur në pikën 5, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, AAC-ja:

- a) verifikon që ai përmban të gjitha elementet e përcaktuara në paragrafin 2, të pikës UAS.SPEC.020 të aneksit;
- b) nëse është në këtë rast, i siguron operatorit UAS një konfirmim të marrjes dijeni dhe plotësueshmërisë, pa asnjë vonesë të panevojshme, në mënyrë që operatori të fillojë operimin.

Neni 13

Operimet ndërkufitare ose operimet jashtë shtetit të regjistrimit

1. Kur një operator UAS synon të kryejë një operim në kategorinë ‘specifike’ për të cilin një autorizim operacional është dhënë në përputhje me nenin 12 të kësaj rregulloreje, dhe i cili ka për qëllim të bëhet pjesërisht ose tërësisht në hapësirën

ajrore të një shteti anëtar të ZPEA-së, përveçse në shtetin e regjistrimit, kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, operatori UAS do t’i sigurojë autoritetit kompetent të shtetit anëtar të ZPEA-së të operimit të synuar, një aplikim duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

a) një kopje të autorizimit të operimit të dhënë operatorit UAS në përputhje me nenin 12; dhe

b) vendndodhjen(et) e operimit të synuar, përfshirë masat zbutëse të përditësuara, nëse është e nevojshme, për të adresuar risqet e identifikuar sipas nenit 11(2)(b) të cilat janë specifike për hapësirën ajrore lokale, terrenin dhe karakteristikat e popullimit dhe kushtet klimaterike.

1.1 Pas marrjes së aplikimit të paraqitur në pikën 1, autoriteti kompetent i shtetit anëtar të ZPEA-së, ku do të kryhet operimi i synuar, për sa kohë Shqipëria nuk është shtet anëtar, do të vendosë nëse do ta vlerësojë atë. Nëse një kërkesë e tillë do të konsiderohet, AAC-ja, si autoriteti kompetent i shtetit të regjistrimit dhe operatori UAS, do të duhet të pajisen me një konfirmim se masat zbutëse të përditësuara, referuar në shkronjën “b”, të pikës 1, janë të kënaqshme për operim në vendin e synuar. Pas marrjes së këtij konfirmimi, operatori UAS mund të fillojë operimin e synuar dhe AAC-ja, si autoriteti i shtetit të regjistrimit, do të regjistrojë masat zbutëse të përditësuara, që operatori UAS duhet të aplikojë në autorizimin operacional të lëshuar në përputhje me nenin 12 të kësaj rregulloreje.

2. Kur një operator UAS synon të kryejë një operim në kategorinë ‘specifike’ për të cilin një autorizim operacional është dhënë nga një shtet anëtar i ZPEA-së, si shtet i regjistrimit, dhe i cili ka për qëllim të bëhet pjesërisht ose tërësisht në hapësirën ajrore të Shqipërisë, përveçse në shtetin e regjistrimit, operatori UAS do t’i sigurojë AAC-së, si autoriteti kompetent i shtetit të operimit të synuar, një aplikim duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

a) një kopje të autorizimit të operimit të dhënë operatorit UAS, në përputhje me ligjin e zbatueshëm në shtetin e ZPEA-së; dhe

b) vendndodhjen(et) e operimit të synuar, përfshirë masat zbutëse të përditësuara, nëse është e nevojshme, për të adresuar risqet e identifikuar sipas nenit 11(2)(b), të cilat janë specifike për



hapësirën ajrore lokale, terrenin dhe karakteristikat e popullimit dhe kushtet klimaterike.

2.1 Pas marrjes së aplikimit të paraqitur në pikën 1, AAC-ja do të vendosë nëse do ta pranojë atë. Gjatë vlerësimit, AAC-ja do të sigurohet se standardet e përdorura nga shteti i ZPEA-së janë në të njëjtin nivel ose më lart krahasuar me këtë rregullore. Me vlerësimin e një kërkesë të tillë, autoriteti kompetent i shtetit anëtar të ZPEA-së, si autoriteti kompetent i shtetit të regjistrimit, dhe operatori UAS do të duhet të pajisen me një konfirmim se masat zbutëse të përditësuara referuar në shkronjën “b”, të pikës 1, janë të kënaqshme për operim në vendin e synuar. Pas marrjes së këtij konfirmimi, operatori UAS mund të fillojë operimin e synuar.

3. Kur një operator UAS synon të kryejë një operim në kategorinë ‘specifike’ për të cilën është bërë një deklaratë në përputhje me pikën 5, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, dhe i cili ka për qëllim të bëhet pjesërisht ose tërësisht në hapësirën ajrore të një shteti anëtar të ZPEA-së, kur është e zbatueshme sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, përveçse në Shqipëri si shtet i regjistrimit, operatori UAS duhet t’i japi autoritetit kompetent të shtetit anëtar të ZPEA-së të operimit të synuar një kopje të deklaratës së dorëzuar në shtetin e regjistrimit, si dhe një kopje të konfirmimit të marrjes dhe të plotësueshmërisë. Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të ZPEA-së, ku do të kryhet operimi i synuar, për sa kohë Shqipëria nuk është shtet anëtar, do të vendosë nëse do ta pranojë atë.

4. Kur një operator UAS synon të kryejë një operim në kategorinë ‘specifike’ për të cilën është bërë një deklaratë në autoritetin kompetent të një shteti anëtar të ZPEA-së të regjistrimit, dhe i cili ka për qëllim të bëhet pjesërisht ose tërësisht në hapësirën ajrore të Shqipërisë, përveçse në një shtet anëtar të ZPEA-së, si shtet i regjistrimit, operatori UAS duhet t’i japë AAC-së, si autoriteti kompetent i shtetit të operimit të synuar, një kopje të deklaratës së dorëzuar në shtetin e regjistrimit, si dhe një kopje të konfirmimit të marrjes dhe të plotësueshmërisë. AAC-ja, si autoriteti kompetent i shtetit ku do të kryhet operimi i synuar, do të vlerësojë nëse do ta pranojë atë. Gjatë vlerësimit, AAC-ja do të sigurohet se standardet e përdorura nga shteti i ZPEA-së janë në të njëjtin nivel ose më lart krahasuar me këtë rregullore.

5. Kur një operator UAS që mban një LUC me privilegje, në përputhje me pikën UAS.LUC.060 të aneksit, synon të kryejë një operim në ‘kategorinë specifike’, që kryhet pjesërisht ose tërësisht në hapësirën ajrore të një shteti anëtar të ZPEA-së, të ndryshëm nga Shqipëria, si shteti i regjistrimit, operatori UAS do t’i sigurojë autoritetit kompetent të shtetit anëtar të operimit të synuar informacionin e mëposhtëm:

a) një kopje të afatit të miratimit të marrë në përputhje me pikën UAS.LUC.050 të aneksit; dhe

b) vendndodhjen(et) e operacionit të synuar në përputhje me paragrafin 1 “b” të këtij neni.

Autoriteti kompetent i shtetit anëtar të ZPEA-së, ku do të kryhet operimi i synuar, për sa kohë Shqipëria nuk është shtet anëtar, do të vendosë nëse do ta pranojë atë.

6. Kur një operator UAS që mban një LUC me privilegje, të lëshuar nga autoriteti kompetent i një shteti anëtar të ZPEA-së, synon të kryejë një operim në ‘kategorinë specifike’ që kryhet pjesërisht ose tërësisht në hapësirën ajrore të Shqipërisë, përveçse në shtetin e regjistrimit, anëtar të ZPEA-së, operatori UAS do t’i sigurojë AAC-së, si autoriteti kompetent i shtetit anëtar të operimit të synuar, informacionin e mëposhtëm:

a) një kopje të afatit të miratimit të marrë; dhe

b) vendndodhjen(et) e operimit të synuar në përputhje me paragrafin 1 “b” të këtij neni.

AAC-ja, si autoriteti kompetent i shtetit ku do të kryhet operimi i synuar, do të vlerësojë dhe do të vendosë nëse do ta pranojë atë. Gjatë vlerësimit, AAC-ja do të sigurohet se standardet e përdorura nga shteti i ZPEA-së janë në të njëjtin nivel ose më lart krahasuar me këtë rregullore.

Neni 14

Regjistrimi i operatorëve UAS dhe UAS-ja e certifikuar

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të mbajë sisteme të sakta regjistrimi për UAS-të, modeli i të cilave është subjekt i certifikimit dhe për operatorët UAS, funksionimi i të cilëve mund të paraqesë një risk për sigurinë në operim, sigurinë, privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale ose mjedisit.

2. Sistemet e regjistrimit për operatorët UAS duhet të japin fushat për prezantimin dhe shkëmbimin e informacionit vijues:



a) emrin e plotë dhe datën e lindjes për personat fizikë, dhe emrin dhe numrin e tyre të identifikimit për personat juridikë;

b) adresën e operatorëve UAS;

c) adresën e tyre të postës elektronike dhe numrin e telefonit;

d) një numër të policës së siguracionit për UAS-në, nëse kërkohet nga legjislacioni në fuqi;

e) konfirmimin nga personat juridikë të deklaratës vijuese: “I gjithë personeli i përfshirë drejtpërdrejt në operime janë kompetent për të kryer detyrat e tyre, dhe UAS-ja do të operohet vetëm nga pilotët që komandojnë në distancë me nivelin e duhur të kompetencës”;

f) autorizimet operacionale dhe LUC-të e mbajtura, dhe deklaratat e ndjekura nga një konfirmim në përputhje me nenin 12(5)(b).

3. Sistemet e regjistrimit për avionët pa pilot, projektimi i të cilëve i nënshtrohen certifikimit duhet të sigurojnë fushat për prezantimin dhe shkëmbimin e informacionit të mëposhtëm:

a) emrin e prodhuesit;

b) përcaktimin e prodhuesit të avionit pa pilot;

c) numrin serial të avionit pa pilot;

d) emrin e plotë, adresën, adresën e *email*-it dhe numrin e telefonit të personit fizik ose juridik nën emrin e të cilit është regjistruar avioni pa pilot.

4. AAC-ja do të sigurojë që sistemet e regjistrimit të jenë digjitale dhe ndërvepruese, dhe në konsideratë të parashikimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, të lejojnë një marrëdhënie të ndërsjellë dhe shkëmbim të informacionit përmes bazës së të dhënave të përmendura në nenin 74, të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”.

5. Operatorët e UAS-së duhet të regjistrohen vetë:

a) kur veprojnë brenda kategorisë ‘e hapur’, çfarëdo avioni të mëposhtëm pa pilot:

i. me një MTOM prej 250 g ose më shumë, ose, i cili në rastin e një përplasjeje, mund të transferojë te njeriu një energji kinetike më shumë se 80 J (xhaul);

ii. që është i pajisur me një sensor të aftë për të kapur të dhëna personale, përveçse nëse përputhet me VKM-në nr. 262, datë 3.4.2013, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për sigurinë e lodrave’”;

b) kur vepron brenda kategorisë ‘specifike’, një avion pa pilot të çdo mase.

6. Operatorët e UAS-së duhet të regjistrojnë vetveten në AAC, kur RSH-ja është vendbanimi i tyre për persona fizikë ose kur RSH-ja është vendi i tyre kryesor i biznesit për personat juridikë dhe të sigurojnë që informacioni i tyre për regjistrimin të jetë i saktë. Një operator UAS-je nuk mund të regjistrohet në më shumë se një shtet njëkohësisht.

Në rastin e regjistrimit në Shqipëri, AAC-ja do të lëshojë një numër unik regjistrimi digjital për operatorët UAS dhe për UAS-të që kërkojnë regjistrim, duke lejuar identifikimin e tyre individual.

Numri i regjistrimit për operatorët UAS duhet të vendoset në bazë të standardeve që mbështesin ndërveprimin e sistemeve të regjistrimit.

7. Pronari i një avioni pa pilot, projektimi i të cilit është subjekt i certifikimit duhet të regjistrojë avionin pa pilot. Marka e shtetësisë dhe regjistrimit të një avioni pa pilot duhet të vendosen në përputhje me rregulloren në fuqi, që adapton aneksin 7 të ICAO-s. Një avion pa pilot nuk mund të regjistrohet njëkohësisht në më shumë se një shtet.

8. Operatorët e UAS-së duhet ta shfaqin numrin e tyre të regjistrimit në çdo avion pa pilot që plotëson kushtet e përshkruara në paragrafin 5.

9. Përveç të dhënave të përcaktuara në pikën 2, AAC-ja mund të mbledhë informacion shtesë identiteti nga operatorët UAS.

Neni 15

Kushtet operuese të UAS-së sipas zonave gjeografike

1. Kur përcaktohen zonat gjeografike të UAS-së, për arsye të sigurisë në operim, sigurisë, privatësisë ose arsye mjedisore, AAC-ja mund:

a) të ndalojë disa ose të gjitha operimet e UAS-së, të kërkojë kushte të veçanta për disa ose të gjitha operimet e UAS-së ose të kërkojë një autorizim paraprak fluturimi për disa ose të gjitha operimet e UAS-së;

b) t'i vendosë operimet e UAS-së nën standarde të specifikuar mjedisore;

c) t'i lejojë hyrjen vetëm disa klasave të caktuara UAS;

d) t'i lejojë hyrjen vetëm UAS-ve të pajisura me karakteristika të caktuara teknike, në veçanti sisteme të identifikimit në distancë ose sisteme gjeo-ndërgjegjësimi (sipas zonave gjeografike).



2. Në bazë të një vlerësimi të riskut, AAC-ja mund të marrë masa me qëllim përcaktimin e zonave të caktuara gjeografike në të cilat operimet UAS përjashtohen nga një ose më shumë kërkesa të kategorisë “e hapur”.

3. Kur në pajtim me paragrafët 1 ose 2, përcaktohen zonat gjeografike të UAS-së, për qëllime të ndërgjegjësimit gjeografik, AAC-ja duhet të sigurojë që informacioni mbi zonat gjeografike të UAS-së, përfshirë periudhën e vlefshmërisë së tyre, të bëhet i disponueshëm publikisht në një format digjital unik të përbashkët.

Neni 16

Operimet UAS në kuadër të klubeve dhe shoqatave të avionëve model

1. Me kërkesë të një klubi ose shoqate të avionëve model, AAC-ja mund të lëshojë një autorizim për operimet UAS në kuadër të klubeve dhe shoqatave të avionëve model.

2. Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 lëshohet në përputhje me çdonjë nga sa vijon:

a) rregullat përkatëse kombëtare;

b) procedurat e vendosura, strukturën organizative dhe sistemin e menaxhimit të klubit ose shoqatës së avionëve model, duke siguruar që:

i. pilotët që komandojnë në distancë, të cilët veprojnë në kuadër të klubeve ose shoqatave të avionëve model, janë të informuar për kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në autorizimin e lëshuar nga AAC-ja;

ii. pilotët në distancë që veprojnë në kuadrin e klubeve ose shoqatave të avionëve model ndihmohen në arritjen e kompetencës minimale të nevojshme për të operuar UAS-në në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në autorizim;

iii. klubi ose shoqata e avionëve model ndërmerr veprime të përshtatshme kur informohet se një pilot në distancë, që vepron në kuadër të klubeve ose shoqatave të avionëve model, nuk i respekton kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në autorizim dhe nëse është e nevojshme, informon AAC-në;

iv. klubi ose shoqata e avionëve model siguron me kërkesë të AAC-së dokumentacionin e kërkuar për qëllime të mbikëqyrjes dhe monitorimit.

3. Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 do të specifikojë kushtet në të cilat mund të kryhen operimet, në kuadrin e klubeve të avionëve model

dhe shoqatave, dhe do të kufizohen në territorin e RSH-së, si vendi ku autorizimi është lëshuar.

4. AAC-ja mund të lejojë që klubet e avionëve model dhe shoqatat të regjistrojnë në emër të tyre anëtarët e tyre, në sistemin e regjistrimit të vendosur në përputhje me nenin 14. Nëse nuk është ky rast, anëtarët e klubeve të avionëve model dhe shoqatave do të regjistrohen në përputhje me nenin 14.

Neni 17

Përcaktimi i autoritetit kompetent

1. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar do të jetë autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë për përmbushjen e detyrave të përmendura në nenin 18 të kësaj rregulloreje.

2. Kur përcaktohet më shumë se një entitet si autoritet kompetent:

a) duhet të përcaktohen qartë fushat e kompetencave të secilit autoritet kompetent për sa i përket përgjegjësisë;

b) duhet të krijohet një mekanizëm i duhur koordinimi midis këtyre subjekteve për të siguruar një mbikëqyrje efektive të të gjitha organizatave dhe personave që i nënshtrohen kësaj rregulloreje.

Neni 18

Detyrat e autoritetit kompetent

Autoriteti i Aviacionit Civil është përgjegjës për:

a) zbatimin e kësaj rregulloreje;

b) lëshimin, pezullimin ose revokimin e certifikatave të operatorëve UAS dhe licencat e pilotëve që komandojnë në distancë, të cilët veprojnë në kategorinë e ‘certifikuar’ të operimeve UAS;

c) pajisjen e pilotëve që komandojnë në distancë, me një vërtetim të përfundimit të një provimi *online* të njohurive teorike, sipas pikave UAS.OPEN.020 dhe UAS.OPEN.040 të aneksit, dhe lëshimin, ndryshimin, pezullimin, kufizimin ose revokimin e certifikatave të kompetencës së pilotëve që komandojnë në distancë, sipas pikës UAS.OPEN.030 të aneksit;

d) lëshimin, ndryshimin, pezullimin, kufizimin ose revokimin e autorizimeve operacionale dhe LUC, dhe verifikimin e plotësueshmërisë së deklaratave, të cilat kërkohen për të kryer operime UAS në kategorinë “specifike” të operimeve UAS;



e) mbajtjen e dokumenteve, regjistrimeve dhe raporteve në lidhje me autorizimet operacionale të UAS-së, deklaratat, certifikatat e kompetencës së pilotëve që komandojnë në distancë dhe LUC;

f) vënien në dispozicion në një format digjital, të përbashkët unik, të informacionit për zonat gjeografike të UAS-ve të identifikuar dhe të vendosura brenda hapësirës ajrore kombëtare;

g) lëshimin e konfirmimit të marrjes dhe plotësueshmërisë në përputhje me nenin 12(5)(b) ose një konfirmim në përputhje me paragrafin 2, të nenit 13;

h) zhvillimin e një sistemi të mbikëqyrjes të bazuar në risk për:

i. operatorët e UAS-së që kanë paraqitur një deklaratë ose kanë një autorizim operacional ose një LUC;

ii. klubet e avionëve model dhe shoqatat që kanë një autorizim të përmendur në nenin 16;

i) për operime të ndryshme nga ato të kategorisë ‘e hapur’, vendosjen e një planifikimi të auditimit bazuar në profilin e riskut, nivelin e pajtueshmërisë dhe performancën e sigurisë teknike të operatorëve UAS që kanë dorëzuar një deklaratë ose mbajnë një certifikatë të lëshuar nga AAC-ja;

j) për operime të ndryshme nga ato të kategorisë ‘e hapur’, kryerjen e inspektimeve në lidhje me operatorët UAS që kanë dorëzuar një deklaratë ose mbajnë një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent që inspekton UAS-në dhe siguron që operatorët UAS dhe pilotët që komandojnë në distancë të respektojnë këtë rregullore;

k) zbatimin e një sistemi për të zbuluar dhe ekzaminuar incidente papajtueshmërie nga ana e operatorëve UAS që veprojnë në kategoritë “e hapur” ose “specifike” dhe të raportuara në përputhje me paragrafin 2, të nenit 19;

l) pajisjen e operatorëve UAS me informacion dhe udhëzime që promovojnë sigurinë teknike të operimeve UAS;

m) krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të regjistrimit për UAS, modeli i të cilit është subjekt i certifikimit dhe për operatorët UAS, funksionimi i të cilëve mund të paraqesë një rrezik për sigurinë teknike, sigurinë, privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale ose mjedisit.

Neni 19

Informacioni mbi sigurinë në operim

1. Autoriteti i Aviacionit Civil dhe autoritetet e mbikëqyrjes dhe kontrollit të tregut, të përmendura në nenin 15 të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, do të bashkëpunojnë në çështjet e sigurisë dhe do të vendosin procedura për shkëmbimin efikas të informacionit mbi sigurinë teknike.

2. Çdo operator i UAS-së i raporton Autoritetit të Aviacionit Civil për çdo ngjarje të lidhur me sigurinë teknike dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me UAS-në e tij, në përputhje me urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, “Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë”.

3. AAC-ja mbledh, analizon dhe publikon informacionin e sigurisë në operim, në lidhje me operimet e UAS-së në RSH, në përputhje me nenin 72, të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe akteve të tij zbatuese.

4. Pas marrjes së ndonjë prej informacioneve të përmendura në paragrafët 1, 2 ose 3, AAC-ja merr masat e nevojshme për të adresuar çdo çështje sigurie teknike për provat dhe analizat më të mira në dispozicion, duke marrë parasysh ndërvarësitë midis fushave të ndryshme të sigurisë teknike në aviacion, dhe midis sigurisë teknike të aviacionit, sigurisë në internet dhe fushat e tjera teknike të rregulloreve të aviacionit.

5. Aty ku AAC-ja merr masa në përputhje me paragrafin 4, ai menjëherë duhet të njoftojë të gjitha palët dhe organizatat e interesuara përkatëse që duhet të zbatojnë ato masa në përputhje me VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, dhe aktet e saj zbatuese.

Neni 20

Dispozita të veçanta në lidhje me përdorimin e disa UAS-ve në llojet e kategorive ‘e hapur’

Llojet UAS brenda kuptimit të ligjit nr. 10489, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, të cilat nuk përputhen me rregulloren e miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe



Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot” dhe të cilat nuk janë ndërtuar privatisht, lejohen të vazhdojnë të operohen nën kushtet e mëposhtme, kur ato janë vendosur në treg para datës 1 janar 2024:

a) në nënkategorinë A1, siç përcaktohet në pjesën A të aneksit, duke siguruar që avioni pa pilot të ketë një masë maksimale të ngritjes prej më pak se 250 g, duke përfshirë ngarkesën e tij;

b) në nënkategorinë A3, siç përcaktohet në pjesën A të aneksit, jep që avioni pa pilot të ketë një masë maksimale të ngritjes prej më pak se 25 kg, përfshirë karburantin dhe ngarkesën e tij.

Neni 21

Përshtatja e autorizimeve, deklaratave dhe certifikatave

1. Autorizimet e dhëna operatorëve UAS, certifikatat e aftësisë së pilotit që komandon në distancë dhe deklaratat e bëra nga operatorët UAS ose dokumentacioni ekuivalent, i lëshuar në bazë të legjislacionit shqiptar, do të qëndrojnë në vlefshme deri më 1 shtator 2022.

2. Deri më 1 shtator 2022, AAC-ja do të marrë masa për të konvertuar certifikatat ekzistuese të aftësisë së pilotit që komandon në distancë dhe autorizimet ose deklaratat e operatorit UAS, ose dokumentacionin ekuivalent, duke përfshirë ato të lëshuara deri në atë datë, në përputhje me këtë rregullore.

3. Pa cenuar nenin 14 të kësaj rregulloreje, operimet e UAS-ve të kryera në kuadrin e klubeve të avionëve model dhe shoqatave lejohen të vazhdojnë në përputhje me rregullat përkatëse kombëtare dhe pa një autorizim, në përputhje me nenin 16, deri më 1 janar 2023.

Neni 22

Dispozitat kalimtare

Pa cenuar nenin 20 të kësaj rregulloreje, përdorimi i UAS-ve në kategorinë ‘e hapur’, që nuk përputhet me kërkesat e pjesëve 1 deri 5 të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot”, do të lejohet për një periudhë kalimtare deri më 31 dhjetor 2023, duke iu nënshtruar kushteve të mëposhtme:

a) avionë pa pilot me një masë maksimale të ngritjes prej më pak se 500 g operohen brenda kërkesave operacionale të përcaktuara në pikat UAS.OPEN.020 1, të pjesës A të aneksit, nga një pilot që komandon në distancë, i cili ka nivelin e kompetencës së përcaktuar nga autoriteti kompetent;

b) avionë pa pilot me një masë maksimale të ngritjes prej më pak se 2 kg operohen duke mbajtur një distancë minimale horizontale prej 50 metra nga njerëzit dhe pilotët që komandojnë në distancë kanë një nivel kompetence të paktën ekuivalent me atë të përcaktuar në pikën UAS. OPEN.030 2 të pjesës A të aneksit;

c) avionë pa pilot me një masë maksimale të ngritjes prej më shumë se 2 kg dhe më pak se 25 kg operohen brenda kërkesave operacionale të përcaktuara në pikën UAS.OPEN.040 1 dhe 2, dhe pilotët që komandojnë në distancë kanë një nivel kompetence të paktën ekuivalent me atë të përcaktuar në pikën UAS.OPEN.020 (4) (b), të pjesës A të aneksit.

Neni 23

Hyrja në fuqi dhe aplikimi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi me publikimin në Fletoren Zyrtare.

2. Paragrafi 5, i nenit 5 do të zbatohet nga data 1 janar 2024.

3. Pika 2 “g”, e pikës UAS.OPEN.060, të aneksit dhe pika 1/1 e pikës UAS.SPEC.050 e aneksit do të aplikohet nga data 1 janar 2024.

4. Pa paragjykuar nenin 21/1, deri në datën 31 dhjetor 2023, mund të pranohen deklarime të kryera nga operatorë UAS në përputhje me nenin 5(5) bazuar në skenarë standard kombëtar ose ekuivalentë, nëse përmbushen kërkesat e pikës UAS.SPEC.020 të aneksit.

Këto deklarime do të ndalojnë së qenuri të vlefshme duke filluar nga data 1 janar 2026.

5. Paragrafi 3, i nenit 15, do të zbatohet nga data 1 janar 2023.



ANEKS
OPERIMET UAS NË KATEGORITË
'E HAPUR' DHE 'SPECIFIKE'

PJESA A
OPERIMET UAS NË KATEGORINË
'E HAPUR'

UAS.OPEN.010 Parashikime të përgjithshme

1. Kategoria e operimeve 'të hapura' të UAS-së është e ndarë në tre nënkategori A1, A2 dhe A3, në bazë të kufizimeve operationale, kërkesave për pilotin në distancë dhe kërkesave teknike për UAS-në.

2. Kur operimi UAS përfshin fluturimin e avionëve pa pilot duke filluar nga një lartësi/ngritje natyrore në terren ose mbi terrene me lartësi natyrore, avioni pa pilot mbahet brenda 120 metrave nga pika më e afërt e sipërfaqes së tokës. Matja e distancave do të përshtatet sipas karakteristikave gjeografike të terrenit, si fushat, kodrat, malet.

3. Kur fluturohet një avion pa pilot brenda një distancë horizontale prej 50 metrash nga një pengesë artificiale më e gjatë se 105 metra, lartësia maksimale e operimit UAS mund të rritet deri në 15 metra mbi lartësinë e pengesës, me kërkesë të subjektit përgjegjës për pengesën.

4. Duke u shmangur nga pika 2, avionët lundruar pa pilotë me një MTOM, përfshirë ngarkesën, më pak se 10 kg, mund të fluturohen në një distancë më të madhe se 120 metra nga pika më e afërt e sipërfaqes së tokës, me kusht që planeri pa pilot të mos fluturohet në një lartësi më të madhe se 120 metra mbi pilotin në distancë në çdo kohë.

UAS.OPEN.020 Operimet UAS në nënkategorinë A1

Operimet UAS në nënkategorinë A1 duhet të jenë në përputhje me të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. Për avionët pa pilot të përmendur në pikën 5 "d", të zhvillohen në atë mënyrë që një pilot në distancë i avionit pa pilot nuk fluturon mbi grumbullimet e njerëzve dhe në mënyrë të arsyeshme pret që mbi asnjë person të papërfshirë të mos mbifluturohet. Në rast të një fluturimi të papritur mbi persona të papërfshirë, piloti në distancë zvogëlon sa më shumë që të jetë e mundur

kohën gjatë së cilës avioni pa pilot fluturon mbi ata persona.

2. Në rastin e një avioni pa pilot të përmendur në pikat 5 "a", 5 "b" dhe 5 "c", të kryhen në atë mënyrë që piloti në distancë i avionit pa pilot të mund të fluturojë mbi personat e papërfshirë, por kurrë nuk do të fluturojë mbi grumbullimet e njerëzve.

3. Duke u shmangur nga pika "d", e paragrafit 1, të nenit 4, të kryhen, kur mënyra "më ndiq mua" është aktive, deri në një distancë prej 50 metra nga piloti në distancë.

4. Kryhen nga një pilot në distancë:

a) i familjarizuar me manualin e përdoruesit të siguruar nga prodhuesi i UAS-së;

b) në rastin e një klase avionësh pa pilot C1, siç përcaktohet në pjesën 2, të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, "Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot", i cili ka përfunduar një kurs trajnimit *online*, i ndjekur nga përfundimi me sukses i një provimi *online* të njohurive teorike, i kryer nga AAC-ja ose nga një subjekt i njohur nga autoriteti kompetent i vendit tonë ose i shtetit anëtar të regjistrimit të operatorit UAS, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, kur është e zbatueshme dhe që ka marrë të paktën 70 % të të gjitha pikëve. Provimi do të përfshijë 40 pyetje me zgjedhje të shumëfishta, të shpërndara në mënyrë të përshtatshme në të gjitha lëndët vijuese:

- i. siguria në operim (*air safety*);
- ii. kufizimet e hapësirës ajrore;
- iii. rregullorja e aviacionit;
- iv. kufizimet e performancës njerëzore;
- v. procedurat operative;
- vi. njohuri të përgjithshme të UAS-së;
- vii. privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave;
- viii. siguracionin;
- ix. sigurinë (*security*).

5. Të kryhet me një avion pa pilot që:

a) ka një MTOM, përfshirë ngarkesën, më pak se 250 g dhe një shpejtësi maksimale operimi më pak se 19 m/s, në rastin e një UAS-je të ndërtuar privatisht; ose

b) plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën "a" të nenit 20;

c) është markuar si klasa C0 dhe përputhet me kërkesat e asaj klase, siç përcaktohet në pjesën 1, të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e



përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot”; ose

d) është markuar si klasa C1 dhe përputhet me kërkesat e asaj klase, siç përcaktohet në pjesën 2, të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot”, dhe operohet me sisteme aktive dhe të përditësuara identifikuese dhe gjeo-ndërgjegjësimi të drejtpërdrejtë në distancë.

UAS.OPEN.030 Operimet e UAS-së në nënkategorinë A2

Operimet UAS në nënkategorinë A2 duhet të jenë në përputhje me të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. Të zhvillohen në atë mënyrë që avioni pa pilot të mos fluturojë mbi personat e papërfshirë dhe operimet UAS të zhvillohen në një distancë të sigurt horizontale prej së paku 30 metra larg tyre; piloti në distancë mund të zvogëlojë distancën horizontale të sigurisë deri në minimum, prej 5 metra nga personat e pa përfshirë, kur drejton një avion pa pilot me program të shpejtësisë aktive të ulët dhe pas vlerësimit të situatës në lidhje me:

- a) kushtet e motit;
- b) performanca e avionit pa pilot;
- c) ndarja e zonës së mbikalimit të fluturimit.

2. Të kryhet nga një pilot në distancë i cili është i njohur me manualin e përdoruesit të siguruar nga prodhuesi i UAS-së dhe mban një certifikatë të aftësisë së pilotit në distancë të lëshuar nga AAC-ja ose nga një subjekt i njohur nga AAC-ja, si autoriteti kompetent i shtetit të regjistrimit të operatorit UAS, ose nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të regjistrimit të operatorit UAS, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, kur është zbatueshme. Kjo certifikatë do të merret pasi të jenë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme dhe sipas rendit të treguar:

a) kryerja e një kursi trajnimi *online* dhe kalimi i provimit *online* të njohurive teorike, siç përmendet në pikën 4 “b” të pikës UAS.OPEN.020;

b) kryerja e një vetëtrajnimi praktik në kushtet e operimit të nënkategorisë A3 të paraqitur në pikat 1 dhe 2, të pikës UAS.OPEN.040;

c) deklarimi i kryerjes së vetëtrajnimit praktik të përcaktuar në pikën “b” dhe kalimin e një provimi shtesë të njohurive teorike të kryer nga AAC-ja ose

nga një subjekt i njohur nga AAC-ja kur Shqipëria është shteti i regjistrimit ose nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të regjistrimit të operatorit UAS, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, ku ka marrë të paktën 75 % të të gjitha pikëve. Provimi do të përfshijë së paku 30 pyetje me zgjedhje të shumëfishta që synojnë vlerësimin e njohurive të pilotit në distancë për mitigimet teknike dhe operacionale për minimizimin e rrezikut në tokë, të shpërndara në mënyrë të përshtatshme në të gjitha lëndët vijuese:

- i. meteorologjia;
- ii. performanca e fluturimit UAS;
- iii. mitigimet teknike dhe operacionale për minimizimin e rrezikut në tokë.

3. Të kryhet me një avion pa pilot i cili është shënuar si klasa C2 dhe përputhet me kërkesat e asaj klase, siç përcaktohet në pjesën 3, të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot”, dhe operohet me sisteme aktive dhe të përditësuara të identifikimit direkt në distancë dhe gjeo-ndërgjegjësimi.

UAS.OPEN.040 Operimet e UAS-së në nënkategorinë A3

Operimet UAS në nënkategorinë A3 duhet të jenë në përputhje me të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. Të bëhen në një zonë ku piloti në distancë pret në mënyrë të arsyeshme që asnjë person i papërfshirë nuk do të rrezikohet brenda zonës ku fluturon avioni pa pilot gjatë gjithë kohës së operimit UAS;

2. Të bëhen në një distancë të sigurt horizontale, të paktën 150 metra nga zonat e banuara, tregtare, industriale ose zonat e pushimit;

3. Të kryhen nga një pilot në distancë i cili është familjarizuar me instruksionet e mundësuar nga prodhuesi i UAS-së dhe i cili ka përfunduar një kurs trajnimi *online* dhe ka kaluar një provim *online* të njohurive teorike, siç përcaktohet në pikën 4 “b” të pikës UAS.OPEN.020;

4. Kryhen nga një avion pa pilot që:

a) ka një MTOM, përfshirë ngarkesën, më pak se 25 kg, në rastin e një UAS-je të ndërtuar privatisht; ose

b) plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën “b”, të nenit 20;



c) është markuar si klasa C2 dhe përputhet me kërkesat e asaj klase, siç përcaktohet në pjesën 3, të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot”, dhe operohet me sisteme identifikuese dhe gjeo-ndërgjegjësimi të drejtpërdrejtë në distancë, aktive dhe të përditësuara; ose

d) është markuar si klasa C3 dhe përputhet me kërkesat e asaj klase, siç përcaktohet në pjesën 4, të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot”, dhe operohet me sisteme identifikuese dhe gjeo-ndërgjegjësimi të drejtpërdrejtë në distancë, aktive dhe të përditësuara; ose

e) është markuar si klasa C4 dhe përputhet me kërkesat e asaj klase, siç përcaktohet në pjesën 5, të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot”.

UAS.OPEN.050 Përgjegjësitë e operatorit UAS

Operatori UAS do të pajtohet me të gjitha sa vijon:

1. Të zhvillojë procedura operacionale të përshtatura me llojin e operimit dhe rrezikun e përfshirë;

2. Të sigurojë që të gjitha operimet përdorin dhe mbështesin në mënyrë efektive përdorimin efikas të spektrit të radios, në mënyrë që të shmangen ndërhyrjet e dëmshme;

3. Të përcaktojë një pilot në distancë për çdo operim UAS-je;

4. Të sigurojë që pilotët në distancë dhe gjithë personeli tjetër që kryejnë një detyrë në mbështetje të operimeve, janë njohur me manualin e përdoruesit të siguruar nga prodhuesi i UAS-së, dhe:

a) kanë kompetencë të përshtatshme në nënkategorinë e operimeve të synuara UAS, në përputhje me pikat UAS.OPEN.020, UAS.OPEN.030 ose UAS.OPEN.040, për të kryer detyrat e tyre ose, për personelin tjetër, përveç pilotit në distancë, të kenë përfunduar trajnimin-nëpunë të zhvilluar nga operatori;

b) janë plotësisht të njohur me procedurat e operatorit UAS;

c) kanë marrë informacione të rëndësishme për operimin e synuar të UAS-së, lidhur me çdo zonë gjeografike të publikuar nga shteti i operimit në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje;

5. Të përditësojnë informacionin në sistemin e gjeo-ndërgjegjësimi, kur është i zbatueshëm, sipas vendndodhjes së synuar të operimit;

6. Në rastin e një operimi me një avion pa pilot të njëres prej klasave të përcaktuara në pjesët 1 deri 5, të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot”, sigurohet që UAS-ja është:

a) shoqëruar nga deklarata përkatëse EU e konformitetit, përfshirë referencën në klasën e duhur; dhe

b) etiketa përkatëse e identifikimit të klasës është ngjitur në avionin pa pilot;

7. Të sigurohet në rastin e një operimi UAS në nënkategorinë A2 ose A3, që të gjithë personat e përfshirë në fushën e operimit kanë qenë të informuar për rreziqet dhe kanë rënë dakord në mënyrë të qartë për të marrë pjesë.

UAS.OPEN.060 Përgjegjësitë e pilotit në distancë

1. Para fillimit të një operimi UAS, piloti në distancë duhet:

a) të ketë kompetencën e duhur në nënkategorinë e operimeve të synuara të UAS-së në përputhje me pikat UAS.OPEN.020, UAS.OPEN.030 ose UAS.OPEN.040, për të kryer detyrën e tij dhe të ketë një dëshmi të kompetencës gjatë operimit të UAS-së, përveç kur përdoret një avion pa pilot të përmendur në pikat 5 “a”, 5 “b” ose 5 “c” të pikës UAS.OPEN.020;

b) të marrë informacion të përditësuar, të rëndësishëm për operacionin e synuar të UAS-së, për çdo zonë gjeografike të publikuar nga shteti i operimit, në përputhje me nenin 15;

c) të vëzhgojë mjedisin e operimit, të kontrollojë praninë e pengesave dhe, përveç nëse vepron në nënkategorinë A1, me një avion pa pilot, të përmendur në pikat 5 “a”, 5 “b” ose 5 “c”, të pikës UAS.OPEN.020, të kontrollojë praninë e ndonjë personi të pa përfshirë;

d) të sigurojë që UAS-ja është në gjendje të përfundojë në mënyrë të sigurt fluturimin e synuar,



dhe nëse është i zbatueshëm, kontrollon nëse identifikimi direkt në distancë funksionon dhe është i përditësuar;

e) nëse UAS-ja është e pajisur me një ngarkesë shtesë, të verifikojë që masa e tij nuk tejkalon MTOM-në të përcaktuar nga prodhuesi ose limiti i MTOM-së i klasës së tij.

2. Gjatë fluturimit, piloti në distancë duhet:

a) të mos kryejë detyra nën ndikimin e substancave psikoaktive ose alkoolit, ose kur është i papërshtatshëm nga ana shëndetësore për të kryer detyrat e tij për shkak të lëndimit, lodhjes, ilaçeve, sëmundjes ose shkaqeve të tjera;

b) të mbajë avionët pa pilot në VLOS dhe të mbajë një skanim të plotë vizual të hapësirës ajrore që rrethon avionin pa pilot, në mënyrë që të shmangë ndonjë rrezik përplasjeje me ndonjë aeroplan të drejtuar me pilot. Piloti në distancë do të ndërpresë fluturimin nëse operimi paraqet rrezik për avionët e tjerë, njerëzit, kafshët, mjedisin ose pronën;

c) të përputhet me kufizimet operationale në zonat gjeografike të përcaktuara në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje;

d) të ketë aftësinë për të mbajtur kontrollin e avionit pa pilot, përveç në rastin e humbjes së lidhjes ose kur drejton një avion pa pilot në fluturim të lirë;

e) të veprojë me UAS-në në përputhje me manualin e përdoruesit të dhënë nga prodhuesi, duke përfshirë çdo kufizim të zbatueshëm;

f) të respektojë procedurat e operatorit kur është e mundur;

g) kur operon natën, të sigurohet që një dritë jeshile pulsuese mbi avionin në distancë është aktivizuar.

3. Gjatë fluturimit, pilotët në distancë dhe operatorët e UAS-së nuk duhet të fluturojnë afër ose brenda zonave ku po vazhdon përpyekja për përgjigje emergjente, përveç nëse ata kanë leje për ta bërë këtë nga shërbimet përgjegjëse të përgjigjes së emergjencës.

4. Për qëllimet e pikës 2 “b”, pilotët në distancë mund të ndihmohen nga një vëzhgues i avionëve pa pilot. Në këtë rast, komunikimi i qartë dhe efektiv do të vendoset midis pilotit në distancë dhe vëzhguesit të avionëve pa pilot.

UAS.OPEN.070 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e kompetencën teorike *online* të pilotit në

distancë dhe certifikatat e kompetencave të pilotit në distancë

1. Kompetenca teorike *online* e pilotit në distancë, e kërkuar nga pikat 4 “b”, të pikës UAS.OPEN.020 dhe pika 3, e pikës UAS.OPEN.040, dhe certifikata e kompetencës së pilotit në distancë, e kërkuar nga pika 2, e pikës UAS.OPEN.030, do të jetë e vlefshme për pesë vjet.

2. Rinovimi i kompetencës teorike *online* të pilotit në distancë dhe i certifikatës së kompetencës së pilotit në distancë, brenda periudhës së vlefshmërisë, është në varësi të:

a) një demonstrimi të kompetencave në përputhje me pikën 2 të pikës UAS.OPEN.030 ose pikën 4 “b” të pikës UAS.OPEN.020; ose

b) përfundimi i një trajnimit rinfreskues që trajton përkatësisht lëndët e njohurive teorike siç përcaktohet në pikën 4 “b”, të pikës UAS.OPEN.020 ose pika 2, e pikës UAS.OPEN.030 ofruar nga AAC-ja ose nga një subjekt i përcaktuar nga AAC-ja.

3. Për të rivlerësuar kompetencën teorike *online* të pilotit në distancë ose certifikatën e kompetencës së pilotit në distancë me skadimin e saj, piloti në distancë duhet të përputhet me pikën 2 “a”.

PJESA B

OPERIMET UAS NË KATEGORINË ‘SPECIFIKE’

UAS.SPEC.010 Dispozitat e përgjithshme

Operatori UAS do t'i sigurojë AAC-së një vlerësim të rrezikut operacional për operimin e synuar në përputhje me nenin 11 ose të paraqesë një deklaratë kur pika e UAS.SPEC.020 është e zbatueshme, përveç nëse operatori mban një certifikatë të lehtë (LUC) të operatorit UAS me privilegjet e duhura, në përputhje me pjesën C të këtij aneksi. Operatori UAS vlerëson rregullisht përshtatshmërinë e masave zbutëse të marra dhe i përditëson ato kur është e nevojshme.

UAS.SPEC.020 Deklaratë Operacionale

1. Në përputhje me nenin 5 të kësaj rregulloreje, operatori UAS mund të paraqesë një deklaratë operationale të pajtueshmërisë me një skenar/plan veprimi standard, siç përcaktohet në shtojcën 1 të këtij aneksi, tek AAC-ja, si autoriteti kompetent i shtetit të regjistrimit, si një alternativë e pikave



UAS.SPEC.30 dhe UAS.SPEC.40, në lidhje me operimet:

a) e avionëve pa pilot me:

i. dimension maksimal të karakteristikave deri në 3 metra në VLOS mbi sipërfaqen e kontrolluar të tokës, përveç mbi grumbullimet e njerëzve;

ii. dimension maksimal të karakteristikave deri në 1 metër në VLOS, përveç mbi grumbullimet e njerëzve;

iii. dimension maksimal të karakteristikave deri në 1 metër në BVLOS, mbi zona me popullim të rrallë;

iv. dimension maksimal të karakteristikave deri në 3 metra në BVLOS, mbi sipërfaqen e kontrolluar të tokës;

b) të kryera nën 120 metra nga pika më e afërt e sipërfaqes së tokës, dhe:

i. në hapësirën ajrore të pakontrolluar (klasa F ose G), përveç rasteve kur parashikohen kufizime të ndryshme përmes zonave gjeografike të UAS-së, në zonat ku probabiliteti për t'u përballur me avionë të drejtuar me pilotë nuk është i ulët; ose

ii. në hapësirën ajrore të kontrolluar në përputhje me procedurat e publikuara për zonën e operimit, në mënyrë që të sigurohet një probabilitet i ulët për t'u përballur me avionë të drejtuar nga pilotë.

2. Një deklaratë e operatorëve UAS përmban:

a) informacion administrativ për operatorin UAS;

b) një deklaratë në të cilën operatori plotëson kërkesën operacionale të paraqitur në pikën 1 dhe një skenar standard, siç përcaktohet në shtojcën 1 të aneksit;

c) angazhimin e operatorit UAS për të zbatuar masat përkatëse zbutëse të kërkuara për sigurinë e operimit, përfshirë udhëzimet e lidhura për operimin, për projektimin e avionit pa pilot dhe kompetencën e personelit të përfshirë;

d) konfirmimin nga operatori UAS se do të ketë një mbulim të duhur siguracioni për çdo fluturim të bërë nën deklaratë, nëse kërkohet nga Bashkimi Evropian kur është e zbatueshme ose ligji kombëtar.

3. Pas marrjes së deklaratës, AAC-ja si autoriteti kompetent do të verifikojë nëse deklarata përmban të gjitha elementet e shënuara në pikën 2 dhe do t'i sigurojë operatorit UAS një konfirmim të marrjes dhe plotësueshmërisë pa vonesa të panevojshme.

4. Pas marrjes së konfirmimit të marrjes dhe plotësueshmërisë, operatori UAS ka të drejtë të fillojë operimin.

5. Operatorët e UAS-së njoftojnë, pa asnjë vonesë, AAC-ja si autoritetin kompetent për çdo ndryshim të informacionit të përfshirë në deklaratën operacionale që ata paraqiten.

6. Operatorët e UAS-së që kanë një LUC me privilegje të përshtatshme, në përputhje me pjesën C të këtij aneksi, nuk u kërkohet të paraqesin deklaratën.

UAS.SPEC.030 Aplikim për një autorizim operacional

1. Para fillimit të një operimi UAS në kategorinë “specifike”, operatori UAS do të marrë një autorizim operacional nga AAC-ja, kur Shqipëria është shteti i regjistrimit, përveç:

a) kur pika e UAS.SPEC.020 është e zbatueshme; ose

b) operatori UAS mban një LUC me privilegjet e duhura, në përputhje me pjesën C të këtij aneksi.

2. Operatori UAS paraqet një kërkesë për një autorizim operacional të përditësuar nëse ka ndonjë ndryshim domethënës në operim ose në masat zbutëse të listuara në autorizimin operacional.

3. Aplikim për një autorizim operacional bazohet në vlerësimin e rrezikut të përmendur në nenin 11 dhe përfshin gjithashtu informacionin e mëposhtëm:

a) numrin e regjistrimit të operatorit UAS;

b) emrin e menaxherit përgjegjës ose emrin e operatorit UAS në rastin e një personi fizik;

c) vlerësimi i rrezikut operacional;

d) listën e masave mitiguese të propozuara nga operatori UAS, me informacion të mjaftueshëm për AAC-në për të vlerësuar përshtatshmërinë e mjeteve lehtësuese për të adresuar rreziqet;

e) një manual operimi kur kërkohet nga rreziku dhe kompleksiteti i operimit;

f) një konfirmim që do të ketë një mbulim të duhur siguracioni në fillimin e operateve UAS, nëse kërkohet nga ligji i zbatueshëm.

UAS.SPEC.040 Lëshimi i një autorizimi operacional

1. Kur merret një aplikim në përputhje me pikën UAS.SPEC.030, AAC-ja lëshon, pa vonesë, një autorizim operacional, në përputhje me nenin 12, kur arrin në përfundimin se operimi plotëson kushtet e mëposhtme:



a) janë siguruar të gjitha informacionet në përputhje me pikën 3, të pikës UAS.SPEC.030;

b) ekziston një procedurë për koordinim me ofruesin e shërbimit përkatës të lundrimit ajror, nëse i gjithë operimi ose një pjesë e tij do të bëhet në hapësirën ajrore të kontrolluar.

2. AAC-ja përcakton në autorizimin operacional qëllimin e saktë të autorizimit, në përputhje me nenin 12.

UAS.SPEC.050 Përgjegjësitë e operatorit UAS

1. Operatori UAS do të respektojë të gjitha që vijojnë:

a) zhvillon procedura dhe kufizime të përshtatura me llojin e operimit të synuar dhe rrezikun përkatës, duke përfshirë:

i. procedurat e operimit për të garantuar sigurinë e operimeve;

ii. procedurat për të garantuar që kërkesat e sigurisë (*security*), të zbatueshme për zonën e operimeve, janë përmbushur në operimin e synuar;

iii. masa për mbrojtje kundër ndërhyrjes së paligjshme dhe hyrjes së paautorizuar;

iv. procedurat për të siguruar që të gjitha operimet janë në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla. Në veçanti, ai do të kryejë një vlerësim të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, kur kërkohet nga Autoriteti Kombëtar për Mbrojtjen e të Dhënave, në zbatim të legjislacionit në fuqi;

v. udhëzues për pilotët e tij në distancë për të planifikuar operimet UAS në një mënyrë që të minimizojnë shqetësimet, përfshirë zhurmën dhe shqetësimet e tjera që lidhen me ndotjet, për njerëzit dhe kafshët;

b) cakton një pilot në distancë për secilin fluturim ose, në rastin e operimeve të pavarura, të sigurojë që gjatë të gjitha fazave të fluturimit, përgjegjësitë dhe detyrat, veçanërisht ato të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të pikës UAS.SPEC.060, të ndahen si duhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në bazë të shkronjës “a” më lart;

c) të sigurojë që të gjitha operacionet të përdorin dhe mbështesin në mënyrë efektive përdorimin efikas të spektrit radio, në mënyrë që të shmangen ndërhyrjet e dëmshme;

d) të sigurojë që para kryerjes së operimeve, pilotët në distancë të plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. kanë kompetencën për të kryer detyrat e tyre në përputhje me trajnimin e zbatueshëm të identifikuar nga autorizimi operacional ose, nëse pika UAS.SPEC.020 zbatohet, nga kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në skenarin standard të listuar në shtojcën 1 ose siç përcaktohet nga LUC;

ii. të ndjekë trajnimin e pilotit në distancë i cili do të jetë i bazuar në kompetenca dhe do të përfshijë kompetencat e përcaktuara në paragrafin 2, të nenit 8;

iii. të ndjekë trajnimin e pilotit në distancë, siç përcaktohet në autorizimin operacional, për operimet që kërkojnë një autorizim të tillë, ai do të kryhet në bashkëpunim me një subjekt të përcaktuar nga AAC-ja;

iv. të ndjekë trajnimin e pilotit në distancë për operime nën një deklaratë që do të kryhen në përputhje me masat zbutëse të përcaktuara nga skenari standard;

v. janë informuar në lidhje me manualin e operimit të operatorit UAS, nëse kërkohet nga vlerësimi i rrezikut dhe procedurat e përcaktuara në përputhje me pikën “a”;

vi. të marrë informacion të përditësuar të nevojshëm për operimin e synuar për çdo zonë gjeografike të përcaktuar në përputhje me nenin 15;

e) të sigurojë që personeli përgjegjës për detyrat thelbësore për operimin UAS, përveç vetë pilotit në distancë, të përmbushë të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. kanë përfunduar trajnimin në punë të zhvilluar nga operatori;

ii. janë informuar në lidhje me manualin e operimit të operatorit UAS, nëse kërkohet nga vlerësimi i rrezikut, dhe për procedurat e përcaktuara në përputhje me pikën “a”;

iii. kanë marrë informacion të përditësuar të nevojshëm për operimin e synuar për çdo zonë gjeografike të përcaktuar në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje;

f) të kryejë çdo operim brenda kufizimeve, kushteve dhe masave zbutëse të përcaktuara në deklaratë ose të specifikuara në autorizimin e operimit;

g) të ketë dhe mbajë të përditësuar regjistrime të të dhënave për:



i. të gjitha kualifikimet përkatëse dhe kurset e trajnimit të kryera nga piloti në distancë dhe personeli tjetër i ngarkuar me detyrat thelbësore për operimet e UAS-së dhe nga stafi i mirëmbajtjes, për të paktën 3 vjet pasi këta persona të kenë ndërprerë marrëdhëniet e punës me organizatën ose të kenë ndryshuar pozicionin e tyre në organizatë;

ii. aktivitetet e mirëmbajtjes të kryera në UAS për të paktën 3 vjet;

iii. informacionin mbi operacionet e UAS-së, duke përfshirë çdo ngjarje të pazakontë teknike ose operacionale dhe të dhëna të tjera siç kërkohet nga deklarata ose nga autorizimi operacional, për një minimum prej 3 vjetësh;

h) përdorimi UAS që, si minimum, janë krijuar në atë mënyrë që një dështim i mundshëm të mos e çojë UAS-në të fluturojë jashtë vëllimit operacional ose të shkaktojë një fatalitet. Për më tepër, ndërveprimet njeri-pajisje duhet të jenë të tilla për të minimizuar rrezikun e gabimit të pilotit dhe nuk do të shkaktojnë lodhje të paarsyeshme;

i) mirëmbajtja e UAS-së në një gjendje të përshtatshme për funksionim të sigurt:

i. minimalisht, duke përcaktuar udhëzimet e mirëmbajtjes dhe punësimin e një stafi mirëmbajtjeje të trajnuar dhe të kualifikuar përputhshëm me kërkesat; dhe

ii. duke respektuar pikën UAS.SPEC.100, nëse kërkohet;

iii. duke përdorur një avion pa pilot i cili është krijuar për të minimizuar zhurmën dhe ndotjet e tjera, duke marrë parasysh llojin e operimeve të synuara dhe zonat gjeografike ku zhurma e avionit dhe ndotjet e tjera janë shqetësuese;

j) të krijojë dhe të mbajë një listë të përditësuar të pilotëve në distancë, të caktuar për çdo fluturim;

k) të krijojë dhe të mbajë një listë të përditësuar të personelit të mirëmbajtjes, të punësuar nga operatori për të kryer aktivitetet e mirëmbajtjes; dhe

l) të sigurojë që çdo avion individual pa pilot ka të instaluar:

i. të paktën një dritë vezulluese jeshile për qëllimin e dukshmërisë së avionit pa pilot gjatë natës; dhe

ii. një sistem identifikimi në distancë, aktiv dhe të përditësuar.

UAS.SPEC.060 Përgjegjësitë e pilotit në distancë

1. Piloti në distancë:

a) nuk do të kryejë detyra nën ndikimin e substancave psikoaktive ose alkoolit, ose kur nuk është i përshtatshëm për të kryer detyrat e tij për shkak të lëndimit, lodhjes, ilaçeve, sëmundjes ose shkaqeve të tjera;

b) do të ketë aftësinë e duhur për të pilotuar në distancë, siç përcaktohet në autorizimin e operimit, në skenarin standard të përcaktuar në shtojcën 1 ose siç përcaktohet nga LUC-ja dhe do të mbajë një dëshmi të kompetencës ndërsa kryen operimin e UAS-së;

c) duhet të jetë i familjarizuar me instruksionet e prodhuesit, të vëna në dispozicion nga prodhuesi i UAS-së.

2. Para fillimit të një operacioni UAS, piloti në distancë duhet të përmbushë të gjitha sa vijon:

a) të marrë informacion të përditësuar, të nevojshëm për operimin e synuar, për çdo zonë gjeografike të përcaktuar në përputhje me nenin 15;

b) të sigurojë që mjedisi operues të jetë në përputhje me kufizimet dhe kushtet e autorizuara ose të deklaruar;

c) të sigurojë që UAS-ja është në një gjendje të sigurt për të përfunduar fluturimin e synuar në mënyrë të sigurt dhe nëse është e mundshme, të kontrollojë nëse identifikimi i menjëhershëm në distancë funksionon siç duhet;

d) të sigurojë që informacionet në lidhje me operimin janë vënë në dispozicion të njësisë së shërbimit përkatës të trafikut ajror (ATS), përdoruesve të tjerë të hapësirës ajrore dhe palëve të interesuara përkatëse, siç kërkohet nga autorizimi operacional ose nga kushtet e publikuara, për zonat gjeografike të operimit, në përputhje me nenin 15.

3. Gjatë fluturimit, piloti në distancë:

a) respekton kufizimet dhe kushtet e autorizuara ose të deklaruar;

b) do të shmangë çdo rrezik të përplasjes me ndonjë aeroplan të drejtuar dhe të ndërpresë një fluturim kur vazhdueshmëria e tij mund të përbëjë rrezik për avionët e tjerë, njerëzit, kafshët, mjedisin ose pronën;

c) do të përputhet me kufizimet operacionale në zonat gjeografike të përcaktuara në përputhje me nenin 15;

d) do të jetë në përputhje me procedurat e operatorit;

e) nuk do të fluturojë afër ose brenda zonave ku një përpjekje për përgjigje emergjente është duke



vazhduar, përveç nëse ata kanë leje ta bëjnë këtë nga shërbimet përgjegjëse të reagimit emergjent.

UAS.SPEC.070 Transferimi i një autorizimi operacional

Një autorizim operacional nuk është i transferueshëm.

UAS.SPEC.080 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e një autorizimi operacional

1. AAC-ja përcakton kohëzgjatjen e autorizimit operacional, në autorizimin përkatës.

2. Pavarësisht nga pika 1, autorizimi operacional mbetet i vlefshëm për sa kohë që operatori UAS mbetet në përputhje me kërkesat përkatëse të kësaj rregulloreje dhe me kushtet e përcaktuara në autorizimin operacional.

3. Pas revokimit ose dorëzimit të autorizimit operacional, operatori UAS do të sigurojë një vërtetim në format digjital që duhet t'i kthehet AAC-së pa vonesë.

UAS.SPEC.085 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e një deklarimi operacional:

Deklarimi operacional do të ketë një kohëzgjatje të kufizuar prej 2 vjetësh. Deklarimi nuk do të konsiderohet më i plotë sipas kuptimit të pikës 4, të pikës UAS.SPEC.020, nëse:

1. Gjatë mbikëqyrjes së operatorit të UAS-së, autoriteti kompetent ka konstatuar se operimi i UAS-së nuk është kryer në përputhje me deklarinin operacional;

2. Kushtet e funksionimit të UAS-së kanë ndryshuar në masën që deklarimi operacional nuk është më në përputhje me kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje;

3. Autoritetit kompetent nuk i jepet akses në përputhje me pikën UAS.SPEC.090.

UAS.SPEC.090 Akses

Për qëllim të demonstrimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, një operator UAS-je i jep çdo personi të autorizuar, siç duhet nga AAC-ja, një akses në çdo strukturë, fasilitet, UAS, dokument, regjistrime, të dhëna, procedura ose ndonjë material tjetër të rëndësishëm për veprimtarinë e tij, e cila është subjekt i autorizimit operacional ose deklaratës operationale, pavarësisht nëse veprimtaria e tij është kontraktuar ose nënkontraktuar në një organizatë tjetër.

UAS.SPEC.100 Përdorimi i pajisjeve të certifikuara dhe avionëve të certifikuar pa pilot

1. Nëse operacioni UAS është duke përdorur një avion pa pilot për të cilin është lëshuar një

certifikatë e vlefshmërisë ajrore ose një certifikatë e kufizuar e vlefshmërisë ajrore, ose është duke përdorur pajisje të certifikuar, operatori UAS regjistron operimin ose kohën e shërbimit, në përputhje me udhëzimet dhe procedurat e zbatueshme për pajisjet e certifikuara ose me miratimin, ose autorizimin organizativ.

2. Operatori UAS duhet të ndjek udhëzimet e përmendura në certifikatën e avionit pa pilot ose në certifikatën e pajisjes, dhe gjithashtu duhet të përputhet me direktivat e vlefshmërisë ajrore ose operative të lëshuara nga EASA, e të pranuar e publikuara nga AAC-ja.

PJESA C

CERTIFIKATA E LEHTËSUAR E OPERATORIT UAS (LUC)

UAS.LUC.010 Kërkesa të përgjithshme për një LUC

1. Një person juridik ka të drejtë të aplikojë për një LUC, sipas kësaj pjese.

2. Një aplikim për një LUC ose për një ndryshim në një LUC ekzistues do t'i paraqitet AAC-së dhe përmban të gjitha informacionet e mëposhtme:

a) një përshkrim të sistemit të menaxhimit të operatorit UAS, përfshirë strukturën e tij organizative dhe sistemin e menaxhimit të sigurisë;

b) emrin(at) e personelit përgjegjës të operatorit UAS, përfshirë personin përgjegjës për autorizimin e operimeve me UAS;

c) një deklaratë që i gjithë dokumentacioni i paraqitur tek AAC-ja është verifikuar nga aplikanti dhe është gjetur se përputhet me kërkesat në fuqi.

3. Nëse plotësohen kërkesat e kësaj pjese, një mbajtësi të LUC-së mund t'i jepen privilegjet, në përputhje me pikën UAS.LUC.060.

UAS.LUC.020 Përgjegjësitë e mbajtësit të LUC-së

Mbajtësi i LUC-së duhet:

1. Të përputhet me kërkesat e pikave UAS.SPEC.050 dhe UAS.SPEC.060;

2. Të përputhet me fushën dhe privilegjet e përcaktuara në kushtet e miratimit;

3. Të krijojë dhe mirëmbajë një sistem për ushtrimin e kontrollit operacional për çdo operim të kryer nën kushtet e LUC-së së tij;

4. Të kryejë një vlerësim të rrezikut operacional të operimit të synuar në përputhje me nenin 11,



përveç nëse kryhet një operim për të cilin një deklaratë operationale është e mjaftueshme sipas pikës UAS.SPEC.020;

5. Të mbajë shënime për artikujt e mëposhtëm, në një mënyrë që të sigurojë mbrojtje nga dëmtimi, ndryshimi dhe vjedhja, për një periudhë të paktën 3 vjet për operimet e kryera duke përdorur privilegjet e përcaktuara në pikën UAS.LUC.060:

a) vlerësimin e rrezikut operacional, kur kërkohet sipas pikës 4, dhe dokumentacionin mbështetës të tij;

b) masat zbutëse të marra; dhe

c) kualifikimet dhe përvoja e personelit të përfshirë në operimin UAS, monitorimin e pajtueshmërisë dhe menaxhimin e sigurisë;

6. Të mbajë të dhënat e personelit të përmendur në pikën 5 “c”, për atë kohë sa personi punon për organizatën dhe do të mbahet deri në 3 vjet pasi personi të ketë dalë nga organizata.

UAS.LUC.030 Sistemi i menaxhimit të sigurisë

1. Një operator UAS-je i cili aplikon për një LUC duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të sigurisë që korrespondon me madhësinë e organizatës, natyrën dhe kompleksitetin e veprimtarive të tij, duke marrë parasysh rreziqet dhe risqet përkatëse që vijnë nga këto aktivitete.

2. Operatori UAS do të përputhet me të gjitha sa vijon:

a) të emërojë një menaxher përgjegjës me autoritetin për të siguruar që brenda organizatës të gjitha aktivitetet të kryhen në përputhje me standardet në fuqi dhe se organizata është vazhdimisht në përputhje me kërkesat e sistemit të menaxhimit dhe procedurat e identifikuara në manualin LUC, të cilit i referohen në pikën UAS.LUC.040;

b) të përcaktojë linja të qarta të përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë në të gjithë organizatën;

c) të krijojë dhe të mbajë një politikë të sigurisë dhe objektivat përkatëse të sigurisë;

d) të emërojë personelin kryesor të sigurisë për të ekzekutuar politikën e sigurisë;

e) të krijojë dhe mirëmbajë një proces të menaxhimit të rrezikut të sigurisë, duke përfshirë identifikimin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me veprimtaritë e operatorit UAS, si dhe vlerësimin e tyre dhe menaxhimin e risqeve përkatëse, duke përfshirë ndërmarrjen e veprimeve për të

minimizuar ato risqe dhe për të verifikuar efektivitetin e veprimt;

f) të promovojë sigurinë në organizatë përmes:

i. trajnimit dhe edukimit;

ii. komunikimit;

g) të dokumentojë të gjitha proceset kryesore të sistemit të menaxhimit të sigurisë për të ndërgjegjësuar personelin për përgjegjësitë e tyre dhe për procedurën e ndryshimit të këtij dokumentacioni; proceset kryesore përfshijnë:

i. raportimin e sigurisë në operim dhe hetimet e brendshme;

ii. kontrollin operacional;

iii. komunikimin mbi sigurinë në operim;

iv. trajnimin dhe promovimin e sigurisë;

v. monitorimin e përputhshmërisë;

vi. menaxhimin e rrezikut të sigurisë;

vii. menaxhimin e ndryshimit;

viii. ndërfaqjen midis organizatave;

ix. përdorimin e nënkontraktuesve dhe partnerëve;

h) të përfshijë një funksion të pavarur për të monitoruar pajtueshmërinë dhe përshtatshmërinë e përmbushjes së kërkesave përkatëse të kësaj rregulloreje, duke përfshirë një sistem për të siguruar informacion për gjetjet, të menaxheri përgjegjës, për të siguruar zbatimin efektiv të masave korrigjuese sipas nevojës;

i) të përfshijë një funksion për të siguruar që rreziqet e sigurisë, të qenësishme, të një shërbimi ose produkti të dhënë përmes nënkontraktuesve, vlerësohen dhe zbuten nën sistemin e menaxhimit të sigurisë së operatorit.

3. Nëse organizata mban certifikata të tjera të organizatës, brenda fushëveprimit të rregullores bazë të miratuar me VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, sistemi i menaxhimit të sigurisë së operatorit UAS mund të integrohet me sistemin e menaxhimit të sigurisë që kërkohet nga secila prej asaj (atyre) certifikate(ave) shtesë.

UAS.LUC.040 Manuali LUC

1. Një mbajtës i LUC-së, i paraqet AAC-së një manual LUC-je që përshkruan drejtpërdrejt ose me referencë organizimin e tij, procedurat përkatëse dhe aktivitetet që do të kryejë.

2. Manuali duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga menaxheri përgjegjës që konfirmon që organizata do të punojë në çdo kohë në përputhje me këtë rregullore dhe me manualin e miratuar të LUC-së. Kur menaxheri i përgjegjshëm



nuk është përgjegjësi drejtues i organizatës, përgjegjësi drejtues do të nënshkruaj deklaratën.

3. Nëse ndonjë aktivitet kryhet nga organizata partnere ose të nënkontraktuar, operatori UAS do të përfshijë në procedurat e manualit të LUC-së, se si mbajtësi i LUC-së do të menaxhojë marrëdhëniet me ato organizata partnere ose të nënkontraktuara.

4. Manuali i LUC-së do të ndryshohet kur është e nevojshme për të mbajtur një përshkrim të azhurnuar të mbajtësit të organizatës së LUC-së dhe kopjet e ndryshimeve do t'i jepen AAC-së.

5. Operatori UAS u shpërndan pjesët përkatëse të manualit të LUC-së të gjithë personelit të tij në përputhje me funksionet dhe detyrat e tyre.

UAS.LUC.050 Kushtet e miratimit të mbajtësit të LUC-së

1. AAC-ja lëshon një LUC pasi të jetë i sigurt që operatori UAS përputhet me pikat UAS.LUC.020, UAS.LUC.030 dhe UAS.LUC.040.

2. LUC-ja përfshin:

- a) identifikimin e operatorit UAS;
- b) privilegjet e operatorit UAS;
- c) tipat e autorizuar të operimit;
- d) hapësira, zona ose klasa e hapësirës ajrore të autorizuar për operime, nëse është e zbatueshme;
- e) çdo kufizim ose kushte të veçanta, nëse është e zbatueshme;

UAS.LUC.060 Privilegjet e mbajtësit të LUC-së

Kur është i kënaqur me dokumentacionin e dhënë, AAC-ja:

1. Do të specifikojë termat dhe kushtet e privilegjeve që i jepen operatorit UAS në LUC; dhe

2. Brenda kushteve të miratimit, mund t'i japë një mbajtësi të LUC-së, privilegjin të autorizojë operimet e tij pa:

- a) paraqitjen e një deklarate operacionale;
- b) aplikimin për një autorizim operacional.

UAS.LUC.070 Ndryshimet në sistemin e menaxhimit LUC

Pas lëshimit të një LUC-je, ndryshimet e mëposhtme kërkojnë miratimin paraprak nga AAC-ja:

1. Çdo ndryshim në kushtet e miratimit të operatorit UAS;

2. Çdo ndryshim domethënës në elementet e sistemit të menaxhimit të sigurisë së mbajtësit të LUC-së siç kërkohet nga pika UAS.LUC.030.

UAS.LUC.075 Transferimi i një LUC-je

Me përjashtim të ndryshimit të pronësisë së organizatës, të miratuar nga AAC-ja në përputhje me pikën UAS.LUC.070, një LUC, nuk është i transferueshëm.

UAS.LUC.080 Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e një LUC-je

1. Një LUC lëshohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. Ai do të mbetet i vlefshëm në varësi të:

- a) pajtueshmërisë së vazhdueshme të mbajtësit të LUC-së me kërkesat përkatëse të kësaj rregulloreje dhe të AAC-së, si autoriteti kompetent i shtetit që ka lëshuar certifikatën; dhe
- b) mosdorëzimit ose mosrevokimit.

2. Pas revokimit ose dorëzimit të një LUC-je, mbajtësi i LUC-së duhet të sigurojë një njohje në format digjital, që duhet t'i kthehet AAC-së pa vonesë.

UAS.LUC.090 Akses

Për qëllim të demonstrimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, mbajtësi i LUC-së do t'i japë çdo personi, të autorizuar sipas kritereve nga AAC-ja, akses në çdo strukturë, fasilite, UAS, dokument, regjistrime, të dhëna, procedura ose çfarëdo materiali tjetër përkatës të rëndësishëm për veprimtarinë e tij, e cila është subjekt i certifikimit, autorizimit operacional ose deklaratës operacionale, pavarësisht nëse veprimtaria e tij është kontraktuar ose nënkontraktuar në një organizatë tjetër.

SHTOJCA 1

PËR SKENARËT STANDARD QË MBËSHITESIN NJË DEKLARATË

KAPITULLI I

STS-01 - VLOS mbi një zonë të kontrolluar tokësore në një mjedis të populluar

UAS.STS-01.010 Parashikime të përgjithshme

1. Gjatë fluturimit, avioni pa pilot duhet të mbahet në një distancë prej 120 m nga pika më e afërt e sipërfaqes së tokës. Matja e distancave do të përshtatet në përputhje me karakteristikat gjeografike të terrenit, si p.sh.: fusha, kodra, male.

2. Kur fluturon një avion pa pilot brenda një distancë horizontale prej 50 m nga një pengesë artificiale më e lartë se 105 metra, lartësia maksimale e operacionit UAS mund të rritet deri në 15 m mbi lartësinë e pengesës, me kërkesë të entitetit përgjegjës për pengesën.



3. Lartësia maksimale e vëllimit të operimit nuk duhet të kalojë 30 m mbi lartësinë maksimale të lejuar në pikat 1 dhe 2.

4. Gjatë fluturimit, avioni pa pilot nuk duhet të mbartë mallra të rrezikshme.

UAS.STS-01.020 Operimet UAS në STS-01

1. Operimet UAS në STS-01 duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) të kryhen me avionët pa pilot të mbajtur në VLOS gjatë të gjithë kohës;

b) të kryhen në përputhje me manualin e operimit të përmendur në pikën 1, të pikës UAS.STS-01.030;

c) të kryhen mbi një zonë të kontrolluar tokësore që përfshin:

i. për operimin e një avioni pa pilot të palidhur:

A) zonën gjeografike të fluturimit;

B) zonën e emergjencës, me kufirin(et) e saj të jashtëm të paktën 10 m përtej kufirit(eve) të zonës gjeografike të fluturimit; dhe

C) baferin e rrezikut tokësor, i cili duhet të mbulojë një distancë përtej kufirit(ve) të jashtëm të zonës së emergjencës që plotëson të paktën parametrat e mëposhtëm:

	Distanca minimale për t'u mbuluar nga baferi i rrezikut në tokë për avionë pa pilotë të palidhur	
Lartësia maksimale mbi tokë (shesh)	me MTOM deri në 10 kg	me MTOM mbi 10 kg
30 m	10 m	20 m
60 m	15 m	30 m
90 m	20 m	45 m
120 m	25 m	60 m

ii. për operimin e një avioni pa pilot të lidhur, një rreze e barabartë me gjatësinë e lidhjes plus 5 m dhe e përqendruar në pikën ku lidhja është e fiksuar mbi sipërfaqen e tokës;

d) të kryhet me një shpejtësi tokësore më të vogël se 5 m/s në rastin e avionëve pa pilot të palidhur;

e) të drejtohet nga një pilot në distancë, i cili:

i. zotëron një certifikatë të njohurive teorike për pilot në distancë, në përputhje me shtojcën A të këtij kapitulli, për operationet në skenarët standardë, të lëshuar nga AAC-ja ose nga një subjekt i përcaktuar nga autoriteti kompetent;

ii. ka një akreditim për përfundimin e trajnimit praktik të aftësive STS-01, në përputhje me shtojcën A të këtij kapitulli dhe të lëshuar nga:

A) një ent që ka deklaruar pajtueshmërinë me kërkesat në shtojcën 3 dhe është njohur nga AAC-ja; ose

B) një operator UAS-je që ka deklaruar pranë AAC-së përputhshmërinë me STS-01 dhe që ka deklaruar pajtueshmërinë me kërkesat në shtojcën 3; dhe

f) të udhëhiqet me një avion pa pilot i cili shënohet si klasi C5 dhe përputhet me kërkesat e asaj klase, siç përcaktohet në pjesën 16 të shtojcës së rregullores për sistemet e avionëve pa pilot dhe operatorët e vendeve të tjera, dhe vendeve të treta të sistemeve të avionëve pa pilot, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, dhe operohet me sistem identifikimi në distancë aktive dhe të përditësuar.

2. Piloti në distancë do të marrë certifikatën e njohurive teorike për operimet në skenarët standardë pasi:

a) të ketë përfunduar një kurs trajnimi *online* dhe ka kaluar provimin e njohurive teorike *online*, siç referohet në pikën 4 “b”, të pikës UAS.OPEN.020; dhe



b) të ketë kaluar një ekzaminim shtesë të njohurive teorike të ofruar nga autoriteti kompetent ose nga një subjekt i përcaktuar nga AAC-ja, në përputhje me shtojcën A të këtij kapitulli.

3. Kjo certifikatë është e vlefshme për pesë vjet. Rivlerësimi, brenda periudhës së vlefshmërisë së tij, i nënshtrohet çdonjëres nga sa vijon:

a) demonstrimit të kompetencave në përputhje me pikën 2;

b) përfundimit të një trajnimi rifreskues që trajton lëndët e njohurive teorike siç përcaktohet në pikën 2 të ofruar nga AAC-ja ose nga një subjekt i përcaktuar nga AAC-ja.

4. Për të rivlerësuar certifikatën pas skadimit të saj, piloti në distancë duhet të përputhet me pikën 2.

UAS.STS-01.030 Përgjegjësitë e operatorit UAS

Përveç përgjegjësive të përcaktuara në UAS.SPEC.050 operatori UAS duhet:

1. Të zhvillojë një manual operimi duke përfshirë elementet e përcaktuara në shtojcën 5;

2. Të përcaktojë vëllimin operacional dhe baferin e rrezikut në tokë për operimet e synuara, duke përfshirë zonën e kontrolluar të tokës që mbulon projeksionet në sipërfaqen e tokës, si brenda vëllimit ashtu edhe në bafer;

3. Të sigurojë përshtatshmërinë e procedurave të kontingjencës dhe emergjencave nëpërmjet ndonjë prej sa më poshtë:

a) testet e dedikuara të fluturimit;

b) simulimet, me kusht që paraqitja e mjeteve të simulimit të jetë e përshtatshme për qëllimin e synuar;

4. Të zhvillojë një plan efektiv të reagimit emergjent (ERP) të përshtatshëm për operimin, që përfshin të paktën:

a) planin për të kufizuar çdo efekt përshkallëzues të situatës së emergjencës;

b) kushtet për të njoftuar autoritetet dhe organizatat përkatëse;

c) kriteret për të identifikuar një situatë emergjente;

d) përcaktimi i qartë i detyrave të pilotit(ëve) në distancë dhe çdo personeli tjetër përgjegjës për detyrat thelbësore për funksionimin e UAS-ve;

5. Të sigurojë që niveli i performancës për çdo shërbim të ofruar nga jashtë, i nevojshëm për

sigurinë e fluturimit, është i përshtatshëm për funksionimin e synuar;

6. Të përcaktojë ndarjen e roleve dhe përgjegjësive ndërmjet operatorit dhe ofruesit të jashtëm të shërbimit, nëse është e aplikueshme;

7. Të ngarkojë informacionin e përditësuar në gjeo-ndërgjegjësimin, nëse funksioni është i instaluar në UAS, kur kërkohet nga zona gjeografike e UAS-së për vendndodhjen e synuar të operimit;

8. Të sigurojë që, përpara fillimit të operimit, zona e kontrolluar e tokës është në vend, efektive dhe në përputhje me distancën minimale të përcaktuar në pikën UAS.STS-01.020(1)(C)(i)(C) dhe, kur kërkohet, është bërë koordinimi me autoritetet përkatëse;

9. Të sigurojë që, përpara fillimit të operimit, të gjithë personat e pranishëm në zonën e kontrolluar të tokës:

a) janë informuar për rreziqet e operimit;

b) janë informuar ose trajnuar, sipas rastit, mbi masat paraprake dhe masat e sigurisë të vendosura nga operatori UAS për mbrojtjen e tyre; dhe

c) kanë rënë dakord shprehimisht të marrin pjesë në operim;

10. Të sigurojë që:

a) UAS-ja shoqërohet nga deklaratat përkatëse të BE-së, të konformitetit, duke përfshirë referencën për klasën C5 ose referencën për klasën C3 dhe për kompletin e aksesoreve; dhe

b) etiketa identifikuese e klasës C5 është ngjitur në avionin pa pilot ose në kompletin e aksesoreve.

UAS.STS-01.040 Përgjegjësitë e pilotit në distancë

Përveç përgjegjësive të përcaktuara në UAS.SPEC.060, piloti në distancë:

1. Përpara fillimit të një operimi UAS, duhet të verifikojë që mjetet për të përfunduar fluturimin e avionit pa pilot janë funksionale dhe të kontrollojë nëse identifikimi i drejtpërdrejtë në distancë është aktiv dhe i përditësuar;

2. Gjatë fluturimit:

a) do të mbajë avionin pa pilot në VLOS dhe do të mbajë një skanim të plotë të hapësirës që rrethon avionin pa pilot, në mënyrë që të shmanget çdo rrezik i një përplasjeje me ndonjë avion me pilot. Piloti në distancë do të ndërpresë fluturimin nëse operimi paraqet rrezik për avionët e tjerë, njerëzit, kafshët, mjedisin ose pronën;



b) për qëllimet e pikës “a”, mund të ndihmohet nga një vëzhgues avioni pa pilot. Në këtë rast, do të vendoset komunikim i qartë dhe efektiv ndërmjet pilotit në distancë dhe vëzhguesit të avionit pa pilot;

c) do të ketë aftësinë për të mbajtur kontrollin e avionit pa pilot, me përjashtim të rastit të lidhjes së humbur të komandës dhe kontrollit (C2);

d) do të operojë vetëm një avion pa pilot në të njëjtën kohë;

e) nuk do të operojë avionin pa pilot nga një mjet në lëvizje;

f) nuk do të dorëzojë kontrollin e avionit pa pilot një njësie tjetër komanduese;

g) do të kryejë procedurat e emergjencës, të përcaktuara nga operatori UAS për situata jonormale, duke përfshirë kur piloti në distancë ka një tregues se avioni pa pilot mund të tejkalojë kufijtë e gjeografisë së fluturimit; dhe

h) do të kryejë procedurat e emergjencës të përcaktuara nga operatori UAS për situatat emergjente, duke përfshirë aktivizimin e mjeteve për të përfunduar fluturimin kur piloti në distancë ka një tregues se avioni pa pilot mund të tejkalojë kufijtë e vëllimit operacional.

SHTOJCA A NJOHURI TEORIKE DHE PROVIMI PRAKTIK I AFTËSIVE TË PILOTT PËR STS-01

1. Ekzaminimi i njohurive teorike:

a) Ekzaminimi i përmendur në pikën 2 “b”, të pikës UAS.STS-01.020, do të përmbajë të paktën

40 pyetje me zgjedhje të shumëfishta që synojnë të vlerësojnë njohuritë e pilotit në distancë për mitigimet teknike dhe operationale, të shpërndara në mënyrë të përshtatshme në temat e mëposhtme:

- i. rregulloret e aviacionit;
- ii. kufizimet e performancës njerëzore;
- iii. procedurat operationale;
- iv. mitigimet teknike dhe operationale për rrezikun në tokë;
- v. njohuri të përgjithshme të UAS-së;
- vi. meteorologjia;
- vii. performancën e fluturimit të UAS-së; dhe
- viii. mitigimet teknike dhe operationale për rreziqet në ajër;

b) Nëse piloti student në distancë tashmë zotëron një certifikatë të kompetencës së pilotit në distancë siç përmendet në pikën 2, të pikës UAS.OPEN.030, provimi duhet të përmbajë të paktën 30 pyetje me zgjedhje të shumëfishta të shpërndara në mënyrë të përshtatshme në të gjitha lëndët në pikën (1)(a)(i) deri në (1)(a)(v);

c) Për të kaluar provimin e njohurive teorike, piloti student në distancë duhet të arrijë të paktën 75% të notave të përgjithshme.

2. Trajnimi i aftësive praktike dhe vlerësimi:

Trajnimi i aftësive praktike dhe vlerësimi për operimet sipas çdo skenari standard do të mbulojë të paktën temat dhe fushat e identifikuara në tabelën 1:

Tabela 1: Lëndët dhe fushat që do të mbulohen për trajnimin dhe vlerësimin e aftësive praktike

Subjekti	Fushat që duhet të mbulohen
a) Veprimet para fluturimit	i. Planifikimi i operimit, konsideratat e hapësirës ajrore dhe vlerësimi i rrezikut të vendndodhjes. Pikat e mëposhtme duhet të përfshijnë: A) identifikimin e objektivave të operacionit të synuar; B) sigurimin që vëllimi i përcaktuar operacional dhe baferat përkatës (p.sh. baferi i rrezikut në tokë) të jenë të përshtatshme për operimin e synuar; C) dallimin e pengesave në vëllimin operacional që mund të pengojnë operimin e synuar; D) identifikimin nëse shpejtësia dhe/ose drejtimi i erës mund të ndikohet nga topografia ose nga pengesat në vëllimin operativ; E) zgjidhjen e të dhënave përkatëse për informacionin e hapësirës ajrore (përfshirë zonat gjeografike të UAS-së) që mund të kenë ndikim në operacionin e synuar; F) sigurimin që UAS-ja është e përshtatshme për funksionimin e synuar; G) sigurimin që ngarkesa e zgjedhur është e pajtueshme me UAS-në e përdorur për operimin;



	H) zbatimin e masave të nevojshme për të përmbushur kufizimet dhe kushtet e zbatueshme për vëllimin operacional dhe baferin për rrezikun në tokë për operimin e synuar në përputhje me procedurat e manualit të operimeve për skenarin përkatës; I) zbatimin e procedurave të nevojshme për të operuar në hapësirën ajrore të kontrolluar, duke përfshirë një protokoll për të komunikuar me ATC-në dhe për të marrë leje dhe udhëzime, nëse është e nevojshme; J) konfirmimin që të gjitha dokumentet e nevojshme për operimin e synuar janë në vend; dhe K) informimin e të gjithë pjesëmarrësve në lidhje me operacionin e planifikuar. ii. Inspektimi dhe konfigurimi i UAS-së para fluturimit (duke përfshirë mënyrat e fluturimit dhe rreziqet nga burimi i energjisë). Pikat e mëposhtme duhet të përfshijnë: A) të vlerësojë gjendjen e përgjithshme të UAS-së; B) të sigurojë që të gjithë komponentët e lëvizshëm të UAS-së janë të siguruar siç duhet; C) të sigurojë që konfigurimet e softuerit UAS janë të pajtueshme; D) të kalibrojë instrumentet në UAS; E) të identifikojë çdo të metë që mund të rrezikojë operacionin e synuar; F) të sigurojë që niveli i energjisë së baterisë të jetë i mjaftueshëm për funksionimin e synuar; G) të sigurojë që sistemi i përfundimit të fluturimit të UAS-së dhe sistemi i tij i ndezjes janë funksionalë; H) të kontrollojë funksionimin e saktë të lidhjes së komandës dhe kontrollit; I) të aktivizojë funksionin e gjeo-ndërgjegjësimit dhe të ngarkojë informacionin në të (nëse funksioni i gjeo-ndërgjegjësimit është i disponueshëm); dhe J) të vendosë sistemet e kufizimit të lartësisë dhe shpejtësisë (nëse ka). iii. Njohuritë për veprimet bazë që duhen ndërmarrë në rast të një situatë emergjente, duke përfshirë çështjet me UAS-në, ose nëse lind një rrezik përplasjeje në ajër gjatë fluturimit.
b) Procedurat në fluturim	i. Mbani një vëzhgim efektiv dhe mbajeni avionin pa pilot brenda vijës vizuale të shikimit (VLOS) gjatë të gjithë kohës për të përfshirë: ndërgjegjësimin për vendndodhjen në lidhje me vëllimin operacional dhe përdoruesit e tjerë të hapësirës ajrore, pengesat, terrenin dhe personat që nuk janë të përfshirë në çdo kohë; ii. Kryeni manovra fluturimi të sakta dhe të kontrolluara në lartësi dhe distanca të ndryshme përfaqësuese të STS-së përkatëse (përfshirë fluturimin në modalitetin manual/jo-GNSS të asistuar ose ekuivalentin, aty ku është e pajisur). Të paktën duhet të kryhen manovrat e mëposhtme: A) rri pezull në pozicion (vetëm për <i>rotorcraft</i>); B) kalimi nga hover në fluturim përpara (vetëm për <i>rotorcraft</i>); C) ngjitja dhe zbritja nga fluturimi në nivel; D) kthesat në fluturim në nivel; E) kontrollin e shpejtësisë në fluturim në nivel; F) veprimet pas një dështimi të një motori/sistemi shtytës; dhe G) veprime evazive (manovra) për të shmangur përplasjet; iii. Monitorimi në kohë reale i statusit të UAS-së dhe kufizimeve të qëndrueshmërisë. Fluturimi në kushte jonormale: A) menaxhoni një mungesë të pjesshme ose të plotë të fuqisë së sistemit të shtytjes së avionit pa pilot duke garantuar sigurinë e palëve të treta në terren; B) menaxhoni rrugën e avionit pa pilot në situata jonormale; C) menaxhoni një situatë në të cilën pajisjet e pozicionimit të avionit pa pilot janë të dëmtuara; D) menaxhoni një situatë të një inkursioni nga një person që nuk është i përfshirë në vëllimin operacional ose në zonën e kontrolluar të tokës dhe të marrë masat e duhura për të ruajtur sigurinë; E) reagoni dhe merrni veprimet e duhura korrigjuese për situatat kur avioni pa pilot ka të ngjarë të kalojë kufirin e gjeografisë së fluturimit (procedurat e emergjencës) dhe nga vëllimi operacional (procedurat e urgjencës) siç përcaktohet gjatë përgatitjes së fluturimit; F) menaxhoni situatën kur një avion i afrohet vëllimit operacional; dhe G) demonstroi metodën e rikuperimit pas një humbjeje të qëllimshme (të simuluar) të lidhjes së komandës dhe kontrollit.
c) Veprime pas fluturimit	i. Mbyllni dhe siguroni UAS-në; ii. Inspektoni pas fluturimit dhe regjistroni çdo të dhënë përkatëse në lidhje me gjendjen e përgjithshme të UAS-së (sistemet, përbërësit dhe burimet e tij të energjisë) dhe lodhjen e ekuipazhit; iii. Kryeni një informim rreth operimit; iv. Identifikoni situatat kur një raport ngjarjeje ishte i nevojshëm dhe plotësoni raportin e kërkuar të ngjarjes.



KAPITULLI II

STS-02 - BVLOS ME VËZHgues TË
HAPËSIRËS AJRORE MBI NJË ZONË
TOKËSORE TË KONTROLLUAR NË NJË
MJEDIS ME POPULLIM TË RRALLË**UAS.STS-02.010 Dispozitat e përgjithshme**

1. Gjatë fluturimit avioni pa pilot duhet të mbahet në një distancë prej 120 m nga pika më e afër e sipërfaqes së tokës. Matja e distancave do të përshtatet sipas karakteristikave gjeografike të terrenit, si p.sh.: fusha, kodra, male.

2. Kur fluturon një avion pa pilot brenda një distancë horizontale prej 50 m nga një pengesë artificiale më e lartë se 105 m, lartësia maksimale e operacionit UAS mund të rritet deri në 15 m mbi lartësinë e pengesës me kërkesë të subjektit përgjegjës për pengesën.

3. Lartësia maksimale e vëllimit operativ nuk duhet të kalojë 30 m mbi lartësinë maksimale të lejuar në pikat 1 dhe 2.

4. Gjatë fluturimit avioni pa pilot nuk duhet të bartë mallra të rrezikshme.

UAS.STS-02.020 Operimet UAS në STS-02

Operimet UAS në STS-02 do të kryhen:

1. Në përputhje me manualin e operimit të përmendur në pikën 1, të pikës UAS.STS-02.030;

2. Mbi një zonë të kontrolluar tokësore të vendosur tërësisht në një mjedis me popullim të rrallë, ku përfshihet:

a) zona gjeografike e fluturimit;

b) kontingjenca, kufiri ose kufijtë e tij të jashtëm do të vendosen të paktën 10 m përtej kufirit(eve) të zonës gjeografike të fluturimit;

c) një bafer i rrezikut në tokë që mbulon një distancë që është të paktën e barabartë me distancën më të mundshme për t'u udhëtuar nga UA pas aktivizimit të mjeteve për të përfunduar fluturimin, e specifikuar nga prodhuesi UAS në udhëzimet e prodhuesit, duke marrë parasysh kushtet operative brenda kufizimeve të specifikuara nga prodhuesi i UAS-së;

3. Në një zonë ku dukshmëria minimale e fluturimit është më shumë se 5 km;

4. Me avionin pa pilot, në shikimin e pilotit në distancë, gjatë nisjes dhe rikuperimit të avionit pa pilot, përveç nëse ky i fundit është rezultat i një ndërprerjeje emergjente të fluturimit;

5. Nëse nuk përdoret asnjë vëzhgues i hapësirës ajrore në operim, me avion pa pilot që fluturon jo

më larg se 1 km nga piloti në distancë, me avion pa pilot që ndjek një trajektore të paraprogramuar, kur avioni pa pilot nuk është në VLOS të pilotit në distancë;

6. Nëse një ose më shumë vëzhgues të hapësirës ajrore përdoren në operim, ai duhet të jetë në përputhje me të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) vëzhguesit e hapësirës ajrore janë të pozicionuar në një mënyrë që mundëson një mbulim adekuat të vëllimit operacional dhe hapësirës ajrore përreth me dukshmërinë minimale të fluturimit të treguar në pikën 3;

b) avioni pa pilot operohet jo më larg se 2 km nga piloti në distancë;

c) avioni pa pilot operohet jo më larg se 1 km nga vëzhguesi i hapësirës ajrore që është më afër avionit pa pilot;

d) distanca ndërmjet çdo vëzhguesi të hapësirës ajrore dhe pilotit në distancë nuk është më shumë se 1 km;

e) mjete komunikimi të fuqishme dhe efektive janë të disponueshme për komunikimin ndërmjet pilotit në distancë dhe vëzhguesit(ve) të hapësirës ajrore;

7. Nga një pilot në distancë i cili zotëron:

a) një certifikatë të njohurive teorike për pilot në distancë për operimet në skenarë standardë, të lëshuar nga AAC-ja ose nga një subjekt i përcaktuar nga AAC-ja, ose autoriteti kompetent i shtetit anëtar të ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, kur është e zbatueshme;

b) një akreditim për përfundimin e trajnimit praktik të aftësive STS-02, në përputhje me shtojcën A të këtij kapitulli dhe të lëshuar nga:

A) një subjekt që ka deklaruar pajtueshmërinë me kërkesat në shtojcën 3 dhe është njohur nga AAC-ja ose autoriteti kompetent i një shteti anëtar të ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, kur është e zbatueshme; ose

B) nga një operator UAS-je që i ka deklaruar përputhshmërinë me STS-02 dhe që ka deklaruar pajtueshmërinë me kërkesat në shtojcën 3, AAC-së, kur Shqipëria është shteti i regjistrimit, ose autoritetit kompetent të shtetit anëtar të regjistrimit, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe, kur është e zbatueshme;

8. Me një avion pa pilot i cili plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:



a) është shënuar si klasa C6 dhe përputhet me kërkesat e asaj klase, siç përcaktohet në pjesën 17 të aneksit të rregullores së miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 114, datë 6.6.2022, “Për miratimin e rregullores për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot”;

b) operohet me një sistem aktiv për të parandaluar avionin pa pilot të shkelë gjeografinë e fluturimit;

c) operohet me sistem aktiv dhe të përditësuar të identifikimit të drejtpërdrejtë në distancë;

9. Piloti në distancë do të marrë certifikatën e njohurive teorike për operimet në skenarët standardë:

a) pasi ka përfunduar një kurs trajnimi *online* dhe ka kaluar provimin e njohurive teorike *online*, siç referohet në pikën 4 “b”, të pikës UAS.OPEN.020; dhe

b) pasi të ketë kaluar një ekzaminim shtesë të njohurive teorike të ofruar nga AAC-ja ose nga një ent i caktuar nga AAC-ja, në përputhje me shtojcën A të këtij kapitulli, ose autoriteti kompetent i një shteti anëtar të ZPEA-së, sipas marrëveshjes shumëpalëshe, kur është e zbatueshme;

10. Kjo certifikatë është e vlefshme për pesë vjet. Rivlerësimi, brenda periudhës së vlefshmërisë së tij, i nënshtrohet njëres nga sa vijon:

a) demonstrimin e kompetencave në përputhje me pikën 9;

b) përfundimin e një trajnimi rifreskues që trajton lëndët e njohurive teorike siç përcaktohet në pikën 9 të ofruar nga autoriteti kompetent ose nga një subjekt i përcaktuar nga autoriteti kompetent;

11. Për të rivlerësuar certifikatën pas skadimit të saj, piloti në distancë duhet të jetë në përputhje me pikën 9.

UAS.STS-02.030 Përgjegjësitë e operatorit UAS

Përveç përgjegjësitë të përcaktuara në UAS.SPEC.050, operatori UAS duhet:

1. Të zhvillojë një manual operimi duke përfshirë elementet e përcaktuara në shtojcën 5;

2. Të përcaktojë vëllimin operacional dhe bafer për rrezikun në tokë për operacionet e synuara, duke përfshirë zonën e kontrolluar të tokës që mbulon projeksionet në sipërfaqen e tokës si të vëllimit ashtu edhe të baferit;

3. Të sigurojë përshtatshmërinë e procedurave të emergjencës dhe emergjencave nëpërmjet ndonjë prej këtyre:

a) testet e dedikuara të fluturimit;

b) simulimet, me kusht që përfaqësimi i mjeteve të simulimit të jetë i përshtatshëm për qëllimin e synuar;

4. Të zhvillojë një plan efektiv të reagimit emergjent (ERP), të përshtatshëm për operacionin që përfshin të paktën:

a) planin për të kufizuar efektet përshkallëzuese të situatës së emergjencës;

b) kushtet për të njoftuar autoritetet dhe organizatat përkatëse;

c) kriteret për të identifikuar një situatë emergjente;

d) përcaktimin e qartë të detyrave të pilotit(ëve) në distancë dhe çdo personeli tjetër përgjegjës për detyrat thelbësore për funksionimin e UAS-ve;

5. Të sigurojë që niveli i performancës për çdo shërbim të ofruar nga jashtë, i nevojshëm për sigurinë e fluturimit, është i përshtatshëm për funksionimin e synuar;

6. Të përcaktojë ndarjen e roleve dhe përgjegjësitë ndërmjet operatorit dhe ofruesit të jashtëm të shërbimit, nëse është e aplikueshme;

7. Të ngarkojë informacionin e përditësuar në gjeo-ndërgjegjësimin, nëse funksioni është i instaluar në UAS, kur kërkohet nga zona gjeografike UAS për vendndodhjen e synuar të operacionit;

8. Të sigurojë që, përpara fillimit të operimit, të jenë marrë të gjitha masat e duhura për të reduktuar rrezikun e ndërhyrjes së personave të pa përfshirë në zonën e kontrolluar të tokës, në përputhje me distancën minimale të përcaktuar në pikën UAS.STS-02.020(2) dhe, kur kërkohet, është bërë koordinimi me autoritetet përkatëse;

9. Të sigurojë që, përpara fillimit të operimit, të gjithë personat e pranishëm në zonën e kontrolluar të tokës:

a) janë informuar për rreziqet e operacionit;

b) janë informuar dhe, nëse është e aplikueshme, trajnuar mbi masat paraprake dhe masat e sigurisë të vendosura nga operatori UAS për mbrojtjen e tyre; dhe

c) kanë rënë dakord shprehimisht të marrin pjesë në operacion;

10. Përpara fillimit të operacionit, nëse përdoren vëzhgues të hapësirës ajrore:

a) të sigurojë vendosjen dhe numrin e saktë të vëzhguesve të hapësirës ajrore përgjatë rrugës së synuar të fluturimit;



b) të verifikojë:

i. që dukshmëria dhe distanca e planifikuar e vëzhguesit të hapësirës ajrore janë brenda kufijve të pranueshëm, siç përcaktohet në manualin e operacioneve;

ii. mungesën e pengesave të mundshme të terrenit për çdo vëzhgues të hapësirës ajrore;

iii. se nuk ka boshllëqe midis zonave të mbuluara nga secili prej vëzhguesve të hapësirës ajrore;

iv. se komunikimi me çdo vëzhgues të hapësirës ajrore është vendosur dhe efektiv;

v. nëse mjetet që përdoren nga vëzhguesit e hapësirës ajrore për të përcaktuar pozicionin e avionit pa pilot, ato mjete janë funksionale dhe efektive;

c) të sigurojë që vëzhguesit e hapësirës ajrore të jenë të informuar mbi rrugën e synuar të avionit pa pilot dhe kohën përkatëse;

11. Të sigurohet që:

a) UAS-ja shoqërohet me deklaratën përkatëse të konformitetit kombëtare ose të BE-së, duke përfshirë referencën në klasën C6;

b) etiketa identifikuese e klasës C6 është ngjitur në avion pa pilot.

UAS.STS-02.040 Përgjegjësitë e pilotit në distancë

Përveç përgjegjësiave të përcaktuara në UAS.SPEC.060, piloti në distancë duhet:

1. Përpara se të fillojë një operacion UAS-je:

a) të vendosë vëllimin e programueshëm të fluturimit të avionit pa pilot për ta mbajtur atë brenda gjeografisë së fluturimit;

b) të verifikojë që mjetet për të përfunduar fluturimin dhe funksionaliteti i vëllimit operacional të programueshëm të avionit pa pilot janë funksionale dhe, kontrollon nëse identifikimi i drejtpërdrejtë në distancë është aktiv dhe i përditësuar.

2. Gjatë fluturimit:

a) nëse nuk mbështetet nga vëzhguesit e hapësirës ajrore, të mbajë një skanim të plotë të hapësirës ajrore që rrethon avionin pa pilot, në mënyrë që të shmangët çdo rrezik i një përplasjeje me ndonjë avion me pilot. Piloti në distancë do të ndërpresë fluturimin nëse operimi paraqet rrezik për avionët e tjerë, njerëzit, kafshët, mjedisin ose pronën;

b) të ketë aftësinë për të mbajtur kontrollin e avionit pa pilot, me përjashtim të rastit të lidhjes së humbur të komandës dhe kontrollit (C2);

c) të operojë vetëm një avion pa pilot në të njëjtën kohë;

d) të mosoperojë avionin pa pilot nga një mjet në lëvizje;

e) të mos ia dorëzojë kontrollin e avionit pa pilot një njësie tjetër komanduese;

f) të informojë në kohën e duhur vëzhguesin(ët) e hapësirës ajrore, kur është i punësuar, për çdo devijim të avionit pa pilot nga rruga e synuar dhe kohën përkatëse;

g) të kryejë procedurat e emergjencës të përcaktuara nga operatori UAS për situata jonormale, duke përfshirë kur piloti në distancë ka tregues se avioni pa pilot mund të tejkalojë kufijtë e gjeografisë së fluturimit;

h) të kryejë procedurat e urgjencës të përcaktuara nga operatori UAS për situata emergjente, duke përfshirë aktivizimin e mjeteve për të përfunduar fluturimin kur piloti në distancë ka një tregues se avioni pa pilot mund të kalojë kufijtë e vëllimit operacional.

UAS.STS-02.050 Përgjegjësitë e vëzhguesit të hapësirës ajrore

Një vëzhgues i hapësirës ajrore duhet:

1. Të mbajë një skanim të plotë të hapësirës ajrore që rrethon avionin pa pilot, në mënyrë që të identifikojë çdo rrezik të një përplasjeje me ndonjë avion me pilot;

2. Të ruajë vetëdijen për pozicionin e avionit pa pilot përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë të hapësirës ajrore ose nëpërmjet ndihmës së ofruar me mjete elektronike;

3. Të lajmërojë pilotin në distancë kur zbulohet një rrezik dhe ndihmohet në shmangien ose minimizimin e efekteve të mundshme negative.

SHTOJCA A

NJOHURI TEORIKE DHE AFTËSI PRAKTIKE TË PILOTT NË DISTANCË PËR STS-02

1. Provimi i njohurive teorike

Provimi do të përcaktohet në përputhje me pikën 1, të shtojcës A, të kapitullit I.



2. Trajnimi dhe vlerësimi i aftësive praktike

Përveç zonave të përcaktuara në pikën A.2, të shtojcës A, të kapitullit I, do të mbulohen edhe fushat e mëposhtme:

Tabela 1: Tema shtesë dhe fusha për t'u mbuluar gjatë trajnimit të aftësive praktike dhe vlerësimit për STS-02

Lënda	Fushat që duhet të mbulohen
a) BVLOS operacionet e kryera nën STS-02	i. Veprimet para fluturimit - planifikimi i operimit, konsideratat e hapësirës ajrore dhe vlerësimi i rrezikut të vendndodhjes. Pikat e mëposhtme duhet të përfshijnë: A) skanimin e hapësirës ajrore, B) operimet me vëzhguesit e hapësirës ajrore (AO): vendosja adekuate e AO-ve dhe një skemë dekonflikti që përfshin frazeologjinë, koordinimin dhe mjetet e komunikimit; (A) ii. Procedurat gjatë fluturimit, të përcaktuara në pikën 2(b)(ii), të shtojcës A, të kapitullit I, do të kryhen si në VLOS ashtu edhe në BVLOS.

SHTOJCA 2 DEKLARIMI OPERACIONAL

Logo	Deklarim operacional		
Mbrojtja e të dhënave: të dhënat personale të përfshira në këtë deklaratë përpunohen nga autoriteti kompetent në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla (referenca). Informacioni do të përpunohet për qëllime të performancës, menaxhimit dhe ndjekjes së aktiviteteve të mbikëqyrjes sipas urdhrit (referenca), “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”. Nëse keni nevojë për informacione të mëtejshme në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale ose dëshironi të ushtroni të drejtat tuaja (p.sh. të aksesoni ose korrigjoni ndonjë të dhënë të pasaktë ose të paplotë), ju lutemi referojuni pikës së kontaktit të autoritetit kompetent. Aplikanti ka të drejtë të bëjë ankesë për përpunimin e të dhënave personale në çdo kohë pranë Autoritetit Mbikëqyrës Kombëtar të Mbrojtjes së të Dhënave.			
Nr. i regjistrimit të operatorit UAS			
Emri i operatorit UAS			
Prodhuesi UAS			
Modeli UAS			
Numri serial UAS			
Unë deklaroj se: - jam në përputhje me parashikimet e (referenca) të urdhrit “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”, dhe me STS.x; dhe - mbulimi i siguracionit do të jetë për çdo fluturim të kryer nën deklaram, nëse kërkohet nga ligji i zbatueshëm.			
Date		Nënshkrimi ose verifikim tjetër	



SHTOJCA 3

KËRKESA SHITESË PËR SUBJEKTET E
NJOHURA NGA AUTORITETI
KOMPETENT (AAC) DHE OPERATORËT
E UAS-së QË KRYEJNË TRAJNIME
PRAKTIKE TË AFTËSIVE DHE
VLERËSIMIN E PILOTËVE NË DISTANCË
PËR OPERIMET E MBULUARA NGA STS-ja

Një subjekt që synon të njihet nga autoriteti kompetent, për kryerjen e trajnimeve praktike të aftësive dhe vlerësimit të pilotëve në distancë për një STS, duhet t'i deklarojë autoritetit kompetent pajtueshmërinë me kërkesat e mëposhtme duke përdorur formularin e deklaratës në shtojcën 6.

Një operator UAS-je që synon të kryejë trajnime praktike të aftësive dhe vlerësim të pilotëve në distancë për një STS, përveç paraqitjes së deklaratës operationale për atë STS, duhet t'i deklarojë autoritetit kompetent pajtueshmërinë me kërkesat e mëposhtme, duke përdorur formularin e deklaratës në shtojcën 4.

Nëse autoriteti kompetent i një shteti anëtar të ZPEA-së ose operatori i UAS-së synon të kryejë trajnime praktike të aftësive dhe vlerësim të pilotëve në distancë për një STS në Shqipëri, kur Shqipëria nuk është shteti i regjistrimit, një kopje e formularit të deklaratës në shtojcën 4 duhet t'i dorëzohet AAC-së, si autoriteti kompetent i shtetit ku kryhet trajnimi.

Nëse një subjekt i njohur nga autoriteti kompetent i një shteti anëtar të ZPEA-së synon të kryejë trajnime praktike të aftësive dhe vlerësim të pilotëve në distancë për një STS në Shqipëri, kur Shqipëria nuk është shteti i njohjes, një dëshmi e njohjes duhet t'i dorëzohet AAC-së, si autoriteti kompetent i shtetit ku zhvillohet trajnimi.

1. Subjekti i njohur nga autoriteti kompetent ose operatori i UAS-së duhet të sigurojë një ndarje të qartë midis aktiviteteve të trajnimit dhe çdo aktiviteti tjetër operacional për të garantuar pavarësinë e vlerësimit.

2. Subjekti i njohur nga autoriteti kompetent ose operatori i UAS-së do të ketë aftësinë për të kryer në mënyrë adekuate aktivitetet teknike dhe administrative të lidhura me të gjithë procesin e detyrës, duke përfshirë përshtatshmërinë e personelit dhe përdorimin e objekteve dhe pajisjeve të përshtatshme për detyrën.

3. Subjekti i njohur nga autoriteti kompetent ose operatori i UAS-së do të ketë një menaxher të përgjegjshëm, me përgjegjësinë për të siguruar që të gjitha detyrat të kryhen në përputhje me informacionin dhe procedurat e përcaktuara në pikën 8.

4. Personeli përgjegjës për trajnimin e aftësive praktike dhe detyrat e vlerësimit të aftësive praktike duhet:

a) të ketë kompetencën për të kryer këto detyra;

b) të jetë i paanshëm dhe të mos marrë pjesë në vlerësime nëse mendojnë se objektiviteti i tyre mund të ndikohet;

c) të ketë njohuri të shëndosha teorike dhe përvojë trajnimi për aftësi praktike, dhe njohuri të kënaqshme të kërkesave për detyrat e vlerësimit të aftësive praktike që kryejnë, si dhe përvojën e duhur të proceseve të tilla;

d) të ketë aftësinë për të administruar deklaratat, të dhënat dhe raportet që tregojnë se janë kryer vlerësimet përkatëse të aftësive praktike dhe për të nxjerrë përfundimet e këtyre vlerësimeve të aftësive praktike; dhe

e) të mos zbulojë asnjë informacion të dhënë nga operatori ose piloti në distancë ndonjë personi tjetër, përveç autoritetit kompetent me kërkesën e tyre.

5. Trajnimi dhe vlerësimi do të mbulojnë aftësitë praktike që korrespondojnë me STS-të për të cilat është bërë deklarata, të përfshira në shtojcën A të kapitullit përkatës.

6. Vendndodhja(et) e trajnimit të aftësive praktike dhe vlerësimit do të kryhet në një mjedis që përfaqëson kushtet e STS-ve.

7. Vlerësimi i aftësive praktike do të përbëhet nga një vlerësim i vazhdueshëm i pilotit student në distancë.

8. Subjekti i njohur nga autoriteti kompetent ose operatori i UAS-së do të prodhojë një raport vlerësimi pas përfundimit të vlerësimit të aftësive praktike, i cili:

a) përfshin të paktën:

i. detajet e identifikimit të pilotit student në distancë;

ii. identitetin e personit përgjegjës për vlerësimin e aftësive praktike;

iii. identifikimin e STS-ë për të cilën është kryer vlerësimi praktik i aftësive;



iv. notat e performancës për çdo veprim të kryer nga piloti student në distancë;

v. një vlerësim të përgjithshëm të aftësive praktike të kompetencave të pilotit student në distancë; dhe

vi. komentet praktike të vlerësimit të aftësive që ofrojnë udhëzime për fushat për përmirësim, aty ku është e aplikueshme;

b) të nënshkruhet dhe datohet siç duhet nga personi përgjegjës për vlerësimin e aftësive praktike pasi të jetë përfunduar; dhe

c) të regjistrohët dhe të vihet në dispozicion për inspektim nga autoriteti kompetent sipas kërkesës.

9. Një akreditim i përfundimit të trajnimit të aftësive praktike për STS-të do t'i dorëzohet pilotit student në distancë nga subjekti i njohur nga autoriteti kompetent ose operatori i UAS-së, nëse raporti i vlerësimit arrin në përfundimin se piloti student ka arritur një nivel të kënaqshëm të aftësive praktike.

10. Lëshimi i akreditimit për plotësimin e pikës 9 do t'i njoftohet autoritetit kompetent të shtetit ku kryhet trajnimi dhe vlerësimi i aftësive praktike, duke përfshirë të dhënat e identifikimit të pilotit student në distancë, STS-në e mbuluar,

datën e lëshimit dhe detajet e identifikimit të subjektit të njohur nga autoriteti kompetent ose operatori UAS që e lëshon atë.

11. Subjekti i njohur nga autoriteti kompetent ose operatori i UAS-së do të përfshijë në manualin e operimit, të zhvilluar në përputhje me shtojcën 5, një seksion të veçantë që mbulon elementet e trajnimit, duke përfshirë sa vijon:

a) personelin e emëruar që kryen trajnime dhe vlerësime praktike të aftësive, duke përfshirë:

i. përshkrimet e kompetencës së personelit përkatës;

ii. detyrat dhe përgjegjësitë e personelit; dhe

iii. një grafik të organizatës që tregon zinxhirët e lidhur të përgjegjësisë;

b) procedurat dhe proceset e përdorura për trajnimin dhe vlerësimin e aftësive praktike, duke përfshirë plan programin e trajnimit që mbulon aftësitë praktike që korrespondojnë me STS-në për të cilën është bërë deklarata, të përcaktuara në shtojcën A të kapitullit përkatës;

c) një përshkrim të UAS-së dhe çdo pajisjeje, mjeti dhe mjedisi tjetër të përdorur për trajnimin dhe vlerësimin e aftësive praktike; dhe

d) një model për raportin e vlerësimit.

SHTOJCA 4

DEKLARATA E OPERATORËVE UAS QË SYNOJNË TË OFROJNË TRAJNIME PRAKTIKE TË AFTËSIVE DHE VLERËSIM TË PILOTËVE NË DISTANCË NË STS-x

Logo	STS-x
	Deklarata e operatorëve UAS që synojnë të ofrojnë trajnime praktike të aftësive dhe vlerësim të pilotëve në distancë
Mbrojtja e të dhënave: Të dhënat personale të përfshira në këtë deklaratë përpunohen nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla (referenca). Informacioni do të përpunohet për qëllime të performancës, menaxhimit dhe ndjekjes së aktiviteteve të mbikëqyrjes sipas urdhrit (referenca) “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”. Nëse keni nevojë për informacione të mëtejshme në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale ose dëshironi të ushtroni të drejtat tuaja (p.sh. të aksesoni ose korrigjoni ndonjë të dhënë të pasaktë ose të paplotë), ju lutemi referojuni pikës së kontaktit të autoritetit kompetent. Aplikanti ka të drejtë të bëjë ankesë për përpunimin e të dhënave personale në çdo kohë pranë Autoritetit Mbikëqyrës Kombëtar të Mbrojtjes së të Dhënave.	
Numri i regjistrimit të operatorit UAS	
Emri i operatorit UAS	
Nëpërmjet këtij dokumenti, deklaroj se: - kam dorëzuar deklaratën operacionale për STS-x;	



- jam në përputhje me parashikimet e shtojcës 3, të aneksit të urdhrit (referenca) “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”; dhe
- gjatë operimit të UAS-së për aktivitete trajnimi për STS.x, jam në përputhje me parashikimet e (referenca) e urdhrit “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”, përfshirë kërkesat për operate nën STS.x

Data		Nënshkrimi ose verifikimi tjetër	
------	--	-------------------------------------	--

SHTOJCA 5 MANUALI I OPERIMEVE PËR SKENARIN STANDARD

Manuali i operimit për STS-në, i përcaktuar në shtojcën 1, duhet të përmbajë të paktën sa vijon:

1. Një deklaratë që manuali i operateve përputhet me kërkesat përkatëse të kësaj rregulloreje dhe me deklaratën, dhe përmban udhëzime që duhet të respektohen nga personeli i përfshirë në operacionet e fluturimit;

2. Një nënshkrim miratimi nga menaxheri përgjegjës ose operatori i UAS-së në rastin e një personi fizik;

3. Një përshkrim të përgjithshëm të organizatës së operatorit UAS;

4. Një përshkrim të konceptit të operimit, duke përfshirë të paktën:

a) natyrën dhe përshkrimin e aktiviteteve të kryera në operacionet e UAS, dhe rreziqet e identifikuara shoqëruese;

b) mjedisin operacional dhe zonën gjeografike për operimet e synuara, duke përfshirë:

i. karakteristikat e zonës që do të mbi-fluturohet për sa i përket dendësisë së popullsisë, topografisë, pengesave etj.;

ii. karakteristikat e hapësirës ajrore që do të përdoret;

iii. kushtet mjedisore duke përfshirë të paktën motin dhe mjedisin elektromagnetik;

iv. përcaktimin e volumit operacional dhe bafereve të rrezikut për të adresuar rreziqet tokësore dhe ajrore;

c) mjetet teknike të përdorura dhe karakteristikat e tyre kryesore, performancën dhe kufizimet, duke përfshirë UAS-në, sistemet e jashtme që mbështesin funksionimin e UAS-së, objektet, etj.;

d) personelin e nevojshëm për kryerjen e operateve, duke përfshirë përbërjen e ekipit, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, kriteret e

përzgjedhjes, trajnimit fillestar dhe kërkesat e përvojës së fundit dhe/ose trajnimit të përsëritur;

5. Udhëzimet e mirëmbajtjes që kërkojnë për të mbajtur UAS-në në një gjendje të sigurt, duke mbuluar udhëzimet dhe kërkesat e prodhuesit të mirëmbajtjes së UAS-së, nëse është e aplikueshme;

6. Procedurat operationale, të cilat do të bazohen në udhëzimet e prodhuesit të dhëna nga prodhuesi UAS, dhe do të përfshijnë:

a) do të marrin parasysh sa vijon për të minimizuar gabimet njerëzore:

i. një shpërndarje dhe caktim të qartë të detyrave; dhe

ii. një listë kontrolli të brendshme për të kontrolluar nëse stafi po kryen detyrat e caktuara në mënyrë adekuate;

b) konsiderimi i përkeqësimit të sistemeve të jashtme që mbështesin funksionimin e UAS-së;

c) procedurat normale, duke përfshirë të paktën:

i. përgatitjet para fluturimit dhe listat kontrolluese, që mbulojnë:

A) vlerësimin e vëllimit operacional dhe mbrojtëseve të lidhura me to (baferi i rrezikut në tokë dhe mbrojtësi i rrezikut ajror kur është i aplikueshëm), duke përfshirë terrenin dhe pengesat e mundshme që mund të zvogëlojnë aftësinë për të mbajtur avionin pa pilot në vijën vizuale të shikimit ose për të skanuar hapësirën ajrore, mbi fluturimin e mundshëm të personave që nuk janë të përfshirë dhe mbi fluturimin e mundshëm të infrastrukturës kritike;

B) vlerësimin e mjedisit dhe hapësirës ajrore përreth, duke përfshirë afërsinë e zonave gjeografike të UAS-së dhe aktivitetet e mundshme nga përdoruesit e tjerë të hapësirës ajrore;

C) kushtet mjedisore të përshtatshme për kryerjen e operimit të UAS-së;

D) numrin minimal të personelit të ngarkuar me detyrat thelbësore për operimin e UAS-së, të



cilëve u kërkohet të kryejnë operacionin, dhe përgjegjësitë e tyre;

E) procedurat e nevojshme të komunikimit ndërmjet pilotit(ëve) në distancë dhe çdo personeli tjetër të ngarkuar me detyrat thelbësore për funksionimin e UAS-së dhe me çdo palë të jashtme, kur është e nevojshme;

F) pajtueshmërinë me çdo kërkesë specifike nga autoritetet përkatëse në zonën e synuar të operimit, duke përfshirë ato që lidhen me sigurinë, privatësinë, të dhënat dhe mbrojtjen e mjedisit, dhe përdorimin e spektrit RF;

G) zbutjen e rrezikut të nevojshëm për të siguruar kryerjen e sigurt të operacionit; në veçanti, për zonën e kontrolluar të tokës:

a) përcaktimi i sipërfaqes së kontrolluar të tokës; dhe

b) sigurimin e zonës së kontrolluar tokësore për të parandaluar hyrjen e palëve të treta në zonë gjatë operacionit dhe sigurimin e koordinimit me autoritetet lokale, kur është e nevojshme;

H) procedurat për të verifikuar që UAS-ja është në një gjendje të përshtatshme për të kryer në mënyrë të sigurt operacionin e synuar;

ii. procedurat e nisjes dhe rikuperimit;

iii. procedurat gjatë fluturimit, duke përfshirë ato për të siguruar që avioni pa pilot të mbetet brenda gjeografisë së fluturimit;

iv. procedurat pas fluturimit, duke përfshirë inspektimet për të verifikuar gjendjen e UAS-së;

v. procedurat për zbulimin e avionëve potencialisht konfliktual nga piloti në distancë dhe, kur kërkohet nga operatori UAS, nga vëzhguesit e hapësirës ajrore ose vëzhguesit e avionëve pa pilot, sipas rastit;

d) procedurat e emergjencës, duke përfshirë të paktën:

i. procedurat për të përballuar avionin pa pilot që largohet nga “gjeografia e fluturimit” e caktuar;

ii. procedurat për të përballuar personat që nuk janë të përfshirë në hyrjen në zonën e kontrolluar të tokës;

iii. procedurat për përballimin e kushteve të pafavorshme të funksionimit;

iv. procedurat për të përballuar përkeqësimin e sistemeve të jashtme që mbështesin funksionimin;

v. nëse janë të punësuar vëzhgues të hapësirës ajrore, frazeologjia që do të përdoret;

vi. procedurat e shmangies së konfliktit me përdoruesit e tjerë të hapësirës ajrore;

e) procedurat e urgjencës për të përballuar situatat emergjente, duke përfshirë të paktën:

i. procedurat për të shmangur, ose të paktën minimizuar, dëmtimin e palëve të treta në ajër ose në tokë;

ii. procedurat për të përballuar avionin pa pilot që largohet nga vëllimi ‘operativ’;

iii. procedurat për rikuperimin emergjent të avionit pa pilot;

f) procedurat e sigurisë siç referohen në pikën (1)(a)(ii) dhe (iii) të pikës UAS.SPEC.050;

g) procedurat për mbrojtjen e të dhënave personale të referuara në pikën (1)(a)(iv) të pikës UAS.SPEC.050;

h) udhëzimet për të minimizuar shqetësimin dhe ndikimin mjedisor të përmendur në pikën (1)(a)(v) të pikës UAS.SPEC.050;

i) procedurat e raportimit të ngjarjeve;

j) procedurat e mbajtjes së shënimeve; dhe

k) politika që përcakton se si piloti(ët) në distancë dhe çdo personel tjetër i ngarkuar me detyrat thelbësore për funksionimin e UAS-ve mund të deklarohen të aftë për të operuar përpara se të kryejnë ndonjë operacion.



SHTOJCA 6

DEKLARATA E SUBJEKTTIT QË SYNON TË NJIHET NGA AUTORITETI KOMPETENT
PËR TË OFRUAR TRAJNIME TË AFTËSIVE PRAKTIKE DHE VLERËSIMIN E PILOTËVE
NË DISTANCË NË STS-x

Logo	STS-x Deklarata e subjektit që synon të njihet nga autoriteti kompetent për të ofruar trajnime të aftësive praktike dhe vlerësimin e pilotëve në distancë
Mbrojtja e të dhënave: Të dhënat personale të përfshira në këtë deklaratë përpunohen nga autoriteti kompetent në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla (referenca). Informacioni do të përpunohet për qëllime të performancës, menaxhimit dhe ndjekjes së aktiviteteve të mbikëqyrjes sipas Urdhrit (referenca) “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”. Nëse keni nevojë për informacione të mëtejshme në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale ose dëshironi të ushtroni të drejtat tuaja (p.sh. të aksesoni ose korrigjoni ndonjë të dhënë të pasaktë ose të paplotë), ju lutemi referojuni pikës së kontaktit të autoritetit kompetent. Aplikanti ka të drejtë të bëjë ankesë për përpunimin e të dhënave personale në çdo kohë pranë Autoritetit Mbikëqyrës Kombëtar të Mbrojtjes së të Dhënave.	
Identifikimi i subjektit	
Emër mbiemër, nr. telefoni dhe adresa e <i>email</i> -it të personit përgjegjës	
Nëpërmjet këtij dokumenti, deklaroj se: -jam në përputhje me parashikimet e shtojcës ,3 të aneksit të urdhrit (referenca) “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”; dhe -gjatë operimi të UAS-së për aktivitete trajnime për STS.x, jam në përputhje me parashikimet e urdhrit (referenca) “Për miratimin e rregullores mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilotë”, përfshirë kërkesat për operime nën STS.x	
Data	Nënshkrimi ose verifikim tjetër

URDHËR

Nr. 157, datë 1.8.2022

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR
MINERAR 2022**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 6, germa “c” dhe nenit 8, pika 6 të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 380, datë 1.6.2022 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për vitet 2022–2024, në zbatim të strategjisë minerare”, VKM nr. 664, datë 10.10.2019, “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar për vitet 2019–2021” dhe urdhrit të ministrit nr. 306, datë 13.4.2011 “Për procedurat dhe formën e hartimit të planit vjetor minerar”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit vjetor minerar për vitin 2022, sipas propozimeve të strukturave përgjegjëse AKBN (shkresa nr. 4669/2 prot., datë 15.07.2022) dhe SHGJSH (shkresa nr. 4669/1 prot., datë 17.6.2022).

2. Zonat minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare, nëpërmjet procesit të konkurrimit apo procedurave të hapura, janë të përcaktuara në aneksin 1 dhe aneksin 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi të nesërmen e botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku



ANEKSI 1

Nr.	Nr. Zonës	Bashkia	Qarku	TË DHËNA PËR VENDBURIMIN										KOORDINATAT E ZONËS		
				Vendburimi	Minerali	Rezerva gjeologjike ton/m ³	Cilësia	Lloji i veprimtarisë minerare	Lloji i Zonës Minerare	Sipërfaqja minimale km ²	Prodhimi minimal t/m ³	Investimi minimal /000 euro	Sipërfaqja km ²	Pika	Y (Lindje)	X (Veri)
1	22/6	Ersekë	Korçë	Pepellash	Gëlqeror Bllakor	1,900,000	CaO 53.55%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.317	1	4475530	4482885
														2	4475030	4483165
														3	4475330	4483275
														4	4475505	4483410
														5	4475730	4483494
														6	4475875	4483487
														7	4476053	4483249
2	22/5	Voskopojë	Korçë	Voskopojë	Gëlqeror Dekorativ	1,110,000	CaO 52%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.914	1	4466445	4500333
														2	4466850	4500994
														3	4467372	4500765
														4	4467503	4500127
														5	4467412	4499884
														6	4466877	4499651
3	22/7	Fier	Fier	Grykë Topojë	Argjilë	343,600	Al ₂ O ₃ 10-13%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.086	1	4366164	4519071
														2	4366461	4518830
														3	4365881	4518722
4	22/8	Mirditë	Lezhë	Xhuxha	Gur Gëlqeror	325,000	CaO 53%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.026	1	4434965	4646771
														2	4435087	4646653
														3	4435061	4646514
														4	4434983	4646497
														5	4434945	4646497
5	22/9	Cërrik	Elbasan	Topoian	Gëlqeror i Mermerizuar	1,464,212	CaO 54-56%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.357	1	4418915	4529950
														2	4418580	4530800
														3	4418970	4530880
														4	4419050	4530555
														5	4419170	4530420
														6	4419340	4530300
														7	4419330	4530145
6	22/14	Shijak	Durrës	Hardhishte	Zhurë	120,000	CaO 31%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.040	1	4382458	4574537
														2	4382160	4574750
														3	4382290	4574838
														4	4382519	4574587
7	22/13	Skrapar	Berat	Muzhëncë	Ranor Pllakor	2,600,000	SiO ₂ 65.79%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.279	1	4440540	4475640
														2	4440645	4476275
														3	4441195	4476065
														4	4441140	4475745
8	22/16	Durrës	Durrës	Manskuri	Argjilë	1,800,000	Al ₂ O ₃ 10-13%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.061	1	4378993	4574334
														2	4378920	4574617
														3	4379315	4574654



														4	4379317	4574563
														5	4379147	4574509
9	22/17	Dibër	Dibër	Dibër	Krom	10,000	Cr2O3 32-36%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	60	0.331	1	4438360	4605970
														2	4437540	4606045
														3	4437660	4606460
														4	4438600	4606250
10	22/21	Kukës	Tropojë	Çorraj	Krom	8,960	Cr2O3 31-32%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	60	0.211	1	4434866	4681693
														2	4435438	4681447
														3	4435172	4681181
														4	4434622	4681435
11	22/22	Kolonjë	Korçë	Vrepejë	Gur Gëlqeror	635,833	CaO 51%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.260	1	4450927	4465441
														2	4450928	4465609
														3	4450524	4465852
														4	4450028	4465602
														5	4450027	4465560
														6	4450377	4465392
12	22/24	Prrenjas	Elbasan	Sravaj	Gur Gëlqeror	1,110,000	CaO 55%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.962	1	4452128	4540364
														2	4452473	4540896
														3	4453001	4541018
														4	4453550	4540758
														5	4453101	4539860
13	22/25	Kolonjë	Korçë	Kaltanji	Gur Gëlqeror	1,110,000	CaO 52%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.899	1	4459369	4477008
														2	4459830	4477153
														3	4460887	4475977
														4	4460200	4475717
14	22/26	Lezhë	Lezhë	Përroi i Mullirit	(Gebro) Gur Dekorativ	1,100,000	CaO 52%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.119	1	4400000	4644110
														2	4399984	4644214
														3	4400190	4644240
														4	4400240	4644270
														5	4400370	4644364
														6	4400500	4644225
														7	4400360	4644060
														8	4400362	4643895
														9	4400280	4643900
														10	4400250	4643950
														11	4400180	4644030
														12	4400110	4644020
15	22/27	Pukë	Shkodër	Kacilingu	Gur Gëlqeror	750,000	CaO 54%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.069	1	4403315	4660431
														2	4403040	4660412
														3	4402989	4660508
														4	4403118	4660622
														5	4403208	4660765
														6	4403296	4660651



16	22/34	Librazhd	Elbasan	Guri Sukullit	Gur Dekorativ	900,000	CaO 51%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.854	1	4447756	4553803
														2	4448256	4554528
														3	4448683	4554452
														4	4449048	4553903
														5	4448652	4553397
17	22/36	Skrapar	Berat	Polena	Ranor	1,100,000	SiO2 54%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.100	1	4439345	4483757
														2	4439336	4483635
														3	4439446	4483407
														4	4439343	4483250
														5	4439152	4483388
18	22/38	Skrapar	Berat	Malindi	Ranor	1,000,000	SiO2 54%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.100	6	4439176	4483779
														1	4441716	4473246
														2	4441787	4473201
														3	4441473	4472496
														4	4441460	4472448
19	22/40	Has	Kukës	Golaj	Bakër	283,536	Cu 0.62%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	300	0.133	5	4441432	4472378
														6	4441312	4472478
														1	4448270	4677520
														2	4448532	4677732
														3	4448392	4677732
20	22/41	Has	Kukës	Nikoliq 1	Bakër	159,652	Cu 1.54%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	300	0.615	4	4448392	4677852
														5	4448538	4677852
														6	4448538	4677874
														7	4448415	4677957
														8	4448131	4678097
21	22/42	Has	Kukës	Nikoliq 2	Bakër	152,509	Cu 1.20%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	300	0.651	9	4448091	4677867
														1	4450435	4679702
														2	4450421	4680294
														3	4451420	4680402
														4	4451346	4679702
22	22/45	Devoll	Korçë	Bilisht	Gëlqeror Bllakor	277,700	CaO 54.14%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.173	1	4451439	4677088
														2	4451439	4677328
														3	4452485	4678102
														4	4452860	4677895
														5	4453196	4677925
														6	4453086	4677744
														1	4500120	4502285
														2	4500352	4502685
														3	4500250	4502985
														4	4500510	4503150
														5	4500710	4503150
														6	4500450	4502985
														7	4500552	4502685



														8	4500320	4502285
23	22/47	Skrapar	Berat	Mollas	Ranor Silicor Pllakor	800,000	SiO2 55-65%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.056	1	4435588	4488173
														2	4435539	4488111
														3	4435563	4488048
														4	4435539	4487988
														5	4435397	4487958
														6	4435396	4487835
														7	4435278	4487866
														8	4435297	4487919
														9	4435280	4487960
														10	4435352	4488144
24	22/49	Pogradec	Korçë	Çërravë	Gur Gëlqeror	3,200,000	CaO 54.11%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.074	1	4478937	4523900
														2	4479080	4523920
														3	4479121	4523994
														4	4478951	4524234
														5	4478769	4524066
														6	4478811	4523906
														7	4478880	4523858
25	22/53	Klos	Dibër	Guri i Bardhë	Gur Gëlqeror	1,100,000	CaO 51%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.163	1	4423596	4593349
														2	4423673	4593477
														3	4423900	4593427
														4	4423980	4593557
														5	4424232	4593353
														6	4424296	4593222
														7	4424156	4593181
														8	4424092	4593108
														9	4423884	4593100
														10	4423870	4593255
26	22/54	Skrapar	Berat	Radesh	Ranor Bllokor	110,000	SiO2 63%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.280	1	4437380	4490380
														2	4436890	4490910
														3	4436915	4491165
														4	4437410	4491025
														5	4437340	4490740
														6	4437605	4490895
														7	4437525	4490705
														8	4437465	4490350
27	22/55	Tiranë	Tiranë	Herraj	Brekçie Shpati	800,000	CaO 53.19%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	10,000	150	0.023	1	4403682	4588740
														2	4403589	4589017
														3	4403630	4589037
														4	4403714	4588921
														5	4403761	4588763
28	22/60	Lezhë	Lezhë	Tresh	Gëlqeror Dekorativ	500,000	CaO 52%	Shfrytëzimi	Konkurruese	0.02	1,000	200	0.098	1	4391718	4626069
														2	4391870	4626007



														3	4391910	4625873
														4	4391818	4625784
														5	4391724	4625710
														6	4391620	4625676
														7	4391473	4625819
29	22/61	Delvinë	Vlorë	Vergo	Gëlqeror Pllakor	4,000,000	CaO 54%	Shfrytëzimi	Konkurrese	0.02	1,000	200	0.050	1	4415652	4431507
														2	4415736	4431410
														3	4415679	4431373
														4	4415645	4431341
														5	4415623	4431311
														6	4415616	4431274
														7	4415606	4431263
														8	4415559	4431222
														9	4415554	4431219
														10	4415552	4431217
														11	4415545	4431206
														12	4415543	4431203
														13	4415542	4431198
														14	4415464	4431178
														15	4415456	4431238
														16	4415453	4431250
														17	4415449	4431288
														18	4415455	4431354
														19	4415470	4431385
														20	4415522	4431435
														21	4415562	4431476
30	22/62	Dimal	Berat	Pashalli	Gur Gëlqeror	1,230,000	CaO 53%	Shfrytëzimi	Konkurrese	0.02	10,000	150	0.259	1	4402673	4514005
														2	4402669	4514222
														3	4402657	4514421
														4	4402768	4514884
														5	4402915	4514642
														6	4403012	4514232
														7	4403022	4513871
														8	4402829	4513866
31	34/5	Himarë-Sarandë	Vlorë	Lasar	Gur Gëlqeror	2,150,000	53% CaO	Shfrytëzim	Konkurrese	0.02	10,000	150	0.1	1	4413820	4420355
														2	4413510	4420725
														3	4413685	4420865
														4	4413960	4420500
32	214/1	Krujë	Durrës	Burizana 6	Gur Gëlqeror	1,950,000	53.5% CaO	Shfrytëzim	Konkurrese	0.02	10,000	150	0.335	1	4394215	4601330
														2	4394285	4600980
														3	4395200	4601160
														4	4395130	4601515
33	421/4	Mallakastër	Fier	Përroi i Thatë	Gur Gëlqeror	1,430,000	55% CaO	Shfrytëzim	Konkurrese	0.02	10,000	150	0.023	1	4395686	4486823



				Vorba										2	4395757	4486793
														3	4395917	4486799
														4	4395937	4486696
														5	4395805	4486691
														6	4395713	4486715
34	22/31	Elbasan	Elbasan	Gjorma	Gur Gëlqeror	5,500,000	CaO 52%	Shfrytëzimi	Konkurrese	0.02	10,000	150	1.504	1	4417092	4562875
														2	4417148	4563357
														3	4417916	4563358
														4	4419249	4562000
														5	4418249	4562000
35	270/5	Selenicë	Vlorë	Brataj	Ranor Silicor, Masiv	950,000	53% SiO ₂	Shfrytëzim	Konkurrese	0.02	1,000	200	0.24	1	4384360	4459730
														2	4384705	4460255
														3	4385040	4460030
														4	4384720	4459555
36	421/3	Mallakastër	Fier	Përroi i Thatë Shesa	Gur Gëlqeror	850,000	51% CaO	Shfrytëzim	Konkurrese	0.02	1,000	150	0.052	1	4396130	4486750
														2	4396146	4486913
														3	4396385	4487043
														4	4396470	4486878

ANEKSI 2

Nr.	Nr. Zonës	Bashkia	Qarku	TË DHËNA PËR VENDBURIMIN								KORDINATAT E ZONËS		
				Emri i Vendburimit	Lloji i Mineralit	Rezerva Gjeologjike, ton/m ³	Cilësia në %	Lloji i Veprimtarisë Minerare	Lloji i Zonës Minerare	Investimi Minimal /000/Euro/km ²	Sipërfaqja e Zonës (në km ²)	Pika	Y (Lindje)	X (Veri)
1	713/3	Shkodër	Pukë	Vrith-Përroi Magjarit	Krom	-	-	Kërkim-Zbulimi	Konkurrese	20	1.100	1	4403963	4647467
												2	4403400	4647467
												3	4403000	4648500
												4	4403000	4649151
												5	4403250	4649151
												6	4403250	4648500
												7	4404200	4648500
												8	4404200	4647870
												9	4403963	4647870
2	615/2	Kukës	Tropojë	Rragam	Krom	-	27 - 41 % Cr ₂ O ₃	Kërkim-Zbulimi	Konkurrese	20	1.500	1	4429172	4691842
												2	4429561	4692017
												3	4430264	4692017
												4	4430264	4693141
												5	4429230	4693141
												6	4429230	4692867
												7	4428675	4692867
3	644/3	Kukës	Tropojë	Vlad	Krom	-	35 % Cr ₂ O ₃	Kërkim-Zbulimi	Konkurrese	20	1.972	1	4433159	4687494



												2	4431990	4687494
												3	4431992	4687792
												4	4431896	4687792
												5	4431896	4689078
												6	4433159	4689078
4	625/3	Kukës	Tropojë	Lugu i Çorrajë	Krom	-	-	Kërkim-Zbulimi	Konkuruese	20	1.995	1	4435300	4683218
												2	4435570	4683330
												3	4435671	4683242
												4	4435698	4683280
												5	4435611	4683358
												6	4435843	4683462
												7	4435843	4683973
												8	4436106	4683973
												9	4437062	4683514
												10	4436796	4682238
												11	4435956	4682238
5	715/2	Kukës	Has	Shpati i Zgjeçit	Krom	-	-	Kërkim-Zbulimi	Konkuruese	20	1.004	1	4445000	4684113
												2	4445000	4683150
												3	4444189	4683150
												4	4444189	4684500
												5	4444531	4684500
6	579/3	Dibër	Dibër	Kreja Veriore	Krom	-	-	Kërkim-Zbulimi	Konkuruese	20	1.850	1	4432385	4633534
												2	4433384	4634620
												3	4434650	4634620
												4	4434584	4633748
												5	4433315	4633611
												6	4433218	4633356
												7	4432672	4633158
												8	4432632	4633558
7	634/2	Kukës	Has	Qafa e Gurit	Krom	-	-	Kërkim-Zbulimi	Konkuruese	20	2.110	1	4449319	4680773
												2	4448274	4680250
												3	4447202	4681525
												4	4448146	4682289
8	3/5	Shkodër	Fushë Arrëz	Iballë	Litium-Toka të rralla	-	-	Kërkim-Zbulimi	Konkuruese	20	1.500	1	4413780	4677500
												2	4412807	4679132
												3	4413507	4679518
												4	4414460	4677902
9	3/8	Dibër	Bulqizë	Ostren	Litium-Toka të rralla	-	-	Kërkim-Zbulimi	Konkuruese	20	1.342	1	4454507	4590228
												2	4454730	4590750
												3	4454690	4591080
												4	4454830	4591370
												5	4454571	4592373
												6	4455228	4592458



												7	4455394	4591444
												8	4455187	4590228
												1	4444219	4557951
												2	4444559	4558284
												3	4445288	4556660
												4	4445426	4556121
												5	4445694	4555999
												6	4446600	4556012
												7	4446584	4555894
												8	4445978	4555829
												9	4445416	4555656
												10	4444943	4556383
												11	4445114	4556551
												12	4444492	4557564
												13	4444399	4557555

**URDHËR****Nr. 223, datë 26.7.2022****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 90, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike falas z. Ergys Qirici, te drejtori i Drejtorisë së Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Lefkothea Lite, për periudhën 1 gusht 2022 deri më 10 gusht 2022.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit do të ushtrohen përgjatë periudhës së pamundësisë së ardhjes në punë të drejtorit të përgjithshëm, si rezultat i kryerjes së lejes vjetore.

3. Në kompetencat e deleguara nuk përfshihen kompetencat e nëpunësit autorizues të institucionit për veprimet pranë Degës së Thesarit Tiranë.

4. Ngarkohet znj. Lefkothea Lite për zbatimin e këtij urdhri, Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri, si dhe të gjithë punonjësit për zbatim.

Ky urdhër hyn në fuqi më datë 1.8.2022 dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ergys Qirici

URDHËR**Nr. 391, datë 1.8.2022****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave

Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 2.8.2022–14.8.2022, zëvendësministrit të Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri i ministrit të Drejtësisë nr. 388, datë 29.7.2022, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR**Nr. 392, datë 1.8.2022****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 15.8.2022–20.8.2022, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajdi Karameta.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajdi Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

**URDHËR****Nr. 437, datë 20.7.2022****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË RREGULLOREN PËR
ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E
PRAKTIKAVE PROFESIONALE PËR
PROFESIONIN E RREGULLUAR TË
MËSUESIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 26 dhe 57, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave në rregulloren bashkëlidhur urdhrit nr. 100, datë 25.2.2022, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

**DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË
RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN DHE
ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE
PROFESIONALE PËR PROFESIONIN E
RREGULLUAR TË MËSUESIT**

1. Pika 1 e nenit 16 ndryshon si vijon:

“1. Kohëzgjatja e praktikës profesionale që kryhet nga praktikanti është një periudhë mësimore”.

2. Shkronja “d”, e nenit 18, ndryshon si vijon:

a) “Projektin kurrikular të nxënësit (1–2 modele)”.

3. Pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 19 ndryshojnë si vijon:

“1. Praktikanti që ka munguar me shumë se 30% të orëve mësimore të kohës së përcaktuar për realizimin e praktikës, përsërit të plotë praktikën profesionale.

2. Praktikantit që ka munguar 20–30% të orëve mësimore të kohës së përcaktuar për realizimin e praktikës, i shtyhet praktika 1 muaj.

3. Praktikanti që ka munguar më pak se 20% të orëve mësimore të kohës së përcaktuar për realizimin e praktikës, i nënshtrohet vlerësimit.”.

4. Në nenin 20 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Për vlerësimin e praktikantëve ngrihet Komisioni i vlerësimit të praktikantëve (në vijim “Komisioni”), me vendim të drejtuesit të ZVAP-së. Komisioni kryesohet nga përgjegjësi i sektorit të monitorimit të kurrikulës dhe i zhvillimit profesional dhe përbëhet nga një specialist i këtij sektori, një specialist jurist, një drejtor IAPP-je dhe një kryetar ekipi lëndor përkatës.”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, si vijon:

“1/1. Brenda një afati 30-ditor nga data e përfundimit të praktikës profesionale nga praktikantët drejtoria e institucionit arsimor, ku praktikantët kanë kryer praktikën dhe ZVAP-ja organizon, realizon dhe përfundon procedurat për vlerësimin e praktikantëve.”.

c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë:

“3. Komisioni vlerëson ‘Dobët’ praktikantin, kur në të paktën një kompetencë ka vlerësimin ‘Dobët’. Në këtë rast, komisioni shtyn afatin e zhvillimit të praktikës profesionale me një muaj. Shtyrja prej një muaji mund të përsëritet deri në tri herë. Praktikanti mund të zhvillojë praktikën profesionale në të njëjtin institucion arsimor.”.



d) Në pikën 4, në fund të fjalisë së dytë, togfjalëshi “në një vit shkollor” zëvendësohet me togfjalëshin “në një periudhë mësimore”.

5. Në shtojcën 2 bëhen ndryshimet si vijon:

a) Në rubrikën “PLOTËSIMI SISTEMATIK I TABELAVE TË KOMPETENCAVE”, kompetenca 4, “muajt”, të zëvendësohen me “periudhë mësimore”.

b) Në rubrikën “PRAKTIKANTI SI MËSUES NDIHMËS”, togfjalëshi “vlerësimin e portofolave të nxënësve” të zëvendësohet me togfjalëshin “vlerësimin e projekteve të nxënësve”.

6. Në shtojcën 3, në treguesin nr. 4, të kompetencës 5, fjala “portofolin” të zëvendësohet me fjalën “projektin”.

7. Në pjesën “Udhëzime” bëhen ndryshimet si vijon:

a) Në treguesin nr. 2, të kompetencës 3, togfjalëshi “gjatë vitit shkollor” të zëvendësohet me togfjalëshin “gjatë periudhës mësimore”;

b) Treguesi nr. 2, i kompetencës 4, ndryshon me këtë përmbajtje:

“Nxënësit punojnë dhe përditësojnë rregullisht projektin e tyre.

Projekti kurrikular shtrihet në një ose më shumë fusha të të nxënësve dhe mund të zhvillohet individualisht ose në grup.”.

VENDIM

Nr. 6, datë 10.6.2022

PËR MIRATIMIN E MARZHEVE NË BAZË TË MONITORIMIT TË ÇMIMEVE PËR PRODUKTET USHQIMORE BAZË DHE PRODUKTET E TJERA TË LIDHURA ME TO, SI PASOJË E SITUATËS SË VEÇANTË TË KRIJUAR NË TREG”

Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Produkteve Ushqimore Bazë dhe Produkteve të Tjera të Lidhura me To, në zbatim të aktit normativ nr. 7, datë 18.3.2022, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”,

VENDOSI:

1. Miratimin e marzheve tavan që do të aplikohen për disa produkte ushqimore bazë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar nga rritja e çmimeve ndërkombëtare. Çdo operator ekonomik i tregtimit të produkteve të mëposhtme, qoftë importues, tregtar me shumicë, transportues apo tregtar me pakicë, është i lirë që të aplikojë marzhe bruto më të ulëta mbi këto produkteve, se ato që rezultojnë nga aplikimi i marzheve tavan të miratuara nga Bordi, duke ofruar çmime shitje në treg më të ulëta se ato që rezultojnë nga aplikimi i këtyre marzheve.

2. Për artikullin oriz kokërrgjatë (1 kg) miratohen marzhet tavan, si më poshtë:

a) Marzhi tavan i tregtimit të shitjes me shumicë të orizit kokërrgjatë është 11 lekë/kg mbi koston e importit plus detyrimet e paguara në doganë. Ky marzh mbulon shpenzimet operative të importuesit dhe ambalazhimit brenda vendit.

b) Marzhi i tregtimit të transportuesit i cili mund të jetë shitësi me shumicë, shitësi me pakicë apo palë të treta, nga magazina e shitësit me shumicë të magazinës e shitësit me pakicë është 2 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur, sipas germës “a” të këtij paragrafi.

c) Marzhi i tregtimit të shitjes në njësitë e tregtimit me pakicë të orizit kokërrgjatë është 3 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur, sipas germës “a” të këtij paragrafi plus transportin, sipas germës “b” të këtij paragrafi.

3. Për artikullin sheqer (1 kg) miratohen marzhet, si më poshtë:

a) Marzhi tavan i tregtimit të shitjes me shumicë të sheqerit nga importuesi dhe ambalazhuesi është 15 lekë/kg (6 lekë/kg për importuesin dhe 9 lekë/kg për ambalazhuesin) mbi koston e importit plus detyrimet e paguara në doganë.

b) Marzhi i tregtimit të transportuesit, i cili mund të jetë shitësi me shumicë, shitësi me pakicë apo palë të treta, nga magazina e shitësit me shumicë të magazinës e shitësit me pakicë është 2 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur, sipas germës “a” të këtij paragrafi.

c) Marzhi i tregtimit të shitjes në njësitë e tregtimit me pakicë të produktit sheqer është 3 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur, sipas germës “a” të këtij paragrafi plus transportin, sipas germës “b” të këtij paragrafi.



4. Për artikullin miell masiv miratohen marzhet tavan, si më poshtë:

a) Marzhi tavan i tregtimit të shitjes me shumicë të miellit nga prodhuesi dhe ambalazhuesi llogaritet, si vijon:

a. Kostos së importit të grurit plus detyrimeve të paguara në doganë i shtohet mbi to 32% kosto e përpunimit dhe ambalazhimit nga grurë në produkt të gatshëm miell; dhe

b. Mbi kostot e llogaritura sipas pikës së mësipërme “i”, shtojmë marzhin e tregtimit 2.5 lekë/kg për tregtarët e shumicës.

b) Marzhi i tregtimit të transportuesit i cili mund të jetë shitësi me shumicë, shitësi me pakicë apo palë të treta, nga magazina e shitësit me shumicë te magazina e shitësit me pakicë është 2.5 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur, sipas germës “a” të këtij paragrafi.

c) Marzhi i tregtimit të shitjes në njësitë e tregtimit me pakicë të produktit miell masiv është 2.5 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur, sipas germës “a” të këtij paragrafi plus transportin, sipas germës “b” të këtij paragrafi.

5. Për artikullin vaj luledielli miratohen marzhet tavan, si më poshtë:

a) Marzhi tavan i tregtimit të shitjes me shumicë të vajit të lulediellit nga importuesi është 35 lekë/litër mbi koston e importit dhe detyrimet e paguara në doganë. Ky marzh mbulon shpenzimet operative, shpenzimet e inbotilimit, si dhe shpenzimet e ambalazhimit, kur ky produkt importohet i hapur dhe ambalazhohet në vend.

b) Marzhi i tregtimit të transportuesit, i cili mund të jetë shitësi me shumicë, shitësi me pakicë apo palë të treta, nga magazina e shitësit me

shumicë te magazina e shitësit me pakicë është 2 lekë/litër mbi çmimin e llogaritur, sipas germës “a” të këtij paragrafi.

c) Marzhi i tregtimit të shitjes në njësitë e tregtimit me pakicë të produktit vaj luledielli është 4 lekë/litër mbi çmimin e llogaritur, sipas germës “a” të këtij paragrafi plus transportin, sipas germës “b” të këtij paragrafi.

6. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha subjektet që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet e përcaktuara në këtë vendim.

7. Në pasqyrën nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi jepen të dhënat, në lidhje me përlogaritjet e çmimit tavan të tregtimit, sipas marzheve të përcaktuara në këtë vendim.

8. Administrata Tatimore monitoron tregun nëpërmjet verifikimit të faturave të lëshuara nga subjektet gjatë periudhës së situatës së veçantë të krijuar në treg dhe raporton pranë Bordit çdo muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës të periudhës raportuese.

9. Ky vendim hyn në fuqi në datë 10.6.2022 dhe i shtrin efektet deri në mbledhjen e ardhshme të Bordit. Ky vendim do të publikohet në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat dhe ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

Kryetar: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Frida Krifca, Ceno Klosi, Irfan Tarelli, Genti Gazheli, Jeta Deda, Nikolla Lera, Fuad Haxhiymeri, Vjollca Ferra, Elona Hametaj Mema, Gentian Celo, Majlinda Bajraktari, . Ermal Babameto

Pasqyra nr. 1

Përshkrimi	Kostoja mesatare e ponderuar në import dhe pagesa në doganë (zhdoganimit 1-9 qershor 2022)	Marzhi në import/shumicë	Marzhi me shumicë (importuesi i ndryshëm nga shitësi me shumicë)	Marzhi i transportuesit	Marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë	Çmimi tavan në njësitë e tregtimit me pakicë	Sqarime
Oriz kokërrgjatë	85 lekë/kg	11 lekë/kg		2 lekë/kg	3 lekë/kg	101 lekë/kg	Marzhi i shumicës mbulon kostot e ambalazhimit, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operationale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar. Çmimi tavan i tregtimit për këtë produkt do të jetë 101 lekë/kg.



Sheqer	84 lekë/kg	6 lekë/kg	9 lekë/kg	2 lekë/kg	3 lekë/kg	104 lekë/kg	Marzhi i shumicës mbulon kostot e ambalazhimit, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operationale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar. Çmimi tavan i tregimit për këtë produkt do të jetë 104 lekë/kg.
Miell	82.5 lekë/kg	32% kosto përpunimi + 2.5 lekë/kg		2,5 lekë/kg	2.5 lekë/kg	90 lekë/kg	Marzhi i shumicës mbulon kostot e përpunimit të grurit dhe prodhimit të miellit, ambalazhimit, firot ligjore, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operationale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar. Çmimi tavan i tregimit për këtë produkt do të jetë 90 lekë/kg.
Vaj luledielli		35 lekë/litër		2 lekë/litër	4 lekë/litër		Marzhi i shumicës mbulon kostot e imbotilimit, ambalazhimit, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operationale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar. Për shkak se operatorë të ndryshëm kanë diferenca të ndjeshme në çmimet e blerjes në import të vajit të lulediellit, nuk do të aplikohet kosto mesatare e ponderuar e zhdoganimeve dhe nuk do të përcaktohet çmim i unifikuar shitje nga çdo subjekt, por çdo importues i vajit të imbotiluar apo importues vajit që e imbotilon dhe e paketon në vend, do të aplikojë marzhin e lejuar mbi koston e importimit të produktit të tyre, sipas deklaratës doganore për çdo parti importi, sipas marzheve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij vendimi.

VENDIM**Nr. 7, datë 27.6.2022**

**PËR MIRATIMIN E MARZHEVE NË
BAZË TË MONITORIMIT TË ÇMIMEVE
PËR PRODUKTET USHQIMORE BAZË
DHE PRODUKTET E TJERA TË
LIDHURA ME TO, SI PASOJË E
SITUATËS SË VEÇANTË TË KRIJUAR
NË TREG**

Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregimit me Shumicë/Pakicë të Produkteve Ushqimore Bazë dhe Produkteve të Tjera të Lidhura me To, në zbatim të aktit normativ nr. 7, datë 18.3.2022, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”,

VENDOSI:

1. Miratimin e marzheve që do të aplikohet për produktin ushqimor bazë sheqer, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar nga rritja e çmimeve ndërkombëtare.

2. Për artikullin sheqer (1 kg) miratohen marzhet, si më poshtë:

a) Marzhi tavan i tregimit të shitjes me shumicë të sheqerit nga importuesi dhe ambalazhuesi është 15 lekë/kg (6 lekë/kg për importuesin dhe 9 lekë/kg për ambalazhuesin) mbi koston e importit plus detyrimet e paguara në doganë.

b) Marzhi i tregimit të transportuesit i cili mund të jetë shitësi me shumicë, shitësi me pakicë apo palë të treta, nga magazina e shitësit me shumicë të magazinës së shitësit me pakicë është 2 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur sipas gërmës “a” të këtij paragrafi.



c) Marzhi i tregtimit të shitjes në njësitë e tregtimit me pakicë të produktit sheqer është 3 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur sipas germës “a” të këtij paragrafi plus transportin, sipas germës “b” të këtij paragrafi.

3. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha subjektet, që tregtojnë me shumicë/pakicë produktin e përcaktuara në këtë vendim.

4. Në pasqyrën nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi jepen të dhënat në lidhje me përlllogaritjet e çmimit tavan të tregtimit, sipas marzheve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi në datë 27.6.2022 dhe i shtrin efektet deri në mbledhjen e ardhshme të Bordit. Ky vendim do të publikohet në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat dhe ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

Kryetar: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Frida Krifca, Ceno Klosi, Irfan Tarelli, Genti Gazheli, Jeta Deda, Nikolla Lera, Fuad Haxhiymeri, Vjollca Ferra, Elona Hametaj Mema, Gentian Celo, Majlinda Bajraktari, Ermal Babameto

Pasqyra nr. 1.

Përshkrimi	Kostoja mesatare e ponderuar në import dhe pagesa në doganë (zhdoganimit 10–24 qershor 2022)	Marzhi në import/shumicë	Marzhi me shumicë (importuesi i ndryshëm nga shitësi me shumicë)	Marzhi i transportuesit	Marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë	Çmimi tavan në njësitë e tregtimit me pakicë	Sqarime
Sheqer	94 lekë/kg	6 lekë/kg	9 lekë/kg	2 lekë/kg	3 lekë/kg	114 lekë/kg	Marzhi i shumicës mbulon kostot e ambalazhimit si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operacionale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar. Çmimi tavan i tregtimit për këtë produkt do të jetë 114 lekë/kg.

VENDIM

Nr. 166, datë 28.6.2022

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA DIELLI, ME FUQI TË INSTALUAR DERI 2 mw, PËR VITIN 2022

Në mbështetje të nenit 10, pika 2, 16 dhe 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë, nga burimet e rinovueshme”; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; VKM-së nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, Faqe| 13616

2019–2020”, të ndryshuar dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s; në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/8 prot., datë 24.6.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 mw për vitin 2022”,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në bazë të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë



elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 14.2.2022, vendosi fillimin e procedurës, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022”.

- ERE, me shkresën nr. 342 prot., datë 2.3.2022, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetin e Konkurrencës (AK), ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (ASHZHI), si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL), lidhur me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022.

- MIE, me anë të shkresës nr. 2842 prot., datë 1.4.2022, është shprehur, se, bazuar në VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, për vitin 2022, ka miratuar ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet 2 mw për 5 subjekte.

- Gjithashtu, me anë të shkresë së sipërcituar, MIE ka përcjellë për referencë planet e biznesit të paraqitura nga subjektet mbajtëse të miratimit përfundimtar.

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, ka përcaktuar kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur. Në themel të metodologjisë së miratuar me VKM-në e lartpërmendur është llogaritja e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nëpërmjet formulës llogaritëse të LCOE-së (kosto e niveluar e energjisë elektrike).

- Çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga

dielli, me fuqi të instaluar deri 2 mw, është një çmim mesatar dhe si i tillë, në vijim dhe të praktikave të viteve të mëparshme, të gjithë komponentët përlllogaritës të këtij çmimi janë të mesatarizuar.

- Për llogaritjen e LCOE-së janë marrë në konsideratë të dhëna mbi komponentët përbërës të nevojshëm, nga burimet, si më poshtë vijon:

- Planet e biznesit të shoqërive mbajtëse të miratimit përfundimtar, siç përcillet nga MIE (kostoja e investimit, shpenzimet operative, degradimi vjetor i prodhimit, jetëgjatësia e inverterit);

- VKM-ja nr. 580, datë 28.8.2019, “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020”, i ndryshuar (kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit, periudha e mbështetjes dhe orët mesatare të punës);

- Studimi i IEA-s (*International Energy Agency-Renewables 2021 Analysis and forecast to 2026*);

- Studimi i MDPI-së – Një rishikim i degradimit të moduleve fotovoltaike për jetëgjatësinë (*A Review of the Degradation of Photovoltaic Modules for Life Expectancy*).

- Në zbatim të sa më sipër dhe nisur nga eksperiencia e krijuar për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet prodhuese fotovoltaike deri në 2 mw dhe eolike deri në 3 mw, në periudhat e mëparshme, është llogaritur çmimi i blerjes së energjisë të prodhuar nga impiantet fotovoltaike për vitin 2022, duke përdorur modelin e *Exvel-it* të hartuar nga AGORA në studimin e saj për Shqipërinë.

- Në kontratat respektive midis subjekteve mbajtëse të miratimit përfundimtar dhe MIE-s përcaktohet se vlerësimi i investimeve mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve, në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit për ndërtimin e parkut eolik, si dhe MIE, bazuar në raportin përfundimtar të testimit dhe pas paraqitjes nga mbajtësit e miratimit përfundimtar të raportit të plotë të shpenzimeve për ndërtimit e veprës, lëshon certifikatën e pranimi të veprës, sipas legjislacionit në fuqi.

1.Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike me



kapacitet të instaluar deri në 2 mw prej 97.21 eurosh/mwh, për vitin 2022.

2. Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga ERE.

3. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM **Nr. 167, datë 28.6.2022**

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SALILLARI ENERGY TRADE” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 935/5 prot., datë 23.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy

Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 90, datë 28.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE, me shkresën nr. 70/15 prot., datë 29.4.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.5.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Me shkresën nr. 469/2 prot., datë 6.5.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 469/5 prot., datë 20.5.2022 dhe nr. 495/6 prot., datë 24.5.2022, ka përcjellë në ERE dokumentacionin dhe informacionin shtesë.

- Në kuptim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 149, datë 10.6.2022, shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k. duhej të depozitonte në ERE, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijani e vendimit, vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sikurse përcaktohet në nenin 9, pika 2, germa “d”, të rregullores së sipërcituar.

- Brenda afatit të përcaktuar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 470/2 prot., datë 20.6.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë për furnizimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin, si vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”;



- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “e”;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h” dhe “i”.

- Për sa u përket kërkesave të nenit 9, pika 2, gjerat “d”, lind nevoja që shoqëria të informojë ERE-n çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor.

- Për sa u përket kërkesave të nenit 9, pika 4.7, gjerat “e”, referuar marrëveshjes së përcjellë nga shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k., të lidhur me shoqërinë mëmë, ku përcaktohet që kjo e fundit merr përsipër që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme, që me stafin dhe mjetet e saj të instalojë sistemin IT në fushën e energjisë për këtë shoqëri, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë së licencuar të depozitojë në ERE informacion mbi instalimin konkret të këtij sistemi.

- Për sa u përket kërkesave të nenit 9, pika 4.7, gjerat “g”, që ka të bëjë me dokumentacionin që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’u ofrohen klientëve, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë depozitimi jo më vonë se data 1.3.2023, të kontratës së rinovuar së disponimit të zyrave për shërbimet që do t’u ofrohen klientëve (data e fundit e vlefshmërisë së saj).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Përpara fillimit të operimit të veprimtarisë së licencuar, shoqëria të informojë ERE-n mbi implementimin konkret të sistemit IT.

3. Shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k. të informojë ERE-n, çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në përfundim të këtij procesi.

4. Shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për disponimin e zyrave, brenda datës 1.3.2023.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 168, datë 28.6.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SALILLARI ENERGY TRADE” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gjerat “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neni 4, pika 1, gjerat “e”, neni 5, pika 1, gjerat “e”, neni 13 dhe neni 14, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neni 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 935/4 prot., datë 23.6.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 20.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade”



sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE, me shkresën nr. 70/13 prot., datë 22.4.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 10.5.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Me shkresën nr. 469/1 prot., datë 27.4.2022, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin dhe informacionin shtesë me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 469/3 prot., datë 11.5.2022, dhe nr. 495/6 prot., datë 24.5.2022.

- Në kuptim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.6.2022, shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k. duhej të depozitonte në ERE, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, siç përcaktohet në nenin 9, pika 2, germa “d”, të rregullores së sipërcituar.

- Brenda afatit të përcaktuar, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 470/2 prot., datë 20.6.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin, si vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “e”;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b” dhe “c”.

- Për sa u përket kërkesave të nenit 9, pika 2, germa “d”, të informojë ERE-n, çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Salillari Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Shoqëria “Salillari Energy Trade” sh.p.k. të informojë ERE-n, çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në përfundim të këtij procesi.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 169, datë 28.6.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NRG POWER” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1, 3 dhe 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”,



të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/2 prot., datë 21.6.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

Shoqëria “NRG Power” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674 prot., datë 12.5.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 131, datë 31.5.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për shkak se në aplikimin e shoqërisë mungonte një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit, në objektin e veprimtarisë së saj nuk ishte i përcaktuar, furnizimi i energjisë elektrike, veprimtari për të cilën kërkon të licencohet, ndaj u vlerësua të mos fillojë procedura për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim, me shkresën nr. 674/1 prot., datë 6.6.2022, ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen si më sipër, duke i dhënë udhëzimet përkatëse, në zbatim të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe sqaroi shoqërinë, se, në rast se do të sillte një aplikim të ri për licencim, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsideroheshin të vlefshme për aplikimin e ri.

- Shoqëria “NRG Power” sh.p.k., brenda afatit 1-mujor, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674/2 prot., datë 10.6.2022, ka riparaqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duke depozituar dhe dokumentacionin shtesë.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për llogari të ERE-së, bazuar në përcaktimet e aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të rregullores, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin, si vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e” dhe “g”;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”.

- Rezulton se nuk është plotësuar ende dokumentacioni si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim – neni 9, pika 1:

- germa “c” (të dhëna për aplikuesin).

- Shoqëria duhet të plotësojë formularin me deklaratat përkatëse, në lidhje me njohjen me kuadrin ligjor dhe angazhimin për zbatimin e tij.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2:

- germa “d” (Vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

- Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e gjykatës për administratorin e saj.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.7:

- germa “e” (Sistemin IT i krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi).

- Shoqëria duhet të depozitojë sistemin IT.

- germa “h” (Të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar).



- Shoqëria duhet të paraqesë në ERE informacion në lidhje me klientët dhe energjinë e furnizuar.

- germa “i” (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët).

- Shoqëria duhet të paraqesë informacion për sa kërkon kjo pikë e rregullores.

- Në vijim të vendimit të Bordit nr. 131/2022, për mosfillimin e procedurës për licencim e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, rezulton se ajo ka depozituar brenda afatit të përcaktuar informacion dhe dokumentacion plotësues, i cili konsiderohet i mjaftueshëm për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 170, datë 28.6.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA HYDROPOWER” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1 germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/3 prot., datë 23.6.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Egnatia Hydropower’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 121, datë 24.5.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shkak se në aplikimin e shoqërisë mungonte një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit.

- Me shkresën nr. 636/1 prot., datë 6.6.2022, ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen si më sipër, duke i dhënë udhëzimet përkatëse në zbatim të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, duke shpjeguar, se, në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri për licencim, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për aplikimin e ri.



- Në përgjigje të sa më sipër (brenda afatit 1-mujor të përcaktuar në rregullore), me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 636/2 prot., datë 10.6.2022, shoqëria ka riparaqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke depozituar dhe dokumentacion shtesë.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “d”;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, germa “c”.

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2:

- germa “d” (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata); shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimet e Prokurorisë dhe të Gjykatës për përfaqësuesin e saj ligjor, në bazë të nenit 7, pika 2, germa “b”, të rregullores së licencimit.

- germa “e” (Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse); shoqëria duhet të informojë ERE-n për departamentin që do të merret për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8:

- germat “a” (Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në gwh/sipas viteve). Shoqëria duhet të dokumentojë sasitë e

parashikuara për t’u tregtuar për pesë vitet e licencës.

- germa “b” (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi vlerën që do të vendosë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 121/2022, për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, rezulton se ajo ka depozituar brenda afatit të përcaktuar informacion dhe dokumentacion plotësues, i cili konsiderohet i mjaftueshëm për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 171, datë 28.6.2022

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT,
QË KONTROLLON INTERESAT E
SHOQËRISË “M.T.C. ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, nenit 7 dhe nenit 9, pikat 4 dhe 5, dhe 8, si dhe nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/6 prot., datë 23.6.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë M.T.C. Energy sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “M.T.C. Energy” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 20, datë 21.3.2014, për një afat 30-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 646 prot., datë 6.5.2022, shoqëria ka paraqitur aplikimin për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, nëpërmjet shitjes së 80% të kuotave të zotëruara nga “Radove Energy Capital LTD”, te “Hydrogy Holdings Single Member” S.A.

- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezultoi se dokumentacioni nuk ishte i plotë dhe po ashtu kishte nevojë për të sqaruar më tej një pjesë të dokumentacionit të këtij aplikimi, ndaj në datën 7.6.2022, u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqërinë, në vijim të së cilës, me shkresën e

protokolluar në ERE me nr. 646/5 prot., datë 7.6.2022, shoqëria ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “M.T.C. Energy” sh.p.k. rezultoi se ajo ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria “M.T.C. Energy” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Në vijim të dhënies së autorizimit, në zbatim të pikës 8 të nenit 9 të “Rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së”, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi i këtij transferimi në të.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k.

2. Ortaku kryesor i shoqërisë “M.T.C. Energy” sh.p.k., me 80% të kuotave të kapitalit, bëhet shoqëria “Hydrogy Holdings Single Member” S.A.

3. Shoqëria “M.T.C. Energy” sh.p.k. të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi i këtij transferimi në të.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,



brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 173, datë 7.7.2022

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN QERSHOR 2022

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/7 prot., datë 5.7.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2022”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me shkresën nr. 4801 prot., datë 1.07.2022, protokolluar në ERE me nr. 886/2 prot., datë 4.7.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 31,84 lekë/kwh për muajin qershor 2022, në të cilin është përfshirë edhe kosto e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 4707 prot., datë 28.6.2022, protokolluar në ERE me nr.

1035 prot., datë 30.6.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18,34 lekësh/kwh për muajin qershor 2022, në të cilin është përfshirë edhe kostoja e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV, 10 kV, si dhe 6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Mbështetur në nenin 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin nr. 201 të bOrdit të ERE-s, datë 4.12.2017, e ndryshuar: tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Kostot e disbalancave do të llogariten dhe faturohen nga shoqëria, në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut të Balancimit dhe akteve të tjera në fuqi.

- Në lidhje me komponentët e tjerë të përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF për muajin qershor 2022, evidentojmë, se në përputhje me nenin 9 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2022 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja për muajin qershor 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse, si vijon:



Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për nivele tensioni për muajin Qershor 2022				
QERSHOR 2022			Nivelet e tensionit	
			35 kV	20/10/6 kV
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	27.47	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.82	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh	31.75	18.26

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2022 do të jetë:

- 31,75 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;

- 18,26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2022, prej:

- 31,75 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;

- 18,26 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 174, datë 7.7.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OST SHA PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË ASETEVE TË INVESTIMIT TË KRYER NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “SUPPLY AND INSTALATION OF TRANSMISSION METER/DATA CENTER” NGA OST SHA TEK OSHEE GROUP SHA

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; pika 1.3 e “Licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”, si dhe neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016, si dhe nenit 19, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/6 prot., datë 4.7.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/data center” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.”,

konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Trasmetimit (OST) sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 944 prot., datë 20.6.2022, ka paraqitur kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve të



investimit të kryer nga zbatimi i projektit “*Supply and Instalation of Transmission Meter/data center*” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë, në zbatim të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se dokumentacioni për qëllim të këtij aplikimi është plotësuar, si më poshtë:

Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, pikat 3, 4 dhe 6.

Shoqëria OST sh.a. duhet të sjellë listën e detajuar të aseteve, e cila duhet të jetë pjesë integrale e marrëveshjes së lidhur me OSHEE sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “*Supply and Instalation of Transmission Meter/data center*” nga OST sh.a. tek OSHEE Group sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 175, datë 7.7.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “M&K ENERGY TRADING CO” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/3 prot., datë 1.7.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “M&K Energy Trading Co” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “M&K Energy Trading Co” sh.p.k., me shkresën nr. 964 prot., datë 24.6.2022, ka përcjellë në ERE aplikimin e saj për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe



pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionit teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germat “a”, “b”;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”.

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germa “c” dhe neni 9, pika 4.8, germa “b”;

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE deklaratën e ortakëve të saj për konfirmimin e mbështetjes financiare për këtë veprimtari.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “M&K Energy Trading Co” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 176, datë 7.7.2022

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 144, DATË 6.6.2022, “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 415, SERIA P18K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGIJËS ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË ‘BLAC ENERGY’ SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 157, DATË 9.7.2018”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 95 dhe nenit 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 7, 8 dhe 9 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/1 prot., datë 30.6.2022, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.6.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 144, datë 6.6.2022, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018.

- Ky vendim u mor për arsye se shoqëria “Blac Energy” sh.p.k. nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2021 për licencën në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike e po ashtu nuk kishte depozituar në



ERE asnjë dokument apo argument, në lidhje me mos zbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 515/1 prot., datë 10.6.2022, shoqëria është njoftuar për vendimarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (*statement*) të ERE-s rezultoi se kjo debi është shlyer më datë 20.6.2022.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezultoi se shoqëria i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitore ndaj ERE-s.

- Në nenin 8 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet, se pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari dhe do t'i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës, në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d” të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

- Në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet, se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast, “qëllimi” i procedurës, lidhet ngushtësisht me marrjen e masave administrative, kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimarrjen. Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të dispozitës së mësipërme, është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% të vlerës së debisë nga shoqëria “Blac Energy” sh.p.k.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesës së prapambetur, faktori ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi në marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: “Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj Rregulloreje, Bordi do të vendosë, për: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.6.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Blac Energy’ sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 144, datë 6.6.2022, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë ‘Blac Energy’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018”.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Blac Energy” sh.p.k për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**KËRKESË****Nr. 132/8, datë 25.7.2022****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i linjës 110 kV, Burrel–Bulqizë’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do

të kompensohen, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “arë”.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 218 208 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



LISTA EMËRORE PARAPRAKE PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTT 'NDËRTIMI I LINJËS 110 KV, BURREL–BULQIZË’”

NR	NR. Shtyllë	PRONARI			Të dhëna Qytet	TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				VLERA TOTALE (Eke)	SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)			
		Emri	Adresa	Mbiemri		L. Ndërtim	Nr. pastrim	Lloji pastrim	Sipërfaqja Totale	"M" (m ²)	"T" (m ²)	"N" (m ²)	Volumi	Tipe	Sipërfaqja (m ²)	C (m ² /ëkë)	V (ëkë)	Y	Z					
1	1	Shtet	German		German	1705	238/3	Kullote	167250	72.3					72.3			0	0	Fshati German/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
2	2	Shtet	German		German	1705	230/22	Are	850	31.6					31.6			0	0	Fshati German/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
3	3	Shtet	Midhe		Midhe	2688	227	Veshit	15000	38.4					38.4			0	0	Fshati Midhe/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
4	4	Shtet	Midhe		Midhe	2688	226/1	Pyll	171600	54.8					54.8			0	0	Fshati Midhe/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
5	5	Shtet	Midhe		Midhe	2688	226/1	Pyll	171600	91.4					91.4			0	0	Fshati Midhe/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
6	6	Shtet	Midhe		Midhe	2688	226/1	Pyll	171600	38.4					38.4			0	0	Fshati Midhe/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
7	7	Shtet	Midhe		Midhe	2688	223	Veshit	113400	38.4					38.4			0	0	Fshati Midhe/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
8	8	Shtet	Midhe		Midhe	2688	212	Pyll	27400	62.4					62.4			0	0	Fshati Midhe/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
9	9	Shtet	Midhe		Midhe	2688	213	Are	93600	46.2					46.2			0	0	Fshati Midhe/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
10	10	Shtet	Midhe		Midhe	2688	221	Are	30000	72.3					72.3			0	0	Fshati Midhe/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
11	11	B P Familja Lami	Fshat Burrel		Fshat Burrel	1325	27166	Are	1917	38.4					38.4	114	4382	4382	0	Fshati Burrel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
12	12	Shtet	Fshat Burrel		Fshat Burrel	1325	509/5	Are	5845	143.0					143.0			0	0	Fshati Burrel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
13	13	Shtet	Fshat Burrel		Fshat Burrel	1325	598	PF	13000	54.0					54.0			0	0	Fshati Burrel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
14	14	Shtet	Fshat Burrel		Fshat Burrel	1325	509/1	Pemto	5660	38.4					38.4			0	0	Fshati Burrel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
15	15	Shtet	Fshat Burrel		Fshat Burrel	1325	684	Are	35200	54.0					54.0			0	0	Fshati Burrel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
16	16	Shtet	Fshat Burrel		Fshat Burrel	1325	687	Are	39100	38.4					38.4			0	0	Fshati Burrel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
17	17	Shtet	Fshat Burrel		Fshat Burrel	1325	686	Pyll	6600	31.6					31.6			0	0	Fshati Burrel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
18	18	Almet	Hysen	Lika	Bater e Vogel	1126	801	Are	500	31.6					31.6	114	3601	3601	0	Fshati Bater e Vogel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
19	19	Naze	Ibrahim	Collaku	Bater e Vogel	1126	52/2	Are	3550	74.0					74.0	114	8431	8431	0	Fshati Bater e Vogel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
20	20	Hakik	Qerim	Pasha	Bater e Vogel	1126	55/9	Are	4690	46.2					46.2	114	5271	5271	0	Fshati Bater e Vogel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
21	21	Shaqir	Tahir	Bashit	Bater e Vogel	1126	16/10	Are	1310	46.2					46.2	114	5271	5271	0	Fshati Bater e Vogel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
22	22	Nebi	Hysen	Miftari	Bater e Vogel	1126	37/45	Are	6125	46.2					46.2	114	5271	5271	0	Fshati Bater e Vogel/Nj A Komsi/Bashkia Mat				
23	23	B P Familja Gjoka & Rustem	Dom		Dom	1507	12/1/1	Are	14500	72.3					72.3	114	8237	8237	0	Fshati Dom/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
24	24	B P Familja Gjoka	Dom		Dom	1507	12/1/2	Are	13500	38.4					38.4	114	4382	4382	0	Fshati Dom/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
25	25	Altman	Qamil	Leshi	Dom	1507	45/2/2	Are	3880	46.2					46.2	114	5271	5271	0	Fshati Dom/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
26	26	Shtet	Dom		Dom	1507	45/2/6	Are	3000	54.8					54.8			0	0	Fshati Dom/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
27	27	Shtet	Veli	Ceni	Kujtim	2312	272/3	Are	1500	38.4					38.4	114	4382	4382	0	Fshati Kujtim/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
28	28	Shtet	Tahir	Kerciku	Kujtim	2312	273/1/3	Are	3300	43.82					43.82	114	4382	4382	0	Fshati Kujtim/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
29	29	Qamil	Garra B P		Kujtim	2312	331/1/2	Are	2250	24.1					24.1	114	2747	2747	0	Fshati Kujtim/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
30	30	Lulzim	Hasan	Garra	Kujtim	2312	331/1/3	Are	2200	20.9					20.9	114	3409	3409	0	Fshati Kujtim/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
31	31	Shtet			Kujtim	2312	401/3	PF	5950	94.1					94.1			0	0	Fshati Kujtim/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
32	32	Sami	Shaqir	Ndregjona	Kujtim	2312	414/2/2	Are	1000	74.0					74.0	114	8431	8431	0	Fshati Kujtim/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
33	33	Shtet			Shulbater	3439	523	Pyll	78200	179.6					179.6			0	0	Fshati Shulbater/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
34	34	Shtet			Shulbater	3439	523	Pyll	78200	179.6					179.6			0	0	Fshati Shulbater/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
35	35	Ismael	Hasan	Gjini	Shulbater	3439	525/1/4	Are	6750	106.1					106.1	114	12094	12094	0	Fshati Shulbater/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
36	36	B P Familja Muga	Bershi		Bershi	1164	11/4	Are	7250	125.4					125.4	114	14300	14300	0	Fshati Bershi/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
37	37	Shtet	Bershi		Bershi	1164	12	Pyll	48950	46.2					46.2			0	0	Fshati Bershi/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
38	38	Shtet	Bershi		Bershi	1164	450	Kanal	3000	38.4					38.4			0	0	Fshati Bershi/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
39	39	Seit	Sadik	Hasa	Bershi	1164	90/1	Are	11320	70.7					70.7	114	8063	8063	0	Fshati Bershi/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
40	40	Shtet			Fullqet	1651	81	Are	5150	143.0					143.0			0	0	Fshati Fullqet/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
41	41	Featon	Riza	Dardhu	Fullqet	1651	189/1	Are	1800	70.7					70.7	114	8063	8063	0	Fshati Fullqet/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
42	42	Shtet			Fullqet	1651	248	Are	5800	54.0					54.0			0	0	Fshati Fullqet/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
43	43	Faik	Abdullah	Jahja	Fullqet	1651	269	Are	3800	70.7					70.7	114	8063	8063	0	Fshati Fullqet/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
44	44	Sami	Harush	Bala	Plesh	2990	124/8	Are	2600	70.7					70.7	114	8063	8063	0	Fshati Plesh/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
45	45	Tite	Ali	Musta	Plesh	2990	159/2/10	Are	4000	70.7					70.7	114	8063	8063	0	Fshati Plesh/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
46	46	Agrom	Masar	Cela	Plesh	2990	237/3	Are	6050	179.6					179.6	114	20474	20474	0	Fshati Plesh/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
47	47	Agrom	Masar	Cela	Plesh	2990	175/6	Are	11750	179.6					179.6	114	20470	20470	0	Fshati Plesh/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
48	48	Shtet	Bejni		Bejni	1137	45/8	Are	10000	62.4					62.4	114	7115	7115	0	Fshati Bejni/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
49	49	Shtet	Bejni		Bejni	1137	76/2	Pemto	50000	46.2					46.2			0	0	Fshati Bejni/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
50	50	B P Familja Lleshi	Klos - Katund		Klos - Katund	2164	71	Are	4200	54.0					54.0	114	6159	6159	0	Fshati Klos Katund/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
51	51	Shtet	Klos - Katund		Klos - Katund	2164	13	Pyll	63600	54.8					54.8			0	0	Fshati Klos Katund/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
52	52	Shtet	Klos - Katund		Klos - Katund	2164	114	Are	3400	70.7					70.7			0	0	Fshati Klos Katund/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
53	53	Shtet	Klos - Katund		Klos - Katund	2164	99	PF	8650	38.4					38.4			0	0	Fshati Klos Katund/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
54	54	Shtet	Klos - Katund		Klos - Katund	2164	80	Pyll	200500	54.8					54.8			0	0	Fshati Klos Katund/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
55	55	Shtet	Klos - Katund		Klos - Katund	2164	80	Pyll	200500	62.4					62.4			0	0	Fshati Klos Katund/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
56	56	Shtet	Klos - Katund		Klos - Katund	2164	80	Pyll	200500	38.4					38.4			0	0	Fshati Klos Katund/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
57	57	Shtet	Klos - Katund		Klos - Katund	2164	182	PF	125300	54.8					54.8			0	0	Fshati Klos Katund/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
58	58	Shtet	Klos - Katund		Klos - Katund	2164	76	PF	753300	46.2					46.2			0	0	Fshati Klos Katund/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
59	59	Shtet	Klos - Katund		Klos - Katund	2164	76	PF	753300	62.4					62.4			0	0	Fshati Klos Katund/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
60	60	Plan I Bardhe	Plan I Bardhe		Plan I Bardhe	2982	2	Pyll	1281500	54.0					54.0			0	0	Fshati Plan I Bardhe/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
61	61	Shtet	Plan I Bardhe		Plan I Bardhe	2982	70/6	Are	1100	72.3					72.3			0	0	Fshati Plan I Bardhe/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
62	62	Kujtim	Bajram	Almet	Plan I Bardhe	2982	75/4	Are	1100	54.0					54.0	114	6159	6159	0	Fshati Plan I Bardhe/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
63	63	Shtet	Plan I Bardhe		Plan I Bardhe	2982	65	Pemto	379800	46.2					46.2			0	0	Fshati Plan I Bardhe/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
64	64	Nalje	Sali	Kurti	Plan I Bardhe	2982	225/2	Are	2600	38.4					38.4	114	4382	4382	0	Fshati Plan I Bardhe/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
65	65	Shtet	Plan I Bardhe		Plan I Bardhe	2982	221/3	Are	1000	54.8					54.8			0	0	Fshati Plan I Bardhe/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
66	66	Aishe	Hysen	Allushi	Plan I Bardhe	2982	218/6	Are	1150	62.4					62.4	114	7115	7115	0	Fshati Plan I Bardhe/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
67	67	Shtet	Plan I Bardhe		Plan I Bardhe	2982	215/3	Are	1150	38.4					38.4			0	0	Fshati Plan I Bardhe/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
68	68	Hasan	Selman	Losha	Plan I Bardhe	2982	160/8	Are	6300	54.0					54.0	114	6159	6159	0	Fshati Plan I Bardhe/Nj A Kurri/Bashkia Klos				
69	69	Shtet	Plan I Bardhe		Plan I Bardhe	2982	176/2	Are	1300															

**KËRKESË****Nr. 228/6, datë 25.7.2022****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV Valias””.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë pronë private, të cilat do të

kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “tokë arë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,728.384 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni**

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 kV VALIAS”

Nr	Te dhena per pronesine								Sip. shpronësimit m ²	Vlera e shpronësimit në Lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në Lekë	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Bashkia	Nr. Kadastral	Nr. Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia Sip pronës m ²				
1	DEVIJE DHE KRISTINA		BUSHI	Kamez	2066	80/19	Are	4,200.00	1,740.00	448.00	779,520.00	Konfirmuar ASHK
2	RAMAZAN DHE SAJMIR	SAMI	BUSHI	Kamez	2066	80/37	Are	1,700.00	443.00	448.00	198,464.00	Konfirmuar ASHK
3	ARBEN	SAMI	BUSHI	Kamez	2066	80/38	Are	1,200.00	258.00	448.00	115,584.00	Konfirmuar ASHK
4	VJOLLCA	SAMI	BUSHI	Kamez	2066	80/39	Are	2,600.00	1,417.00	448.00	634,816.00	Konfirmuar ASHK
	SHUMA								3,858.00		1,728,384.00	

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 280(1630), datë 27.4.2022. vendosi pranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesja shoqata “Opera della Divina Provvidenza Madonnina del Grappa”, me seli në Shkodër, me president Vincenzo Russo; kufizimin e zotësisë për të vepruar të shtetases Kristina Llazo Zhulati, e lindur më datë 30.11.1981, në Sarandë, banuese në Sarandë me vendqëndrim në Shkodër, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e shoqatës “Opera della Divina Provvidenza Madonnina del Grappa”.

KËRKESË

Shtetasja Suzana Çobani, e datëlindjes 13.7.1949, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen e vdekjes së shtetasit Mazar Pustina, i datëlindjes 10.6.1910, lindur në Dibër dhe me vendbanimin e fundit në Tiranë.

**KËRKUESE
Suzana Çobani**

KËRKESË

Shtetasja Sadete Halebi (Zhegu), e datëlindjes 11.4.1963, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të zhdukur të shtetasit Halil Zhegu, i datëlindjes 30.4.1924.

**KËRKUESE
Sadete Halebi (Zhegu)**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 736 lekë